


Muharrem Xhufi

BIBLIOTEKA

8SH - 94

XH 94



Kalen  
ditësh të zjarr


*9 + 91  
x 11 91*

**Muharrem Xhufi**

# **Kalendar Ditësh të Zjarra**

*Episode partizane*

*Dedikuar të rënëve në Luftën ANÇl*



**albin  
1996**

Redaktor: Anila (Omari) Xhufi  
Art grafik: Elida Tëllezi  
Shtypur: MNS  
Botues: albin

Hyri në Shtyp: Dhjetor 1996

© Të gjitha të drejtat i takojnë autorit

## NË VEND TË HYRJES

*Lufta ANÇl përbën epopenë më të lavdishme në vargun e qëndresave të gjertanishme që u ka bërë populli shqiptar invadorëve të huaj gjatë shekujve. Libri “Kalendar ditësh të zjarra” që po u paraqitet lexuesve përmban vetëm pjesëza të asaj lufte, ashtu siç janë parë e përjetuar ato nga autorit në bazë të ditarit të asaj kohe e të para nga këndvështrimi i pozicioneve që ka patur ai gjatë periudhës së luftës si protagonist i saj, pa marrë përsipër gjëra të tepërtë dhe pa pretendimin se është thënë gjithshka.*

*Krahas dokumentave të asaj periudhe, edhe ky botim modest, mund të ndihmojë sadopak në qartësimin e disa aspekteve historike e të faktorëve realë që determinuan nevojën, karakterin, përmasat dhe triumfin e asaj lufte me të gjitha vështirësitet e mungesat që e shoqëruan atë.*

*Edhe pse jo pa ca të meta që u vunë re gjatë luftës, siç qe mosangazhimi edhe i disa forcave që mund të kontribuonin në suksesin e saj, shfaqja e një farë konservatorizmi me karakter partiak etj, meritat e rezistencës heroike të shqiptarëve kundër agresorëve më të rrezikshëm e më të fuqishëm në Europë, siç qenë fashistët italianë e nazistët gjermanë me ndihmën e bashkëpunës së tyre vendas, janë historike e të pamohueshme. Në tërësi kontributi i popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore i kaloi ndjeshëm kufijtë kombëtarë deri tek ndihma përfundimtare; prandaj dhe shkaktoi shumë keqardhje fakti kur pas mbarimit të luftës, disa prej këtyre ish aleatëve u dhanë strehim dhe morën nën mbrojtje krerët e reaksionit shqiptar të luftës, bashkëpunë-*

*Jehona e betejave partizane me okupatorët nazifashistë e vuri edhe Kordonin e Madh Antifashist përpëra domosdoshmërisë që, pavarësisht nga interesat e veçanta të secilit nga komponentët e tij karshi Shqipërisë, të njohë Frontin Nçl të Shqipërisë si aleat të tij duke bashkëvepruar me të deri në fitoren përfundimtare; prandaj dhe shkaktoi shumë keqardhje fakti kur pas mbarimit të luftës, disa prej këtyre ish aleatëve u dhanë strehim dhe morën nën mbrojtje krerët e reaksionit shqiptar të luftës, bashkëpunë-*

torë me armiqjtë tanë të përbashkët, veprim ky që e shtyri edhe udhëheqjen shqiptare të asaj kohe të anojë më tepër nga e kundërtë ekstreme.

Roli i PKSH si faktor historik i dorës së parë në organizimin dhe drejtimin e Luftës ANÇ, ishte dhe mbetet i pakontestueshëm. Ajo diti të mbështetet fort në shpirtin luftarak e liridashës të shqiptarëve aq sa edhe në ndjenjat e tyre humane si “të gjithë për një e një për të gjithë”, në kohë rreziku; këto në ditët e luftës u bënë norma sjelljeje e virtute të qëndrueshme morale edhe për partizanët. Kur ndonjeri prej partizanëve plagosej apo binte në ndonjë vështirësi tjetër, gjithë të tjerët tregoheshin të gatshëm të sakrifikonin për ta shpëtuar atë; ndërsa kur bëhej fjalë për marrjen e ushqimit, për pushim e të tjera, çdo njeri prej tyre ia linte radhën shokut. Kështu ata qenë të parët në sakrifica e të fundit në pretendime.

Populli shqiptar ka të drejtë të krenohet me sakrificat që bëri dhe me partizanët e tij trima, të cilët në ditët më të vështira që kalonte Atdheu, nuk kursyen as jetën për ta shpëtuar atë; po ashtu populli i ka mallkuar për jetë bastardët e tij që e braktisën atë pikërisht në ato ditë, duke u bashkuar me pushtuesit e huaj.

Vendosja e pluralizmit politik në Shqipëri solli një sërë të mirash e bashkë me to edhe një tok spekullimesh gjer tek tjetërsimi i disa fakteve historike, duke abuzuar në emër të demokracisë aq pa skrupull saqë edhe ndëshkimi i tradhëtisë në kohën e Luftës ANÇ nga ana e popullit shqiptar dhe e Frontit të tij NÇl, të cilësohen, në disa raste, si i paligjshëm.

Mbetet detyrë parësore për gjithë pjesëmarrësit e Luftës ANÇ si dhe për të tjerët që e përjetuan atë që t'u lenë brezave pasardhës dëshmi autentike të asaj lufte si mesazhe të qartë atdhetarizmi e krenarie kombëtare.

## Autori

# NGA VITI 1942

## I. IDETË QË NGRITËN STUHINË

*Nga propaganda në veprime konkrete, efektet e para të thirrjes së PKSH për luftë kundër pushtuesve; hovi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe popullariteti i saj.*

Ka ardhur koha të hidhemi të gjithë së bashku në betejë qe jehona e thirrjes luftarake të PKSH që po zgjonte masat popullore në ditët e pushtimit fashist të vendit. Traktet e ndryshme që shpërndaheshin dhe takimet me përsaqësuesit e saj linin gjurmë të thella. Çdo fjalë e thënë përpjihet nga populli me etje të madhe. E tërë kjo shpjegohej me gjendjen e mjerueshme që kishte pllakosur vendin dhe me dëshirën e zjarrtë për të dalë nga kjo gjendje. Atëkohë edhe në sektorët e ndryshëm të minierës së Selenicës si kudo flitej dendur për lëvizjen kryengritëse për njësitet guerile, për ekzekutimin e spiunëve të ndryshëm nëpër qytete, për luftën që e priste të gjithë popullin kundër armiqve...Të gjitha këto kishin ngjallur një ndjenjë të lartë entuziazmi midis të rinjve sa që mezi përbaheshin për të mos u rënë në sy forcave të "rendit".

### *Kontakti i parë*

Kisha dëgjuar që flitej shumë për Haredinin<sup>1)</sup> po deri atëhere nuk më ishte dhënë rasti që ta njihja nga afër.

<sup>1)</sup>Haredin Beqari, dëshmor i Luftës ANÇl

Në një mëngjes qershori kur të lashtat priteshin dita-ditës për t'u korru, babai u ngrit më herët se zakonisht nga padurimi për të kontrolluar grurin që kishte mbjellë në beliket<sup>1</sup> e Paraserit afër Selenicës. Unë gjithashtu dola për në punë si gjithmonë dhe më ra të bëja një copë rrugë bashkë me të, gjatë ecjes për në ofiçinën e minierës, që mbante nja gjysmë ore nga kasollet tonë. Babai sapo shkeli në cepin e arës, kapi disa kallinj gruri dhe i shtrën-goi në dorë, duke përshpëritur diçka nëpër dhëmbë.

- Si u gdhive xha Dino?- u dëgjua zëri nga ana e rrugës.

-O, o faleminderit Haredin, po ti si u gdhive?- ishte përgjigja.

Ktheva kokën andej nga erdhi zëri dhe pasqë një burrë të zh-dervjellëtë në ecje e sipër që po i ngadalësonte këmbët aty afër nesh, ku kalonte rruga. Dukej me moshë rrëth të 30-tave. Kur u afrua fare pranë i dukeshin qartë edhe rrobat që kishte veshur. Ato nuk ishin as si të punëtorëve, as si të fshatarëve, as ushtarake dhe as civile të mirëfillta, po një përzierje e parregullt prej të gjithave, sepse si qe njera s'qe tjetra. Ajo që mund të bashkonte të gjitha këto ishte trupi i fuqishëm që i mbante mbi vete, supet e tij të gjëra që dukeshin se mund të ngrinin çdo peshë, si dhe sytë e tij plot jetë që i jepnin një gjallëri të veçantë asaj fytyre të vrarë dhe me ca rrudha të parakohshme.

-Si duket gruri, do ta mbledhësh apo jo?- pyeti ai.

-Atë po shikoj edhe unë se kemi mbetur shumë ngushtë për bukë, po qenka akoma e butë viraneja dhe kur e shikon kështu, për dita ta bën si për inat, rri në vend- tha babai me të qeshur - veç ta mbledhim për kide.

-Si të veprosh për vete, xha Dino, kij parasysh që të më ndihmosh edhe mua.

-Mos ki merak se bashkë do ta ndajmë atë që të marrim...

Pas këtyre fjalëve babai u kthye nga unë e tha:- Ky është Haredini që të kam folur,- pastaj u kthye përsëri nga Haredini dhe shtoi:- Ky është djali im- i tha atij, fukarrallëku s'na la që të vazhdonte shkollën, tanë punon në atë makinën, ku bëhen fuçitë e serës, këtu në Selenicë.

---

1) Bileket, quheshin tokat shtetërore

-Më vjen mirë që u njoħemm,- tha Haredini, e paskemi edhe rrugën bashkë, hajde\* pra se edhe unë nxitoj.

Pasi kishim ecur një copë rrugę nē heshtje, ai qe i pari që e hapi bisedën përsëri me pyetjen:- Si tē duket puna nē ofiċinē?

-Më kerkohen tē paktēn 360 kapakē fustash nē ditē që nuk mund tē bēhen pér mē pak se 10 orē puné tē lodħëshme, pérveç kësaj pér tē gjithë këtë shoqëria italiiane paguan vetēm 18 lekē. Me ato nuk mund tē marrēsh mē tepér se 1.5 kg bukē.

-Ah, e di more vëlla e di, na ēshtë bérë jeta e padurueshme si nga matrapazet vendas, ashtu edhe nga tē huajt që janē bérë zotter nē shtëpinē tonē. Me xha Dinon i kemi qarē hallet vazhdimisht qysh se ka ardhur andej nga Progonati. S'i kish mbetur asgię nga shtëpia e katandia atje; ne e ndihmuam edhe pér ngritjen e kasolles... Po kjo gjendje s'ka pér tē zgjatur shumē kështu. Do tē kemi rastin tē bisedojmë edhe herē tē tjera, tanī mirupafshim! përfundoj ai dhe u ndamē, me që e kishte pér tē kaluar anës Selenicës, nga Qafa e Kishës pér nē madem.

-Mirupafshim!- u përgjigja dhe vazhdova tē ecja, duke përfityuar akoma atë me tē cilin sapo isha ndarë.

### ***Leximi i traktit***

Xha Kola<sup>1)</sup> e përdorte furrën edhe si restorant. Kur punētorët bënien pushimin e drekës e shkonin tē merrnin racionin e bukës, aty hanin dhe drekën nē këmbë, rrēth një tavoline tē vjetër që ishte nē cep, afér daljes. E hanim bukën si tē na vinte: thatë, me ndonjë pjatë fasule apo me ndonjë lek vaj ulliri tē hedhur përsipër e që i tregëtonte po ashtu xha Kola, së bashku me bukën.

Ishte koha e pushimit tē drekës mē 23 nëntor, kur na u dha shenja pér një mbledhje tē fshehtë. Ne tē ofiċinës, që ishim mē afér, ia mbërritëm mē shpejt. Në fillim u bë edhe pak zhurmë nga kurioziteti që kishim. Xha Kola dukej ca i shqetësuar nga posta e karabinierëve tē Selenicës që ishte fare afér. Ai vinte vërdallë nëpér

---

1) Kolë Jani, furrëxhi nē qytezën punētore Selenicë.

furrë, herë duke na u lutur që të mbanim qetësi, herë duke nxjerë kokën në drejtim të postkomandës për t'u siguruar se mos na diktonin e na zinin aty brenda. Më në fund u vendos qetësia. Haredini u ngrit ashtu thjesht siç ishte dhe, pasi hapi mbledhjen, ma dha traktatin që ta lexoja, për më shpejt. Trakti niste me inicialet: "VF LP" dhe vazhdonte me thirrjen drejtar popullit të Vlorës nga Qarkori i PKSH me rastin e 28 nëntorit.

Leximi u dëgjua me kujdes sidomos ajo faqe e traktit, ku riprodhoj një pjesë e gazetës "Zëri i Popullit". Aty thuhet: "Neve komunistët, pjella e këtij populli po luftojmë okupatorët dhe veglat e tij...përpara shokë me gjithë populin, me turmat punëtore e fshatare...për një luftë të vërtetë kundra okupatorit fashist, nën valët e flamurit të Skënderbeut...për një Shqipëri indipendente, të lirë dhe demokratike"<sup>1)</sup>

Në fund Haredini dha porosi që të bisedohej shtruar në popull e nëpër familje për të gjitha ato që thuheshin në trakt, të ruhej fshehtësia nga karabinierët e spiunët, të mos tregojhej mbledhja dhe vendi i saj, të shkruheshin disa parrulla nga përbajtja e traktit, të bënim sabotime në minierë etj. Ai fliste me urrejtje të thellë për armikun dhe në çdo rast binte si shembull jetën e tij të mjeruar që nuk kish mundur ta ngopte kurrë barkun me bukë as përvete, as të fëmijëve të tij.

## 28 nëntor

Ne punëtorët tërë atë ditë po sorrollateshim kot nëpër rrugë. Me që nuk kishite ndonjë aktivitet të organizuar, boshllëku i krijuar jepte përshtypjen më tepër të një dite zie se sa atë të festës.

Paria e vendit, drejtuesit e minierës së Selenicës dhe titullari i postkomandës u nisën që në mëngjes për në Vlorë me një mjet të posaçëm (një biçim vture që rrëshqiste me shpejtësi mbi shinan e hekurta e që ne qemë mësuar ta quanim "terezinë"). Këshfu bënin gjithnjë ata në ditët e pushimit për ta kaluar kohën sa më mirë.

1) Zëri i Popullit" Nr.3 e 4, tetor 1942.

Ishte ora nja 15.<sup>00</sup> kur filluan të ndiheshin vesh më vesh pëshpëritjet:"ka takim te shkolla", "lajmëroni të mblidhen", "shpejtohuni" etj. Pas këtyre lajmërimeve po mblidheshin njerëzit grupë-grupe te sheshi i shkollës nga rrugicat e ndryshme të Selenicës. Ata që vinin pyesnin me kurresti:- Ç'do bëhet?- Kush pritet të vijë?- Ç'do të thuhet?...

Sheshi pothuajse u mbush plot e përplot e akoma vazhdonin të vinin. Atëhere u shkëput nga grumbulli i njerëzve aty pranë, një djalë rreth të njëzet e pesave. Kishte një trup të hollë me lartësi mesatare. Në kokë mbante një kapele studenti në ngjyrë të zezë që ia bënte edhe më të dukshëm yllin e kuq me pesë cepa, të ngjitur mbi strehën e saj. Ai shoqërohej edhe nga një tjetër. Të dy ishin të armatosur me bomba e pushkë. Ai me kapele pasi njigiti 5-6 shkallët që formonin një të ngritur si ballkon para hyrjes kryesore të godinës njëkatëshe të shkollës, u kthye me të shpejtë nga populli që priste aty. Mbështeti pushkën në tokë, pranë këmbës së majtë, duke ngritur dorën e djathtë të mbledhur grusht pranë ballit dhe përshëndeti me zë të lartë:"Vdekje fashizmit! Shumë zëra nga masa u përgjigjën si në kor:"Liri popullit!" Nga sa u mësua më vonë ky ishte Fejzo Gjomemua<sup>1)</sup> i dërguar nga udhëheqja e organizatës së partisë për Vlorën posaçërisht për t'ju folë punëtorëve të Selenicës me rastin e 28 nëntorit.

-Shokë e shoqë punëtorë!- u dëgjua zëri i folësit. Po dëgjonim për herë të parë një folës të tillë që iu drejtëhej punëtorëve me aq ngrohtësi, kështu u krijuan përshtypje têrheqëse, u nxit interesi për të dëgjuar sa më me kujdes. Pastaj vazhdoi:- Le të sjellim ndër mend se në një ditë si kjo e sotmja, 30 vjet më parë, patriotët shqiptarë me në krye plakun Ismail Qemali, ngritën flamurin e pavarësisë kombëtare...sot fashistët italianë e kanë marrë nëpër këmbë lirinë tonë. Ata duan ta kthejnë Shqipërinë në një shesh luftërash imperialiste ...PKSH dhe Fronti Nacionalçlirimtar i bëjnë thirrje të gjithë popullit që të ngrihet pa dallim për shpëtimin e Atdheut të robëruar...

Fejzua i thoshte të gjitha këto me një bindje të plotë, me një

1) Fejzo Gjomemo, dëshmor i Luftës ANÇl, hero i popullit

ton të sigurtë e të qartë që po ngjallte besim tek dëgjuesit. Në këtë mbledhje të pazakontë mbretëroi një rregull e qetësi e pararë ndonjëherë.

Të gjithë dëgjonin me vëmendje aq sa edhe karabinierët e pëstkomandës që nuk ishin më tepër se 700 metra larg nga vendi ku bëhej mbledhja, nuk e morën vesh atë që ndodhi, ose bënë sikur nuk morën vesh për të mos i nxjerrë telashe vetes.

Zgjati afro një orë të tërë takimi. Po ne na u duk se mbaroi vetëm për disa minuta. Pastaj u dëgjuan thirrjet: "Rroftë Liria!" "Rroftë bashkimi i popullit!... Këto qenë parrulat me të cilat të rinjtë shoqëruan të deleguarin. Edhe ai, në ikje e sipër, u përgjegj po me të njëjtën mënyrë, duke ngritur herë pas here grushtin përpjete dhe duke shqiptuar fjalët: "Rroftë Shqipëria e lirë!", "Poshtë okupatorët!"

Në këtë mjedis kaq të gjallë që krijoj kjo ngjarje e shënuar për ne, ra në sy edhe njeri nga ata që paraqitej si aktivist i lëvizjes sonë. Ai nga njera anë përplaste duart për ato që dëgjonte së bashku me turmën, nga ana tjetër mundohej të regjistronte diçka në një bllok me kapakë të zinj. Njerit nga punëtorët i bëri përshtypje kjo dhe tha:- Refati<sup>1)</sup> duhet të ketë përfituar më shumë se të tjerët me që mundi të mbajë edhe shënimë... "Aktivisti" u përgjigj: E kemi detyrë t'ua themi dhe të tjerëve këto që na thonë.

Dhe këto i tha në një mënyrë kaq të natyrshme e si pa të keq sa që asnjeri nga ne nuk mundi të dallonte atë që fshihite ai në vevvete. Dallimet u bënë më vonë, kur kishte rrjedhur shumë ujë, ishin bërë shumë sabotime dhe qenë zbuluar disa baza të lëvizjes e ishin persekuar nga armiku mjaft shokë tanët. Të gjitha këto kishin qënë pasojë e informacioneve që pat dhënë agjenti i tij, i cili kishte vepruar brenda radhëve tona. Operacioni i Qershorit 1944 si shumë të tjerëve, edhe Refat Mehmetit ia hoqi maskën. Ai u vra prej partizanëve ndërsa përpiquej të largohej bashkë me hitlerianët, kur ata u detyruan të linin Vlorën.

---

1) *Refat Mehmeti nga Ramësi, dezertori i Lëvizjes ANÇI*

## *Jebona e 28 nëntorit*

Fjalimi i 28 Nëntorit la përshtypje të thella ndër punëtorët si dhe në masën e popullit. Pas asaj dite tema kryesore e çdo bise është rreth asaj ngjarjeje që pasurohej me gjithfarë hamendjesh për guximin e trimërinë e partizanëve, rreth çështjes së tyre të drejtë.

Karabinierët e postës së Selenicës, ditët e fundit pas festës ishin përforcuar edhe me dhjetë trupa të tjera. Kishte ardhur edhe një toger italian në krye të tyre. Ata hiqeshin sikur nuk kishte ndodhur asgjë e keqe për ta, ose të paktën, nuk ishin në dijeni. Me këtë lloj qëndrimi "mbajtësit e rendit" mundoheshin të ruanin prestigjin e tyre në dukje, duke qenë të detyruar ta gëlltisnin në heshtje atë që u ishte bërë nga partizanët dhe nga vetë populli. Ky qëndrim i tyre synonte nga ana tjetër të krijonte edhe një gjendje shkujdesjeje të përgjithshme tek ne për të mundur që t'i zbulonin më lehtë "fijet" e "ngatërrresave" dhe t'i prisnin ato më kollaj.

Agjentura armike ishte plotësisht në dijeni të gjendjes që ekzistonte në minierë, ajo gjurmonte me kujdes çdo hap që bëhej në favor të lëvizjes. Tetar Refati<sup>1)</sup> më pas do të deklaronte në gjyqin që iu bë:Ishim të detyruar të vpronim sepse për atë paguheshim..., Pastaj për ta lehtësuar veten shtoi:"Italianëve nuk ua kemi raportuar të gjitha ato që shihnim e dëgjonim!..."

Tetari gënjenjete. Ata nuhasnin qosheve të minierës, në fjetore të punëtorëve, në kafene e kudo për të gjetur ndonjë shenjë në favor të Lëvizjes Nacionaklçirimitare për të bërë arrestime dhe persekuime.

Në mëngjes herët me 7 dhjetori, kur së bashku me shokun e punës, Petin, nxitonim për në oficinë, kaluam pranë kafes së Tahirit.<sup>2)</sup> Ajo ishte hapur dhe u kthyem për të pirë ndonjë çaj të nxehjtë. Aty gjetëm veç të zotin e kafes, edhe plakun Toli Kita dhe një të moshuar tjetër që nuk e njihnim. Ishin ulur që të tre, pranë një mangalli me qymyr, duke gjerbur filxhanët e kafes. Sapo

---

1)Tetar Refati karabinier, shërbëtor i zellshëm i okupatorëve.

2) Tahir Leshnaka, përkrahës i Lëvizjes ANÇL dhe pjesëmarrës i luftës së 1920-ës

hymë ne ata e ndërprenë bisedën që kishin midis tyre dhe iu përgjegjën përshtetjes së të porsaardhurve "Mirëmëngjes djema!", njeri pas tjetrit.

-Ç'dëshironi të merrni? pyeti i zoti i kafes, pas pak.

-Nga një çaj, po të jetë i nxehjtë se mardhëm- tha Peti.

-Djalërisë i zien gjaku e nuk do t'ja dijë me kaq, po si t'ja bëjmë ne që jemi pleq?- tha xha Toli me një farë përmallimi për rininë e tij të kaluar.

-Edhe kështu siç bën kjo djalëria e sotme, konferencë në mes të ditës, mu afër xhandarëve, nuk bëhet de...Po ta kishin ditur ata që u bë një mbledhje si ajo e ditës së flamurit, do qe bërë një gjurulldi që nuk mund ta marrësh me mend...Mund të qe clerdhur edhe gjak, nuk u vjen keq njerëzve të Duçes për ne- ia priti burri i thinjur që rrinte pranë Tolit, duke trazuar me një cipal druri kokrrat e qymyrit që kërcisin në mangall. Pastaj shtoi:-

-Kam frikë se do të merremi në qafë e do të shkojmë si "qeni në vësht". Janë mbretëri të mëdha këto....

-Jo Vasil, jo- u dëgjua zëri i kujdeshëm i Tahirit nga ana tjetër e banakut, shqiptari edhe pse ka qenë i vogël në numër, për lirinë e tij nuk ka pasur frikë të luftojë; e kanë pushtuar kushedi sa herë po asnjëherë nuk ka renë në gjunjë...Kujto 1920-ën se si luftuam dhe ti e unë me shokë...

.....Lëre se i paska hyrë lepuri në bark xhaxhait...ia preu Peti.

-E, po ata ishin Selam Musajtë e Kanan Mazërit...burra me peshë e jo si ju çiliminj, more bir.

-Zigur Lelot e Sulo Begët me shokë nuk ishin më tepër se 25 vjeç, kur e rrëzuan ballonin italian me pushkë atje mbi Kotë, prandaj mos e humb besimin te djemtë- ndërhyri xha Toli si për ta këshilluar Vasilin që nuk kishte shumë besim te rinia.

-Sh-sht mos e ngrini zërin aq lart- bëri Tahiri, që sapo na mbushi gotat e çajit, shkoi e u ul te vendi që ishte më parë dhe tha: -Dëgjomëni me kujdes! Dje erdhë një bashkëfshatari im nga

---

1) Mustafa Matohiti, dëshmor hero i popullit, njeri nga udhëheqësit kryesorë të Lëvizjes ANÇ në Jugë.

Progonati dhe më solli ca lajme shumë të gjëzuarat. Andej nga malësia kryengritësit kishin dalë fare sheshit më 28 Nëntor. Mustafa Matohiti<sup>1)</sup> e kish rrëthuar Gusmarin me një çetë partizane dhe me një pjesë të popullit që e kishte armatosur me ç'kishte mundur. Ai pastaj kish hyrë vetë te nënprefekti. I dorëzoi atij e rrëth komandantit një ultimatum të prerë: ose dorëzim të qeverisë këtu dhe të armëve, ose na prit me lufthë me të gjithë 100 karabinierët e milicët që të ruajnë, i kish thënë. Populli kërkon që ditën e pavarësisë ta festojë i lirë...

-Po pastaj si vajti puna?- u interesuam ne që po e dëgjonim me vëmendje.

-Prisni që t'jua them me sira- vazhdoi Tahiri- Nënprefekti dhe rrëthkomandanti kur u shfaq aty Mustafai me emër, u hutuan sepse nuk u besohej se mund të binin kaq papandehur ballëpërballë me të. Atë kohë togerit me ngadalë i kish shkuar dora te revolja. Po toni i prerë i Mustafait dhe gryka e autmatikut të të tij që u duk nën cepin e kapardinës, e "bindi" oficerin fashist dhe nënprefektin se me një "mysafir" si ky duhej folur ndryshe.Ndërkohë togerit si padashur ju largua dora përsëri nga revolja, ndërsa nënprefekti e fttoi Mustafanë që të merreshin vesh duke dekluaruar: "Ne zoti Matohiti jemi gati t'i japim kënaqësi popullit të Kurvelleshit e ta festojmë ditën e flamurit së bashku. Për këtë qëllim kemi shpërndarë edhe ftesa që të mbledhjen këtu, në qendër të nënprefekturës gjithë paria e krahinës. Në një mendje me ne është edhe zoti Muharrem Duka <sup>2)</sup> Ai mund të mbajë edhe fjalën e rastit për ngjarjen e shënuar..."

"Fronti Nacionalçlirimtar dhe populli kanë marrë vendim që të mos njojin asnjë lloj parie dhe asnjë lloj pushteti tjetër përveç pushtetit të vet që po e vendosin me grykën e pushkës"...ndërhyri Mustafai, papritur nënprefektin të mbaronte...Pastaj me një ton urdhërues përfundoi:"Zoti nënprefekt, ke 20 minuta kohë të vendosësh për të ngritur flamurin e bardhë e të shpëtosh veten dhe kokat e këtyre që ke këtu, ose për ndryshe janë marrë të gjitha

---

1) Mustafa Matohiti, dëshmor, Heroi i Popullit

2) Muharrem Duka,bashkëpunëtor i okupatorëve.

masat që këtë ne ta arrijmë me luftë, ja prit! Vendimin do ta merrni ju këtu, sepse me më të mëdhenjtë tuaj është ndërprerë çdo lidhje; kohë për pazarllëqe nuk kemi". Me këto fjalë Mustafai e mbylli takimin dhe doli nga zyra me të gjithë shoqëruesit që kishte prapa duke iu drejtar kodrës dominuese mbi fshat, tek Qafa e Mihajit, ku kishte lënë shtabin e tij.

-Po pastaj?- s'iua durua xha Tolit.

-Pastaj, pa kaluar mirë afati i ultimatumit, të gjitha forcat rrëthuese ishin gati për zjarr. Kjo gjë edhe atyre të nënprefekturës nuk u shpëtoi pa e vënë re, ndërkaoq u duk flamuri i bardhë në godinën kryesore të administratës fashiste si dhe forcat e karabinierëve e të milicisë dukë u rreshtuar për nisje. Pra dorëzimi ishte pranuar, pa qenë nevoja të hapej luftë me pushkë. Kjo ngjarje u prit me një beshëri të shtënash në ajër nga ana e partizanëve. Pastaj këta marshuan në mënyrë të rregullt drejt qendrës së nënprefekturës. Aty morën në dorëzim armët dhe pajisjet e tjera ushtarake si dhe një sasi të konsiderueshme sendesh ushqimore që u gjendën në gazermat, së bashku me depot e veshmbathjes etj.

Populli dhe partizanët që mbushën sheshin përpara nënprefekturës dëgjuan me vëmendje të madhe fjalimin e zjarrtë që mbajti Mustafai. Pas tre ditësh u konfirmua çlirimi i nënprefekturës së Kurveleshit edhe nga burime të tjera më të sigurta; kështu që edhe informatat e shpërndara nga kafeneja e Tahirit kishin qenë fare të sakta.

Kafja e Tahir Leshnekës në Selenicë ishte bërë një vend i preferuar për njerëzit që përkrahnin Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Pronari i saj, si përkrahës i vendosur i luftës sonë dhe si aktivist i luftës së Vlorës, prej kohësh e ruante të gjallë urrejtjen karshi pushuesit të vjetër e të ri njëkohësisht, po edhe fashistët nga ana e tyre e ruanin "konsideratën" që kishin krijuar për të si për të gjithë luftëtarët e tjerë të Babicës e të Qafës së Koçut. Pra ngjarjet e kaluara së bashku me ato që po zhvilloheshin tanë, e përligjinë vrojtimin e kujdesshëm të agjentëve fashistë karshi hyrje-daljeve në këtë kafene.

Në njerën nga ditët e tetorit, tregonte vetë Tahiri, tetar Refati i qe paraqitur atij si shqiptar i ndershëm, gjoja për ta këshilluar

kafexhiun që të hiqte dorë nga çdo punë e dsyshimtë, meqenëse fashistët e dinin mirë edhe të kaluarën e tij... Këtë "këshillë" tetari shtirej se e thoshte në konfidencë, nxirre një "sekret". Në të vërtetë ai e bënte këtë për presion nga që i detyrohej Tahirit materialisht për mospagimin e shpenzimeve të shumta që kishte bërë në kafe për mjaft kohë e që nuk i pagoi kurrë.

Gjatë reprezaljeve të vazhdueshme që kryenin fashistët, italianë më pas, do ta gjenin rastin për t'i larë hesapet edhe me kafexhiun. Në një operacion "spastrimi" që bënë ata, pas shkatërrimit të minierës, vranë shumë banorë të Selenicës që ishin në ikje e sipër për të mos rënë në duart e pushtuesve, ndërmjet tyre edhe Tahirin. Po vendosmëria e popullit për qëndresë nuk u vra, ajo vazhdoi të bëhej më e madhe.

### *Dy sibariqe*

Më 20 dhjetor pasdite përgjegjësi ynë thirri në takim aktivistët e rinj që punonin në minierë. Aty morën pjesë Shaban Hoxha e Qemal Velçan<sup>1</sup>. Misto Dhimitri, A.K., J.S., unë dhe disa të tjera. Gjithsej ishim 7-8 vetë. Këtë herë mundëm të mësojmë mjaft lajme të gjëzueshme nëpërmjet gazetës "Zëri i Popullit" që na erdhë në botim të plotë, sepse në raste të tjera na kishin ardhur vetëm pjesë të rishtypura të kësaj gazete, ngaqë nuk mjaftonte për t'i plotësuar të gjitha kërkesat.

"'Zëri i Popullit' kjo tribunë e vërtetë e luftëtarëve të lirisë, u jep një sihariq të madh. Në shtatorin e kaluar u bë konferanca për zgjedhjen e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar...."- thuhej aty ndër të tjera, ku flitej për Konferencën e Pezës dhe vendimet e saj. Në këtë numër të gazetës, më poshtë nënvisohej: "Mashat e fëlliqura të milicisës e të karabinierisë po i qëron, një nga një, populli shqiptar, ashtu siç hedh shqiponja prej folesë së

---

1)Shaban Hoxha e Qemal Velçan, dëshmorë të Luftës ANÇI

saj zogjtë e degjeneruar...”, dhe më poshtë porosia e redaksisë:”Pasi ta këndoni “Zërin e Popullit”, mos e ruani po shkojeni dorë më dorë, në mënyrë që të mos mbetet asnje kasolle,asnje shtëpi, ku të mos këtë hyrë fjala e lirë dhe e vërteta”<sup>1)</sup>

Lajmi tjertër që na gëzoi së tepërmë në këtë mbledhje ishte ai i krijimit të çetës së parë partizane në rrethin e Vlorës.- Çeta tani është në veprim- tha Haredini.-Ajo është dukur në shumë fshatra të qarkut, atje ka rrëzuar kryepleqtë nga fuqia dhe ka vendosur në vend të tyre këshillat nacionalçlirimtare, si formë e pushtetit të ri...

-Rroftë çeta partizane!- thirri me të madhe Shabani që nuk u përmbajt dot nga gjëzimi. Këtë ndjenjë e provuam edhe ne të tjetët. Aty na lindi edhe një dëshirë e madhe që të njiheshim nga afër me çetën, me partizanët e saj, me komisarin, me...

Lajmi për krijimin e çetës ngjalli shumë interes tek shokët. Nuk mbeti asnjeri pa folur disa herë. Aty u shpreh dëshira edhe për pjesëmarrjen tonë në çetë, pa përjashtim.

-Si mendoni ju, unë nuk paskam dëshirë të shkoj në çetë?- tha pastaj Haredini.-Jo shokë, edhe unë kam dëshirë të bëhem anëtar i çetës partizane, po puna duhet bërë në çdo cep të Atdheut, edhe këtu ku jemi ne së bashku...Do të vijë koha të shkojmë edhe ne në çetë; do të krijohen edhe çeta të tjera. Detyra jonë është të bëjmë popullin përvete, sidomos punëtorët...

-Tri kopjet e komunikatës që morët- vazhdoi Haredini- duhet të vendosen: njera në sektorin e mademit për ata të nëntokës; një në sektorin e atyre që punojnë në transportin e serës; një tjetër te blloku i banesave të nëpunësve italianë. Me këto detyra u shpërnda grupi ynë këtë herë nga kodra e vogël që ngrihej mes plajës në jug të Selenicës. Atë ditë qelli qe mbuluar me ca re të zeza, të ulura mbi kokat tona sikur donin të parathoshnin furtunën dhe stuhinë që do të vinin më prapa.

---

1) Gazeta “Zëri i Popullit”, Nr.3 viti 1942

## *Një postë e veçantë*

Pas aksioneve që ishin bërë me rastin e 28 Nëntorit krerët fashistë bënë edhe kërcënime të reja në adresë të "turbulluesve" të rendit. Me autorët e këtyre kërcënimeve ishte bashkuar edhe prefekti i Vlorës. Atë, me sa dihej, Lëvizja NÇL, mundohej ta mbante nën kontroll dhe brenda mundësive, ta përdorte në shërbim të vetin, në pamundësi për t'ia arritur kësaj- ta neutralizonte.

Në mbledhjen e 25 dhjetorit në Romës përgjegjësi ynë shtroi nevojën e dy shokëve që duhej të shkonin deri në Vlorë për të shpurë një postë të veçantë te prefekti. Kjo detyrë na u ngarkua ne të dyve me Qemalin, meqenëse ishim akoma gjysmëlegalë e nuk gjurmoheshim aq shumë nga ana e policisë.

-Ka rëndësi që kjo postë- tha Haredinim, duke nxjerrë nga xhepi një zarf të mbyllur, sipër të cilit binte në sy një kaligrafi e kujdeshshme, shkruar me bojë, ku lexohej: "Zotit prefekt në dorë" dhe pak më poshtë: "Personale"- të lihet në zyrën e prefektit, pa i rënë atij në sy aty për aty, në mënyrë që të largoheni para se ai të ketë hapur zarin. Në çdo rast që mund t'ju diktohet kjo postë, do të pranoni vetëm se ju a ka dhënë një i panjohur për t'ia shpënë prefektit dhe asgjë më tepër...Duhet patur parasysh- vazhdoi të udhëzonte përgjegjësi-se prefekti më me siguri në zyrë mund të gjen-det në orët e para të mëngjesit.

Që të hyni tek prefekti, preteksti do të jetë kërkesa për 50 kg miell me bono. Bonon (autorizimin) e jep ai personalisht, në bazë të vërtetimit që jep kryeplaku i fshatit për të vobektit. Këtë lloj vërtetimi ia mora Vangjel Nasit dhe ja ku e keni.

Vangjeli nga ana e autoriteteve njihej si kryeplak i Selenicës, në fakt aty tërë punën e bënte këshilli nacionalçirimitar, ku bënte pjesë edhe vetë Vangjeli.

### *Tek prefekti<sup>1)</sup>*

Dita e 26 dhjetorit 1942 goditi e shtunë; rreth orës 4.00 të

1) Prefekti i Vlorës Lele Koçi, i emëruar aty nga okupatorët italianë u likuidua më pas po prej tyre.

mëngjesit të asaj dite të dy shokët me vërtetimin e kryeplakut në xhep dhe me plikon e prefektit, të fshehur në një mënyrë që dukej e sigurtë, u nisëm gjithë qejf me llogarinë që rreth orës 8.00 të mund të mbërrinim në qytet, duke ecur njeri në këmbë e tjetri hipur në kalë.

Pas 15-20 minutave të para të udhëtimit, kur kishim dalë në krye të kodrave të Paraserit e udhëtonim gjatë pllajës së Treblovës, u ndie një "Fermo!" e fortë. Kjo na gjeti në befasi dhe vetveti hodhëm shikimin në errësirën përreth për të hetuar se ç'po ndodhte. Sakaq e pamë veten midis katër ushtarëve të armatosur që ishin ngritur në këmbë, në një largësi jo më tepër se 10 metra nga ne dhe po na afroheshin me bajoneta të mbërthyera e të drejtuarë përparrë sikur do të zhvillonin ndonjë luftim trup me trup.

"Giu!" - urdhëroi njeri prej tyre, duke më bërë shenjë me dorë që të zbrisja nga kali dhe, pa humbur kohë, nisën një kontroll nga këmbët tona e deri te koka. Pasi u siguruan nga njerëzit, filluan kontrollin e kalit. Atij ia hoqën, një e nga një, të dy thasët bosh që kishte mbi samar, kontrolluan rripat e samarit nga ana e brendshme e sidomos stromën me kashtë, nën samar, në disa vende atë e grisën. Pjesën tjetër e "shëtitën" me majat e mprehta të bajonetave me një vëmendje aq të madhe sa; menduam se zarfi nuk do t'u shpëtonte dot pa e gjetur. Në këto mendime e sipër që po bluanin kokat tona, përgjegjësi i patrullës (kështu jepte përshtypje të ishte ai që fliste më shumë se të tjerët), vuri dorën pikërisht mbi atë vend të stromës së samarit, ku gjendej i fshehur zarfi. Çast kritik! Ne të dy i mbërthyem sytë në drejtim të njeritjetrit si për të caktuar sekondën për t'ua mbathur këmbëve, nëpër errësirë që t'u shpëtonim atyre nga duart. Po aty ndodhi një diçka që nuk do ta besonim: ai papritur e ngriti përsëri dorën shpejt, sikur t'i ishte shpuar në ndonjë majë gjilpërse dhe njëkohësisht na dha shenjë që të niseshim, duke shqiptuar një "Vettene!" të urrejtshme (domethënë, ikni). Kjo sjellje e tyre tregoi se nuk kishin diktuar gjë; edhe ne e mblozhëm veten disi më mirë, duke u munduar që të shtireshim sa më të qetë përparrë tyre dhe kësh-tu vazduham rrugën.

Ecja jonë tanë, njeri me kalin përdore e tjetri prapa ishte e de-

tyruar të vazhdonte nëpër kalime anësore. Rrugën kryesore e kishte zënë kolona e ushtrisë fashiste që zgjatej përreth dy kilometra me të gjithë mushkat që mbanin ngakuar pjesët e rënda të artilerisë. Kur dolëm në Treblovë ishte kapërcyer pothuajse krejt pengesa e parë që na kish dalë aq papritur.

Në Vlorë arritëm me ca vonesë nga koha që kishim parashikuar. Aty nxorrëm plikon nga samari, e futa atë nën rrpin e pantallonave, poshtë xhaketës me merakun si do të na priste roja e prefektit. Po ky nuk na pengoi me që nuk i lamë ndonjë përshtypje të dyshimtë.

Në katin e dytë, portieri i prefektit ishte më i reptyë. Ai nuk lejonte asnjeri të hynte brenda. "Zoti prefekt është i zënë me disa persona të rëndësishëm..." Këtë përcjellje ne e dëgjuam, kur po ia thoshte një tjetri. Po papritmas ra zilja që e detyroi portierin të hyjë brenda te shefi i tij, nga ku doli përsëri pa u vonuar shumë, duke iu drejtuar zyrës fqinje, ndoshta për të zbatuar ndonjë urdhër të prefektit. Këtë rast e shfrytëzuam ne me shkathësi. Pas një trokitjeje të lehtë në derë, hymë brenda pa pritur përgjigje. Nga brenda derës, duke hedhur sytë në krye të zyrës, aty pranë një tavoline, të fundosur në kolltukë të mëdhenj sa mezi duke-shin, rrinin tre burra të stërmajmur e të veshur mirë. Ata hera-herës thithnin ca cigare të gjata me një erë të këndshme që arriți gjer tek ne, flisnin dhe qeshnin me përzemërsi. Një kohë mbetën ashtu të mospërfillur dhe plot shqetësimë. Pastaj njeri nga zotërinjtë, ai që rrinte me ballë nga dera, hodhi sytë nga ne dhe pyeti:

-Ç'kérkuat, kush ju dërgoi këtu?

-Jemi hallexhinj zoti prefekt- ja prita, duke marrë me mënd se ai duhej të ishte,-kemi ardhur për një çikë miell me bono se jemi fukarenj e nuk kemi para që ta blejmë me të shtrenjtë në treg të lirë- dhe, si për të përforuar ato që kisha thënë, u afrova disa hapa dhe ia vura mbi cepin e tavolinës vërtetimin e kryeplakut.

-Po ky tjetri ç'do?- pyeti ai, në kohë që sytë i kishte akoma te letra.

-Eshtë vëllai im.

-Ç'e doni ju miellin apo për mysafirët e shumtë që ju vijnë? (Me pyetjen që bëri këtë herë na u duk sikur diç kishte kuptuar,

ndaj Qemali u mundua të “shkiste” disi).

-Ne s’kemi për vete zoti prefekt e jo për mysafirë, sepse jemi shumë gojë për të ngrënë në familje, vetëm ne të dy që na shihni këtu jemi më të rriturit- u përpoq ta arsyetonte kërkësën shoku im.

-Jo more!- shfryu duke ia hedhur shikimin mysafirëve që kishte aty, pastaj shtoi:- na ka gjetur belaja zoti (emri i tjeterit nuk u dëgjuat mirë) me këta; në kohën që jemi të preokupuar të plotësojmë nevojat e shumta të forcav qeveritare, na vjen edhe ndonjë kësh-tu...-bëri me dorë nga ne, në një mënyrë përcmuese.

-Dilni një herë jashtë!- urdhëroi dhe në të njëjtën kohë shtypi butonin e ziles.

-Ti Maksut shpjeri këta te sekretari që t'u japë një bono nga ato që kam firmosur, për 20 kg miell misri- e porositi ai karabinierin që tani kishte hyrë në zyrë.

Maksuti pasi nderoi në mënyrë fashiste, duke ngritur pëllëmbën e dorës së djathtë përpjetë dhe duke përpjekur thembrat e çizmeve fort, u drejtua për nga dera. Na ftoi edhe ne që ta ndiqnim prapa. Qemali u nis prapa Maksutit si me përtim, ndërsa unë vazhdova disa sekonda ta falenderoja prefektin për “bujarinë” që tregoi, duke u tërhequr prapa e pak si majtas, deri sa u përpoqa me sofanë e dritäres së zyrës që binte nga perëndimi. Aty lëshova zarfin me kujdes dhe isha gati të dilja nga dera. Po prefekti që deri tani nuk e kishte pasur fare mendjen te falenderimet e mia, më pa përsëri dhe tha me nervozitet:

-Akoma këtu qenke ti, ik se na mërzite!

Me të marrë bonon që tek e fundit nuk kishte shumë rëndësi edhe sikur të mos e merrnim, nxorrëm kalin nga hani dhe ndo-qëm rrugën që të shpinte te fabrika e miellit, drejt skajit verilindor të qytetit. Aty bëhej edhe ndarja e miellit si pas bonove, po nga frika se mos na ndiqnin nga prapa, kaluam me të shpejtë rrugicën përbri fabrikës dhe dolëm në plajën me ullinj, mbi qytet. Tani siguria për të ecur në drejtim të Selenicës pothuajse ishte e plotë.

Ecëm e ecëm për gati dy orë. Në pushimin e shkurtër që bëmë në vendin e quajtur Picar, apo kishim kaluar në bregun e djath-

të të lumit Shushicë, Qemali duke marrë fryshtë hellë e me një ndjenjë kënaqësie tha:

-E kaluam vanë pa u lagur.

-Nga që patëm kalin e ia hipëm, pastaj edhe lumi nuk ishte aq i fryrë.

-Nuk e pata fjalën për këtë të lumit, po për atë të madhen që në fillim e morëm si të lehtë, po kur hymë aty brenda, m'u duk sikur ndjeva një farë dridhjeje te gjunjët; besoj se dhe ti do ta kesh provuar një gjë të tillë.

-Sidoqoftë ne kaluam një provë të mirë dhe pas kësaj na duket vetja ca më burrërore, apo jo?

-Ashtu është me të vërtetë, çohu të ecim se po na ze nata, - e mbylli bisedën ai.

Kur mbërritëm në shtëpi i gjetëm të gjithë njerëzit e familjes të shqetësuar nga telashet e ditës. Trupat fashiste që kishin ardhur fshehumë si gjahtarë nate i kishin bezidur shumë. Këto përbënë një regiment italian të përforcuar që kish ardhur për të rrëthuar rajonin e minierës së Selenicës në befasi me shpresë se mund të kapnin aty baza me rëndësi të Lëvizjes Nacionalçlirimtare e ti shkatërronin ato. Fashistët nuk kishin përtuar të kontrollonin edhe kasollet e bagëtive, një me një, deri te kotecët e pulave, po nuk kishin mundur të arrinin asnjerin nga synimet e mësipërm. Kësh-tu që kishin ardhur e shkuar me duar bosh.

## **NGA VITI 1943**

### **II. FORMACIONET PARTIZANE NË VEPRIM**

*Aksionet me armë në shkallë të gjerë.  
Forcimi i lidhjeve të partizanëve me popullin,  
kapitullimi i pushtuesve fashistë.*

#### ***Aksioni i parë me armë***

Më 21 shkurt na lajmëruan të mblidheshim të gjithë pjesëtarët e njësitit territorial për një detyrë të ngutshme. Atë pasdite u ndodha në Treblovë, në shtëpinë e Dano Halimit, një babaxhan njeri, minator i vjetër i minierës së Selenicës, po edhe guximtar. Ishte një ndër aktivistët e parë të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Shoku që na lajmëroi tha:

-Më duket se do ta shkrepim edhe ne këtë herë...-Në orën 22.00 sonte të jeni sipër Kishës së Selenicës. Unë po shkoj të lajmëroj të tjerët...

-Grua, ma sill pak atë hekurin që kam atje në baxhak!- i tha xha Danua të shoqes. Ajo që ja merrte vesh gjuhën atij i solli dyfekun. Ai e mori në dorë, i fryu një herë si për t'i shkundur

pluhurin dhe e vuri pranë vetes.

-Isha i ri kur u bë Lufta e Babicës me Italinë e parë... që atëhere e kam ruajtur këtë dyfek: fshih andej e fshih këtej mos ma gjenin xhandarët - shpjegoi Danua.

U nisëm bashkë në mugëtirën e mbrëmjes për te vendi që ishim lajmëruar. Mbase kishim bërë nga 100 hapa, kur u ndie nga prapa thirrja:

-O burrë, o burrë, prit pak- foli e shoqja.

-Ç'ka ndodhur, moj?

-Ke lënë të vegjëlit po prit!- dhe qe nisur e po vinte drejt nesh.

-Dre - paskam harruar fishekët nga nxitimi - u kujtua Danua, pastaj u kthye e mori torbën që i pruri e shoqja dhe vazhduam rrugën përsëri.

Njësiti në orën e caktuar qe grumbulluar pothuajse i téri. Aty mbërriti edhe një partizan i çetës "Plakë". Atë na e prezantoi komandanti i njësirit.

-Shoku Shyqyri Alimerko<sup>1)</sup> do të na thotë se si do të veprojë edhe njësiti ynë territorial bashkë me të dy çetat partizane që do t'i bien Selenicës- tha Haredini. Pastaj foli Shyqyri për aksionin që do të bënim, për disiplinën që kërkohej, për shpejtësinë, gjaktohtësinë, lidhjet me shoku-shokun...

Me të mësuar se do të sulmonim postkomandën e do të hidh-nim në erë të gjitha pjesët e minierës, provova ca ndjenja që s'i kishia provuar herë tjetër: edhe gëzim, edhe frikë. Gëzimi vinte ngaqë së fundi po na plotësohej një dëshirë e herëshme për ta luftuar armikun me armë. Frika ime kësaj radhe i ngjante asaj që ndjen nxënësi përpara një provimi të vështirë, se a do ta kaloja dot me sukses apo jo. Dhe e ndjeja që të rrahurat e zemrës m'u bënë më të shpeshta.

Duke ndejtur dora-dorës, aty me shokët, m'u krijua bindja se edhe ata kishin shqetësimë si të miat. Lëviznim nga një vend te tjetri, përpinqeshim të përfytyronim, se si do të ishte lufta... si do t'i çarmatosnim karabinierët, si...

<sup>1)</sup>Shyqyri Alimerko, dëshmor i Luftës ANÇl, njëri nga partizanët më të vjetër të Çetës "Plakë" hero i popullit.

Xha Danos nuk iu durua në një çast tha:- Kur do të vijë ora ta fillojmë këtë të shkretë muharrebe se nuk po na durohet. Kurse P.M.-në e pushtoi një e dridhur që ia hidhte përpjetë të gjithë trupin sikur ta kishin zënë “ethet e gushtit”. Tek secili kishte nga një “xhevahir” të tillë.

Aty nga ora 23.00 u dha shenja e goditjes. Të shtënat tonë u derdhën njëherësh si prej një gryke të vetme. Gjithë territori i minierës u përfshi nga flakët e zjarrit, ushtonte nga krismat e pushkëve, nga uturima e bombave dhe e minave që ngjanin sikur po plotësonin boshillëqet e njera-tjetrës. Ndërkaq edhe ne u mësuam tanimë me gjendjen. Pak nga pak, u çliruam nga “ngarkesa” psikologjike e parafillimit të luftimeve që na shqetësonë.

Befasia e sulmit partizan dhe shpejtësia e rrufeshme me të cilën filloi e po zhvillohej ai, shkaktoi te armiqtë një rrëmujë të madhe dhe panik, çka se edhe ata u përpoqën të luftonin me çdo kusht nga aty ku ishin. Këtë mundësi e patën vetëm forcat kryesore të karabinierëve brenda postkomandës, kurse patrullat që u ndodhën nëpër objekte e që shpëtuan gjallë nga vrulli i parë i sulmit partizan, u munduan të bënin njëfarë qëndrese pranë objekteve që ishin caktuar, po prapëseprapë nuk mundën të qëndronin gjatë dhe u detyruan t'i braktisin ato. U vunë në ikje të fshehtë, secili me iniciativën e tij dhe për hesapin e vet. Në këtë mënyrë ajo pjesë e tyre që u tregua më e “shkathët”, mundi të përfitojë nga errësira e natës për të hyrë në pyjet e Gërrhanit që shtriheshin prej Qafës së Armenit e deri aty afér Selenicës, në përpjekje për të arritur të gjallë në Vlorë. Pjesa tjeter u detyrua të kapej me thonj e dhëmbë pas mureve të gurta të postkomandës, ku ishin futur.

Mitralozi i lehtë që ishte vendosur nga karabinierët te hyrja e postës u bllokua nga granatat e dorës që hodhën tanët. Shënjuesi që e përdorte atë nuk u ndie më, gjithashtu edhe ndihmësi i tij nuk u muar vesh se ç'u bë. Të tjerët që ishin brenda vazhdonin të shtinin, thirrjeve të partizanëve për t'u dorëzuar nuk po u përgjigjeshin.

Pas rreth gjysmë ore nga fillimi i luftimeve, në të gjithë Selenicën partizanët u bënë të plotfuqishëm. Atëhere u dha edhe shenja e têrheqjes sonë.

Dëmet që iu shkaktuan armikut ishin të mëdha. U nxorrën jashtë përdorimit, të gjitha impiantet, galeritë, lokomotivat dhe makineritë e ndryshme që nevojiteshin për ta vënë minierën rishtazi në prodhim.

Të nesërmenne me një grup shokësh, zbritëm në Selenicë, si punëtorë të minierës. Në sy të të tjerëve u paraqitëm sikur nuk kishim pasur të bënim fare me ato që kishin ndodhur natën... Edhe personeli specialist italian u grumbullua te sheshi i ofiçinës me të gjitha familjet e tyre, të tromaksura. Qanin, si fëmijë fatin e tyre të keq q'i kishte sjellë në Shqipëri...Ngrinin kokën drejt qiel-lit, i lëteshin zotit dhe mallkonin Duçen.

-Nuk mund të qëndrojmë dot më nën vërvhëllimën e plumbave, prandaj jua dimë për ndër që po na ndihmoni të ikim sa më parë...deklaroi Ugo Russo, (ish drejtor i ofiçinës së minierës) përpëra gjithë atyre që po i përcillnin nga ana e banorëve. Pastaj edhe me ndihmën tonë, u riparua disi një lokomotivë që ishte dëmtuar më pak si dhe disa vagona nga ato të serës, ngarkuan me nxitim teshat dhe pjesëtarët e familjeve që kishin me vete e u larguan me lot në sy.

Selenica kishte marrë pamjen e një zone të prekur rëndë nga tërmeti. Sapo qenë larguar partizanët, edhe karabinierët që kishin mundur të shpëtonin gjallë, kishin marrë arratinë nëpër pyje e kodra drejt Vlorës, sipas shembullit të atyre që kishin ikur natën.

Nga kjo ditë ne pushuam edhe formalisht së qëni punëtorë të shoqërisë italiane, e cila faktikisht puštoi së ekzistuari. Çdo veprimtari e mëtejshme do t'i kushtohej kryesisht Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

### ***Armiku shpartallobet plotësisht***

"Erdhën për lesh e u kthyen të qethur", kështu i etiketoi populli të 200 karabinierët që u nisën në ditën e parë të prillit 1943 për të mbjellë frikë e për të vënë "rregull" në minierën e Selenicës.

Partizanët që ishin vendosur qysh natën pa gdhirë mirë në pritë për t'i "përshëndetur" këta mysafirë të paftuar, shpesh pyesnim

njeri-tjetrin se ç'kërkonin këta që nga përtjej detit këtu tek ne.

- Me sa mend në kokë nisen italianët për këtu, kur e dinë se ne do t'i presim me fishekë e do t'i vrasim?- pyeti edhe Thomai<sup>1)</sup> aty ku rrnim në priti të tyre.

-Ku e dinë ata se ne jemi këtu- tha tjetri.

-E dinë që ç'ke me të, po kështu janë urdhëruar-sqaroi i treti. Ora po i afrohej 10-ës.

-Sh-sht, qetësi se po vijnë, fshihuni mirë që të mos ju shohin dhe rrini gati-paralajmëroi komandanti i skuadrës.

Tek bishti i malit të Armenit, u duk kreuz i kolonës së karabinierëve italianë. Ata ecnin në këmbë, ishin të armatosur gjë në dhëmbë dhe të veshur me ato uniformat e tyre hijerënda.

Dalëngadalë doli në fushë të hapur e gjithë kolona. Ajo me atë lëvizjen e saj të kujdeshshme drejt minierës, i ngjante rrëshqitjes së gjarpërith që shpejton për në strofkën e vet.

Ajo ndoshta e parandjente që me qindra sy ishin ngulur si shigjeta mbi të, e shoqëronin në çdo hap që bënte përpara. Masa e sigurimit nga e papritura për të qenë të plota, sipas të gjitha rregullave që kërkonte taktika e luftës.

Kur karabinierët qenë afruar shumë, pranë meje u dëgjuan ca kërcitje dhëmbësh: aty pashë Xhevitin<sup>2)</sup> që nuk po e mundte dot urrejtjen karshi armiqve. Tre të shtëna pushke dhe plasja e një granate i dhanë fund pritjes sonë. Kjo ishte shenja e sulmit mbi ta.

Edhe karabinierët u përgjigjën, po vrulli i partizanëve nuk u dha kohë atyre as të merrnin frymë; ishte i menjëhershëm dhe i shpejtë. Grupë partizanësh u futën si pyka brenda formacionit armik, i copëtuan karabinierët në pjesë të vogla. Ata nuk ishin më në gjendje për qëndresë serioze. Një pjesë u futën nëpër hendekët e arave për t'u fshehur plumbave; një pjesë tjetër ngritën shamitë e bardha duke kërkuar që të dorëzoheshin; ca të tjerë nisën vrapin për nga lumi për t'u hedhur në anën e Mallakastrës, po me t'u afruar tek uji i rrëmbenin me vete dallgët e vrullshme të Vjosës, pa arritur dot matanë. Të 200 karabinierëve

---

1) Thoma Koçi, ish vullnetar në aksion

2)Xheviti Prenjo, luftëtar i shquar, dëshmor i Luftës ANÇL

me gjithë komandantët e tyre po u vinte fundi.

Kur grupi ynë iu afro distilerisë ku ndodheshin të struktur një numër armiqsh, Xhevitet Prënja u shkëput nga shokët dhe u hodh në mes të tyre me revole në dorë. Rrëzoi nja dy nga ata për tokë, të tjerët thërritën me lebeti "mama mia!" dhe ngritën duart. Në këto çaste u godit për vdekje edhe Xheviti. Kjo qe humbja e vetme për ne, po edhe e ndjeshme;

Ndërmjet shumë robërve që u zunë, qe edhe togeri fashist Tasiq Spahiu, një shqiptar i shitur tek të huajt. Gjyktimi i tij më pas u bë veças nga karabinierët dhe oficerët e tjerë italiane. Nuk iu vërtetuan dot në atë kohë krimë të veçanta. Toger Spahiu bëri betimin e dha fjalën e "nderit" se po t'i falej jeta këtë radhë, do t'i shkëpuste lidhjet me pushtuesin. Ngjarjet e mëpastajme do të vinin në provë betimet e përgjërimet për "ndershmëri" e "patriotizëm" të oficerit fashist.

### ***Pëllëmbë e plumb***

Dielli sapo kishte zbardhur majën e malit Shashicë. Një kolonë e madhe ushtarësh armiq u dukën te Ura e Peshkëpisë në drejtim të Selenicës. Me kalimin nga kjo anë ata nisën të hapeshin për luftim, gjatë anës së djathtë të rrugës automobilistike që vinte nga Vlora. Me kohë filloj të godasi edhe artilleria italiane që nga Qafa e Babicës, po pa ndonjë adresë të saktë.

Në orët e para të drekës ushtarët armiq, në formë të hapur, arritën fare pranë pritës që u ishte bërë në kodrat poshtë Penkovës. Radhën për të hapur zjarr mbi ta e kishim ne. Batareja e menjëershme e pushkëve dhe mitralozëve e bënë vendin pëllëmbë e plumb. Nisën të ndihen rënkimë, pastaj dhe thirrje: "Aiuto!" (ndihmë) nga ana e ushtarëve fashistë që ishin goditur qysh me të shtenat e para. Ata nuk kishin më forca as për të luftuar bashkë me të tjerët, as për t'u tërhequr prapa.

Pas afro dy orë luftimesh pozicionale ngjante sikur qe vendosur një gjendje barazpeshimi në luftime. Papritmas një breshëri automatiku, ca pushkë e pastaj një bombë dore, e ndryshoi situatën. Armiku na kishte marrë krahët nga e majta.

-Shokë, vazhdoni zjarrin prej pozicioneve ku jeni, krahët i kemi të siguruar!- tha Namiku<sup>1)</sup> Ai si komandant i shkathët e kuptoi se italianët kërkonin të na dilnin prapa krahëve. Vetë u nis me shpejtësi bashkë me skuadrën që ndodhej në anën prej nga vinin të shtënat. Iu pre rruga njësitit armik që ishte afroar duke bërë qitje nga pas shkurreve, nja 20 metra prapa pozicioneve tona.

Njësiti ynë e sulmoi armikun ballë për ballë me të gjitha armët e lehta që kishim. Pas një dyluftimi të shkurtër njësiti armik nisi të tërhiqet, duke lënë në vend një të plagosur rëndë që pak më vonë edhe vdiq.

Përpjekja me fashistët gjatë asaj dite zgjati shumë. Kjo i mërziti ca partizanët, ishim mësuar që me goditje të shpejta e të befasishme ta thyenim armikun në kalim e sipër. Po tani ai edhe pse pësoi dëme të rënda qysh në goditjen e parë, i mbulonte ato vazhdimisht me forcat e reja që sillte nga prapavija. Megjithatë përrpara nuk po çante dot, po edhe prapa nuk po tërhiqeji.

Nuk kishte më interes për ne që të vazhdonim luftë frontale dhe u bëmë gati të shkëpusnim kontaktin me armikun. Po aeroplanët gjuajtës që na mbërritën mbi kokë e na mitralonin, na detyruan të vazhdonim akoma betejën jo vetëm në tokë, po edhe në ajër, aq sa arrinin armët tona.

U bënë mbi 7 orë të gozhduar në pozicione. Dielli i qershori qëndronte si një saç i nxeh të mbi kokë. Sadikut<sup>2)</sup> i kish rënë të fikët nga vapa. Dy nga shokët e morën dhe e vendosën atë në një hije pàk më prapa vijës së luftimeve. Shumicës së partizanëve u qenë tharë buzet për ujë. Në kodrat e Penkovës ku gjendeshin ne, nuk kishte asnjë burim uji.

Për të ngrënë nuk bëhej fjalë fare, ishim mësuar të rrnim pa bukë edhe më gjatë. Ushqimet që kishin përgatitur fshatarët për të na i sjellë kishin mbetur lart, në Vezhdanisht. Nuk kishte asnjë mundësi për të na i sjellë ato në vijën e parë. Prapëseprapë shpirti i qëndresës dhe humorit ndër partizanët mbetej i palëkundur. Ja dhe qyfyret:

1) *Namik Xhafa, komandant i çetës "Ismail Qemali"*

2) *Sadik Meçani, partizan.*

-E lamë atë kërricin të na vejë dëm, nuk e morëm ta piqnim se qe i njomë,- tha njeri nga partizanët aty prapa nesh në shkurre.

-Ç'është ky kërric? - u bënë kuriozë të tjerët dhe ngulën këmbë që ta dinin. Ne që na kishte ndodhur ngjarja nuk donim ta merrnin vesh të tjerët dhe bënim sikur s'dinim gjë, për të mos na venë në lojë ata. Mirëpo Selfua<sup>1</sup> që e hapi i pari këtë ngjarje e kishte mësuar nga një shoku i tij, nisi ta tjerrë fill e për pe atë, pa ia kursyer edhe ndonjë bisht nga vetja e tij:

-Mbrëmë natën skuadra e parë kishte nxjerrë në patrullë për nga drejtimi i urës Ramadani me gjithë Koçon- nisi të tregojë ai.-Rrugës që vinte në drejtim të tyre u ndie një ecje këmbësh. Ramadani, si përgjegjës i patrullës, pasi zunë pozicion në kanalin e xhades të dy, thirri me zë të lartë:- Ndal! po ecja vazhdoi, edhe një herë tjetër: Ndall!, tani jo vetëm që "armiku" nuk u ndal, po nisi të dukej edhe vetë trupi i tij si një hije misterioze që ecte serbes drejt xhades.

- "Tani i dolëm borxhi" i tha Ramadani shokut dhe mori shenjë...Shtiu fishekun e parë, hiç: shtiu të dytin, prapë hiç; me të tretin trupi i atij që vinte u rrëzua përtokë dhe nisi të rënkojë.

Të dy shokët lëvizën barkas drejt tij, duke i bërë thirrje që të mos shtinte me armë...Kur iu afroan fare pranë, ç'të shihnin?! Një gomar duke dhënë shpirt...

Me këtë kallëzim të Selfos u shkulën së qeshuri të gjithë ata që e dëgjonin. Ai u përcoll gojë më gojë tek të gjithë. Kjo ndodhi sikur na çeli e na lehtësoi disi nga të gjitha telashet e asaj dite.

Pasdite armiku nisi t'i têrheqë forcat e tij, nën mbrojtjen e qitjeve të artilerisë dhe të avacionit që patrullonte vazhdimesh me çifte aeroplanelë mbi pozicionet tonë dhe mitralonte në kalim.

Me prishjen e planit të veprimeve të armikut dhe me dëmtimet në njerëz që iu shkaktuan, detyra nga ne përgjithsisht ishte plotësuar.

---

1) *Selfo Idrizi, partizan*

## **Nga ngrobtësia e një nëne**

Kisha dy ditë me një dhimbje të fortë dhëmballe; tani ajo kishte nisur të enjtej, dhe dhimbja më ngacmonte edhe te veshi. Më qe ndezur trupi flakë nga temperatura. S'doja tjetër gjë veç ujë.

-Do të rrish këtu në Peçkat!- tha komisari, sa të të bjerë temperaturat.

-Këtu rrrotull jemi edhe ne, po na u desh të largohemi vijmë e të marrim- tha prapë Nuriu<sup>1</sup>, kur pa se nuk ma kishte qejfi të shkëputesh nga çeta.

-Ti Serjan<sup>2</sup> shoqëroje pak deri në shtëpinë tënde!- porositi ai shokun tonë të çetës nga ky fshat.

-Hajde me mua,- tha Serjani dhe u nis përpara nëpër muzgun e lehtë të mbrëmjes, ndërsa unë e ndoqa prapa. Kur kishim kaluar nga 50 metra nëpër sokakët e Peçkatit, u kthyem djathtas, te një lesë e mbajtur me tel, që shërbente si portë. Hymë në oborrin e vogël të një kasolleje të lyer me gëlqere jashtë e brenda.- Ja, kjo është shtëpia ime, - tha ai.

- O nëne, nënë!- pas kësaj thirrjeje të lehtë që u përsërit nga i zoti i shtëpisë, u pa të dilte nga dera e kasolles një grua e veshur me ca rroba gjithë arna, duke hequr në këmbë një palë nallane prej druri. Ajo e la për tokë fshesën që i ishte ndodhur në dorë dhe iu hodh Serjanit për qafe duke mërmëritur "biri i nënës!". Pastaj u kthyte nga unë me fjalët "mirëse na erdhe!", më përqafoi, dhe shtoi: -Dukesh që je shoku i Serjanit, ini të lodhur, hajdeni brenda!

Dhoma ku hymë ishte e lyer mirë dhe e pastër, në të dy qoshet e kreut ishin shtruar dy rrogoza, mbi ta kishte edhe nga një shilte. Nëna më kishte kapur për krahu e po më drejtonte për te qoshnja, afër oxhakut, duke më folur me një zë dashamirës e me ca fjalë që për mua ishin plotësisht të kuptueshme.

-Ja, ulu këtu mbi shilte, i kemi të vjetra po të pastra, rehatohu

---

1.Nuri Arapi, komisari i Çetës "Ismail Qemali" në atë kohë.

2.Serjan Xhaferi partizan i çetës "Ismail Qemali"

pa merak, si në shtëpinë tënde...paske edhe dhëmballën e së-murë e të qenka çarë buza- shtoi pas pak.

- Ka porositur komisari që të rrijë ca këtu, nëno-, tha Serjani. Pastaj kërkoi leje nga e ëma që të kthehej tek shokët, sa nuk ishin larguar akoma.

-Jo-o- kundërshtoi ajo- do hani pak bukë me një çikë dhallë që më ndodhet se keni uri, pastaj do të pjetë nëna edhe një ku-laç që t'ua shpiresh shokëve. Si dashke të ikësh kështu?! Sa për shokun tënd që do të qëndrojë këtu mos kini fare merak se do i bëjë nëna ilaçe nga ato tonat dhe do të shërohet. Këto munda të mbaj mend nga ajo mbrëmje dhe që u shtriva mbi shiltenë pranë oxhakut. Ç'u bë më vonë nuk mora vesh.

Të nesërmen hapa sytë e po mundohesha të lidhja fillin e ko-hës që prej ardhjes në këtë shtëpi. Trupin e ndjeja të bllokuar saqë mezi lëvizja nga vendi, pjesën e sipërme të tij, deri te gryka e gjeta të mbuluar me lesh deleje. Sipër më mbulonte një velenxë leshi. Pranë meje qëndronte një kotruve prej balte dhe një tas prej alumini me një copë leckë të kredhur brenda në ujë. Nëna hynte e dilte shpesh nga dhoma, me një futë të lidhur për mesi dhe seç po jepte e merrete. Sapo më pa mua që kisha hapur sytë dhe po shikoja nga ajo, m'u afrua me ngadalë dhe më pyeti:

-Si e ndjen veten sot djali i nënës, dukesh më mirë apo jo?

-Tani nuk ndjej ndonjë dhimbje të madhe, veç pak therje veshi, prapëseprapë paskam fjetur shumë!

-Ti nuk mban mend gjë fare?

-Jo, pse, kam bërë ndonjë ...

....Asgjë, asgjë- tha ajo- po ke patur ca nxehësi dhe ke kërkuar ujë shpesh. Të kam vënë disa herë lecka me ujë të ftohtë nga të pusit në ballë se të bën mirë kur ke zjarr,...afër mëngjesit të mbuluan ca djersë, prandaj të kam futur lesh në gjoks e në kurriz që të ta thithë atë e të mos ftoheshe më tepër. Dalja e djersës është shenjë e mirë për shërimin nga të ftohit...

-Më fal, nënë, se të paskam munduar shumë!

-Çështë ajo që thua, mos të ta dëgjoj më këtë fjalë se më mbetet qejfi. Ju luftoni për ne, për të gjithë popullin, pastaj unë jam nënë si për Serjanin edhe për ty. Po sikur të sëmurej Serjani diku afër

shtëpisë sate- vazhdoi ajo- a nuk do të kujdesej nëna jote për të njësoj si për ty?

-Besoj se po.

-Ashtu të keqen nëna; po pa më thuaj tani ç'do për të ngrënë se po bëhen dy ditë që ke ardhur këtu e s'ke vënë asgjë në gojë? Të ka therur nëna një zog dhe e kam vënë të ziejë- shtoi ajo, pa pritur përgjigje nga ana e të sëmurit.- Dua të ta bëj me ca kumbulla të tharta, ato të hapin midenë. Për pak do të jetë gati, edhe veshit që të dhemb do t'ja bëjmë' dermanin, pasi të kesh ngrënë...

Dhe me të vërtetë sa hëngra atë lëngun e zogut me të thartë kumbulle m'u duk vetja si më e lehtë, po dhembja e veshit më shqetëson me ca të shpaura si me gjilpërë; ato po bëheshin gjithnjë e më të padurueshme. Në mbëmje nëna me gjithë një plakë që banonte afér saj, më vuri një fitil dylli të ndezur në vesh në një mënyrë të tillë që tymi i dalë nga djegia takonte membranën e veshit. Pas djegies së dy fitilave të tillë, pati shenja qelbzëzimi po jo rrjedhje. Dhimbja vazhdonte. Më së fundi nëna vendosi të përdorë metodën e vet të mjekimit: ajo nisi ta thitë veshin me buzët e saj dhe, pas çdo thithjeje, kontrollonte pështymën që e derdhte në një legen aty pranë. Pas disa thithjeve të tilla ndjeva një farë zhbllokimi në thellësi të veshit, kurse nëna, me një ndjenjë gëzimi tha:"Kaq e pat, veshi u hap!" dhe tregoi rrjedhjen që nisi të dilte...

Me pushimin e dhimbjes së veshit e të uljes së nxehësisë, në mëngjesin e ditës së tretë e ndjeva veten të shëruar. I kërkova asaj leje për të shkuar te shokët. Ata tani nuk duhej të ishin shumë larg; por ajo në fillim nuk pranoi të largohesha vetëm. Kështu që m'u desh ca punë sa ta bindja nënën që të më lejonte të nisësha për në çetë. Para se të më përcillte më dha edhe një tok porosish, se sipas saj, edhe ethet nga ftoma i kisha pasur...

Kur po ndahesha me të, nisa ta falenderoja nënën, për gjithë sa kishte bërë ajo për mua. Por ajo ma preu fjalën...

-Dëgjo bir!- më tha- ne kemi vuajtur tërë jetën si hyzmeqarë nëpër agallarë. Atyre akoma u duket se do të na kenë ashtu si më parë, po rroftë kjo parti që na doli për zot e nuk i lë që të na vijnë te dera e të na kanosen për t'u paguar të tretat, të dhjetat,

pulat, vezët e të gjitha ato që janë mësuar të marrin nga ne populli fukara, pa derdhur vetë asnjë pikë djerse... Tani udhë e mbarë e të na ktheheni me fitore mbi jezitët. Thuaj edhe Serjanit të mos ketë merak për ne se po t'ju kemi juve mirë, edhe ne mirë jemi. Po na!, kur të kalosh herë tjetër këtej, mos e harro kasollen time...

Edhe unë nuk e harrova e nuk do ta harroj kurrë këtë nënë me shpirt kaq të madh si të gjitha nënët tonë.

### *Përtëritje kujtimesh*



Heroi i Popullit  
Asim Zeneli

Më 4 korrik mësuam se ditët e fundit ishin zhvilluar luftime të ashpra ndërmjet forcave partizane dhe fashistëve italianë, ku kishte rënë edhe komisari partizan që udhëhiqte betejën në Grykën e Mezgoranit, Asim Zeneli. Me propozimin e komisarit çeta u ngrit në këmbë në shenjë nderimi dhe pa soi fjalët e tij: "Do t'ia marrim hakun!"

-Rënja e Asimit- vazhdoi komisari na prek të gjithëve, sepse ai ishte ndër ata patriotë të flaktë që e kishin përbuzur me urrejtje çdo premtim për rehati që u ishte dhënë nga regjimi i pushtimit. Kish vendosur të ish i lirë e t'ia kushtonte

popullit të tij forcat, aftësitë dhe tërë jetën...Luftonte në vijën e parë duke i inkuruar dhe të tjerët me guximin e tij. Në kohën që Asimi sulmonte, si gjithnjë, në këmbë, një plumb e mori në ballë...Kur u ngritën shokët, e gjetën me dorën e majtë që shtrëngonte akoma automatikun, ndërsa të djathën e kishte shtrirë nga armiku sikur donte t'u thoshte shokëve: "Vazhdoni përpara, mos u ndalni!" Edhe ne, shokë,- përfundoi komisari,- do të vazhdojmë ta plotësojmë amanetin e dëshmorëve tanë!...

E kisha njojur Asimin që i vogël, atje në malet e thata e plot shkëmbinj të Progonatit. Atë ditë që mësova për rënien e tij, më lindi një dëshirë e zjarrtë që t'i hidhja në bllokun tim të xhepit disa nga kujtimet që kisha për të.

...Për herë të fundit e pashë Asimin në verën e 1937-ës, kur ishte kthyer për pushime nga Italia ku vazhdonte studimet. Natyra e tij e thjeshtë bënte që të "shkrihej" në mes të tjerëve. Gjithnjë kur kthehej në vendlindje, i hiqte rrobat e studentit të akademisë, vishej njësoj me të tjerët, bashkohej me ne, djemtë e tjerë të fshatit e bisedonte me përzemërzi për gjithshka. Na krijonte një afërsi vëllazërore; çdonjeri nga ne e ndjente veten të vogël përpara tij jo vetëm nga mosha, që ishte ca më i rritur, por edhe në mendime. Për këto arsyet vazhdimisht i shkonim prapa në shëtitjet që kishte qejf të bënte, nëpër ato vende të fshatit, ku kishte luajtur edhe ai me shokët e fëminisë.

Një ditë, moshatarët e mi, Hiqmeti, Namiku dhe Sadiku i kërkuan Asimit që të dilnin shëtitje nga Shullëri (faqja e malit) nga ku duket i tërë fshati. Asimit nuk i mërzitej kurrë natyra e maleve, e pranoi këtë mendim dhe ashtu u bë.

Të nesërmen u mblodhëm rreth dhjetë djem te shtëpitë e Gaxhe, ku nis edhe ngjitja për në Shullë. Kur arritëm tek gërmadhat e fshatit të vjetër, në Dhimaj, qëndruam. Aty Asimi nisi të na thoshte:

-Më kujtohen si tanit ato çapkënllëqet e vegjëlisë, kur ngjante të ziheshin psh dy vetë nga ne me njeri-tjetrin, linim takim që pas mbarimit të mësimeve ta vazhdonim përsëri sherrin, tamam siç vepronin ata që bënин dyluftime në mesjetë. Po në duelet e atëherëshme ishin vetëm dy që luftonin, ndërsa tek ne, pas dy të parëve që nisnin sherrin, krijuheshin tarafe të mëdha, ku përfshiheshin të gjithë djemtë e fshatit. Ata ndaheshin në dy grupe dhe fillonin "luftën", duke qëlluar në drejtim të njeri-tjetrit me hobe.

Ndarja në grupe kundërshtare, zakonisht bëhej sipas vendit ku banonte secili, si kufi shërbën rrepet në mes të fshatit: nga rrepet e përpjetë formohej një "parti", ndërsa nga rrepet e poshtë formonin "partinë" tjetër. Ajo që ishte më me interes në këto "ndeshje" ishte taktika që përdorej me sulm, kundërsulm, rrethim,

krahëmarrje, zënie robërish, bisedime për shkëmbim robërish, marrëveshje për "paqe", e të tjera.

-Edhe tani vazhdon ajo gjë,- ndërhyjn Namiku me Sadikun njëherësh

-Jo-o!- tha prerazi Asimi-ky ka qenë një zakon i keq që na i kanë lënë të huajt për qëllimet e tyre, për të na futur mërinë dhe përçarjen midis njeri-tjetrit. Në këtë mënyrë ata e kanë pasur më të lehtë që të na sundonin. Të parët tanë shpesh kanë rënë në gracka të tilla. Neve nuk na falet që të veprojmë akoma ashtu. Duhet t'ua shpjegojmë mirë edhe më të rinjve këtë të keqe dhe në vend të grindjeve, të fusim dashurinë për njeri-tjetrin, sepse kështu do të jemi në gjendje të luftojmë me të vërtetë kundër armiqve tanë, cilëtdo qofshin ata...

Asimi na fliste për vështirësitë e jetës së fshatarëve dhe të gjithë punonjësve të thjeshtë në Shqipëri, si rrjedhojë e pabarazisë ekonomiko-shoqërore që ekzistonte në vend. Këtë gjë ai e kishte parë edhe në Itali, ku studionte. -Brezat e rinj të çdo vendi qofshin, -thoshte ai-nuk mund t'i durojnë gjatë rregullat e rënda të së kaluarës. Ata një ditë, të detyruar nga barra e rëndë e vuajtjeve, do ta ndryshojnë gjendjen. Nuk përashtohet që edhe ne së bashku, të jemi ndër ata...

Asimit i pëlqenin shunië edhe zakonet tonë të hershme, traditët e mira të popullit. Na fliste vazhdimisht mbi luftën dhe heroizmat e të parëve si bilbilenjtë, që edhe kur do të vareshin në litar, e përbuzën vdekjen me një mënyrë të rrallë krenarie: në vend që t'i binin më gjunjë mëkëmbësit të sulltanit, ndezën nga një cigare dhe i thithën ato me një gjakftohtësi dinjitoze që i pati zili edhe armiku...

-Trimëria dhe besa janë dy nga cilësitë më dalluese të shqiptarit, thoshte Asimi. Këtë gjë e kanë kuptuar edhe armiqtë ndaj, nga njera anë janë munduar të na fërkojnë krahët, sa të na fitojnë besën, nga ana tjetër na nxisin në armiqësi me njeri-tjetrin që të na sundojnë.

Djalëria shqiptare duhet t'u ngjasë të parëve edhe në trimëri e në besë, por nuk duhet harruar se "besa" dhe premtimet e armiqve nuk kanë pasur asnjëherë vlera të vërteta. Ata që na hiqen si miq

duhet t'i çmojmë jo nga fjalët që thonë, por nga punët që bëjnë... Asimi ndërmjet shumë të tjerëve, përmendi edhe pabesinë e Portës së Lartë Osmane kur thirri gjithë parinë shqiptare në Manastir, gjoja për t'i "shpërblyer" në emër të sulltanit, pastaj u ra prapa krahëve,. Një nga këto viktima që i zuri besë armikut dhe ra në grackën e tij, ishte edhe bashkëfshatari ynë Asllan Kuca... Ai kur e kuptoi hilen, luftoi burrërisht por ishte tepër vonë, kështu edhe çështja që ata mbronin pati humbje...

Megjithëse ne në atë kohë nuk ishim në gjendje t'i kuptionim të gjitha hollësitë e ndodhive që na thoshte Asimi, po më kryesorja e këtyre thënieve se "edhe ne mund të jemi ndër ata që do përbysim botën e vjetër..." tanimë qe bërë moto e Luftës sonë ANÇI.

### ***Malli që djeg për vendlindjen***

Sa mbërritëm në Qafën e Shënthanasit, të dy me Sami Gjergjin<sup>1)</sup>, na doli përpara Progonati me tërë pamjen e tij, i rrethuar nga të gjitha anët me male të larta që arrijnë mijëra metra mbi nivelin e detit, me afro të 500 shtëpitë e tij, të ndërtuara në rrafshinën më të madhe të malësisë së Kurveleshit. Që andej dukej i téri si në pëllëmbë të dorës. Ndërtesar e tij të gurta edhe pse të dëmtuara që nga lufta italo-greke e më pas, qëndronin në grumbuj të mëdhenj pranë njera-tjetrës, në bazë të të pesë mëhallave që e formonin fshatin. Rrugët më të mëdha që e përshkonin atë kryq e tërthor shërbenin shpesh edhe si një farë kufiri ndarës i secilës mëhallë prej të tjerave. Ambienti përreth ishte kredhur në gjelbërimin e dendur plot ngjyra që krijonin kopshtet e mbushura me qershi, me arra, me gështenja, me mollë, me hardhi e të tjera pemë frutore, që bënin edhe freski tani në verë. Të gjitha këto i jepnin atij një pamje befasuese për cilindo që mund ta shikonte qoftë edhe jo për të parën herë.

Luftëtrat e viteve të fundit, sidomos që nga ajo italo-greke e këtej dhe hallet e tjera të jetës që nuk u ishin ndarë kurrë malë-

1)Sami Gjergji, partizan i orëve të para, dëshmor i Luftës ANÇI

sorëve të këtyre anëve, i kishin detyruar shumë prej familjeve tonë që të largoheshin me dhimbje nga vendi i tyre, kurse unë vetë isha larguar prej andej qysh në moshën 12 vjeçare dhe po kthehesha pas shumë vjetësh.

Me të mbërritur tek Qafa e Shënathanasit, ndjeva një farë prejeje në gjunjë nga emocionet e malli për vendlindjen dhe i shfaqa dëshirën shokut tim gusmaras që të uleshim e të "shplodheshim" pak. Ai nuk ma prishi qejfin. Malli që më kishte marrë për truallin ku isha lindur e rritur ma bënte aq të shtrenjtë atë sa që më dukej se nuk do të kisha kurrë të ngopur. U ula aty mbi një plakë të madhe prej guri, duke "notuar", me mendje nëpër qindra e mijëra kujtime që lidheshin me jetën e viteve të mia të vegjëlisë.

Në atë pamje mundohesha të shquaja truallin e shtëpisë, ku kisha lindur, sokakët përreth, rrugën e Lumaqeve që na bllokohej aq shpesh nga dëbora në dimër e i kish detyruar nënënat tonë që mezi ta çanin atë duke qëruar dëborën me lopatë sa hapnin një farë kalimi të ngushtë dhe na shpinin deri në shkollë kalifoç... Këtë punë e bënин vetëm gratë sepse burrat në dimër iknин me bagëti poshtë nga vendet e thella të Delvinës e të Vlorës për t'i dimëruar ato.

Mundohesha të saktësoja Bregun e Skrelit, ku loznim shpesh në dimër duke formuar topa me dëborë sa që nuk mund t'i shtynim dot më tutje nga mbështjellja e dëborës që merrnin ata me vete gjatë rrokullisjes. Pastaj qëndronim dhe i qëndisnim me "sy" "burzë" e "veshë" me anë të thëngjive që vendosnim mbi ta, sa mernin pamjen e ndonjë shtatoreje. Kërkova me sy ato shkurret e ngjeshura me përrallë që mbulonin rrëzën e shullërit e Arat e Dolle, ku kisha ngrehur pahidhe për të zenë mëllënjë.

Ja dhe Rrypat e Kuqe, ku vraponim me fëmijët e tjerë ditën e parë të pranverës (14 mars) me nga një bype nga ato të deshëve apo zile të madhe në qafë; i tundnim që nga mëngjesi e deri në mibrëmje për "Ditë Vere", siç qe bërë zakon të thuhej. Në darkë ktheheshim të lodhur e të këputur. Hanim me oreks ç'të na vinin përpara nënënat: bukë e shëllirë, kur na ndodhej, edhe djathë a ndonjë kokërr qepë, që gjithashtu na dukej shumë e shijshme.

Ja edhe shkolla aty ndanë rrepeve, ku kisha mësuar shkronjat

e para të alfabetit si dhe vjershat e para. Aty më erdhi ndërmend edhe ajo vjersha e ime e preferuar që e kisha recituar përpara nxënësve e prindërve me rastin e mbylljes së vitit të parë shkollor, ashtu siç më kishte këshilluar mësues Idajeti<sup>1)</sup> Më hipi në kokë për atë vjershë dhe ashtu vetveti nisa ta përsëris një strofë të saj me vete:

“Mëmëdhe quhetë toka/ku më ka rënurë koka,

Ku kam dashur mëm’ e atë/ ku më njeh dhe gur’i thatë...”

Kënaqësinë e madhe që kisha ndjerë kur e kisha thënë këtë vjershë për herë të parë në shkollë, pothuajse e shijoja edhe tani që e shkoja nëpër mend.

Samiu që ishte ulur pak më tej e po rregullonte një tel të opingës që i kishte dalë ca si anash dhe po e pengonte, gjatë gjithë atyre minutave nuk ishte ndjerë. Tani nisi edhe ai të shqiptojë lehtë-lehtë, vargjet e një këngë të njojur. Melodia e saj e njojur dhe fjalët arritën gjer tek unë dhe m’i ngacmuau veshët këndshëm:

*“O Progonati me vulë, kala ndërmjet maleve,*

*Që nga Stambolli me bujë e të madhe axhale,*

*Me taborre t’u vërsule të të bëjnë terbije...”*

Ngacmimi që më bëri shoku me përmendjen e kësaj këngë epike, protagonistet e së cilës ishin ngulitur në përfytyrimin tim si gjigandë të pamposhtur, më largoi disi nga bota e lojërave fëminore dhe shkolla fillore që kisha bërë aty. Ai më hodhi në atë botën e tregimeve që kisha dëgjuar për kreshnikët e që më kishin mbetur të pashlyera nga kallëzimet e gjyshit e sidomos të gjyshes.

“Palla e Skënderbeut ishte me shtatë presa,- më kishte thënë gjyshja disa herë mbrëmjeve kur më vinte në gjumë,- vetëm ai mundi ta vrasi kuçedrën me shtatë koka që na pat zaptuar vendin..., Bilbilenjtë nuk donin t’ia dinin fare për vezirët dhe pashallarët e Turqisë..., Gjoleka çau nëpërmes 40 mijë asqerëve që e mbronin kaftanazin dhe e vrou atë..., Hamit Guga me komitet

---

1) *Idajet Shehu, ish mësues në shkollën e Progonatit*

e tij u kish kallur tmerrin karvaneve të dovletit...Të gjithë këta i kish lindur e rritur ky truall..."

"Po, mendova, ky trualli ynë është i mbushur plot e përplot me histori betejash heroike të të parëve. Eshtë i larë në çdo pël-lëmbë të tij me gjakun e tyre..."

Hodha shikimin djathtas dhe më vajtën sytë te Përrallët e Buxë që lidheshin me atë Kuvendin e Tretë të burrave të Labërisë -siç më kish thënë edhe gjyshi-për të kundërshtuar xhelepin e nizamët që kërkonte Porta e Lartë...

Nuk qenë vetëm osmanët hasmit tanë më të prapë, më pat thënë gjyshi, me ta u bashkuan në atë kohë edhe priftërinjtë e kishave e të Manastirëve të Stambollit që bashkë me turqit e rinj, kur këta erdhën në fuqi, bënë çmos gjer, sa na i mbyllën Klubin "Arbëria" që u krijua në fshatin tonë atë sene.

Kur u bë ngritja e flamurit dhe shpallja e pavarësisë nga Ismail Qemali, disa fqinj me emrin e sajuar "Vorioepirotas", të prirë nga Jorgji Zografos prej Qesarati që ishte pajtuar në shërbim të mbretërisë greke si ministër i saj, kanë bërë zullume të mëdha karshi nesh. Zografa atëhere na burgosi pabesisht me të gjithë parinë e Kurveleshit, se nuk u pajtuam me planin e tij të copëtimit të atdheut. Ai u suall shumë keq me ne..."

Pak nga e majta e përballë vendit ku po rrnim, në anën veriore të fshatit qëndronte Mali i Gjoloçit, po ashtu me shumë kujtime për mua. Aty qe trualli i shtëpisë së Ago Myhyrdarit dhe birit të tij Asllan Kuces, dy nga kapedanët më të shquar në oborrin e Ali Pashë Tepelenës.

Ndërkaq Samiu që kish shkelur shpesh këtyre fshatrave m'u afroa e më njoftoi se dhjetëra nga versnikët tanë prej këtej qenë hedhur në radhët e çetave partizane...

Ecëm. Ishte afër drekës, dielli na i lëshonte rrezet e tij të nxehtha mbi kokë, na dukej se edhe gurët që shtriheshin anës rrugës lëshonin xixa prej vapës që këtë herë ndihej edhe këtu në malësi. Sa mbërritëm te rrepet e mëdhenj në mes të fshatit midis bashkëfshatarëve të parë që takuam aty gjeta edhe motrën time, Venon, të martuar e me banim aty. Kisha kohë pa e parë dhe me këtë rast sikur u çmallova pak. Ndër të tjera ajo nisi të na tregojë për

pasojat rrënuese e të shumta të operacionit armik të prillit që ishte zhvilluar në Kurvelesh atë vit.

Nga ana e të pranishmëve pranë rrepeve ndërkokë u ndien zëra: "Po vjen Margleni po vjen Margleni<sup>1)</sup>; ktheva kokën edhe unë nga shikonin të tjerët, nga baçja e Kokajve, dhe dallova që po ecte drejt nesh një burrë me trup të pakët dhe energjik. "Ky përparrë është shoku Mustafa Matohiti, tha Venua, ndërsa ai që e shoqëron është Babushi<sup>2)</sup>. Emrin e Mustafait e kisha dëgjuar po nga afër nuk e njihja, prandaj dhe ndjeva një kënaqësi të madhe për rastin që m'u dha.

Mustafai hyri në mes tonë dhe na përshtëndeti të gjithëve partizanë, pastaj iu drejtua edhe me emër secilit. Samiu që njihej prej kohësh me të, me prezantoi edhe mua me Mustafanë, ndërkokë ky i fundit porositi mbledhjen e të gjithë fshatit aty tek rrepet, në mes të tij.

Në pritje të njerëzvë që po mlidheshin si zakonisht nisi kënga nga një grup të rinjsh e të reja: me ta clora-dorës bashkoheshin edhe ata që sapo vinin.

Njera nga këngët lidhej me aksionet e kryera në Kurvelesh gjatë vittit 1942. Ja disa nga vargjet e kësaj kënge që mbaj mend:

*"Komand'e shtabi dërgoi,  
Kuç i të jetë gati,  
Mareshallin me italianë  
Ta digni, ta bëni bi!  
....."*

Entuziasmi i fshatarëve nuk kishte të pëershkuar, ç'ka se gjendja e tyre ekonomike nuk ishte e kënaqshme. Vapa e verës këtë herë edhe në Progonat kishte zhuritur gjithshka. Kishte shumë kohë pa rënë shi dhe të lashtat ishin mbledhur më përparrë se zakon-

---

1) Marglen qe pseudonimi i Mustafa Matohitit gjatë Luftës ANÇI.

2) Babushi, qe pseudonimi i Kadri Matohitit, luftëtar i orëve të para.

isht. Fshatarët tani as nuk lëviznin dot si pérherë, pér të siguruar bereqet jashtë krahinës së tyre. Kurveleshi ishte shpallur prej forcave kryengritëse, zonë e lirë, qysh më 28 nëntor 1942. Çdo hyrje e dalje nga kjo zonë ishte vënë në mbikqyrje të rreptë nga ana e pushtuesit.

Problemet ekonomike të krahinës mplekseshin ngushtë me ato ushtarake e politike. Duke shfrytëzuar një situatë të tillë kërret e reaksionit mundoheshin që ta dëmtonin sa më tepër Lëvizjen NÇ, duke goditur edhe nga jashtë, edhe nga brenda. U grumbulluan atë ditë mbi 200 burra e gra, bile edhe fëmijë. Mustafai nisi ligjëratën, përafërsisht me këto fjalë:

-Këta rrepe hijerëndë, me moshë qindravjeçare qëndrojnë në mes të fshatit tuaj si dëshmitarë të gjallë pér luftërat e rrepta të të parëve tanë. Këtu janë bërë shumë kuvende e janë marrë sa e sa vendime pér qëndresë të vendosur karshi armiqve. Prej këtej u nis edhe çeta e birbilejve të famshëm. Pranë këtyere rrepeve patrioti Shaqo Buzo e çburriroi komandantin xhonturk kur ai kërkonte çarmatimin e progonatasve....,Prej këtej u nis çeta e vullnetarëve të Vlorës më 1920. Këta rrepe përshtendetën para një viti vullnetarët e parë të Çetës "Haredin Tremishti". Po këta rrepe përcollën para një muaji birin tuaj Asim Zenelin pér në Grykën e Mezgoranit. Ne sot përsërisim betimin tonë të madh se do t'u qëndrojmë besnikë traditave të të parëve tanë dhe idealeve të shenjta të lirisë!....

Fronti NÇI dhe PKSH ju drejtohen juve të bërrucave të vjetër dhe të opingave me tela që të hidheni menjëherë në radhët e luftëtarëve të lirisë dhe ashtu si baballarët e gjyshërit tanë qëmoti t'ia bëjmë forra, të mos lëmë asnjë këmbë armiku brenda truallit tonë të shenjtë!...

Ndërkohë dikush iu afrua Mustafait në krah dhe i tha me zë të ulët aq sa mezi dëgjuam vetëm ne që ishin më afër tij:-Zoti Ismail Golemi<sup>1)</sup> ka një punë të rëndësishme me ju dhe po ju pret në shkollë.

Në ballkonin e shkollës, që nuk ishte as 30 metra larg nga vendi

---

1) Ismail Golemi, njieri nga kërret më aktivë të Ballit Kombëtar

ku fliste Mustafai dukej të qëndronte një burrë i bëshëm, me trup mesatar me rroba që ngjanin me ato të oficerëve fashistë. Në krahun e majtë mbi sisë kishte vendosur një flamur të madh me shkabë në mes. Në dorë rrötullonte një kamzhik që më tepër tregonte nervozizëm se sa fodullëk. Mustafai nuk i tha asgjë të dërguarit që e lajmëroi me aq ngut, i bëri atij vetëm një shenjë me dorë që të largohej dhe vazhdoi:

-Fronti NÇl nuk ulet kurrë në një sofër me armikun që na ka zenë vendin, as me ata që përpinqen t'i zgjasin ditët atij...Ne nuk bëjmë prapaskena, letrat i kemi të hapur përpara popullit- luftë deri në fund. Le të dalë të thotë ai që di rrugë tjetër shpëtimi.... Zotërinjtë e Ballit pse kanë frikë t'ia thonë popullit haptazi qëllimet e tyre?

Udhëheqësi i "Ballit Kombëtar" që u lodh së prituri në ballkonin përkarshi, fjalët e Mustafait i dëgjonte të gjitha. Me sa dukej ato e shponin si maja thike, prandaj nuk po e mabnte vendi. Lëvizte vazhdimisht me ecejake në ballkonin e shkollës, po edhe të zbriste poshtë e të ballafaqohej me popullin nuk guxoi.

Kur mbaroi Mustafai së foluri ishte kohë dreke: shumë nga ata që dëgjuan fjalimin e tij, iu afroan kush e kush ta ftonte më parë në shtëpi. Në këto çaste Ismaili zbriti me të shpejtë shkallët e shkollës dhe i doli Mustafait përpara, me këto fjalë.

-Zoti Mustafa, kam një punë shumë serioze me ju, veças.

-Po ke ndonjë gjë me rëndësi, zoti Ismail thuaje përpara popullit se ne nuk kemi gjë të fshehur nga ai!

-Do t'ju jem shumë mirënlohës- nguli kënmbë Ismaili me një ton diplomatik.

-Hajde pra, ç'do të na thuash?- tha Mustafai duke e ftuar atë të printe përpara për të hyrë në shkollë. Babushi shkoi bashkë me ta. Edhe ne me Samiun deshëm të shkonim prapa tyre po me dy mendje se mos bënim gabim; Babushi me një lëvizje të krahut na bëri shenjë dhe shkuam.

Me të hyrë në shkollë Ismaili pa njëherë nga ne që sikur iu dukëm të tepër aty: Mustafai e vuri re këtë dhe tha: -S'ka gjë janë me mua, le të vazhdojmë!

-Atëhere unë dua t'ju njoh më me hollësi me një plan që ka

përgatitur organizata e Ballit Kombëtar për mbrojtjen e Kurveleshit- filloj të thotë Ismaili, duke nxjerrë nga çanta një hartë... -Ja kjo është skema e mbrojtjes- vazhdoi udhëheqësi i Ballit, duke shtruar mbi tavolinë hartën, forcat tonë të përbashkëta do të mbrojnë Grykën e Bënçës, Grykën e Rehovës, Grykën e Shurit, Gry...

-....Mjaft me grykat e tua! Po Shqipërinë kujt do t'ia lemë o Ismail Golemi?- u revoltua Mustafai.

-Këto forcat janë vetëm për mbrojtjen e Kurveleshit, pa u tra- zuar me krahinat e tjera të vendit dhe as ata nuk duhet të trazohen me ne. Po nuk bëmë një politikë të zgjuar në këtë situatë, do të digjemi nga italianët si miu në kashtë- arsyetoi ballisti me një ton të qetë në pamje.

-Ky është avazi juaj i vjetër zoti Golemi, ju na këshilloni ta lemë armikun të qetë që edhe ai të tregojë "mëshirë" karshi nesh e të "mos na djegë"...Sa bukur e kini menduar! Fronti Nacionalçlirimtar nuk bën asnje kompromis me armikun! Ju këtë e dini- përfundoi Mustafai dhe doli me vrull nga shkolla.

Populli qe kurioz se ç'të reja do të propozonte Ismail Golemi, prandaj nuk ishte larguar akoma. Me të dalë te shkallët, Mustafai tha me zë të lartë:

-Ismaili u përpoq të më mbushë mendjen për "patriotizmin" e Ballit Kombëtar. Ai me fjalë të tjera na kërkon që të mos i luftojmë fashistët, se ashtu edhe ata nuk do të na ngasin neve! Të bëjmë paqe me ata që na kanë zaptuar vendin, si thoni ju?

-Poshtë Balli Kombëtar, poshtë tradhëtarët!- thirrën zëra të fuqishëm nga masa.

Kisha dëgjuar më parë për rolin sabotues të Ismail Golemit si drejtues i Ballit Kombëtar. Këtë herë u binda edhe më tepër që ai ishte me të vërtetë një "dhelpër" e vjetër, siç e kishte quajtur populli, që kërkonte të nxirri pulat nga dera e pasme e kotocit. Kjo nuhatje e popullit u vërtetua edhe atë ditë, ai e la udhëheqësin e Ballit të vëtmuar, kurse Mustafain e priti dhe e përcollti me respekt. "Udh'e mbarë more bir, na u kthefsh shëndoshë! Këtu të gjithëve me vete na ke, le të lehin qentë..."- këto ishin disa nga fjalët e nënë Nazifes <sup>1)</sup> në përcjellje të Mustafait.

---

<sup>1)</sup>Nazif Hila, aktiviste e shqar e Luftës ANÇL në Progonat gjatë kohës së okupacionit.

Mustafai kishte një paraqitje mjaft të thjeshtë. Automatiku i markës italiane që mbante në sup dukej ca si i gjatë për trupin e tij të pa-ktë e të dobësuar. Buština partizane me strehën e ulur mbi ballë dhe yllin e kuq që shndriste në krye të saj, e bënte edhe më tërheqëse ftyrën e tij aq të rregullt. Mustaqet e zeza ia bënин edhe më burrërore pamjen e jashtme. Sytë e tij të ndritshëm e të zgjuar, gjatë polemikave sidomos, shikonin gjithnjë drejt bashkëbiseduesit, saqë e detyronin atë t'i nxirre në shesh pikpamjet e tij. Fjalët aq të matura e të kuptueshme prej të gjithëve dhe arsyetimet e shëndosha, të bazuara në interesin e At-dheut e të popullit, vërtetonin cilësitet e larta patriotike dhe logjikën e hekur të këtij udhëheqësi të shquar. Ai mund ta bënte për vete shumë shpejt cilindo njeri të ndershëm. I tillë ka mbetur Mustafa Mato-hiti, në kujtesën time.



Hero i Popullit Mustafa Mato-hiti

### **Lufta na njeh me njeri-tjetrin**

Një pasdite të nxeh të gushti po ecnim bashkë me Koçon<sup>1)</sup> nga Treblova për tek Shkëmbi i Kalivaçit. Gjatë rrugës, në mes të Fushës së Shkozës gjetëm tre partizanë që ishin ulur e çlodheshin në hijen e një peme, ndanë kalimit tonë. I përshëndetëm me atë mënyrën tonë të zakonshme "Vdekje Fashizmit" dhe ata na u përgjigjën: "Liri Popullit! "Ndërkohë bëmë të vazhdonim ecjen më tej.

-Rrini pak, ku nxitoheni kështu, shplodhuni ca në hije bashkë me ne! - tha njeri prej tyre, ai që rrinte i mbështetur pas gorricës, duke vënë buzën në gaz.

1) Koço Dhimitri ish-partizan i çetës "Ismail Qemali"

-Jo se na bëhet vonë për në çetë,- qe përgjigja jonë.

-Në cilën çetë bëni pjesë ju?

-Nuk i është vënë emri akoma se kohët e fundit janë krijuar shumë çeta të reja...Duhet të shkojmë sa më parë se atje është edhe Besniku<sup>1)</sup> e na pret- tha Koçua.

Qeshën të tre ata njëherësh, pastaj ai që fliste tha:- E e paski sekret emrin e çetës; kështu ju paska porositur Besniku? -Mirë pravazhdoi ai- mund të na thoni nga jeni ju, apo mos ju kanë porositur që të mos e tregoni as këtë?

-Unë jam nga Progonati, kurse shoku im është nga Selenica u përgjigja drejt dhe e ftova shokut të vazhdonim ecjen, pa e zgjatur muhabetin më tej.

-Epo mirë pra, meqë e paskeni punën me aq axhele shkoni - tha tjetri. Dy të tjerët vetëm dëgjonin e hera-herës qeshnin. Qeshën fort sidomos kur Koçua tha se na pret Besniku.

U përshtendetëm përsëri dhe vazhduam rrugën. Gjatë ecjes shoku im zuri të më shpjegojë disa "rregulla" mbi ruajtjen e sekretit. Në këtë kuptim e arsyetoi ai edhe atë përgjigjen që u dha atyre, kur na pyetën për emrin e çetës, sa i bëri të tjerët edhe për të qeshur.

Të nesërmen më 12 gusht, u gjendëm në anën e djathë të Vjosës, poshtë fshatit Kalivaç. Aty ishin grumbulluar edhe disa çeta të tjera, përveç tonës. Thuhej gojë më gojë se do të bëhej një aksion i madh i përbashkët.

Qenë orët e paradrekës kur një grup nga ne, së bashku me ca nga shokët e çetave të tjera, ia kishim marrë këngës në hijen e plepave aty. Papritur njera nga shoqet tha:- Erdhi shoku Besnik!

Ky emër aq i njojur në tërë Qarkun e Vlorës na bëri të gjithëve të pushonim këngën e të kthejmë kokën. Prapa krahëve tanë shoh që po afrohej fare pranë fytyrën që më ngjau si e njerit nga të tre partizanët që kisha takuar në Fushën e Shkozës, një ditë më parë. Fërkova një herë sytë se mos më gënjenin, po jo, ishte tamam ai me të cilin kisha bërë atë copë bisedë në hije të gorricës, atje ndanë rrugës. Buzëqeshja e tij e ëmbël e vërtetonte më së miri këtë.

---

1)Pseudonimi i Hysni Kapos

Besniku bëri shenjë me dorë që të mos shqetësoshe him, pastaj nisi të përshëndesë shokët e shoqet me radhë. Në këto çaste u vura në pozitë të papërshtatshme nga takimi që kisha pasur me të një ditë më parë dhe nuk e kisha njojur. Po mundoheshë t'i mposhtja shqetësimet që m'u krijuan, kur shumë shpejt më erdhi radha t'i përgjigjesha përshëndetjes së tij. Ai duke ma shtrën-guar dorën e me të qeshur tha:

-E, Progonat, e gjetët dot çetën?- dhe papritur përgjigje shtoi: - Po emrin ia vutë, apo jo akoma?... E pa që më zuri ngushtë e s'kisha ç'ti thoshja. Për të mos më lënë në turp, ashtu siç ma kishte zenë dorën, më tërhoqi nga vetja e më përqafoi, duke thënë:- Lufta kundër armiqve do na njojë më mirë me njeri tjetrin.

Pas asaj kohe e deri në fund, pata shumë raste takimi me të. Sa herë që e binte puna të takoheshë me Besnikun, ai si me shaka nuk harronte të më përmendte atë "sekretin" e emrit të çetës.



Heroi i Popullit Hysni Kapo

Më bënte gjithnjë përshtypje me gjak-fohtësinë që kishte, me maturinë në çdo punë, me tonin shoqëror e të ëmbël të të folurit.

Besniku zotëronte edhe një kujtesë të jashtëzakonshme për njerëzit, për emrat e tyre dhe për hallet që i preokuponin ata. Ai dallohej për thjeshtësi e çiltërsi të jashtëzakonshme në marëdhëniet me të tjerët. Ishte ndoshta pikërisht kjo çiltërsi e qëndrueshmëri karakteri, që nuk e lejuan të distancohej prej shkaktarëve kryesorë të gabimeve të mëdha parimore që u vërtetuan në drejtimin e vendit në vitet e pasçlirimit.

### **Kolona e pestë**

Kishim udhëtarë tërë natën prej fshatit Kalivaç nëpër zona të thyera e të pyllëzuara. Mëngjesi i 13 gushtit na gjeti të vendosur në një pritë që e patëm zënë me natë gjatë rrugës automobilistike Tepelenë-Vlorë në sektorin e Malit të Bardhë, ndërmjet fshat-

rave Dorëz e Mazhar. Aty u rreshtuam njëherazi disa çeta nga qarku i Vlorës dhe nga ai i Gjirokastrës. Përveç që ishim të lodhur pas mbërritjes aty, ishim edhe të lagur, sepse lumin Vjosë e patëm kaluar në këmbë, të zënë dorë për dorë.

Sapo kish çelur dita, kur në anë të fshatit të vogël Martallos u duk nga larg një grup makinash që lëvizte në drejtimin Tepelenë-Vlorë, gjë që pritej prandaj na gëzoi. Partizanët nisën, sejcili në pozicionin e vet, të bënин kontrollin e gadishmërisë për hapjen e zjarrit, ndërkohë secili mundohej ta përfytyronte sa më konkrete betejën që na priste përpara...

Kur kreu i autokolonës armike ariti në Qafën e Mehmete, që binte në vijë të drejtë me fshatin e Dhemblanit, ndaloj atje për nja dhjetë minuta. Pastaj vazhdoi përsëri të ecte, duke e rritur edhe më lagësinë që mbanin makinat me njera-tjetër, gjatë ecjes. Këtu u krijua dyshimi i parë lidhur me fshehtësinë e pritës që kishim zenë.

Nga Qafa e Mehmete, autokolonës që ecte ngadalë i duhej një kohë prej 30 deri 40 minutash për të mbërritur te prita. Megjithatë kaluan afro dy orë e makinat nuk po dilnin akoma nga Lugina e Matohasanajve. Me këtë vonesë dyshimi i mëparshëm u shtua dhe më tepër. Nuk kaloi shumë dhe afër pozicioneve tona u ndie një zhurmë motorresh që sa vinte e po bëhej më e fortë. Dhe ja, përpara nesh, në rrugën automobilistike, po kalojnë dy autoblinda, duke zbruzur në ecje e sipër disa breshëri mitralozi, pa ndonjë shenjëmarje të caktuar. Nga ana e jonë mund të hapej zjarr vetëm kur të hynin në pritë makinat e autokolonës, kështu ishte urdhëri. Por makinat nuk po dukeshin. Autoblindat që kaluan, shkuan gjer në një farë vendi dhe u kthyen përsëri andej nga erdhën. Atëhere u bë krejt e qartë se fashistët ishin informuar saktësisht mbi praninë tonë aty.

Nga sqarimi i mëvonshëm i situatës doli se autokolona e trupave armike ishte ndaluar në bisht të Malit të Dorëzës, atje ku rruga automobilistike fillonte pjerrësinë më të madhe të ngjitet. Ushtarët kishin zbritur nga makinat dhe po lëviznin përpara në formacion luftarak e me kujdes, në krahëmarrje të pozitave tona, prej anës së djathtë që binte faqes së malit përsipër. Autoblindat

ishin shfaqur vetëm për qëllim zbulimi. "Kolona e pestë" siç ishte bërë zakon ta quanin agjenturën armike, ishte vënë në veprim.

Me këtë ndryshim të situatës Mustafa Matohiti dhe Besniku që ishin drejtuesit kryesorë të aksionit, lëvizën nga njeri pozicion te tjetri për të bërë korrigjimet e nevojshme në vendosjen tonë e duke dhënë udhëzime të reja.

Artilleria armike nisi të bëjë qitje në masë, duke bombarduar papushim gjithë faqen e malit ku ishim vendosur. Partizanët qëndruan në vendet e tyre të luftimit, pa u tundur dhe pa e zbuluar veten, deri sa ushtarët fashistë ia mbërritën andej nga nuk i prisin. Ata ecnin në vijë të hapur, duke gulçuar prej lodhjes që u kishte shkaktuar terreni i thyer e me shkëmbenj, nga u ishte dashur të ecnin për të bërë krahmarrjen tonë.

Urrejtja në gjokset partizane tanimë po bëhej e papërmrbajtur, koha për të shtirë mbi armiqjtë kishte ardhur dhe nisi gjithë forcë.- Përpara shokë, pas meje!- u dëgjua zëri i Koçi Ramadanit e pas tij edhe të tjerë. Në të njëjtën kohë u shkëputën nga pozicionet për në kundërsulm disa grupe partizanësh njeri pas tjetrit duke hedhur bomba dore kryesisht kundër autoblindave armike dhe duke ecur furishëm përpresa.

Në kundërsulm u hodhën partizanët edhe në sektorë të tjerë të pritës, drejt pikash të caktuara armike gjersa fashistët u detyruan të kalojnë në mbrojtje.

Befasia që ishte parashikuar nga ne për ta goditur armikun nuk ekzistonte më, kështu u detyruam të pranojmë një betejë frontale e të pabarabartë. Sikur të mos mjaftonte kjo e keqe, doli dhe tjetra: zhurmë makinash nga prapa krahëve. Autokolona tjetër armike me drejtim Vlorë-Gjirokastrës ndaloi fare afër shpinës sonë. Ushtarët e saj po zbrisnin me shpejtësi nga makinat dhe nisën goditjen kundër nesh. Tani plumbat na vërvshëllenin nga të dy anët, edhe përpresa, edhe prapa.

-Çeta "Ismail Qemali" të kthehet me front prapa dhe të kundërsulmojë këta që vijnë nga Vlora!- u dha komanda. Gjaktrat i kishim të nxeha nga beteja e nisur më parë, po edhe ca të dëshpëruar ishim që na i kishin zbuluar planin armiqjtë e nuk arritëm dot t'i shpartallonim ashtu siç e përfytyronim ne. Në këtë inat e sipër

gjithë çeta u hodh në kundërgoditje ndaj ushtarëve të autokolonës së dytë.



Heroina e Popullit Zonja Çurre (pikturë)

Në kundërsulm e sipër miralieri i një skuadre u plagos në krahun e djathë. Ishte kulmi i betejës në këtë anë të frontit, pikërisht kur armiqjtë nisën të shkuleshin nga vendet që kishin zenë. Me iniciativë të saj Zonja Çurre <sup>1)</sup> që u ndodh pranë e mori vetë mitralozin dhe nga pozicioni në këmbë vazhdoi ta përdorë atë në sulm e sipër. Shembulli i Zojës e shtoi sedrën tek partizanët

e tjerë në ndjekje të armikut, gjersa e detyruam atë të ngulitet tek ca shkëmbenj të mëdhenj, anë xhades, ku qenë lënë makinat e autokolonës së tyre. Ndërkohë sharapnelat që hidhët armiku prej të dy anëve shpërthenin papushim në ajër mbi kryet e formacioneve partizane.

Pas disa orë luftimesh, morëm urdhër të ngjiteshim pjesë-pjesë, lart pllajës së malit! Kur arritëm në hijen e ca kumbullave të egra, u muar vesh se mungonte edhe italiani me gjithë mitralozin "breda" që i ishte besuar për përdorim. Ky ishte një nga karabinierët që kohë më parë i kishim zënë robër në Selenicë. Kishte shifqur dëshirën të bëhej partizan dhe qe pranuar në çetë. Dukej si i vendosur kundër fashizmit, po tani ç'e gjeti?! Për të vrarë qemë të sigurt se jo. Dikush tha se duhej të ishte zenë rob. Një shok tjetër tha se e kishte parë të kalonte vetë në anë të italianëve. Çështjen e tij nuk mundëm ta sqaronim saktësisht aty për aty, po varianti i fundit u quajt si më i besueshëm, meqë në raste të tjera ishte provuar që armiku synonte vazhdimi shëtë fuste njerëzit e

---

1) Zonja Çurre, dëshmore e Luftës ANÇl, heroinë e popullit.

tij në radhët tona.

Aty nën hijen e kumbullave të egra erdhi dhe Mustafa Matohiti. Ndër të tjera ai tha: "Forcat tona partizane arritën sot një fitore të rëndësishme. Armiku pësoi disfatë. E gozhduam atë në vend për më tepër se 7 orë dhe i shkaktuan dëme në njerëz e në mjete. Kjo ishte një tjetër provë bindëse e forcës sonë. I detyruam italianët që të lenë rrugën e të struken nëpër gurë për të shpëtuar kokën... Ne fituam edhe një mësim të mirë lidhur me fshehtësinë e veprimeve tona nga bashkëpunëtorët e armikut si kolonë e pestë. Pastaj porisiti për luftimet e ardhshme duke thënë... Le të jemi gati shokë, detyra të tjera luftarake na presin... - Jemi gati për çdo aksion.

E mori fjalën edhe Hysniu i cili e quajti aksionin si mjaft të dobishëm sepse i detyroi armiqëtë të angazhohen në luftime të paparashikuara. Ndërkohë lavdëroi qëndresën burrërore të partizanëve nën plasjet e shpërthimeve që s'pushuan tërë kohës së luftimeve. Fjalët e tij qenë mjaft të vlefshme po të mbahet parasysh edhe fakti që partizanët nga mosha qenë shumë të rinj. Mosha mesatare e tyre nuk i kalonte të 21 vjetët.

### **"Dora e Zezë"**

Orët e vona të mbrëmjes së 20 gushtit na gjetën në fshatin Hysoverdh. Korieri i dërguar nga Këshilli NÇl i fshatit Mallkeq e lajmëroi se "i dërguari" shëtitës kishte ardhur në atë fshat. Për ta marrë këtë njeri u dërgua partizani Laver Sino, së bashku me dy shokë të tjerë. Mëngjesi i ditës së nesërme e gjeti përpëra çetës atë që kishte qarkulluar si hije.

-Kush je ti dhe me se merresh? - pyeti komandanti i çetës, duke u bërë shenjë partizanëve që e mbanin nën vërejtje për t'i zgjidhur duart.

-Në asnjë mënyrë, shoku komandant- tha Laveri, është shumë i rrezikshëm, gjatë arrestimit deshi të shtinte edhe me armë, po nuk mundi sepse fishekët i qenë hequr më parë nga i zoti i shtëpisë.

-Më jepni fjalën se do të më lini të lirë dhe unë do të jem

Dora e Zezë (kështu e quante veten ai) e Lëvizjes NÇl, do bëj si të më thoni ju, do të vras të gjithë ata armiq që do më thoni ju...

-Ç'thoni ju për këtë?- ndërhyri, Mynyr<sup>1</sup> duke u kthyer ëndej nga ishin radhitur partizanët e çetës.

Të gjithë e shikonim me urrejtje të arrestuarin, disa kërkuan të clenohej menjëherë: të tjerët kërkuan që t'i bëhej gjyqi më parë e të dënohej si provokator. Komisari premitoi se do të respektohej drejtësia partizane, pasi të hetohej çështja mirë. Pastaj dha urdhër që ta hiqnin mënjanë "Dorën e Zezë", duke i dhënë kohë që të mendohej mirë e të tregonte hapët për gjithshka.

Ky qe një njeri i armatosur që vërtitej si kusari në mjergull, nëpër zonat e çliruara të Vlorës, nga Treblova e Sevesteri e deri në Mesaplik. Ngjante si partizan, edhe nga veshja. Yllin e kuq e mbante në dy vende, edhe mbi bustinë, edhe në kraharor, mbi anën e majtë të bluzës. Nderonte me grusht dhe përdorte shprehjet e përshtëndetjes sonë: "Vdekje Fashizmit!" e "Liri Popullit", sipas rastit, në popull paraqitej si i dërguar i Frontit NÇl, për të mbledhur ndihma në të holla.

Të dhënat e ndryshme nga populli mbi këtë "të dërguar" të lëvizjes sonë, kishin formuar bindjen se ishte fjala për një provokacion që luhej në kurriz të saj. Ishin porositur Këshillat NÇl nga kalonte ai të ndihmonin për ta vënë në dorë. Dhe ja ku e kemi: duhet të japë llogari.

Kaloi një ditë, dy, tri e më tepër dhe ai nuk thoshte më asgjë tjeter konkrete, veç atyre që kishte thënë më parë. Sipas pothive të tij, i paskish rënë në kokë të luftonte armikun dhe të bashkohej me partizanët, por hë për hë, nuk e kishte bërë këtë, me që më parë kishte pasur dëshirë të kryente disa shërbime në "interes" të lëvizjes që të mund të krijonte në popull një imazh të favorshëm për personin e tij...dhe gjithnjë lutej për ta falur.

Por "Dora e Zezë", përveç emrit që i shkonte për shtati misionit që i kish vënë vetes, nuk kishte asgjë të qartë. Duhej dhe ca kohë që të përcaktohej drejt ç'përfaqësonte ky njeri dhe kujt i

---

*1) Mynyr Xhindi, ish komisar i çetës, dëshmor i Luftës ANÇL*

shërbente ai. Për këtë arsy e mbajt i arrestuar në çetë për aq kohë, sa të dhënat e ardhura nga burime të mirëbesuara vërtetuan se “Dora e Zezë” ishte vetë S.S., një i ngarkuar i reaksionit vendas dhe atij të huaj për të bërë diversion në zonat e lira me qëllim që të diskreditonte Lëvizjen NÇl dhe qëllimet e saj në popull.

Zbulimi i misionit të vërtetë të këtij personi bëri që të shtoeshin kërkesat e popullit për dënimin e tij, ashtu siç ishte propozuar edhe nga çeta. Kjo kërkesë e popullit dhe e partizanëve së fundi u plotësua me anë të gjyqit partizan.

Kanë mbetur të paharruara fjalët e pendimit të S.S. në prag e pas shpalljes së dënimit nga gjyqi, kur ai kërkoi që sapo të vërtetohet faji të goditej me plumb vetëm në ballë. Ai qe një trim sypatrembur, por fatkeqësisht i përdorur nga armiku për veprime të mbrapështa. Megjithatë trimi e vlerëson trimin më tepër se kushdo tjetër, prandaj ky fakt shkakttoi keqardhje të madhe sidomos tek partizanët, duke e quajtur atë viktimi të reaksionit vendas, i cili bashkëvepronëngushtë me pushtuesit e huaj e në këtë mënyrë ia shtonte edhe më plagët e dhimbëshme popullit tonë.

Ishte koha kur urrejtja ndaj okupatorëve të huaj e veglave të tij vendase qe rritur së tepërmë dhe gjendja qe e acarruar. Në një situatë tjetër më të qetë, ndoshta edhe gjykimi i “Dorës së Zezë” do qe bërë pa nxitim, edhe masa e dënimit mund të kishte qenë më e lehtë.

Humbja e djelmoshave të tillë si S.S.<sup>1)</sup> bënte pjesë në tragedinë që po luhej në kurriz të kombit tonë nga të huajt me mbështetjen e “parisë” shqiptare që e demaskoi veten me turp qysh në fillim të okupacionit fashist, duke ia dorëzuar kurorën e Shqipërisë mbretit italian Viktor Emanuelit të III<sup>e</sup> dhe më pas me protokollin famëkeq “Delmaco-Këlcyra”<sup>2)</sup> etj.

1) *Safet Sarac i ishte emri i vërteti i “Dorës së zezë”*

2) *Protokolli Dalmaco-Këlcyra (mars 1943) obligonte qeverinë kukull të Maliq Bushatit në atë kohë që t'u garantonte siguri e përkrahje pushtuesve fashistë.*

## *Garnizoni fashist bedb armët*

Lajmi për kapitullimin e Italisë fashiste qe i gjëzushëm për të gjithë Shqipërinë, sepse edhe ne kishim dhënë ndihmesën tonë në këtë luftë, duke gozhduar këtu disa divizione armike përveç trupave të asgjësuara dhe mjeteve të dëmtuara që u kishim shkaktuar pushtuesve.

Nëpërmjet bisedave që bënim me shoku-shokun në këtë rast përpinqeshim të përfytyronim edhe marrëdhëniet që mund të kishim paskëtej, me ata që ishim kacafytur me dhjetëra herë dhe ishim gjakosur aq shumë. Cili do të ishte qëndrimi ynë karshi ushtarëve italianë? Dikush thoshte t'u presim kokën se na kanë dje-gur e përvëluar. Të tjerët thoshin jo, koka e falur s'pritet kurre nga shqiptari...

Kishte mendime edhe më konkrete tek partizanët.

Nino Abazi<sup>1)</sup> për shembull në një rast tha:-T'i mbajmë këtu sa të na ndreqin shtëpitë që na kanë dje-gur e urat që na kanë prishur e pastaj le të shporren!...

-Po shokët që na kanë vrarë, apo t'ua falim?...

-Sidoqoftë duhet bërë dallim, se nuk janë përgjegjës të gjithë për të këqijat që na janë bërë...

Më 11 shtator erdhi urdhëri që të marshojmë drejt Selenicës dhe të marrim në dorëzim trupat e shumta italiane që ndodheshin aty me gjithë ç'kishin. Pastaj pasoi porosia: Ata mbeteshin në dorën tonë, ndaj lypej disiplinë në veprime, seriozitet, asnjë shenjë brutaliteti, të mos bënim përshtypje të keqe gjatë çarmatimit, kujdes!...

Në fillim komanda e trupave italiane nisi të bëjë ca naze që ta vononte dorëzimin tek ne, po qëndrimi i vendosur dhe ultimatumi i Komandës partizane si përfaqësuese e Koalicionit të madh Antifashist i "bindi" shpejt italianët të shtrohen. Hoqën rojet dhe hapën dyert e gazermave.

Çastet e marrjes në dorëzim të trupave dhe të mjeteve përbënин kulmin e këtij aksioni. Të mi 600 ushtarët me të gjithë eprorët e

1) Nino Abazi, partizane

tyre u vunë në radhë, hodhën armët e vogla mënjanë një e nga një, pushkët dhe armët e rënda i kishin lënë në gazermë. Pasi dorëzuan armët dhe mjetet në rregull, u vunë në rresht dhe qëndronin gati për ku t'i urdhëronin.

Veçanërisht të pashlyeshme në kujtesë na kanë mbetur skenat e krijuara nga rreshti shumë i gjatë i ushtarakëve fashistë që nisën të parakalojnë përpara fituesve sikur po i tërhiqte njeri zvarrë.

Me fytyrë të vrara, me kokë të ulura dhe me lot në sy.

Ky lloj “parakalimi” sipas nesh ishte një ndëshkim në ndërgjegjen e secilit për rolin e tyre të ulët që kishin lojtur si push-tues. Ky parakalim formonte edhe një akt-akuzë të ashpër në adresë të atyre që i kishin dërguar këta njerëz si mish për top në dhera të huaja.

Një pjesë e tyre, ata më të ndërgjegjshmit, shprehën dëshirën për të qëndruar në rreshtat partizane. U pranuan dhe kështu i lanë një pjesë të fajeve. Të tjerët u vunë në dispozicion të Këshil-lave NÇI dhe ata i sistemuan si mundën, shumicën nëpër familje të ndryshme, ku qëndruan gjersa mbaroi lufta.

Më pas, sa herë që vinte fjala me italianët që mbetën tek ne si partizanë, ata nuk linin pa vënë në dukje zemërgjerësinë dhe korrektësinë tonë. “Shqiptarët-thoshin ata- janë sa trima, aq edhe bujarë”.

### **III. BALLAFAQIMI ME PUSHTUESIT E RINJ GJERMANË**

*Nga përpjekjet me nazistët gjermanë; vetëdemaskimi i "Ballit Kombëtar" si bashkëpunëtor i pushtuesit; fillimi i operacionit të dimrit 1943-1944.*

#### ***Përpjeka e parë me nazistët gjermanë***

Pas kapitullimit të Italisë fashiste, grykët e pushkëve partizane nuk patën kohë të ftoheshin. Më 13 duke gdhirë 14 shtatori bëmë provën e parë për të çarë mbrojtjen e trupave gjermane që sapo ishin vendosur në Drashovicë.

Drejtimi që na ishte dhënë qe fundi i vreshtave të Kropishtit-kalimi i Lumin Shushicë nga 500 metra sipër Urës së Peshkëpisë kundër gazermave gjermane në Drashovicë.

Përpara se të fillonte ndeshja me gjermanët pati mjaft diskutime rrith mënyrës së tyre të luftimit. Njeri thoshte: "Po i vure përpara ikin si lepuj", tjetri: "janë shumë fanattikë" etj.

Në mes të tjerëve Filo Ramadani<sup>1)</sup> tha:- Le të fillojë sulmi pa e shohim...Lermani mua sektorin më të vështirë të mbrojtjes armike.

Pastaj filluan të "flisnin" armët, disa njësite përparuan deri në bregun e djathtë të lumit Shushicë; më tutje s'mund të ecej nga pengesat e mëdha të telave me gjemba. Ishin topa teli të pash-

---

<sup>1)</sup>*Filo Ramadani, partizan shumë i guximshëm, dëshmor i Luftës ANÇl.*

tjelluar, të hedhur me ngut pranë njeri-tjetrit gjatë tërë anës së lumit. Kështu që prova jonë e parë nuk pati sukses. U tërhoqëm nën zjarrin e dendor armik.

U vendos të bëhej një përpjekje tjetër për të çarë rrugë kalimi në një pikë të vetme po atë natë. Kjo detyrë iu besua një njësiti të posaçëm. Ky me hedhje granatash mundi të çajë një farë shtegu nëpër telat me gjemba, u hodh matanë me grupe të vegjël dy-tre vetësh edhe aty u munduam që në fillim të asgjësonim dy mitralozët që pengonin kalimin e shokëve të tjerë. Po predhat dhe granatat tona binin mbi mbulesat e betonta armike, pa u shkaktuar dëm atyre që ishin brenda.

Po bëheshin mbi dy orë luftimesh të ashpra deri afër agimit dhe përsëri nuk e çamië dot mbrojtjen gjermane. Në këtë mënyrë edhe prova jonë e dytë nuk ia arriti dot qëllimit.

### ***Prova e tretë.***

Praktika e luftimeve të natës së parë na u bë mësim. U bindëm tanimë se me gjermanët duhej një taktkë më e studiuar e jo me sulm frontal siç ishim mësuar të luftonim me fashistët italianë.

Këtë herë na u dha si objekt sulmi marrja e Urës së Peshkëpisë që ishte skaji më i djathhtë i frontit, por edhe më i studiuari nga ana jonë.

. Me vrullin e parë të sulmit çeta jonë mundi të kalojë lumin në anën e sipërme të urës dhe t'u bjerë forcave që e mbronin atë nga prapa krahëve. Në këtë mënyrë iu dha mundësia edhe çetave vullnetare të Veshdanishtit e të Penkovës, që kishin gjetur qendresa, të merrnin urën dhe të kalonin në anën tjetër të saj.

Afër mëngjesit të 16 shtatorit gjermanët u vunë në ikje drejt kodrave të Zhyherinës e të Kishëbardhës. Përpjekja jonë e tretë, ndryshe nga dy të parat, ia arriti qëllimit. Ajo u hapi rrugën fitoreve të tjera. Në luftë e sipër ia morëm dorën edhe taktkës që përdornin pushtuesit e rinj nazistë. Përparimi i forcave tona vazhdoi në tërë frontin.

## ***Partizanë e popull në një llogore.***

Forcat partizane, duke u gdhirë 17 shtatori, u gjendën të vendosura në një vijë të re luftimi, në Kodrat e Kishëbardhës që shtrihet prej jugut, rreth 2 km, në perëndim të Drashovicës, deri poshtë për nga veriu, afër Xhyherinës. Këtu mbërritën edhe forca të tjera vullnetarësh prej fshatrave më të largëta të qarkut, me nga një torbë bukë në krahë për ata që luftonin dhe nga një dyfek ose çifte në sup. Sapo këta arrinin në vijën e frontit, përfshiheshin bashkë me të tjerët në luftime e nuk "kujtoheshin" më të largo-heshin. Ata që vepronin kështu ishin pothuajse të gjithë, ndaj është zor të cilësohen me emra.

Këshillat NÇl të fshatrave që ishin në lidhje të drejtpëdrejtë me zonat e luftimit si ai i Drashovicës, Mavrovës, Kropishtit, Penkovës etj. kishin marrë përsipër furnizimin e vazhdueshëm të partizanëve kryesisht me rrush, sepse ai qe dhe ushqimi kryesor. Rezervat e bukës ishin të pakta ose mungonin fare në këto fshatra. Njerëzit që mund të bënin furnizimin nga fshatrat më të largëta, apo merrnin kontakt me frontin, mbeteshin aty si pjesëtarë të luftës me armë.

17 shtatori u shqua po ashtu për luftime të ashpra, po në ndryshim nga ditët e tjera, tani armiku bënte luftime në tërheqje. Ai përpinqej jo më të qëndronte aty, po t'i pakësonte sa më tepër humbjet në njerëz gjatë tërheqjes. Këtë detyrë ua kish besuar më tepër armëve të rënda, artilerisë dhe mortajave që qëllonin pa pushim prej pozicioneve të Qafës së Koçit dhe të Kalasë së Kaninës.

Një nga mbresat e asaj dite është edhe njohja me një fletushkë pro qeveritare që paskish arritur deri tek ne për të na "këshilluar" që të mos e luftonim armikun sepse "...duke u shpallur luftë ushtrive gjermane që kanë ardhur si miq dhe vetëm për nevojë ushtarake...ne po vrasim veten"<sup>1)</sup>. E gjithë kjo mikpritje e reaksionit shqiptar ndaj të huajve tregon haptazi se ai tani i ka lidhur fatet me pushtuesit e rinj...Dhimbjen e grushteve që po hanë gjermanë nga lufta popullore, e ndjen edhe ai në kurrizin e tij- tha

1)Gazeta "Kombi" nr.1, dt. 14.9.1943, organ i komitetit ekzekutiv provizor

komisari në komentin që i bëri kësaj fletushke.

Lufta e Drashovicës për ne ishte përpjekja e parë në shkallë të gjerë me pushtuesit e rinj, ajo ishte beteja që zgjati më shumë edhe në kohë (15 shtator-5 tetor), pati karakter frontal, u zhvillua në një sektor fronti më të gjerë etj.

Me anë të kësaj lufte u çliruan edhe nja 6000 italianë që mbaheshin nga gjermanët si pengje. Populli betejën e Drashovicës e përjetësoi në një këngë që u ngrit aty flakë për flakë. Ajo u këndua e u përhap shpejt. Për herë të parë, atë e dëgjova nga një grup vullnetarësh që kishin ardhur atë ditë dhe po rrinin të grumbulluar pas një kodre, në pritje që t'u caktohej sektori i luftimit. Disa nga rreshtat e kësaj këngë janë këto:

*More gjermanë, jezitë!  
nuk ju kishin parë sytë,  
partizanë si petritë,  
yll'i kuq që lëshon dritë..."*

.....

### ***"U shqye fshati në gaz"***

Më 23 tetor çeta "Ismail Qemali" u nis nga fusha e Gumenicës, për tërë natën, nëpërmjet Malit të Tragjasit, dhe arriti në mëngjesin e thellë të ditës së nesërme tek Burimet e Izvorit, midis fshatrave Tragjas dhe Radhimë. Aty gjetëm dhe çetën tjetër partizane "Hakmarrje" që po ashtu kishte mbërritur aty për tërë natën. Zumë vend në kodrat që rrethojnë burimet nga ana lindore dhe jugore. Këtë prezencë tonën e kishte kërkuar populli i atjeshëm për t'i ardhur në mbrojtje nga besdisjet e ballistëve.

Me ardhjen e pushtuesve gjermanë "Balli Kombëtar" mundohej të rregullonte biografinë. "Ushtritë" e Ballit, filluan të dalin në popull plot me salltanete si një farë fuqie që gjoja nuk kishte pasur të bënte fare me pushtuesit. Se tani paskish "ardhur koha" e duheshin luftuar ata pa "mëshirë!". Edhe batalioni i ballistëve të Azis Sharrës<sup>1)</sup> ato ditë kishte mbërritur e po sorrollatej në ra-

1)Azis Sharr, eksponent ballist, njeri nga të ashtuquajturit strategë të tij.

jonin e fshatrave Tragjas e Radhimë. Qendra kryesore e tij qenë Burimet e Ftohta të Izvorit që u shërbenin atyre edhe për të tre-tur ushqimet e shumta që ua merrnin detyrimisht fshatarëve.

Prej lajmeve që na viniin kishim mësuar se edhe në qarkun e Gjirokastërës, Balli Kombëtar kishte vepruar po kështu duke nisur edhe luftën vëllavrasëse. Ai u kishte rënë nga prapa batalioneve partizane "Asim Zeneli", "Naim Frashëri", etj., kur këto forca po shpartallonin garnizonin fashist italian të Libohovës, në prag të kapitullimit të tij. Nga gjithë këto të dhëna, kërkohej vëmendje. Qemë porositur që të ishim shumë të kujdeshëm karshi provokacioneve të Ballit.

Në mëngjes të 24 tetorit kur ishte bërë fare ditë, ballistët e morën vesh se aty afër tyre qenë vendosur forca partizane, pa i përsillur ata që ndodheshin këtu më parë. Komandanti i Ballit kërkoi që forcat partizane të largoheshin. Në përgjigjen që iu dha komandantit ballist, iu bë një paralajmërim i rreptë nga ana e të dy komandave të çetave partizane. Iu vu atij në dukje se kjo ishte zonë e çliruar nga forcat e ushtrisë NÇl, prandaj në se dikush duhet të largohej prej këtej, ata ishin ballistët e jo partizanët.

"Luftëtarët" e ballit jo vetëm nuk u larguan, po nisen të bënin edhe ngacmimë të ndryshme. Ata, si të padisiplinë që ishin, nuk respektonin asnjë farë rregulli ushtarak, kalonin nga njera anë e vendqëndrimit tonë në tjetrin, pa iu dhënë rëndësi paralajmërimëve të rojeve partizane.

Mund të ishte e dhjeta herë që një grup ballistësh po sorrol-latej rrötull nesh; së fundi po atë ditë afër drekës hapën edhe zjarr me armë kundër rojeve tona. Me këtë provokim të tyre kish marrë fund durimi ynë dhe sa hap e mbyll sytë, dy nga ballistët që hapën zjarr, u palosën për tokë nga një breshëri automatiku që zbrazi Luftëtaril<sup>1)</sup> kundër tyre.

Në kampin e ballistëve filloi një zhurmë shurdhuese, plot me kërcënime e sharje në adresë të partizanëve. Zbrazën edhe disa pushkë, për të na frikësuar! Kjo ishte në logjikën e tyre. Forcat

---

1) Pseudonimi i Mehmet Jahos, komandant i çetës "Hakmarrje"

tona morën masa të tjera gatishmërie, duke i këshilluar përsëri ballistët që të mos ofendonin e të mos shtinin me pushkë!

Kur u pa se ata nuk donin të na kuptonin, përgjigja nuk vonioi t'u jepej forcërisht me anë të një sulmi të rrufeshëm. Brenda më pak se 20 minutave, gjithë kampi ballist u gjend i braktisur nga ana e të zot dhe gjithëçka mbeti në duart e partizanëve. Vetë ballistët morën arratinë të llahtarisor sa nuk e panë i pari të pasmin. Ata nuk menduan më as për mishrat që ishin akoma në hell e po piqeshin, as për rrangullat e tyre personale që kishin mbledhur nëpër fshatarë, bile nuk u kujtuan as për kalin me shalë të komandantit të tyre, i cili këtë herë nuk mundi t'ia hipe dhe ia mbathi me këmbë, bashkë me të tjerët.

Midis atyre që la armiku në kampin e braktisur ishin edhe 8 robër, 5 mitralozë, dhjetëra pushkë, disa thasë me sheqer, makarona, oriz, ca teneqe me mjaltë e të tjera.

Në këtë përpjekje u dallua në mënyrë të veçantë partizan Moreti, i vetmi shok që na mbeti këtu. Ai e kishte hedhur rrÿpin e mitrolozit në qafë dhe shtinte në ecje e sipër, pa pranuar që të mbetej qoftë edhe një hap prapa të tjerëve. Në këtë vrull u godit nga një plumb armik në vetullën e djathjtë, ra kështu në vijën e parë trimërisht.

Moreti e kishte braktisur ushtrinë fashiste dhe ishte bashkuar me ne. Rridhte nga një familje punëtore hekurudhash italiane, babanë ia kishte vrarë Musolini qysh në kohën e "Marshimit mbi Romë" më 1923. Fliste gjithnjë me urrejtje të thellë për sistemin fashist. Në fakt kishte një emër tjetër, po për lehtësi ne i flisnim të gjithë Moret, gjë që i pëlqente edhe vetë atij. Moreti ishte shumë i urtë, mbi të gjitha ai ishte trim; shokët e çetës e donin tamam si vëlla llogoreje. Rënia e tij na dëshpëroi të gjithëve. Varrimi iu bë aty, po atë ditë. Shokët shprehën për të, gjithë respektin dhe nderimet që u takonin të rënëve.

Lufta e Izvorrit midis partizanëve dhe një turme të Ballit Kombëtar ishte përpjekja e parë midis dy palëve në qarkun e Vlorës. Balli Kombëtar u bë shkaktar i vëllavrasjes, na ra prapa shpinës kur ne goditnim armikun...Partizanët e Vlorës dhe populli i Vlorës i kanë demaskuar më përpara se kushdo këta tradhëtarë!"

Asaj lufte iu bë një jehonë e madhe edhe nga ana e popullit. Ai e demaskoi keqas "Ballkombin" me gjithfarë talljesh. Fuqishëm tingëlluan në atë kohë vargjet e poetit partizan, Memo Meto<sup>2</sup>) ku thuhej:

*"Atje përposh në Tragjas,  
u shqye fshati në gaz,  
me një batalion të Ballit  
që përroit u përplas*

.....

*Komandant Azis strategu  
që kish ndenjur pas një bregu,  
fluturoi më tëposhtë,  
pa shikuar ku ish shtegu..."*

Kjo ndeshje me ballistët shërbeu edhe si përgjigje karshi ndonjë pyetjeje që bëhej nga populli si psh.: Si është e mundur- pyesnin ata- që ballistët në luftë të jenë kaq të dobët karshi partizanëve?.... Edhe ata shqiptarë janë... etj Pyetje të tillë edhe pse qenë naivë duheshin sqaruar për të mos na vënë ne në të njëjtën radhë me ballistët.

Ne e kuptonim dhe e shpjegonim organizatën e Ballit Kombëtar në bazë të faktave konkrete. Ajo bashkëpunonte me okupatorët, në vend që të luftonte kundër tyre. Në vend që të bashkëvepronë me partizanët, i godiste ata nga prapashpina, kështu që në vend të mbrojtjes së interesave kombëtare po i tradhëtonte ato duke u vënë në shërbim të armiqve.

PKSH qysh në fillim e pat quajtur organizatën e "Ballit Kombëtar" si të paprincipitë ku "...ca janë partizanë të 99 hileve e të një trimërie, të tjerët partizanë të berihait dhe të tjerët të fjalëve të mëdha po të asnjë pune"<sup>3)</sup>

Gjithsesi në përcaktimin e përgjegjësisë së "Ballit" për qëndrimin e tij profashist, duhet që ajo të mos shpërndahet në mënyrë të

---

1)Dokumente të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë NÇlSh, vëll. I, f.204-205

2)Memo Meto, dëshmor i Lufisë ANÇl, hero i popullit në librin "lulet e Lirisë" faqe 83.

3)E.Hoxha, vëll. I, f.169-170

barabartë, sa tek kërët aq edhe tek anëtarët më të thjeshtë, të cilët në fakt u zhgënjen nga premtimet joshëse të kërëve dhe u bënë viktimë e pabesisë së atyre.

Faktet dëshmojnë se ata ballistë të thjeshtë që e kuptuan me kohë demagogjinë e kërëve të tyte, e korrigjuan veten. Ndërmjet shumë të tillëve mund të përmendet edhe bashkëmoshatari im Labe Kérma, i cili, pasi kaloi në radhët partizane, duke braktisur radhët e Ballkomit u dallua për trimëri të rrallë në përpjekjet me okupatorët e tradhëtarët, gjersa ra heroikisht në luftimet për çlirimin e Peqinit. Kur e gjetën shokët pa jetë, mezi ia zbërthyen duart që i kishin ngrirë në fytin e një nazisti që ishte i shtrirë poshtë tij gjithashtu pa jetë. Po kështu mund të thuhet për Dino Kërmën, Feti Memën e shumë të tjera.

Shembujt e mësipërm dëshmuan nga një anë devotshmërinë e shqiptarëve të ndershëm për t'i shërbyer Atdheut me çdo kusht, kur e kanë të qartë se nga i vjen rreziku, nga ana tjetër nxjerrin në pah përmasat kolosale të dëmit që iu soll kombit nga ana e organizatave kolaboracioniste si Ballkomi e Legaliteti, duke inkriminuar kështu edhe një pjesë të djalërisë shqiptare.

Krejt ndryshe paraqitej puna me partizanët, sqaronte Partia Komuniste. Ata luftojnë për një ideal të madh, për çlirimin e Atdheut. Për këtë qëllim e përbuzin edhe vdekjen. Partizanët nuk marrin asnjëloj shpërblimi material, përkundrazi ata janë vullnetarë të lirisë e si të tillë kapërcejnë vështirësi të panumërtë në çdo drejtim. Populli i do dhe i ndihmon. Mbi bazën e këtyre idealeve qëndron edhe forca e tyre.

### ***Vullneti e mposht moshën***

Po bëheshin nja 7 ditë që po lëviznim nëpër disa nga fshatrat e komunës së Treblovës për të regjistruar vullnetarë të rinj, me që do të krijoreshin reparte të reja, më të mëdha se çetë e batalionet që kishim deri atëhere.

Ishim dy shokë që i njihnin deridiku mirë këto fshatra, bashkë me Kadri Hazbiun. Mbrëmja e 21 dhjetorit na zuri në mëhallën Rexhepaj të fshatit Gorrisht. Deri atëhere kishim regjistruar nja 30

vullnetarë. Këtu do mbaronte edhe misioni ynë. Pas këtej do të kthehet në Gjorm tek shokët.

Atë mbrëmje Këshilli NÇI i Rexhepajve na drejtoi për të fjetur në një shtëpi që ishte në krye të mëhallës. Për fat aty gjetëm edhe babanë tim!- Kam dy ditë që po ju ndjek këmba-këmbës, sot që u ktheva këtu për të parë mikun, ju zura dhe juve, paska qënë ditë e mbarë- tha ai, pastaj u përshtëndetëm dhe u çmallëm disi tërë atë natë.

Të nesërmen më 22 dhjetor në mbledhjen e gjerë të popullit u fol pak për situatën, pastaj u kalua në problemin e regjistrimit të vullnetarëve. Gjithshka u tha shkurt. -Besoj çdo njeri është mirë ta thotë vetë dëshirën që ka- e hapi diskutimin njeri nga anëtarët e këshillit, ai që përgjigjej për anën ushtarake.

-Shkruani atje emrin tim!- tha Istrefi dhe u ul.

-Unë e kam një djalë në çetë, tani do të më ikë edhe tjetri...Mbase ja mbushni mendjen ju që të qëndrojë edhe këta dy muaj se i kemi bagëtinë vetëm- tha një grua e moshuar .

-Unë jam përgatitur....-foli një i ri.

-More unë s'e marr vesh ç'duhen këta partizanë të tjerë, kur ne kemi çetën tonë "Halim Rakipi", ajo është e Gorishtit- tha K.R., një burrë me moshë mesatarë.

Ndërkohë kryetari i këshillit që ishte aty pranë kthehet e na thotë me zë të ulët:" ky është nga ata që u ka fryrë në vesh Balli..."Po papritur të mbaronte mirë tjetri u ngrit rrëmbimthi një burrë i moshuar që duhej t'i kishte kaluar të 70-tat.

-Lufta që po bën djalëria e sotme nga çdo pikpamje është më e mira nga të gjitha ato që janë bërë...Njëzet e ca vjet më parë luftuam edhe ne, po, ohu-u, jo me këtë rregull që shohim tek partizanët...Prapëseprapë fituam. Pastaj shtoi:

-Ca na qajnë hallin se nuk na vijnë pas disa nga agallarët e na pas kanë lënë gafil!-Ja tek po ua them edhe njëherë atyre që ndjekin agallarët e shitur prapa: të hapin sytë e të ecin në rrugën e drejtë.

-Fjalët e të dërguarëve më pëlqyen- vahdoi ai,-veç në një pikë jo; kur u tha se do pranohen gjithë të rinjtë që kanë dëshirë. Pyes, po ne të tjerët të bëjmë sehir? Ju bëj rixha shkruani edhe emrin tim.

Pas këtyre fjalëve u bë ca zhurmë, nga përshtypja që la ai, po xha Sejdini ndërhyri përsëri. -Vullneti e vë poshitë edhe pleqërinë, ai e rinon moshiën... Përpara thoshin edhe për gratë që s'janë të zonjat, po tani ato janë në një front me burrat e dijemtë.

Xha Sejdini ishte shquar edhe në Luftën e 1920-ës. Atje kishte marrë edhe ca plagë. Kishte një trup të thatë, po të regjur e të shkathët. Nuk e mbante vendi kur fliste ndonjeri nga ata që donin t'i bënin bisht luftës si K.R.-ja.

Na u desh të diskutonim akoma gjatë sa t'i mbushej mendja luftëtarit 70 vjeçar të 1920-ës që të qëndronte në çetën teritoriale të fshatit. U detyruam t'i jasin edhe premtimin se do ta thërrisin im sa herë që të bëheshin aksione aty rrotull. Pastaj lufta duhej mbështetur edhe nga prapavija.

### ***Babai i lë amanet djalit***

Sapo qe bërë ndërtimi i ri i reparteve tona. Pas këtej edhe emrat që kishin mbajtur çetat deri tani u zëvendësuan me:kompani e parë, e dytë...e të tjera që kishte çdo batalion. Pra, u hodh një hap tjetër drejt formimit të një ushtrie të rregullt. Kjo masë u pasua edhe me formimin e njësisë partizane më të madhe në qark. Njësia e sapokrijuar aty për aty u quajt si grup po në fakt kjo ishte Brigada e V.S. që do të shpaljej zyrtarisht me emrin e saj të plotë afro dy muaj më vonë.

Kjo ditë për ne partizanët dhe popullin e shumtë që ishte grumbulluar aty qe një festë e dyfishtë, edhe për ditën e flamurit, po edhe për formimin e njësisë më të madhe në qark. Qëndronim të grumbulluar në këmbë në një shesh të rrethuar me ullinj në anën juglindore të fshatit Gumenicë; në vend të gotave me raki për të ngritur dollitë e për të uruar njeri-tjetrin siç është zakoni në raste të tillë, mbanim në krahë pushkët; në dorë disa flamuj kuq e zi dhe në gji-zjarrin e luftës për çlirimin e Atdheut. Nga goja e çdonjerit kur përshëndeteshin me shoqi-shoqin përsëritej:"Vdekje Fashizmit" dhe pastaj urimi:"Rroftë 28 nëntori i lirë".

Një breshëri të shtënash që shoqëruan ngritjen e flamurit nga skuadra e caktuar për këtë qëllim, shënoi edhe hapjen e aktiv-

iteteve të festës. Prej podiumit natyral që formohej nga niveli e vendit përballë, komisari iu drejtua partizanëve me këto fjalë:

-Shokë e shoqe partizanë, vëllezër e motra, nëna e baballarë Ju uroj ditën e pavarësisë kombëtare me çlirimin e plotë të At-dheut, me një Shqipëri të lirë, demokratike, të begatë...

Ai përshkroi shkurtazi rëndësinë e ditës së 28 nëntorit për të gjithë kombin shqiptar, dhe sakrificat që u janë dashur të parëve tanë, deri në arritjen e pavarësisë. Pastaj u përqendrua në barrën që na ngarkonte historia për të vënë në vend padrejtësitë e së kaluarës, për çlirimin e plotë dhe përtëritjen e Atdheut. "Rroftë 28 nëntori!" - përfundoi ai dhe ia dha fjalën Abaz Shehut<sup>1)</sup>, si komandant i formacionit partizan që sapo u krijua.

Kur nisi të fliste Abazi më shkoi mendja fluturimthi kur plot një vit më parë u fliste Fejzo Gjomemua punëtorëve të Selenicës, në sheshin përpara shkollës, me të njëjtin zjarr e me të njëjtin besim në fitoren e luftës që po bënim. Ai tanimë i kish vulosur me jetën e tij ato që pat thënë.

-Varet pikërisht nga ne- nisi të thotë Abazi, midis të tjerasht, që t'i tregojmë botës se stërnipërit e Skënderbeut, pasardhësit e Abdyl Frashërit, të Ismail Qemalit e të Isa Buletinit, bijtë e Selam Musait e të Avni Rustemit dhe të gjithë patriotëve të tjerë që janë shkrirë për Mëmëdheun, i kanë dalë atij për zot e nuk lejojnë asnje fuqi, ciladoqoftë ajo, që të na marrë nëpër këmbë. Këtë detyrë të madhe e ka marrë përsipër e po e kryen djalëria shqiptare e bashkuar në frontin NÇl nën drejtimin e PKSH. "Rroftë Shqipëria e Lirë! Rroftë 28 nëntori!" - përfundoi ai.

Fjalimet e komisarit e të komandantit u priten me vëmendje nga të gjithë. Gëzimi e hareja sa vinte e po rriteshin. Partizanë e popull, përqafoheshin e puthesin midis tyre duke e uruar njeritjetrin që "28 nëntorët e tjerë të festoheshin pa okupatorë të huaj e pa tradhëtarë në Shqipëri", "më të fortë e më të bashkuar rrëth Frontit Nacionalçlirimtar!".

Në grumbullin e njerëzve aty pranë, më tërhoqi vëmendjen një burrë i moshuar, me një trup të drejtë që nuk i përgjigjej moshës

---

1) *Abaz Shehu, dëshmor i Luftës ANÇl, hero i popullit*

së tij afro 80 vjeçare. Ai më kishte kthyer krahët, mbante dhe një shami në dorë. Kur iu afrova dhe e pashë më me kujdes e njohja dhe i thirra në emër, më ngjante se i ishin skuqur pak edhe sytë.

-Xha Selam<sup>1)</sup> kur paske ardhur?!

Ai u kthyte drejt meje më pa mirë e tha:

-Ma bën hallal more bir se nuk ka lezet të derdhi burri lotë po nuk e mbajta dot veten. Ndërkajmbeti si i menduar për një çast, pastaj vazhdoi:- Erdha të shihja festën e të çmallesha edhe me Qemalin e të gjithë ju djemtë. Fjalimet që u mbajtën këtu më kujtuan ditët e sulmit mbi Babicën e 1920-ës dhe urdhërin e komandantit të çetës: "Përpara mbi ta!"...Se si më erdhi një mall për ato ditë dhe një dëshirë për t'ia bërë edhe një herë fora, po ç'e do ju nuk na pranoni në çetat tuaja, dëshirën e kam të madhe...

-Ti baba mos u dëshpëro se dhe ne nuk do të luftojmë më keq se ju, jemi më të fuqishëm se ju në kohën tuaj, kemi dhe forca më të mëdha, pastaj unë të kam thënë se do luftoj edhe për ty- tha Qemali që e vuri re keqardhjen e të atit.

Ushqjeja prej kohësh një dashamirësi e nderim të veçantë për xha Selamin, po edhe ai më donte si djalin e tij. Në rastin e tanishëm na dha edhe një tok këshilla, me gjithë shokët që kisha aty, se si të luftonim më mirë, sipas përvojës që kishte fituar ai.

-Ju pafsha me fitore o djem!- uroi ai më në fund, pastaj u kthyte nga Qemali me këto fjalë:-Amaneti im është që ti të luftosh sa për dy e më tepër akoma, sepse vëllezërit i ke të vegjël e nuk të ndjekin dot prapa, unë po jam plak, pra të luftosh edhe për ne, armikut mos ia kthe kurrë krahët! Këto ishin fjalët e fundit që tha Xha Selami kur po ndahej me të birin.

### ***"Lufta kërkon sakrifica dbe beronj"***

Na ishte bërë zakon që çdo ditë të shënuar ta kremonim edhe me aksione e në çdo aksion të arrinim sa më shumë fitore. Kështu u nisëm edhe këtë radhë. Qysh të nesërmen e 28 nëntorit iu drej-

---

1) Selam Velça, luftëtar i 1920-ës, patriot

tuam Malit të Tragjasit, duke marshuar për tërë natën dhe në mëngjesin e thellë të 30 nëntorit u shpërndamë për luftime në kodrat që mbyllin Fushën e Dukatit, nga ana lindore e saj, ku pritej të kalonin trupa naziste.

Pas rreth një ore, qysh se ishim në pozicione u duk vargu i makinave që po vinin me ngadalë nga ana e Vlorës. Abazi me atë gjaktohtësinë e zakonshme të tij, porositi që të rrnim gati. Nuk pritëm shumë. Tre makinat e para që ecnin veças nga të tjerat arritën përra pozicioneve tona. Komandanti shtiu i pari me automatikun e tij dhe njëkohësisht thirri me zë të lartë: "Zjarr!" Makinat e pararojës u detyruan nga të shtenat tona të qëndronin në vend, në këtë kohë komandanti kërkoi disa vullnetarë për të shkuar tek ato- Jemi gati shoku komendant- u dëgjuan përnjëherësh shumë zëra. Aty puna nuk priste për të diskutuar. U takoi të niseshin ata që u ndodhën më afër e që kishin folur më parë, kështu ishte bërë zakon të veprohej në raste të tilla për të mos ua prishur qejfin edhe të tjerëve që kishin po të njëjtën dëshirë.

Grupi ynë u nis në drejtim të makinave, i mbështetur nga qitjet e vazhdueshme që bënin shokët prej pozicioneve ku ishin. Ai nuk e pati zor që t'u afrohej makinave të ndaluara dhe t'u vinte zjarrin menjëherë, duke hequr më parë disa armë e pajisje të tjera, të cilat nazistët i braktisën duke u hallakatur nëpër fushë, në kërkim mbrojtjeje për kokat e tyre.

Nazistët ishin tepër fanatikë dhe po aq këmbëngulës në ndërmarrjen e tyre. Ata nuk pajtoheshin kollaj me disfatat që pësonin edhe në kushte aq të dëshpëruara për ta. Nga të rreth 30 ushtarët e oficerët që ishin në këto makina, një pjesë u asgjësuan në ikje e sipër, disa mundën të shpëtonin. Ndonjeri që kishte mbetur i fshehur afër makinave, herë-herë qëllonte kundër nesh në kohën kur po u vihej zjarri atyre. Breshëria e gjatë e një automatiku i bëri të paktën një pesë vrima kapotës së mitralierit tonë: ky fakt sikur na tundi ca, na bëri më të kujdeshshëm në veprime.

Duke qenë i përqendruar me shikim andej nga erdhën të shtenat, po lëvizja ngadalë nga e majta për t'ju afuar një pezuli që mund të shërbente si mbrojtje për armiqëtë e hallakatur. Pritur u gjenda i rrëzuar për tokë. Te këmbët e mia ndodhej një

ushtar armik që po jepte shpirt. Isha penguar në trupin e tij.

Mbase do të ishin bërë nga 10 minuta që gjurmonim armiqtë e mbetur gjallë përreth makinave që po digjeshin, kur u dëgjua një vërvshëllimë, pastaj një breshëri automatiku, ajo u përsërit edhe dy herë të tjera. Ishte shenja për têrheqje që jepte komandanti për t'u kthyer në pozicionet tek shokët.

Në têrheqje e sipër kur s'kishim bërë akoma më tepër se 50-60 hapa nga makinat e prishura në xhade, një valë e dendur zjarri gjitharmësh shpërtheu që nga xhadeja. Predhat vërvshëllenin mbi kokat tona dhe përfundonin në brezin e pritës ku qenë vendosur shokët tanë. Forcat kryesore të autokolonës gjermane kishin mbërritur në sektorin e pritës dhe kishin hyrë tanimë në luftim drejtpërsëdrejti.

Rruja e têrheqjes së njësitet tonë deri tek shokët e tjerë, zgjaste rreth 800 metra, përmes një pllaje krejt të zhveshur e të kontrolluar mirë nga nazistët. Në ato kushte nuk do të kishte pasur ndonjë shpresë tjetër shpëtimi, po të mos kishte rënë një mjer-gull e dendur që u përhap me shpejtësi mbi ne, sikur të kishte dalë edhe ajo nga grykat e topave e të mortajave gjermane që po zbrazeshin papushim.

Në pasditen e vonë, gjermanët mblohdhën trupat e të vrarëve e të plagosurit dhe u kthyen prapë për në Vlorë. Kurse ne u grumbulluan aty në pllajën e malit, jo larg nga ku kishim lufuar tërë ditën. Po aty u bë edhe varrimi i partizanes vlonjate Rrapushe Dogani që ra nga predhat e artilerisë armike. U njoftua edhe rënia e 4 partizanëve të tjerë në sektorët e ndryshëm të luftimit.

Abazi, sa po mbërriti në mes nesh, aty ku qemë grumbulluar na propozoi të nderonim kujtimin e të rënëve. U ngritëm të gjithë në këmbë me grushtin e shtrënguar pranë ballit dhe, njëzëri, përsëritëm fjalët e betimit të tij. "Do t'ua marrim hakun!"

Ai bëri edhe kritikën e veprimeve gjatë atij aksioni. Tha fjalë të mira për guximin dhe qëndresën e partizanëve në përgjithësi. U interesua edhe për shokët e njësitet që u rrezikuan në aksionin për shkatërrimin e makinave. Na përgëzoi aty, para të gjithëve për suksesin që arritëm.

Në këtë rast komandanti vuri në dukje edhe disa nga gabimet

që kishte parë në veprimet tona. Kritikoi mënyrën e tepruar të harxhimit të fishekëve, kur ata edhe mund të kurseheshin; ngadalësinë e veprimeve në ndonjë rast, si ai i tërheqjes sonë pas shkatërrimit të makinave; dehja nga sukseset e para të goditjes,

manovrimet e pakujdeshme gjatë luftimeve etj. Prapëseprapë edhe vërejtjet Abazi na i bëri në një mënyrë të tillë që nuk të lëndonin; përkundrazi të rrisin besimin te vetvetja, të nxisin moralisht e të ngrinin më tepër si luftëtar.

Si kujtim nga ky aksion mua më mbeti edhe një aparat fotografik që ishte gjendur ndërmjet sendeve të tjera, në makinat e armikut që u shkatëruan.- Merre këtë aparat ti komandanti i njësitet- tha Abazi që të na i nxjerrësh shokët në fotografi se edhe

fotografitë do na duhen...!

-Ju e dini mirë shokë e shoqe- përfundoi komandanti- se lufta kërkon sakrifica dhe heronj si këta që po ndahen çdo ditë nga radhët tona; po ne i kemi dalë për zot kësaj lufte dhe do ta vazhdojmë deri në fund. Le të ecim gjithmonë përparrë drejt fitores së madhe!

Këto fjalë të tij më pas do të ngjanin si ndonjë parathënie profetike e asaj që së shpejti do të ndodhët edhe me atë vetë.

### **Nga beteja në betejë**

Moti më 3 dhjetor qe i butë, me pak re të çrregullta. Partizanët qenë në çlodhje, pas udhëtimit që kishin bërë prej Malit të Dukatit deri në Gjorm. Gjatë këtij marshimi na pat shoqëruar edhe një kohë e keqe, me rreshje. Pushimi pas luftimesh të ashpra me armikun dhe një mot relativisht i mirë pas atyre shirave që kishin rënë gjatë atyre ditëve, na dha një farë kënaqësie. Ndodheshim në krahun e majtë të Urës së Gjormit atë paradite. Një pjesë



Heroi i Popullit Abaz Shehu

shokësh vazhdonin akoma pastrimin e armëve. Ca të tjerë që e kishin mbaruar këtë punë, atje më tej ia thoshin këngës partizane :"Bashkohi shok me ne ndër çeta! "Dikujt i shkoi ndërmend që të bënim disa fotografi me aparatin që sapo ua kishim zenë gjermanëve. Filluam të fotografoheshim ne që u ndodhi em aty; sapo na panë të tjerët, ca e nga ca, ugrumbulluan pothuajse gjithë pjesa e batalionit që ndodhej përreth. Çdonjeri shprehite dëshirën që të delte me shokun, me skuadrën, me armën...Nuk ishte e mundur që të mos ia plotësoje qejfin shokut në të tilla raste, kjo ishte në natyrën tonë partizane. Kështu po vazhdonim gjersa të arrinte filmi që kishte aparati brenda.

Papritur u dha alarmi:- Shpejt, merrni armët dhe zini pozicionet me ballë nga ura!... Ishin diktuar forca të mëdha naziste që po afroheshin drejt nesh nga ana e Qafës së Dushkut. Një betejë e re na priste.

Qenë orët e para të drekës kur u shkrepën pushkët e para kundër nazistëve që po sulmonin si gjysmë të dehur, pa i përfil-lur plumbat që ju shkonin përpara e anash dhe u futën në urë për nga ne. Skuadra jonë që ishte vendosur në këtë anë, mori urdhër për ta kundërsulmuar armikun ballëpërballë gjatë kalimit të urës. Këtu u zhvillua edhe pjesa më e rreptë e kësaj beteje.

Ndërmjet tanëve u dallua veçanërisht i riu komunist Bilal Malo<sup>1)</sup> Ai sapo u ngrit nga pozicioni, shpejtoi në ballë të shokëve, hodhi dy granata dore, njerën pas tjetrës, te këmbët e ushtarëve armiq. Nga këta dy tre ranë menjëherë të vdekur mbi urë; një tjetri që e cte akoma si i trullosur, iu hodh për fytin, e goditi me tabanin e pushkës diku në kokë dhe e shtyu nga parmaku i urës poshtë në lumë. Atë kohë u godit edhe vetë dhe, rrëshqitazi, ra pranë parmakut të urës. Shokët e tërhoqën me të shpejtë trupin e atij tanimë pa jetë në këtë anë të urës.

Përpjekje e parë e gjermanëve për të kaluar urën dështoi, ata u tërhoqën paksa nga ajo anë, po qitjet e artilerisë që nga rajoni i Qafës së Dushkut u bënë edhe më të dendura. Pas pak, pothua-

---

1)Bilal Malo, dëshmor i Luftës ANÇl, luftëtar i dalluar

jse papritmas, gjermanët u shfaqën përsëri në sulm te këmba e urës. Në këto çaste Mehmet Skëndo<sup>1)</sup> u ngrit i pari e doli në krye të një skuadre tjetër për kundërsulm. Në këtë skuadër bënte pjesë edhe djali i xha Selamit, Qemal Velça. Atë e mori një plumb në llërën e krahut sapo u ngrit në këmbë, po prapëserapë kjo nuk e ndau nga shokët. Plaga qe akoma e ngrohtë dhe nuk e pengonte që të shtinte gjatë ecjes. Në minutën e fundit, kur gjermanët u detyruan përsëri të tërhoqen matanë urës, shoku ynë u godit përsëri, këtë herë për vdekje.

Ura dhe të dy anët e saj u mbushën me trupa të vrarësh. Nga të armikut mumdëm të numërojmë nga 20 të tillë, po edhe neve na mbetën aty 12 shokë nga më të mirët; ndërmjet këtyre edhe Qemali që kishte marrë zotim përpëra të atit të luftonte sa për dy, që të mos mbetej prapa shokëve, që....Gjatë këtij luftimi patëm edhe mbi 16 të plagosur. Plaga që mora unë në këtë rast në krahun e majtë qe pothuajse e papërfillshme në krahasim me disa të tjera.

Rënia e shokëve këtu dhe ajo e Abazit më vonë na shkaktuan dhimbje, po na rritën edhe urejtjen karshi armikut. Lufta na kishte regjur para kohe, krahasuar me moshën që kishim dhe na kishte bërë të papërkulshëm në çdo situatë që kalonim.

Abazi më kishte lënë një kujtim (aparatin fotografik), me atë e ngushëllova veten disi. Po ashtu edhe një pjesë shokëve të rënë do t'i plotësoja një dëshirë që kishin shprehur atë ditë: do t'i përgastisja fotografitë e tyre të fundit dhe do t'ua nisja familjeve të tyre. Mirë më kish thënë Abazi "...se do na duhen edhe fotografitë" rikujtova me vete.

Dëshira për ta plotësuar sa më shpejt detyrimin që i kisha vënë vetes karshi shokëve të rënë, më shtyri që në rastin më të parë që m'u krijua, ta nis ilegalisht aparatin fotografik me gjithë filmin që kishte brenda për në Vlorë, për të me stamposur fotografitë e shokëve; njeriu që ma mori përsipër këtë detyrë kaq të shtrenjtë ishte një burrë i pjekur, simpatizant i Lëvizjes NÇl. Qendro Nasto

---

1) *Mehmet Skëndo ish komisari i kompanisë parë, batalioni i dytë*

e quanin atë. Nuk mendoja se mund ta shpërdoronte besimin që i dhashë, ngaqë edhe e kisha njohur prej kohësh. Pas ca kohësh, kur u detyrua të më përgjigjej, më kthen lajm se e kishte humbur aparatin me të gjithë filmin që kishte brenda; atëhere u bëra vrer nga dëshpërimi. U binda se isha gabuar në vlerësimin e atij njeriu dhe e urreva gjer në fund si frikacak që, sipas bindjes sime, ishte trembur dhe e kishte hedhur aparatin se mos ia gjeni gjermano-ballistët gjatë operacionit të dimrit që po zhvillonin, prandaj veç të mos e gjeja përrpara. Edhe ai e njihet veten e tij, prandaj, kur mori vesh se kisha shpëtuar pa u vrarë gjatë luftës, m'u fsheh me çdo mënyrë e s'e pashë më dot sa qe gjallë.

### ***Nëna ia bën hallall sisën birit të saj***

Sapo m'u krijua mundësia nxitova për të vizituar prindërit e Qemalit, në shtëpinë e ish shokut tim të luftës. Nënë Hesmaja e xha Selami më priten me krahë hapur, tamam sikur t'iu ishte kthyer Qemali gjallë...

Nxora nga çanta dhe u dorëzova atyre mbajtësen e fishekëve që kishte zbrazur kundër armiqve, biri i tyre para se të binte. Nënë Hesmaja e mori atë, e puthi dhe në atë kohë i rrëshqitën faqeve dy pika loti. Xha Selami nuk deshi ta japi veten.

-Grua, jo ashtu!- tha ai- se ja ku e kemi Qemalin -drejtoi dorën nga unë- Ai s'ka vdekur....Kishim një Qemal, tanë kemi dhjetëra e qindra të tillë, të gjithë këta djemtë tanë janë.

-Mirë thua ti o burrë, se trimat që bien për vatan nuk vdesin, po mua të zezën më ka marrë malli, nëna ia ka bërë sisën hallall Qemalit.... - tha nënë Hesmaja; pastaj e mblohdhi veten. U ngre nga vendi e filloj të kujdeset nëpër shtëpi.

-Atë, kokoshin që kishim caktuar për djalin..., mos harro dhe një çikë nga ajo me nisesh që di til!- tha xha Selami. (Kjo qe porosia e tij për përgatitjen e drekës).

-E di vetë nëna, po bëni muhabet...

-Ulu dhe pak nënë Hesma të rrimë se mua nuk më pret puna, më duhet të shkoj, mos...

Mos thuaj ashtu se ne sot e kemi ditë gëzimi, na ka ardhur

djali e do tē çmallemi me tē, ashtu si na i do zemra -ma preu nëna.

“Po, mendova me vete- këta prindër janë edhe tē mitë, janë edhe tē partizanëve tē tjerë. Zemra e tyre është aq e madhe sa i nxërë tē gjithë. Eshtë sa deti...”.

Ato pak orë që kalova atë ditë tē ftohtë me ngrica në shtëpinë e Velçajve qenë aq tē ngrohta e prekëse saqë mua nuk do tē më dilnin kurrë nga kujtesa; do tē më përcillnin kudo sidomos në rast që më tē vështira tē betejave gjatë kohës së luftës, do tē më shlonin forcat.

Para se tē largohesha, xha Selami nxori nga kuleta një copë kartë, ma zgjati ta shikoja, ishte kopja e letrës drejtuar shtabit të brigadës, pas rënies së Qemalit. Aty thuhej se familja e tij ndihej krenare që me gjakun e djalit tē vet kishte ndihmuar sadopak në çlirimini e afërt tē Atdheut... Pastaj përfundonte: "...dëshiroj që vendi i varrit mos tē harrohet në mënyrë që kur tē jetë e mundur tē vete ta shoh"<sup>11</sup>). Tani eshtrat e Qemalit prehen në varrezat e dëshmorëve në Vlorë.

### ***Mbrohemi duke sulmuar***

Në mbrëmjen e 17 dhjetorit batalioni ynë u grumbullua në Grykën e Kallaratit, në vazhdim tē têrheqjes nga lugina e Mesaplikut. Faktet që u paraqitën atë mbrëmje përpëra partizanëve nga komisari i brigadës qenë bindëse se operacioni kish filluar e do tē vazhdonte, se forcat tona duhej t'i përgjigjeshin kësaj ndërmarrjeje tē armikut me shkathtësi e guxim, me manovrime tē shpejta, me goditje tē befasishme, ta mbronim popullsinë nga reprezaljet armike, tē ruanim edhe forcat tona nga grackat e gjermanëve dhe tē mercenarëve, tē mbroheshin duke sulmuar, ta ndëshkonin armikun sa më ashpër...

Përballë forcave tē shumta gjermano-balliste që merrnin pjesë

---

1) ANÇ, Brig. V S. kutia I, dosja 7.

në Operacionin e Dimrit 1943-1944, formacionet partizane edhe në zonën e Mesaplikut u detyruan t'iu shmangeshin luftimeve frontale, duke preferuar rrëshqitjen në prapavijat armike e duke organizuar goditje të befasishme me grupe kundër tij. Në funksion të kësaj ideje u caktuan edhe detyrat taktike.

Qysh në atë mbrëmje u nisëm me një grup partizanësh dhe zumë pozicione të fshehta pak më në lindje të fshatit Vranisht, në rajonin e quajtur Harcat e Aliut, i cili e kontrollonte plotësisht fshatin.

Në orët e hershme të mëngjesit të 18 dhjetorit pa u gdhirë mirë, nazistët, pasi i qenë shmangur pritës sonë, kishin hyrë tinës në fshat dhe nisen bastisjen e tij. Armiku na e kishte hedhur, koha më nuk priste. Edhe pse nuk e kishim zakon të zhvillonim dyluftime brenda qendrave të banuara për të mos iu dhënë shkas armiqve për reprezalje karshi popullsisë civile, këtë herë sapo u njohëm me situatën e krijuar, u hodhëm menjëherë në sulm kundër tyre, në tre drejtime të ndryshme, të ndarë në grupe prej 5-6 partizanësh secili. Goditjet partizane i detyruan hilerianët të copëtohen edhe ata në grupe të vogla pa lidhje ndërmjet tyre.

Vranishti, si një nga bazat e Luftës ANÇI nuk e dëgjonte për herë të parë "simfoninë" e armëve, po kësaj here hasmi i kishte vajtur tek dera fshehurazi, ndaj dhe krismat e armëve e vërvshëllimat e plumbave që e zgjuan nga gjumi i natës para kohe, kishin një ndjellëkeqe të veçantë.

Nga konkluzionet që u nxorrën më pas u vërtetuan edhe këto episode: Siri Gjyshi që bënte pjesë në grupin e parë, duke u gjenjur me një gjerman ballëpërballë, në cepin e një kthese, aq afér sa që asnjeri nuk pati mundësi ta përdorte armën veç duarve, u kacafytën një copë herë ashtu grykë për grykë dhe nuk se si do të përfundonte kjo kacafytje, po të mos kish mbërritur aty, në kalim Sali Ormeni<sup>1)</sup>. Ai duke parë këtë skenë me një të shkrehur automatiku e shtriu nazistin përtokë. Kjo ngjau në çastin më vendimtar, kur nazisti ishte shkëputur nga duart e Siriut, u tërroq

---

1)Sali Ormeni, ish komandant batalioni

pak mbropa dhe kapi revolen.

Gjithashtu grupi i dytë në ndjekjen që u bënte gjermanëve u gjet i rrethuar pranë oborrit të një shtëpie. Disa ushtarë gjermanë që ishin fshehir aty i ranë që mbropa; në këtë duel të vogël u godit Ymer Gjika, të cilit ju thye njera nofull; po aty u asgjësuan edhe dy nga nazistët që kishin qenë të fshehir. Luftimet vazhdonin akoma në gjysmë errësire, sepse nuk kishte aguar mirë dita.

Ne të grupit të tretë vazhduam përpjekjet për t'u prerë armiqve rrugën e kalimit në pjesën tjeter të fshatit, matanë përroit që e ndante atë në mes. Luftimet zhvilloheshin në një largësi të tillë saqë edhe bombat e dorës nuk arrinin të pëlcisin me të rënë në tokë. Shaqo Kapllani<sup>1)</sup> u hodhi granatën e dorës disa nazistëve që kishin zenë sofanë e një porte duke shtirë me pushkë dhe nuk po shkuleshin, por ajo nuk shpërtheu menjëherë; njeri prej tyre e mori me shpejtësi granatën nga toka dhe ia rihodhi Shaqos, duke e goditur atë në këmbë, gjë që i shkaktoi dhimbje me peshën e saj prej metali. Ky e pandehu se u godit me ndonjë gur dhe pa humbur kohë kapërcen murin e një oborri për t'iu dalë armiqve nga prapa krahëve, ndërkohë shpërtheu granata dhe vetëm atëhere e kuptoi edhe Shaqua se nuk ishte goditur me gur.

Pas një ore luftimi pothuajse trup me trup me repartin armik rreth 3 herë më të madh se forcat që kishim ne, po zbardhët edhe dita, po ia mbërrinin edhe forca të tjera armike, në ndihmë të të parëve. Ndërkohë shenjën e tërheqjes që ishte dhënë, shokët e kishin marrë dhe qenë larguar, pa arritur akoma forcat e reja armike.

Mua më tërhiqnin pas vetes disa armiq që zvarriteshin nëpër një rrugicë të fshatit, hë këtu e hë atje, sa që u gjeta i shkëputur nga të tjerët pa e kuptuar shënjen e tërheqjes. Kur e kuptova këtë e bëra të kthehesha prapa, më gozhduan në vend të shtënat e një arme të veçuar që vinin nga buza e një muri fare pranë. Ndërkohë dalëngadalë dita po zbardhët plotësisht.

Shtegdalja e vetme qe rruga e ngushtë përmes shtëpive të gurta

---

1) Shaqo Kapllani, dëshmor i Luftës ANÇL.

prej nga vinin edhe të shtënat e automatikut. Që të dilja nga situata duhej patjetër të luftoja deri në fund, por të shtënat e mia të përgjigjes përsëri nuk patën efekt. Vetëm pas hedhjes edhe të granatës së vetme të dorës që më kish mbetur. automatiku armik pushoi.

Iu afrova me kujdes vendit nga më kishin ardhur të shtënat; aty gjej të shtrirë siç e kish zenë hera, oficerin nazist me kokën të lëshuar pas ledhit. Automatiku i kishte rënë mënjanë. Mendovala se duhej të kishte mbetur i plagosur më parë, prandaj qe shkëputur nga shokët. Në çast rrëmbeva me të shpejtë automatikun e tij dhe bëra të ikja, por kur më vanë sytë te kapota e re që e kishte zënë më dysh nën vete, e lakmova edhe atë. Shtyva pak anash kufomën se u lirua dhe kapota.

Gjatë gjithë jetës partizane deri atëherë, nuk kisha mbajtur asnjëherë kapotë. Herë kisha menduar se më pengonte në lëvizje gjatë aksioneve, herë të tjera kisha ndjerë neveri ndaj, të vrarëve...Këtë radhë sesi m'u mbush mendja dhe e mora!

Isha i lirë për të shpejtuar në drejtimin e paracaktuar nga duhej të ishin têrhequr edhe shokët. Po qe bërë vonë, nuk dukej asnjë prej tyre. Dola në krye të fshatit dhe u futa nëpër një lëndinë që shtrihej prapa Harcave të Aliut e të nxirre në rrëzë të malit. Aty gjermanët e riardhur, që tanimë e kishin zënë shkëmbin e Harcave të Aliut, qenë vetëm 150-200 metra larg meje dhe nisën qitje të dendura. Vazhdoja të ecja, pa u rrëzuar për tokë, siç po prisja nga sekonda në sekondë, gjersa arrita në anën tjetër të arës, ku fillonte edhe e ngjitura e malit me ca lisa të rrallë që ngriheshin aty-këtu.

Nuk kisha më forca të ecja dhe sa arrita tek lisi i parë, u mbësh-teta pas trungut të tij për t'u mbrojtur nga plumbat që më vër-shëllenin akoma mbi kokë; aty u kujtova të kontrollohesha për plagët që mund të kisha marrë, po për çudi nuk gjeta asgjë!Kisha shpëtuar në një mënyrë që akoma s'po më besohej; me gjithëse rrobat, sidomos kapota qe bërë sikur ta kishin kafshuar qentë.

Takimi me shokët që i arrita në Malin e Pilurit po atë ditë ishte krejt i veçantë. Ata më kishin llogaritur të vrarë dhe qenë shqetësuar për gjetjen dhe têrheqjen e trupit tim e jo më të kthe-

hesha përsëri i gjallë në radhët e tyre...

Njeri nga partizanët më të hershëm të fshatit Vranisht, Çobo Osmani, që i ndoqi ngjarjet më nga afër gjithë atë ditë në fshat, pas aksionit, do të dëshmonte se hitlerianët pas këtij dyluftimi, ku u shpartallua rreth një kompani trupash, qenë hakmarrë mirorisht kárshi banorëve civilë, duke masakruar afro 60 fëmijë, pleq e gra që gjetën aty.

Pjesa më e ndërgjegjshme e tyre shkuan drejt pushkatimit më ballë lart, duke ua përplasur hitlerianëve në fytyrë gjithë zemërimin që kishin grumbulluar. Pleqtë Dalan Koçi, luftëtar i 1920-ës, ku kishte marrë edhe disa plagë dhe Rexhep Çinua, xhaxhai i heroit të popullit Hysen Çinos, u kapën nga ushtarët nazistë, të cilët i lidhën e nisën t'i shtyjnë me shkelma duke u thënë: Kaput partizan". Ata përnjëherë dhe pa u trembur u përgjegjën: "Kaput Hitler!" Në këtë çast gjermanët të egërsuar i shtynë pleqtë të gjallë në flakët e zjarrit të një shtëpie që po digjej. Të dy burrat i pësh-tolli flaka me fjalët në gojë: "Rroftë Shqipëria!", "Rroftë Liria!..."

Bashkëfshatares Sute Veliu, që para ca ditësh i ishte vrarë vël-lai në luftime, aty iu vra edhe djali i vetëm, po kur i shkuan shqet për ta ngushëlluar tha: Të na çlirohet Shqipëria dhe atëhere gjithë hidhërimin do ta kthejmë në gaz!

Kur e pruri rasti që ne të ktheheshim përsëri në Vranisht, vumë re se karshi okupatorëve dhe reaksionit, banorët e atyshëm ishin bërë edhe më të vendosur; për këtë fliste gjithshka, edhe shtëpitë e djegura, edhe varret e shumta, deri tek ai fëmija njëvjeçar që duke pirë në gjun e nënës kishte marrë dy plumba në kofshë prej automatikëve nazistë, kur ata patën qëlluar symbyllurazi në mes të popullit. Aty u bindëm se qëndrimi i vranishtjotëve gjatë asaj raprezaljeje kishte qenë edhe më heroik se sa dinim ne.

### ***Bishti i derrit***

19 dhjetori na gjeti në Malin e Pilurit. Aty u vërtetuan lajmet se përveç forcave gjermane e balliste që operonin në Mesaplik, një kolonë tjetër ishte nisur nga Saranda me derjtim Borshin, për t'u takuar më pas me atë që vinte nga Vlora. Në konsultën e

shkurtër që u bë atë ditë me shokët lidhur me situatën e krijuar, u shqyrtua edhe mënyra se si duhej të vepronim. Porosia ishte që të manovronim me iniciativë, në përshtatje me situatën.

Kishim mbetur aty vetëm 10 vjetë, të shkëputur nga forcat e tjera të batalionit që po operonin në Kurveleshin e Sipërm. Qëndrimi i mëtejshëm në atë strehën e vogël të shpellës në majë të malit po bëhej i pamundur. Shtigjet na ishin zenë nga të gjitha anët prej fuqive armike që bridhnin me urë në dorë. Të ftohtit e uria gjithashtu nuk na ndaheshin, më keq se gjermanët. Ndonjë bimë që mund t'i kishte qëndruar ashpërsisë së dimrit, ishte "fshehur" thellë në dëborën që arrinte deri në dyzet centimetra.

U gëzua shumë njeri nga shokët kur gjeti një lloj bari në rrëzë të një shkëmbi dhe e futi me të shpejtë në gojë, po pas ca ai u bë keq, nga që bari paskish qenë helmues. E keqja tjetër ishte se nuk po gjenim ujë për t'i bërë ndonjë fare lavazhi, sipas pervojes së një rasti tjetër më parë. Së fundi gjetëm një spithar<sup>1)</sup> me pak ujë nën koren e trashë të akullit që e përdorëm si nisje, ku shtuam dëborë pak nga pak deri sa mezi u bënë rreth dy gota ujë që ia dhamë të sëmurit për larje stomaku.

Fluturimi i disa shpendëve që dukeshin si mishngrënëse prej vendit ku ishim struktur, ia tërhoqi vëmendjen njeri nga shokët. Na lindi shpresa se diku aty afër mund të ndodhej ndonjë kafshë e egër e ngordhur nga dimri që mund të na shërbente edhe neve për të shuar urinë. Për të vërtetuar këtë mundësi u caktuan dy nga shokët e grupit që të kontrollonin vendin, ku uleshin e ngriheshin shpendët. Ata e morën me po aq qejf atë detyrë sa ç'i prisnim edhe ne që të na ktheheshin sa më parë.

Pas një ore të dy shokët u dukën nga larg që po vinin me kokë të varur. Kur ata u afruan edhe më tepër, vumë re që mbanin në dorë një bisht derri të egër, krejt të rrjepur. Atëhere na u bë gjithshka e qartë, pa qenë nevoja që të na i thoshin shokët me gojën e tyre. Në këtë mënyrë dhe kjo shpresë që na pat lindur, ashtu rastësisht, për të ngrënë diçka, na u shua.

---

1) Spithari, shkëmb me një të thelluar që mban ujë

Kishin kaluar nja 30 orë që rrnim të mbërthyer në atë strehë aty në majë të malit. Shikimi kish nisur të na mjegullohej. Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, m'u mais e nisi të më dhembti edhe plaga që kisha marrë në përpjekjen e Urës së Gjormit. Ajo qe e lehtë, prandaj nuk isha shkëputur nga shokët për në spital. "Doktori" siç na qe bërë zakon ta thërrisnim infermierin Osman Xhemali<sup>1</sup>), ma kishte mjekuar me kujdes dhe pas kalimit të 4-5 ditëve të para, nuk kisha ndier më asnje shqetësim.

Nga çdo anë që e studionim gjendjen, aty ku ishim të mble-dhur kokë më kokë, na dilte e zymtë. Më në fund arritëm në mendimin se për të dalë nga një situatë e tillë duhej të çanim me çdo mënyrë përpëra, pavarësisht nga rreziqet që paraqiteshin. Tek e fundit, gjykuam se do të qe më e mirë vdekja duke luftuar, se sa ngordhja, pa bërë asnje përpjekje e të përfundonim në ushqim për shpendët e egra...

### ***"Kafshatën e parë partizanëve"***

Në mbrëmjen e 20 dhjetorit 1943 filluam lëvizjen nga vendi, ku kishim mbetur të izoluar. Më i përshtatshëm na u duk drejtimi juglindor. Kur zbritëm në kryqëzim të dy rrugëve, të lehurat e një qeni aty më poshtë, në vendin e quajtur Katun, na ndihmuani për ta tërhequr njësitin doradorës në atë drejtim. Me atrimin te vendi ku lihte qeni u diktua një shtëpi e ulët që mezi shquhej në mes ca drurëve. Ajo më tepër ngjante si e lënë pa zot sesa menjerëz brenda.

-Ju shokë afrohuni edhe më brenda!- u foli përgjegjësi i njësitet atyre që ecnin më përpëra. Sapo u shqiptua fjala "shok", u hap dera nga ku u dallua disi, aq sa mund të lejonte errësira, koka e një gruaje dhe diçka që ajo mbante në dorë. Ajo foli:

-Kush jeni ju që po vini kështu rrotull?

-Jemi tuajtë, mund të na prisni?- ishte përgjigja dhe njëherazi pyetja nga ai që ishte më afér saj.

---

1)Osman Xhemali, partizan i dalluar nga Dukati me profesion infermier

-Po të jeni tanët derën e keni të hapët, po më gënjetët më mirë mos u afroni sepse e zeza ju ka për të gjetur - tha ajo prerë, duke i vënë re me kujdes ata që i ishin afruar për t'u bindur në se ishin me të vërtetë partizanë.

-Prisni!- tha prapë ajo, si u bind për këtë. La mënjanë sopatën që kish pasur në dorë, nxori te dera, në anën e brendshme të saj një ashkël pishe të ndezur që të mund të shihnim për të hyrë brenda.

-Urdhëroni, po do na falni që s'na ndodhet vajguri për të ndezur kandilin- tha dhe tregoi me dorë vendin e kandilit mbi oxhak. Pastaj i vuri zjarrit ca dru deri sa mori mirë flakë. Ajo e kuptoi gjendjen tonë, sa e mori vesh që vinim nga mali i Pilurit dhe nisi të na shpjegojë për ç'ndodhët në fshat. Nga të thënët e saj kuptuam se kishin ardhur dy kolona të mëdha nazistësh e mercenarësh së bashku; njera nga Vlora, tjeter nga Borshi. Në fshat nuk kishte mbetur asnjeri nga banorët; ata ishin larguar, duke u fshehur me të gjithë familjet e tyre nëpër pyje...

Ndërkaq ajo u ngrit e kaloi në dhomën tjetër që e ndante një korridor i ngushtë prej asaj ku rrnim ne. Dyert ishin të vjetra e nuk mbylleshin mirë, kur flitej normalisht mund të dëgjohej fjala nga dhoma në dhomë. Mbetëm për ca çaste në heshtje, duke u ngrohur në prushin e mareve që kërcisin, sikur të kishin hedhur kokrra misri.-Ah sa të mira do të ishin ato!- tha njeri nga shokët.- Cilat?- pyetëm disa nga ne të tjerët njeri pas tjetrit e aty ia dhamë një të qeshure të madhe. E njëjtë gjë na kishte ardhur ndërmend pothuajse të gjithëve nga kërcitjet e drurëve që digjeshin sepse na kishte qëlluar shpesh që kur s'gjenim bukë, bënim kaposhe nga misrat e thatë.

Nga dhoma tjetër vinin copa fjalësh. E zonja e shtëpisë fliste me dikë.- Janë partizanë si Lutua...<sup>1)</sup> kanë kohë pa ngrënë...-u duk sikur thoshte zëri i saj i kujdesshëm. -Mirë jepua se ne do flemë e nuk ndjejmë uri..-thoshte një tjetër që ngjante me zërin e një fëmije.

-Jo unë nuk do të pranoj kurrë që të hyj në pjesën e këtyre fëmijëve- tha Egeremi<sup>1)</sup> ai që një ditë më parë kishte vajtur deri

---

1) *Luto Begiri, biri i saj, ish partizan në brigadën IS.*

në buzë të varrit prej atij barit të hidhur që kishte ngrënë. Ata mendim shprehëm edhe ne të tjerët. Po bëhej afro një orë që po ngroheshim pranë zjarrit, një pjesë shokësh i zuri edhe gjumi nga ngrohtësia që u krijua aty, të mbështetur njeri pas tjetrit. Në këtë kohë u hap prapë dera dhe hyri e zonja e shtëpisë me një tepsi në dorë e na e vuri atë përpara. -Do të na e bëni kabull me këtë që kemi, e kam hedhur në enë të hapët një çikë qull që të ftohej shpejt- tha ajo.

-A- a, kjo është e tepërt...-nisi të fliste Egeremi

-E di që duhej t'ju jepja më tepër- e ndërpren ajo, pa e lënë atë që të mbaronte fjalën. Po ashtu ia mori nga goja fjalën edhe Shaqos, duke thënë:"Ne e kemi rregull-kafshatën e parë partizanëve" -Hajdeni shpejt, afrohuni se ju jeni partizanë dhe e dini më mirë se unë, ç'bie minuta nuk bie as viti!

Ishte e pa mundur të na linte, pa u bërë e saja. Morëm pastaj të hanim prej atij qulli që ngjante se ishte nga mielli i misrit e i thekrës përzier, ndoshta mund të kishte brenda edhe elb ose ndonjë lëndë tjetër. Megjithatë nuk i bëmë naze, na u duk jashtëzakonisht i shijshëm. Në fund i kërkuan që të na tregonte se nga na binte më mirë për të dalë diku në rrugën Fterrë-Kuç.

-Për të ikur e dini vetë punën tuaj, po të ishit ngrohur edhe ca se shpejt është- tha ajo.

-Jemi shumë mirënjoës karshi jush, ja pritëm, mjافت halle paske, kujdesu për këta fëmijët e vegjël...

-Fëmijët tanë janë regjur me vuajtjet e luftës: ata kishin shumë qejf të takoheshin me ju, deshën të ngriheshin nga rrobat, po nuk i lashë unë se ishte tepër vonë.

-Mirë bëre që nuk u prishe gjumin, jepu të fala nga ne, partizanët! Kështu u ndamë me trimëreshën labe Merjo Beqiraj. Ajo na përcollti deri poshtë shtëpisë duke mbajtur sëpatën në dorë dhe na porositi të ishim të kujdeshshëm. Në fund, si të gjitha nënët e tjera që na kishin pritur e përcjellë, na tha se shtëpia e saj e vogël në anë të pyllit, rrinte gjithmonë e hapur për djemtë e popullit.

---

1)Egerem Bicalli, partizan qysh me formimin e çetës "Ismail Qemali"

Njësitit tonë iu desh të qëndronte edhe disa ditë të tjera në pyjet e Kuçit, së bashku me shumë familje nga ato të fshatit që ishin fshehur aty. U bëmë një me popullin, këtu nuk ndiem me ndonjë krizë të madhe as për ushqim, sepse ata ndiqnin rregullin: "kafshatën e parë partizanëve". Ne nga ana e jonë u munduam që t'ua shpërblenim disi këtë bujari E morëm vetë përsipër mbrojtjen e rajonit përreth nga patrullat armike që vinin vazhdimisht vërdallë. Edhe atë kapotën me shenja plumbash që pata marrë në duelin e Vranishtit e ndonjë send tjetër ua falëm atyre që kishin fëmijë të vegjël për t'i ruajtur nga të ftohët.

Më të gdhirë 25 dhjetori u ndie një katrahurë e madhe në radhët e ballistëve që kishin vepruar së bashku me gjermanët gjatë operacionit. Kjo zhurmë, që pasohet edhe nga ndonjë e shtënë pushke, na vuri edhe ne në gjendje përgjimi. Më pas u dëgjua thirrja: Gjermanët ia kanë mbathur për tërë natën, po ngrehuni t'u biem aleatëve të tyre. Ky që sillte kushtrimin, ishte një nga kuçotët që ishin fshehur në anën tjetër të pyllit dhe i kishte parë me sytë e tij lëvizjet e armikut.

Thirrjet: "Para partizanë!" sa vinte e bëheshin më të shpeshta. U vunë në lëvizje dhe grupet e tjera të partizanëve që deri atëhere kishin qëndruar gjithashtu të fshehur nga vala e parë e operacionit. Në ndjekje të armikut u vunë edhe fshatarët, bashkë me partizanët. Një frikë e pasiguri ngjalli tek ballistët sidomos zbritja e njësive partizane nga Kurveleshi i Sipërm. Ata po u rrezikonin atyre rrugën e tërheqjes për në Vlorë, prandaj nuk mundën të qëndronin më shumë se disa orë, pas tërheqjes së gjermanëve. Në këtë ndjekje të armiqve u përfshimë edhe ne, bashkë me të tjerët, deri sa u bashkuam me forcat e tjera të batalionit tonë në Ranicë.

Me tërheqjen e gjermano-ballistëve nga zonat e veprimit për në qytetet, në fund të dhjetorit, përfundonte edhe faza e parë e operacionit të dimrit 1943 -1944, njera nga periudhat më të ashpra të luftës partizane në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe, u bë edhe kalitja e mëtejshme e çetave dhe batalioneve tona, pra u bëmë më të fortë.

## **NGA VITI 1944**

### **IV.NGA BRAMYSHJA NË PËRMET**

*Dita e përrurimit të Brigadës VS; nga luftimet gjatë operacionit të dimrit 1943-1944, grimca nga bashkëveprimi në luftë me misionarët e aleatëve të mëdhenj; zgjerimi i zonave të çliruara.*

#### ***Përrurimi i Brigadës***

Atë ditë, të 20 janarit 1944 qysh në mëngjes herët grykat e maleve përreth përcillnin, valë-valë, oshtimën e këngës gjatë tërë Luginës së Mesaplikut. Vinin njeri pas tjetrit, karvanet e gjata të njerëzve, ca me kuaj e të tjerët në këmbë; dikush mbante edhe flamurin në dorë. Ngjanim me krushqit që shkojnë për të marrë nuse. Ishin nisur nga fshatra të ndryshme të të gjithë qarkut për të marrë pjesë në përrurimin e brigadës V.S. Dora-dorës me ta bashkoheshin edhe vullnetarët e rinj që do të plotësonin radhët e kësaj brigade.

Bukurinë që i dhanë këta "dasmorë" Tërbaçit, ku u bë përrumi atë ditë dimri, më shumë nga të tjerët e shijuam ne që ndodheshim atje qysh një ditë më parë e na takoi t'i prisnim gjithë ata që vinin. Ngjante sikur edhe natyra merrte pjesë në gjëzimin tonë, duke na "dhuruar" një ditë me mot të mirë.

Aty nga ora 10 e ditës ranë bilbilat. Kishte ardhur koha përrreshtimin e partizanëve. Çetat e batalionet partizane që formonin brigadën kishin "datëlindje" të ndryshme qysh prej viteve 1942 e 1943. Ato përbënин pjesën më të madhe të saj. Luftëtarët e tyre ishin të sprovuar me dhjetëra herë në fushën e betejës. Në vend të dekoratave ata mbanin shenjat e plagëve të shumta nga plumbat e armiqve. Armët që mbanin në sup ishin të markave të ndryshme. Disa iu ishin rrëmbyer fashistëve italianë, disa nazistëve gjermanë, të tjerat edhe më të vjetra, që nga 1920-ta dhe Lufta e Parë Botërore.

Vullnetarët e rinj që plotësonin brigadën përgjithësisht kishin bërë pjesë në njësitë teritoriale të vetëmbrojtjes së fshatrave, ata qenë të njohur shum' a pak me kërkeshat e luftës partizane, veçse ishin më pak të pajisur se sa partizanët e vjetër. Prapëserapë ata kishin hijeshinë e tyre me ata gjerdanët e qëndisur për mesi, një pushkë në krahë, siç i ishte ndodhur secilit dlie nga një torbë për të vënë ndonjë copë bukë, ndonjë bombë dore apo edhe ndoca fishekë, ashtu siç i kishin mbajtur edhe të parët tanë.

Dalja e Besnikut përpëra partizanëve e popullit u prit me shumë interes. Ai leksi përshtendetjen që dërgonte Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë PVNCL me rastin e formimit të brigadës së 5-të S. dlie rëndësinë që kishte kjo ngjarje... "Përpëra gjithmonë në sulm!" "Përpëra gjithmonë në fitore!" - përfundonte përshtendetja<sup>1)</sup>

Komandanti i Brigadës, Shefqet Peçi u përqendrua më tepër në vlerësimin e përgjithshëm të situatës ushtarake e politike dhe në veçanti foli për detyrat e mëdha që u kishte besuar populli e PK Brigadës së 5-të. Me kujdes u dëgjua edhe fjala që mbajti Ramize Gjebrea<sup>2)</sup> e cila përshtëndeti në emër të KQ të Rinisë Antifashiste Shqiptare.

Ramizeja qe një befasim për të gjithë me kurajon për të ngritur probleme aq të rëndësishme përpëra një mase të madhe njerëzish dhe me logikën e fortë për të argumentuar rëndësinë e pjesë-

---

1) Dok.të shtabit të përgjithshëm të UNCL vell.3, f.205

2) Ramize Gjebrea ish anëtare e KQ të rinisë antifashiste shqiptare, dëshmore e Luftës ANÇL

marrjes së femrës shqiptare në luftën e armatosur që po drejton-te PKSH. Arsyetimet e Rëmizësë tingëlluan fuqishëm edhe kundër moralizimeve bajate të "Ballit Kombëtar" e koncepteve mesjetare që kishte ajo organizatë lidhur me femrat. Gjithë ajo ditë kaloi si një dasëm e madhe ku gjëmonte gazi e hareja, njerëzit të mble-dhur nëpër grupe në bazë të fshatrave këndonin e kërcenin. Grumbulli i madh i tërbaçjotëve ja thonte këngës:

*"Europa shkruajnë e thonë  
se Shqiptarët luftojnë..."*

Dhe grupi tjetër i vranishtjotëve që ishte pak më tej e vazhdonte (me që këndohej më dysh):

*"Po me se luftojnë vallë  
me sopata e me hanxharë.."*

Partizanët gjatë asaj dite nuk u ndanë nga populli në të gjitha ato manifestime. Kënaqësi të madhe ndjemë sidomos kur takonim të njohurit tanë më të vjetër, ata që i kishin bërë shtëpitë e tyre baza për ne, në çdo kohë pa u tërhequr nga asnjë rrezik. Një i tillë ishte edhe patrioti Muço Delua. Gjetëm rastin me një grup shokësh i u afroam për t'u takuar me të; ai fillmisht na uroi neve për brigadën që po përryrohej pastaj nisi të na flasë për epopenë e 1920-s si pjesëmarrës i saj, për komandantët e çetave dhe për bëmat e tyre. Biseda që nisi midis nesh tërhoqi edhe të tjerë; kështu pak e nga pak u krijuua një grupi i madh partizanësh që po e dëg-jonin me vëmendje.

Biseda të tilla bëheshin edhe pak më tej ku na tërhoqi vëmendjen sidomos e qeshura e madhe që shkaktonte kallëzimi i një fshatari nga Bratajt.

-Kur erdhën mercenarët e Halil Alisë në stalin tim-vazhdoi ainjeri prej tyre u shkëput nga të tjerët e hyri në kasolle brenda, për të rrëmbyer ndonjë brashnjë. Unë, i kërcënuar prej tij, mbeta në këmbë e po shikoja veprimet që bënte. Luajti nga vendi gjithë rrangullat e ndryshme, zgjati kokën qosheve të kasolles për të gjetur gjoja "depot e komunistëve"<sup>1)</sup>, pastaj iu afrua një kashune të madhe që e përdornim si punë hambari, ku mbanim miellin;

-----  
<sup>1)</sup>Kështu i quanim ata depot dhe bazat e lëvizjes Nacionalçlirimtare

ngriti kapakun dhe uli kokën të shikonte brenda; atëhere m'u er-rën sytë nga inati. Shikova një herë përjashta; shokët e tij i qenë vërsulur vathës së kecërve e s'e kishin mendjen këtej; atëhere mora tokmakun prej lisi që më zunë sytë përparrë vetes e i rashë me të prapa qafës dhe ai menjëherë e "lëshoi" kokën në miell sikur ta kishte të prerë, pa bërë as gëk, as mek...

Po tani që më mbeti në derë?! mendova me vete. Të them të drejtën, zuri të më vijë festja rrotull nga frika se mos ma gjenin brenda.... Për fatin tim nuk vonoi as dy minuta dhe u ndie sokëllima e partizanëve nga ana tjetër: "U bini qenërve!". Pas këtyre thirrjeve, mercenarët u vunë në ikje të shpejtë sa nuk shihnin ku



Parakalim në ditën e përrurimit të Brigadës së V Salmuese

shkelnin... Shpëtova unë, po edhe kecërit më shpëtuan...

Kështu kaloi ajo ditë, mbyllja e së cilës u bë me parakalimin e formacioneve të brigadës përparrë popullit dhe nisja e tyre në drejtime të reja betejash.

### ***"Mos pyesni për shtëpitë tonal!"***

Kishim udhëtar tërë natën e gjithë atë paradite prej Kallaratit, që shtrihet në krye të Luginës së Mesaplikut, nëpërmjet Malit të Çikës që tanimë ishte mbuluar me dëborë, gjersa mbërritëm, në vendin e quajtur Kare, sipër Vunoit, nga ku edhe fshati poshtë dukej i téri.

Pas pak ia mbëritën tek ne një grup grash e vajzash nga fshati i Vunoit, të cilat sollën dhe ushqimet që kishin mundur të grum-

bullonin shpejt e shpejt, apo qenë lajmëruar për ardhjen tonë.

Gjatë kohës që ishim ulur e po hanim bukë, grupe-grupe më bëri përshtypje kur njera nga gratë u shkëput dhe i vajti pranë një partizani. Aty hoqi çorapet e saj më të reja që i kishte veshur poshtë të vjetrave dhe ia zgjati atij që t'i vishte; tjetri s'po dëgjon te t'i merrte, ajo nguli këmbë duke thënë: "Do t'i marrësh patjetër se po të këputen këmbët nga të ftohit..." U afrova ca dhe i dola përpara partizanit që më kishte kthyer krahët, e pashë ishte Çomja i skuadrës së parë që shokët e thërisnin "shkatarraq" nga që nuk mbahej mirë në veshje, çka se si luftëtar që sypatrembur. Ai edhe bustinën nuk dinte ta mbante ndonjëherë drejt, ylli i kuq në ballë të saj, zakonisht, i binte ose mbi syrin e djathtë, ose në anën tjetër, e nga një herë edhe mbi vesh.

Këtë herë Çomes s'mund t'i hidhej edhe aq faj për paraqitjen e tij të jashtme, sepse përvëç lodhjes si gjithë të tjerët, opingat e tij prej gome automobilash, ishin të hapura anash, i kish hyrë débora brenda gjatë kalimit të malit dhe ia kishte nxjerrë çorapet krejtësisht jashtëpërdorimit. Mishi i këmbëve i qe bërë gjak i kuq. Ai më në fund i veshi çorapet që i fali nëna vunjotëse, duke e falenderuar atë përzemërsisht.

-Dëshirën e madhe që kishim për të hyrë brenda në fshat, këtë herë nuk do ta plotësojmë dot me që ai është në mes të rrugës, ku lëvizin shpesh autokolonat gjermane, dhe me një veprim, të tillë mund t'u japim shkas atyre që ta djegin fshatin, tha ndër të tjera komisari, duke iu përgjegjur grupit të grave që na ftoi të zbrisnim në fshat.

-Vunoj është me partizanët dhe me frontin NÇl që i luftojnë armiqtë pa mëshirë... Flaka në majë le t'iu dali edhe shtëpive tonë po të jetë nevoja... Ky ishte pak a shumë kuptimi i fjalëve aq të vendosura që tha gruaja më e dalluar nga të tjerat, ajo që pak më parë hoqi çorapet e saj dhe ia dha Çomes. Mandej ajo e mbylli arsyetimin e saj me fjalët.

-Erdhëm sot tek ju, jo për t'ju sjellë një copë bukë dhe as me kokën tonë, po në emër të këshillit NÇ dhe të të gjithë fshatit, ata ju presin që të hyni aty medoemos e të gdiheni nëpër shtëpitë

tona...Ndërkaq Eftali Trolja,<sup>1)</sup> u bëri shenjë me dorë dhe i rreshtoi gratë e vajzat pranë skuadrës, ku ishte flamuri repartit për të na prirë rrugën. Më në fund ju bindëm asaj, deshëm s'deshëm.

Mbërritëm në fshat bashkë me muzgun e mbrëmjes. Në një copë vend të shtruar, pranë xhadesë në mes të fshatit kishin dalë e po na prisnin pothuaje të gjithë banorët e fshatit. Më tej një grup të rejash ia thoshin këngës, oshtima e saj në melodinë himariote buçiste:

“.....  
*Nat' e errët mbi Shkumbin, mbi Bujan,  
dhe mbi Vjosën val' e trubull, ane mban,*  
.....”

Dëshira e fshatarëve ishte që të kishte secili të paktën nga një partizan në shtëpinë e tij, kurse neve na duhej të ishim sa më afër me shoqi-shoqin, që për çdo rast të ishim gati. Kështu që nuk patën mundësi t'u plotësonim vullnetin të gjitha familjeve. Megjithatë kjo pamundësi e jona u kuptua drejtë.

Atë mbrëmje të zonjat e shtëpive u bënë copë, kush e kush t'u bënte më mirë mysafirëve për të ngrënë; petullat me vaj ulliri, nuk mbeti asnjë familje pa i bërë çka se ne nuk donim që ata të harxhoheshin.

Aty nga ora 21.00, kur shumë kush mund të mendonte se nuk do të kishim ndonjë shqetësim, patrulla që kishim nxjerrë nga ana e Dhërmiut na lajmëron se një zhurmë makinash po dëgjohej andej dhe ca drita të zbehta që dukeshin e zhdukeshin shpesh po afroheshin gjithnjë e më shumë. Sa u bëmë gati ne autokolona armike prej rreth 7-8 makinash me ushtarë, ia mbërriti në të hyrë të fshatit. Po të llogaritej se në çdo makinë mund të kishte jo më pak se 40 ushtarë, kishim të bënim me një forcë armike deri 8 herë më të madhe nga ç'ishim ne.

Dihej që reparti partizan kishte ardhur këtyre anëve jo për shëtitje po për luftë me armikun kudo që ta gjente atë. Për të mos i eksposuar banorët karshi terrorit armik, goditjet si rregull

---

1)Eftali Trole, aktiviste e dalluar gjatë Luftës ANÇI

bëheshin jashtë qendrave të banuara. Këtë herë ishte tepër vonë për t'ia arritur kësaj, po edhe sikur ta godisnim armikun në kushtet që ishim, të shpërndarë nëpër shtëpira, zor se do të mund t'i shkaktonim ndonjë dëm të ndjeshëm.

Nga drejtپeshimi i gjithë faktorëve u vendos që partizanët të zinin pozicione sa më të përshtatshme nëpër dritaret e shtëpive të gurta, me drejtim nga rruga, ku do të kalonte autokolona siç qenë dhënë udhëzimet paraprake dhe, po qe se gjermanët do të kërkonin të zbrisnin në fshat, t'u hapej zjarr dhe të hidheshim mbi ta. Ky vendim u quajt më i arsyeshëmi edhe nga këshilli NÇl i fshatit "Ju bëni detyrën, mos pyesni për shtëpitë tona"- thanë ata.

E zonja e shtëpisë, ku qemë ne një grup shokësh atë natë pa hyrë akoma makinat, e para të autokolonës në fshat mori në dorë sopatën që e kish lënë pas derës duke na thënë:-Ju bëni detyrën andej nga dritarja se nga dera jam vetë, jeto..."

Zhurma e makinave që nisën të kalonin aty pranë ngjante sikur po e lëvizte shtëpinë nga themeli; nëna në këtë kohë nisi të mërmëriste me vete:"Ç'ju pruri sonte o të mallkuar?...ju s'e kini pasur zakon të kaloni natën...Sa për shtëpinë nuk kam dert se digjet, të keqen na kini për të marrë..."

Shqetësimi ynë mbaroi apo fundi i autokolonës kaloi fshatin dhe u largua në drejtim të Himarës, por armikut i duhej treguar se ne ishim me këmbë e të pamëshirshëm ndaj tij. Pa hapur mirë mëngjesi reparti u nis në drejtimin veri perëndimor. E kaluam Dhërmiun përsipër nga ana e malit në mënyrë që të mos i binim në sy një farë agjenture që kish mundur armiku të krijonte aty me parrullën e tij të njojur "Për të shpëtuar fshatin nga djegia , të mos pranohen partizanët".

### ***Shkatërrimi i urës***

Ditën e parë të shkurtit një pjesë prej tanëve u zuri pritë në Përroin e Palasës tre kamionëve të mbushur me ushtarë gjermanë që udhëtonin në drejtimin Llogara-Himarë. Goditja qe e befasishme dhe e shpejtë. E detyruam armikun të ndalet dhe t'i kthejë makinanat prapa, andej nga qenë nisur. Nuk shkatërruam dot asnjerën

prej tyre. Ne ishim nxituar në goditjen që i bëmë armikut dhe i dhamë atij mundësi të shpëtojë.

Nga vlerësimi që iu bë gjendjes në atë mbrëmje vendosëm që të nxirrej mësim nga gabimi i ditës së parë, kështu që mëngjesi tjetër urën e gjeti të prishur dhe neve në pozicione në anën e majtë të saj. Rreth kohës së drekës një autokolonë gjermane prej 6 makinash u duk përsëri në zbritje të Llogarasë, gjatë rrugës automobilistike për në Himarë që duhej të kalonte nëpërmjet Urës së Palasës, e cila në fakt nuk ekzistonte më; po meqenëse ajo ndodhej në një vend të thellë, hitlerianët nuk mundën ta diktonin me kohë. E panë vetëm kur mbërritën fare afër saj.



Heroi i Popullit Hysen Çino

Një grup parizanësh nën udhëheqjen e Hysen Çinos<sup>1)</sup> u hodhë në anën tjetër të përroit dhe i sulmoi ushtarët që sapo zbritën nga makinat e kreut të kolonës e po mundoheshin të zinin vend për qëndresë. Veprimet e shpejta e tepër të guximshme të Hysenit me shokë e çorientuan armikun.

Luftimet, pas disa minutash arritën fazën e tyre më kulminante. Artileria gjermane nisi të godasë me predhat e saj që nga Maja e Llogarasë gjithë zonën e vendosjes së forcave tonë, po me një farë drujtje për të mos dëmtuar të vetët.

Grupi ynë sulmues vazhdonte të ndiqte këmbës atë pjesë hitlerianësh që i kish vënë përpëra që nga këmbë e urës dhe po tërhiqeshin duke kapërcyer prej trungut të një lisi te tjetri. Ata përpinqeshin të arrini gjallë një bregore me gurë të mëdhenj që i joshte për qëndresë të sigurtë.

Në këtë kohë përgjegjës i njësitet u shkëput nga shokët e tjerë të grupit dhe hyri në mes të armiqve që po iknin; breshëria e

-----  
1)Hysen Çino, dëshmor i Luftës ANÇl, Hero i Popullit, ish komandant batalioni.

automatikut të tij e shtriu për tokë një oficer armik dhe një nazi i tjetër që ishte fare afër tij. Nazistët e tjerë e kishin të vështirë në këto çaste të shtinin kundër shokëve tanë nga që mund të vrisin njeri-tjetrin.

Kishin kaluar rrreth dy orë prej fillimit të luftimeve kur gjermanët nisën tërheqjen përfundimtare dhe artileria e tyre nisi t'i korrigjonte qitjet e saj, duke iu afruar më shumë pozicioneve tona. Në këtë kohë erdhi dhe lajmi se disa forca ballistësh po afroheshin nga ana e Dhërmijut për të na rënë prapa krahëve. Për ballistët nuk na u desh shumë punë që t'i "bindnim" se e kishin të kotë. Ata u tërhoqën në panik pas një kundërpërgjigjeje të vendosur nga ana jonë. Kështu që ajo ditë u mbyll me prishjen e urës dhe me 7 të vrarë e 12 të plagosur nga ana e armikut<sup>1)</sup>

### ***Goditje nga pas shpine***

Në mëngjesin e 3 shkurtit u dëgjuan breshëritë e para të mitrozozëve gjermanë që vinin nga ana e fshatit Palasë, në shpinë të krahut të djathtë të pozicioneve tona përballë urës së shkatëruar. Në fillim kjo gjë na u duk e pabesueshme, por plumbat që na vërshtellenin prapa krahëve "flisnin" vetë. Armiku kishte vepruar me zgjuarsi. Ai i qe përshtatur më së miri taktilës sonë të befasisë. Agjentët vendas e kishin udhëhequr nëpër shkëmbenj e gremina nga ana e Malit të Llogarasë përmbi Përroin e Palasës dhe kishin dalë në anë të fshatit pa u diktuar, nga ku edhe nisën të qëllojnë.

Nazistët e dinin që mali për ne ishte aleati më i sigurtë prandaj synonin ta mbanin vetë atë krah dhe të na detyronin ne që të merrnin anën e detit, ku mund të na dëmtonin më shumë ose të na asgjësonin. Kjo shpinë-marrje u ngjalli atyre shumë shpresë për fitore po me veprimet taktkike shumë të shkathta dhe të vendosura nga ana e të gjithë partizanëve u arrit që benda rrreth 30 minutave të dalim në anën tjetër të fshatit, në një vijë me gjermanët e në krahun e majtë të tyre. Kështu ua hoqëm atyre edhe

---

1)Buletini "Zëri i Popullit"- AU Fan.Brig. V.S. Nr.743 datë 20 maj 1944

mundësinë e hapjes së mëtejshme gjatë rrëzës së malit për të na futur në rrethim.

Në këtë situatë nxorën përsëri kokën ballistët. Ata na goditën nga prapa shpine prej kodrave të Dhërmiut. U desh luftuar tanë në të dy krahët. Forcat tona u ndanë në dy pjesë: gjysma u hodh në sulm kundër gjermanëve për t'i shkultur nga prapa shkëmbenjve ku ishin ngulitur, gjysma tjetër u drejtua kundër ballistëve që s'pushonin së qëlluari nga ana tjetër e përritoit.

Rreth orës 4 të pasdites gjermanët u larguan drejt Llogarasë andej nga qenë nisur. Mitralozi ynë i rëndë "Breda" tanë që kish mbaruar punë me gjermanët e ktheu grykën e tij nga ballistët të cilët e ndjerë frikën e një ndeshjeje vetëm për vetëm me partizanët gjë që s'u kishte ecur asnjëherë dhe ua mbathën këmbëve për në Dhërmi. Në këtë mënyrë u hapën rrugëdalje edhe për tre partizanët që i kishin bllokuar qysh një ditë më parë në një shtëpi dhërmiasë.

### ***Blokimi në shpellë***

Më 4 shkurt reparti ynë partizan kishte mbërritur në një shpellë të Malit të Vunoit, në pjerrësinë perëndimore të tij. Ajo ishte aq e ulët sa njeriu mund të lëviste vetëm gjunjazi. Nga pikat e ujit që kullonin vazhdimisht, me kohë qenë krijuar ca shkopinj akulli që ngjanin si qirinj të stërmëdhenj. Megjithatë gjendja e jonë aty nuk ishte shumë për t'u ankuar, po të krahasohej me atë përreth të mbuluar nga dëbora, që arrinte deri te gjoksi e që vazhdonte të binte akoma. Synimi ynë kryesor ishte që të shpëtoheshin partizanët nga ngrirja, të ruanin shpirtin luftarak dhe aftësitë fizike të tyre për veprime të mëtejshme.

Partizanët më të vjetër edhe këtu në shpellë po e plotësonin mirë detyrën që u ngarkonte situata. Zaho Koka<sup>1)</sup> në një rast tha: "Edhe të qëndruarit këtu në shpellë ka një anë të mirë se kalisim durimin dhe çmallohem me njeri-tjetrin..." ndërkohe; trupat

---

1)Zaho Koka, dëshmor i Luftës ANÇL, Hero i Popullit

naziste dhe grupet e mercenarëve bënин shumë presion poshtë në fshatra. Ata kishin ndërtuar një sistem të repte patrullimi brenda zonave të ndodhjes së tyre. Operacioni armik i dimrit vazhdonte me të gjithë ashpërsinë e tij.

Ditën e pestë të qëndrimit tonë aty, u mendua që dikush nga shokët të zbriste poshtë në fshatin e Vunoit ose të Himarës që edhe të shikonte gjendjen e armikut aty, edhe të përpiquej për të gjetur ndonjë send për të ngrënë. Pati mjaft vullnetarë nga ata që e njihnin vendin; po ky mision më në fund iu ngarkua Kozma Danit<sup>1</sup>. Ai mori me vete edhe një shok tjetër. Ata mundën të kalojnë nëpërmes patrullave të shumta gjermane dhe detyrën e ngarkuar e plotësuan mirë. Vajtën e erdhën brenda natës. Gjenda e paraqitur nga njerëzit që kishin takuar ishte e rëndë, ashtu siç e kishim mësuar edhe nga informatat e mëparshme. Furnizimi që sollën përbëhej nga një shishe raki e dy vargje fiqsh, aq sa kishin mundur të gjenin.

Zahua e mori i pari shishen e rakisë, me urimin drejtuar të gjithëve që ishim grumbulluar në aneksin kryesor të shpellës dhe e ktheu duke thënë; "Gëzuar shokë, rakia na erdhi, mezen e kemi me fiq, po kujdes të mos dehem, hajt pra, me fitore!" E kaluam shishen dorë më dorë deri tek i fundit. Por prapë nga kujdesi që të mos mbeteshin të tjerët pa pjesë, tepëroi ca raki. Kështu patëm mundësi që ta qarkullonim shishen nga pak edhe njëherë tjetër. Pastaj Refat Deliu<sup>2</sup> na ndau edhe nga 5 kokrra fiku, duke u lënë diçka më tepër shokëve që ndodheshin nëpër vendroje.

Ditën e shtatë dhe të tetë, situata u bë edhe më e acaruar në shpellë. Skuadrat gjermane të patrullimit nisën të afrohen gjithnjë e më shpesh në drejtimin tonë, duke ecur nëpër borë dhe përsëri largoheshin.

Me kalimin e ditëve, qëndrimi brenda shpellës bëhej më i dyshimtë, patrullat gjermane që tanimë e bënë zakon të vinin deri afér nesh e të qëllonin disa herë kuturu, para se të ktheheshin prapa, ngjante sikur donin të thonin: "Ne ju dimë ku jeni"

1)Kozma Dani, ish partizan i shkathët dhe energjik nga Himara

2)Refat Deliu, ish intendent kompanie

Ditën e nëntë na humbi pa lënë gjurmë njera nga rojet e patrullës, Shaban Hoxha nga Romësi, një nga partizanët më të shkathët dhe shumë i dashur me shokët. Ai shkoi në patrullë bashkë me një shok tjetër dhe papritmas u shkëput nga shoku në kohën e një furtune që e ngrinte dëborën përpjetë; ishte natë po nuk u gjend më as ditën. Nga kërkimet e mëpastajme u konkludua se kishte ngrirë prej të ftohtit dhe në pamundësi lëvizjeje, e kishin gjetur gjermanët. Ata pasi nuk kishin mundur ta përdornin për qëllimet e tyre e zhdukën në një mënyrë të tillë që as trupin nuk mundëm t'ia gjenim dot.

Dita e dhjetë dhe e fundit në shpellë ishte 13 shkurti. Refati që paskish ruajtur pak miell për "ditë të zezë" na bëri ca qull, diku në anën tjetër të malit sepse aty, nga frika e të diktuarit nuk mund të ndizej zjarri. Na i ndau atë nga 2-3 lugë për shok. Në konsultën që u bë me të gjithë partizanët atë pasdite doli se kishte vetëm dy rrugë: ose të pranonim të ndlesheshim në luftime me armiqët nga vendi ku ishim, ose të çanim me çdo kusht e të dilnim në prapavijat e tyre dhe t'i godisnim ata nga prapa shpina. Me korierin që pat dërguar shtabi i brigadës variantin e dytë e quante më të përshtatshëm. Ja si na pat shkruar ai: "Në rast se forcat tona do të detyrohen të tërhiqen prej reaksionit armik duhet të keni parasysh ta godisni armikun pas shpine në formë njësitesh..."<sup>1)</sup>

### ***Çarja e bllokimit***

Duke u gdhirë 14 shkurti u bë nisja nëpër një terren me vende të thyera e shkëmbenj të thepisur, të vështirësuar edhe nga dëbora. Errësira e natës, vendi i pyllëzuar me shkurre në anën tjetër të malit nga do të kalonim dhe ruajtja e fshehtësisë së lëvizjes ishin gjithashtu vështirësi të tjera që duheshin përballuar gjatë marshimit. Grupi ynë prej 7 vetësh u nis në drejtësim të Grykës së Kallaratit po praktikisht ramë diku në lindje të Vranishtit tek një shtëpi e veçuar mbi një kodrinë. Këtu grupi u nda më dysh, tre

---

<sup>1)</sup>AU, Fon.Brig.VS,kutia 1. dosja7.

nga shokët morën drejtimin e rrëzës së malit të Vranishtit për nga Mali i Bratë; ndërsa ne 4 të tjerët duhej të kalonim matanë lumi Shushicë në të djathtë të tij e të dilnim në Ramicë ose dhe më thellë prapavijave armike.

Gjatë ecjes për nga lumi ndihej kudo prania e ushtarëve pushtues. Vëmendjen tonë e tërhiqte sidomos ai “alti” që përsëritet shpesh në drejtime të ndryshme dhe që nganjëherë zërat na dukeshin si fare afër. Një nga të zotët e shtëpisë që kishim mundur të takonim te kodra, na pat shpjeguar se ushtarët që ndodheshin aty ishin si “mizë lisi”, shtriheshin në të gjithë rajonin përreth; nuk mund të lëvizte njeri nga vendi. Gjermanët nuk kishin lënë pulë e vezë pa marrë, kudo që takoninë to.

Në ecje e sipër hasëm në një roje gjermane dhe sa u dëgjua thirrja e saj për ndalim, njeri nga shokët tanë shtiu me armë. Ky gabim pa dashur na ekspozoi; për ta riparuar disi këtë veprim të pamatur u detyruam të largohemi me shpejtësi në drejtimin e kundërt të rojes që na diktoi. Pas një pauze të shkurtër morëm përsëri drejtimin për nga lumi. Po shpejtonim nëpër një rryp vendi të zhveshur. Mëngjezi po afronte dhe ja, përsëri një tjetër “alt” dhe një e zbrazur pushke menjëherë pas saj nga ajo anë. Këtë herë e patëm më kollaj që ta korigjonim lëvizjen pa iu përgjegjur atij që na qëlloi.

Duke ecur më tej vumë re se na mungonte njeri nga shokët, Filo Ramadani<sup>1</sup>, ai ishte shumë guzimtar e i zhdërvjelltë, ekte gjithnjë përpara grupit. Përpjekjet tona për ta gjetur aty rrotull nuk dhanë asnjë rezultat. Ishte në të zbardhur dita, kur grapi kishte arritur në anë të lumit, po lumi ishte shumë i fryrë e nuk mund të kalohej. Dallgët që formoheshin nga përplasja e ujit të vrullshëm pas shkëmbinjve të bregut, i hidhni brizgat e përziera me shkumë e ujë bashkë deri tek ne që mbetëm të struktur aty. Tërë atë ditë na u desh ta kalonim në shkurret e buzës së lumit të rrëmbyeshëm ku nuk mund të dëgjohej asgjë tjetër përvëç zhurmës së tij monotone. Në anën tjetër shiheshin qartë ushtarët gjermanë që bënin

---

1) Filo Ramadani nga Armeni, dëshmor i Luftës ANÇL

kontroll nëpër shtëpitë e fshatarëve. Duke u munduar të orientoheshim, mundëm të njohim sipër nesh e përreth vendin ku para 20 e ca ditëve ishte përvuuar brigada jonë, pra ndodheshim në fund të Bramyshnjës. Po peripecitë e misjonit tonë do të vazhdonin.

Në mbrëmje grupi, tanimë pa Filon vendosi të vazhdojë ecjen më të poshtë, paralel me rrjedhjen e lumbit Shushicë, gjersa hasëm në një haur të vjetër, ku banonte një plakë që nuk kishte pasur mundësi të lëvizte pas të tjerëve në mal nga frika e operacionit; ajo tha se në dimër lumi nuk mund të kalohej veçse në Urën e Bratë, po dhe atje ka gjermanë... Pastaj na tregoi disa kallinj misri të thatë që ishin fshehur sipër, pas një trari të tavanit. Morëm nga një për shok dhe aty për aty i hëngrem misrat të gjallë megjithatë na u dukën tamam sikur të kishin qënë të zier. Ishte kjo një gosti shumë e mirë, po edhe sa na dëftoi ajo për kalimin matanë lumbit na vlejtën myftë.

Për të kaluar lumin pra, i vetmi shteg mbetej ai i Urës së Bratë, megjithëse ura ruhej nga trupat armike të operacionit; përndryshe do mbeteshim në mëshirën e gjermanëve. U muar vendimi njëzëri që të kalonim urën me çdo kusht e në kohën më të shkurtër.

Afër mesit të natës grupi i ishte afruar urës deri rreth 40 metra. Kishte roje nga të dy anët e saj; ato herë - herë lëviznin në drejtim të njëra - tjetrës, takoheshin në mes të urës dhe pas disa sekondash, se cila kthehej përsëri në vendin e mëparshëm. Hap pas hapi arritëm fshehtazi deri fare pranë urës ku u përpoqëm të siguroheshim nëse rojet që bënin lëvizjet e takimit ishin të vetme apo linin edhe të tjera prapa. Këtë nuk e zbuluam dot por megjithatë vendimi që ishte marrë nuk do të ndryshohej, nuk kishte rrugëdalje tjetër.

Çastet për veprim erdhën. Sapo u takuan të dy rojet te mesi i urës, plasën dy granata dore njera pas tjetrës të hedhura nga kjo anë, edhe një breshëri automatiku pas tyre. Më i pari nga të tre shokët që shkeli urën u bëri thirrje të tjerëve dhe shpejtuam duke kapërcyer mbi trupat e nazistëve që përpëliteshin ende duke dhënë shpirt. I tërë operacioni për kalimin e urës na u duk se nuk vazhdoi më shumë se dy deri në tre minuta.

Kur kishim kaluar matanë u bindëm se kishin qenë vetëm dy roje gjermane, ata që u goditën qysh në fillim. Kalimin e urës nuk e patëm aq të vështirë sa e kishim menduar, shpirtërisht qem përgatitur për më të keqen. Alarmi që u shkaktua në gjithë zonën e vendosjes së trupave armike, në Brataj e përreth, nuk e pengoi dot grupin. Kur u vunë në veprim prozhektorët e armikut për të ndriçuar rajonin e urës dhe repartet e ndihmës së shëpejtë mbërritën te vendi i ngjarjes, grupi ynë ishte larguar matanë dhe po ecte në ngjitje të plajës nën Ramicë.

\*\*\*

### ***“Gryk’ e Kuçit, gryk’ e keqe...”***

Më 7 mars u nisëm nga Ramica në drejtim të kundërt me rrjedhën e lumit Shushicë. Këtë lëvizje, që kishte të bënte me kalimin tonë në një zonë tjetër, e pritëm me qejf, ç’ka se këtë herë po largoheshim ca më shumë nga vendbanimi i familjeve tona, kalonim në zona që vareshin prej qarkut të Gjirokastrës. Këngët partizane gjatë ecjes pothuajse nuk pushuan deri sa arritëm më të hyrë të Grykës së Kuçit.

Gjatë qëndrimit për ngrënien e drekës, komisari bëri një bisedë të shkurtër rreth disa detyrave që dilnin me kalimin tonë në një zonë si ajo e Kurveleshit të Sipërm. Foli për kujdesin në sjelljet me popullin, për vigjilencën që duhej treguar dhe për ruajtjen e emërit partizan në tërsë; në fund ai e mbylli fjalën e tij me ngjarjet historike që na kujtonte vendi ku ndodheshim, sidomos kryengritja e njohur kundër Tanzimatit, e udhëhequr nga Gjoleka...

Me të mbaruar komisari së foluri, në atë shesh të vogël ndanë rrugës, buiqitën këngët. Hasan Muharremi<sup>1</sup> që e kishim të dalluar në valle labçë e filloj i pari atë.

---

1)Hasan Muharremi, luftëtar shumë gazmor, ish nënkomandant kompanie.

*"Gryk' e Kuçit, gryk e keqe,  
tremij' e duqint dyfeqe  
i mban Gjoleka me vete..."*

Sakaq ia priti grupi tjetër që gjithashtu ishte zënë në valle me këngën tjetër e cila bënte fjalë edhe ajo për luftën kundër pushtuesve të rinj. Të dy këngët bënë të ushtonte e tërë gryka, ato ngjanin si një fill i pashkëputur që lidhte të djeshmen tonë me të sotmen. Ja dhe tjetra:

*"Kurvelesh lile xbeneti  
si kala në mes të detit  
seç' i nxore punë shtetit;  
fuqisë madhe, dovletit..."*

Fjalët e thëna në këngë dhe valle e shtuan më shumë entuziazmin e gjallérinë që ishte krijuar në mes tonë. Erdhi koha të rreshtoheshin përsëri për të vazduar rrugën; në këto çaste komisari nisi prapë të thotë diçka. Ideja e përgjithshme e fjalëve të tij ishte kjo: Fama e luftëtarëve të stërgjyshërvë tanë për të siguruar jetesën e lirë e krenare në prehrin e këtyre maleve ka vazduar të ndihet e fuqishme nga brezi në brez. Asnjë okupator nuk ka mundur të qëndrojë këtu, sepse i ka prerë shpata e të parëve tanë ashtu siç po i grin tani plumbi i partizanëve, gjersat'i shporrim përfundimisht..

### ***Historia e mustaqeve të qethura***

Atë mbrëmje bënte ftohtë këshilli i fashatit të Qeparoit na shpërndau nëpër baza, ku qeparotasit na priten me shumë përzemërsi. Tani e kishim harruar zakonin e vjetër të shpërndarjes nëpër shtëpira, siç bëhej kur ishin ende në çeta. Kështu që rasti i paraqitur rishtazi për të ngrënë e për të fjetur nëpër shtëpira, na u duk si një luks. Megjithatë ky farë "luksi" nuk e pati të gjatë.

Afër mesit të natës lajmërohemë papritur të dalim me shpejtësi dhe të zemë vendet e luftimit... Një batalion ballistësh që

ndodhej në Borsh ishte bërë gati për të na sulmuar në befasi bashkë me gjermanët. Duke dalë nga shtëpitë njeri nga partizanët i mallkoi ballistët që na e prishën atë çikë rehat. Një tjetër u ankua se nuk ishte ngopur me gjumë dhe po fërkonte sytë. Fasliu<sup>1</sup> që kish qëlluar edhe ai në një bazë me mua, si për të bërë shaka kur po hidhte pushkën krahëve, foli me të: "Hajde tashti të llafolesh me ballistët se dhe ti je mërzitur..."

U vendosëm me shpejtësi në prita jashtë fshatit. Një grup partizanësh që kishin qenë në drejtim të Borshit me detyrë për të saktësuar të dhënat mbi armikun që sigruar se gjermano-ballistët nuk ndodheshin më aty. Ata e kishim nuhatur situatën e pavolitshme për ta në një ndeshje kundër nesh, e cila tanimë e kishte humbur avantazhin e befasisë; kishin ndryshuar drejtimin e lëvizjes së tyre për në Piqeras, pra ia kishin mbathur në drejtim të kundërt me partizanët.

Aty për aty nisen përsëri mallkimet e partizanëve në drejtim të ballistëve. Secili e shprehte inatin me mënyrën e tij:

-Na ikën qentë

-T'i ndjekim këmba këmbës

-Më gjan se këtë herë u shpëtuan mustaqet pa ua qethur...

Ajo puna e mustaqeve qe diskтуar e po diskutohej akoma ato ditë ndërmjet nesh. Kishte lidhje me një numër të madh ballistësh që ishin çarmatosur aty së afërmi nga një njësiti yni partizan në luginën ndërmjet fshatrave që formonin trekëndshin Shkozë, Sevester e Dushkarak të qarkut të Vlorës. Ballistët e kapur nuk qenë të njojur për krimë të rënda. Kjo mbështet që qenë shumë të rinj në radhët e organizatës së Ballit e s'kishin arritur dot të bënин krimë të tillë paçka që vetë pohuan se ishin në prag të krimeve kur deklaruan se aty prisnin bashkimin me një forcë gjermane që vinte nga Tepelena për veprime të përbashkëta në të pastajmen, megjithatë për gjykim iu lanë vetë popullit. Dhe populli i atyre fshatrave në këtë rast tregoi një shembull të rrallë pjekurie. Dënimet që u dhanë ishin përgjithësisht të lehta me

---

1) *Fasli Rushiti, një partizan pa shumë pretendime*

përjashtim dy-tre vetëve si KL, ZS e ndonjë tjetër. që hiqeshin si pari e mbanin përgjegjësi edhe pér të tjerét duke i nxitur në rrugë të gabuar. Pér ata u propozua qethja e mustaqeve me gëershëret që qetheshin dhëntë. Këtë mendim e kishte shprehur një bari që ruante bravaret e fshatit dlie qe miratuar prej të gjithëve si më i përshtatëshmi pér psikologjinë dhe moralin e të kapurve. Këta gjersa kishin pranuar të bëheshin vegla të Ballit e të patronëve të tij nazistë, nuk e njihnin moralin e shqiptarit patriot ndaj iu dha rasti të mendoheshin mirë në të pastajmen.

Na kishte rënë rasti të kapnim gjithfarë armiqsh gjer atëhere, ndërmjet tyre edhe njerëz të gabuar që u shkonin pas armiqve, kishim dhënë edhe masa nga më të ndryshmet, por pér një ndëshkim kaq origjinal, siç u veprua nga populli këtë herë, nuk na kishte shkuar kurrë ndërmënd.

### ***Marrja e Kalasë***

Sapo patëm mbërritur në Fterrë, ty morëm njoftimin se në Kalanë e Borshit na paskëshin mbërritur forca të reja gjermane nga ana e Sarandës, të përbëra prej mbi 100 trupash . Qe afër dreke prandaj duhej vepruar me kujdes në fshehtësi. Kur arritëm në afërsi të murave të kalasë, armiku e diktoi të keqen dhe nisi të shtjerë. Përparimi i mëtejshëm drejt pozicionave armike u çà nga ana partizane me shpërthimin e granatave të dorës, brenda llogoreve të tij.

Nga qëndresa që bënte armiku dukej se nuk kishte ndërmend t'i lëshonte muret e kalasë. Kishte treguar një farë pakujdesie që nuk i diktoi dot me kohë tanët, por nëpërmjet zjarrit të ashpër që nxirrin grykat e 'armëve gjermane, ngjante sikur çdo gjë që mund t'u kish " shpëtuar" deri atëhere tani do të ndreqej.

- Përpara mbi pozicionet armike! - u digjua thirrja e komendantit të batalionit në krahun tjetër. Ai ishte afruar me kompaninë e tretë nga ana veriore e kalasë. Tani në radhët e armikut nisi të ndihej një farë pasigurie. "Urra-të" e përnjehershme të të dy kompanive që u hodhën njëherazi përpara, nuk i dhanë atij mundësi që të ngrinte kokën nga llogoret e të merrte shenjë.

Pozicionet e vijës së parë armike nga ana perëndimore ranë të parat. Çania<sup>1</sup> me skuadrën e tij po përleshej me ata që përpinqeshin të mbanin të hapur rrugën e tërheqjes në drejtimin jugor të kalasë. Nuk kaluan shumë minuta dhe shpërtheu brenda mbrojtjes armike edhe ana e majtë e sulmit partizan. Mustafa Mexhiti që zakonisht përdorte mitralozin e rëndë, këtë herë, me këmbënguljen e tij, po merrte pjesë në luftimet e vijës së parë duke thërritur si e kishte zakon: "Oho-ho, u bini derrave!" dhe rrëmbeu nga toka automatikun e një gjermani që kish mbetur i vrarë, e hodhi pushkën e tij në krahë, e nga pozicioni në këmbë nisi të "provojë" armën armike kundër të zot me gjithë kapacitetin që kishte ajo.

Nazistët po bënин çmos që çdo pëllëmbë të kalasë ta mbronin deri në fund, duke u kapur me thonj e me dhëmbë pas çdo guri të saj që jepte mundësi për qëndressë. Kacafytja u shkallëzua më tej gjersa ata filluan të lëshojnë terren, dora dorës, me një tërheqje shumë të kursyer deri sa më në fund u vunë në ikje të plotë.

Sulmi partizan vazhdoi me ndjekjen e armikut gjatë pllajës jugore të kalasë, në drejtim të përroit për tek ura e xhadesë kryesore. Në këto çaste u shqua në mënyrë të veçantë Hysen Çinua. Ai kapërceu nga një shkëmb në tjetrin, pa shikuar se prapa tij po mbeteshin ende armiq, po vepronte gati një lloj siç kishte bërë edhe në raste të tjera. Boshllëku që ishte krijuar brenda formacionit tonë u mbyll kur dy nga skuadrat tona u hodhën nëpër tymin e bombave të dorës që shpërthenin apo takonin në shkëmbenj dhe, pas pak minutash, zbritën te ura ku ndodhej grupi sulmues më i përparuar. Kalaja u vu plotësisht nën kontrollin tonë. Armiku morri arratinë në drejtim të Porto-Palermos.

### ***Me Memo Meton<sup>2</sup>***

1 prilli ishte ditë me diell partizanët e shfrytëzuan këtë për t'u larë e pastruar me të gjitha teshat. Në mesditë, para dreke u

1) Cane Serjani, ish skuadërkomandant

2) Memo Meto, poet e luftëtar partizan, dëshmor, hero i popullit.

grumbulluan në anë të fshatit Çorraj ku do zhvuillohej konferanca politike (kështu i quanim ne atëhere edhe bisedat e informacionet e ndryshme që bëheshin me partizanët). Komandati paraqiti në fillim të mbledhjes një shok që kishte ardhur aty për t'u takuar me partizanët. Emri i Memo Metos ishte i njohur për partizanët sidomos nëpërmjet vjershave që ai i kish kushtuar luftës sonë, por jo të gjithë kishim pasur mundësi ta njihnim nga afër, prandaj takimi u prit me interes. Ai pasi na përshëndeti përzemërisht e me grushtin lart, na pyeti edhe se si e ndjenim veten në këto anë:

-S'kemi ankesa - thanë disa nga shokët.

-Po të kini mundësi ,na thoni diçka për situatën andej nga fronti i lindjes - propozoi Xhevua<sup>1</sup>.

-Tjetër dëshirë a ka njeri?- pyeti ai, po pasi pasoi heshtja e mori fjalën vetë, ku midis të tjerash tha:

-Situata kudo është në favorin tonë, ajo si brenda edhe jashtë tregon se fundi i okupatorëve e tradhëtarëve nuk është i largët...Këtu te ne ata janë tërbuar nga disfatat e shumta dhe kanë kaluar në një terror masiv karshi banorëve të pafajshëm me qëllim që të mbjellin frikë. Dëgjoni ç'thotë renegati Xhelal Mtrovica!- dhe sakaq nxori nga xhepi një fletushkë, ku midis të tjerash thuhej: "**Gjaku do gjak...për të vendosur tërësisht qetësinë, duhet përdorur thellësisht terrorin... në këto çaste vendimtare nuk shikohen kurër mjetet, shikohen vetëm qëllimet...**"<sup>2</sup>

Dhe xhelatët e bënë të tyren, - vazhdoi ai - po atë ditë që shkruan në gazetë, më 4 shkurt, masakruan disa dhjetëra fëmijë e gra nëpër rrugët e Tiranës... Jemi të sigurtë se armiqëtë tanë, hakmarrjes popullore s'kanë për t'i shpëtuar... Përsa i përket frontit kryesor të luftës në lindje që u interesuat ju, Ushtria Kuqe e Bashkimit Sovjetik po u jep hitlerianëve grushte vdekjeje. Vetëm gjatë tre muajve të fundit ajo ka shpartalluar mbi 30 divizione gjermane nga më të zgjedhurit...

Ne i dëgjonim më shumë vëmendje sqarimet e Memos, po edhe atij vetë ju bë shumë qejfi kur vu re, siç tha vetë, për gjendjen

1) Xhevo Shehu,partizane, bashkëshorte e heroit të popullit abaz Shehu

2) "Bashkimi i kombit" Nr.28 dt. 4.II. 1944, gazetë pronaziste

shpirtërore të partizanëve që ishte shumë e lartë si dhe për interesin që tregohej prej tyre rrëth problemeve të kohës. Pastaj iu grumbulluam pérreth tij, aty mori shkas nga shoqet partizane që ishin prezent dhe ia nisi këngës

*"Dua arm' e munizione se do shkoj,  
e urrej dbe un' fashizmin do luftoj.  
jam një vajzë shqipëtare, vajzë mali..."*

Numri i partizanëve që mbante iso labçë u rrit dalëngadalë me ata që afroheshin gjithnjë. Kënga na shkonte shumë në çdo kohë po këtë herë më mirë akoma, edhe pse ishim ca të lodhur. Në këtë kohë kryetari i Këshillit NCL të fshatit e tërroqi Memon veçmas. Ndërkohë edhe ne e ndaluam këngën pér ta pritur atë. Memua e kuptoi dëshirën tonë dhe pasi hyri përsëri në mes nesh,

me dashamirësi e keqardhje tha:  
"Kisha shumë qejf shokë e shoqe partizanë që të rrija edhe ca me ju, po më duhet të shkoj se nuk më pret puna, besoj se nuk do tju mbetet qejfi që të iki..."

-Ju presim përsëri!...

-Pa tjetër - tha ai- Vdekje fashizmi!

-Liri popullit- qe përgjigja e njëzëshme. Ndërkohë Bajram Shuaipi<sup>1)</sup> që nuk ia përtonte pér të kënduar, në përcjellje të Memos, ia mori këngës përsëri sipas atyre vargjeve që gjithashtu ishin shkruar po nga Memua: "Kurvelesh zëmra ime/ të dërgon Duçja lëvdime..." e cila në atë kohë ishte bërë shumë popullore. Kështu u ndamë me heroin kuçjot. Të nesërmen morëm lajmin e hidhur se Memua ishte qëlluar që nga prapa krahëve në një pritë të ngritur prej armiqve. Dëshpërimi që u ndie nga ne ishte i madh. Sapo ishim



Heroi i Popullit Memo Meto

heroin kuçjot. Të nesërmen morëm lajmin e hidhur se Memua ishte qëlluar që nga prapa krahëve në një pritë të ngritur prej armiqve. Dëshpërimi që u ndie nga ne ishte i madh. Sapo ishim

1) Bajram Shuaipi, njieri nga partizanët me entuziatë në batalion

ndarë, na kish premtuar se do shiheshim përsëri dhe i kishim akoma të freskëta kujtimet e takimit me të. Aty ku mësuam lajmin e rënies u ngrem në këmbë e bëmë edhe betimin me zotimin: "Hakun s'do t'ia lëmë pa marrë!"

### ***Asgjësimi i kriminelit***

- "Me t'u errur nisni lëvizjen e repartit që të mbërrini sa më parë!..." Korrieri që solli këtë udhër me shkrim në fshatin Kullës më 11 prill e dinte edhe vendin me saktësi ku do të shkonim. Ai do të na udhëhiqte vetë deri atje.

Kur dolëm në rrugën Kuç- Fterrë, në vendin e quajtur Qafa e Dërrasës, aty na priste Dervish Hekali<sup>1</sup> sipas porosisë që na kish dërguar. Në takimin e që sapobëmë me të, na foli për situatën e krijuar aty:

-Një kollonë armike sot ka hyrë në Kuç nga ana e Fterrës- tha ai- duke kaluar pikërisht nëpër këtë rrugë ku ndodhemi ne tan; forcat e tjera tonat kanë dalë sipër në Malin e Shkagëzës, për atje do të niset menjëherë edhe reparti juaj. Këtu do rrinë vetëm 10 vetë për zbatimin e një detyre të veçantë, dhe pasi u sigurua përgadishmërinë tonë vazhdoi të shpjegojë:

-Priten të vijnë forca të tjera armike nga ajo anë- tha ai, duke treguar me dorë nga drejtimi i Fterrës dhe i Borshit - për t'u bashkuar me këta që kanë hyrë në trojet e Kuçit. Nuk duhet t'i lejojmë ata që të shkojnë si në dasmë. ...Si ju duket juve kjo?

-Jemi gatil- qe përgjigja e shokëve përsëri.

-Atëhere hajde të zëmë vendet e luftimit me qenë se armiku pritet të vijë nga njëri çast në tjeterin- tha pastaj me kënaqësi Dervishi. Më tepër se një skuadër partizanësh do të ishte shumë për këtë copë vend... Përveç mitralozit e pushkëve, po na u paraqit nevoja, do t'i përdorim edhe granatat e dorës... kam bindjen se armikut do ti' japim një mësim të mirë këtu...- ishin këto disa

---

1) Devish Hekali zv.komandant i brigadës dëshmor, hero i popullit

arsyetime që shprehu zv. komandanti i brigadës rrëth pritës. Pas këtyre spjegimeve erdhi e u vendos në krahun e djathtë të anës së poshtme të rrugës, pikërisht nga pritej të vinte armiku fare pranë meje, gjë që mua m'u duk si privilegi.

Mbrëmja e vonë i gjeti partizanët e pritës të sistemuar dhe të maskuar me shumë kujdes. Vendi ishte i mbuluar me drurë që sapo kishin çelur gjethet. Por pylli edhe na fshihte edhe na pengonte sepse edhe armiku mund ta përdorte atë si një mbroje për t'u fshehur.

Ishin plot me emocione për ndeshjen që pritej të bënëm me armikun. Në të njëjtën kohë kishim besim se do fitonim. Nuk po duronim dot në pritje. Nuk po duket gjë... Mos vallë kanë ndryshuar drejtimin e kalimit?... Mos nuk vijnë fare?... Befas u dëgjuan zhurmë ecjesh nga rruga që vinte prej Fterre. Të gjithë mbajtëm frymën. Pas pak e ndjejmë që ishin hapa njerëzish. Ecnin me një farë kujdesi për të mos u ndjerë. Nata ishte e zënë, pa hënë dhe e vrenjtur. Me sy nuk mund të shihej asgjë. Zhurma sa vinte afrohej më shumë drejt nesh. Kur kërcitjet e këpucëve kishin ardhur fare afër, buçiti zëri i Dervishit: "Ndal!"

-Kamerad, Kamerad! (shokë; shokë)- u përgjegj një zë nga ata që po vinin, i cili me sa u kuptua, pandehu se kish të bënte me rojet e trupave gjermane që qenë në Kuç. Po pa mbaruar fjalët, "Kamerad" ushtoi pylli dhe gjithë faqja e malit nga zbrazja e menjëherëshme e armëve tonë. Pylli nga flakët e pushkëve dhe nga plasjet e granatave dukej e zhdukej papushim në errësirë si nga shkrepëtimat e vetëtimës.

U dëgjua një e bërtitur nga ana tjetër pasaj një e zbrazur automatiku në drejtimin tonë dhe disa të shtëna pushke. Më pas zhurma mbytëse e shkarpave që kërcisinin nën këmbët e atyre që vraponin poshtë pyllit. Armiqtë ishin vënë në ikje të çrrëgullt nëpër pyllin e dendur. Lugina ushtonte sikur të ishin lëshuar në të ndonjë tufë kafshës të egra.

-Na shpëtuan qentë!- tha Dervishi, kontrolloni vendin përreth!

-Seç po lëviz këtu nën rrugë!- raportoi njeri nga partizanët.

-Amani mosmë vrissi se nuk kam faj- u dëgjua një zë pak metra përpara nesh që u dallua si diçka rrafsh me tokën e që dalëngadalë

po rrитеј si ndonjë hije pérpara syve tanë, me duart e ngritura pérpjetë.

Njeriu që u kap këtu, në fillim nuk donte të fliste pér asgjë. Pastaj nisi të shfajësohej duke thënë se ishte marrë nga Idriz Jazua<sup>1</sup> jashtë vullnetit të tij, pér t'i treguar rrugën batalionit ballist që ishte nisur në ndihmë të gjermanëve. Ai pohoi se vetë Idrizi kishte qenë me pararojën e batalionit prej rreth 10-15 vetësh gjatë marshimit dhe pikërisht ai ishte përgjegjur: "Kamerad..." Pér pjesën tjetër të batalionit ballist që na interesonte më tepër, ai nuk dinte se ç'u bë me të.

Duke kontrolluar vendin pérreth, në mes të rrugës u gjet edhe një trup i shtrirë pér tokë; aty pranë i qe varur automatiku gjerman qafën ia mbështillte rrypi i një palë dylbive që i kishin rënë gjithash tu paksa anash; më tej disa pushkë të hedhura nëpër pyll, një çantë shpine e rrangulla të tjera pa rëndësi.

"Udhërrëfyesi" pas disa minutash e ndjeu veten më të mësuar me gjendjen ku ndodhej e po fliste më qartë. Ai tha se trupi që u gjend aty ishte i vrasësit të Memo Metos. Pér këtë shërbim që ai i kishte bërë armikut, komanda gjermane i kishte falur ato dylbitë që ai nuk mundi t'i tundë në qafë pér shumë kohë; atë automatikun, që nuk mundi ta zbrazë dhe 100 napolona monedhë shqiptare që iu gjetën po ashtu me vete. Shtypi ynë i luftës pér këtë ngjarje do të shkruante se "një njësit partizan" ...që po vinte nga Kudhësi në drejtim të forcave të tjera të batalionit, hasi në bashibuzukët e Idriz Jazos<sup>2</sup>). ku mbeti i vrarë krimineli Arap Lilua, vrasësi i shokut Memo Meto")<sup>2</sup>

-Mblidheni skuadrën të nisemi!- urdhëroi Dervishi - dhe kijeni kujdes "udhërrëfyesin"!

-Pse nuk dashkemi ta dënojmë atë?- pyeti dikush ..

-Ka kohë pér të gjitha, po le ta shohim njëherë punën e tij, tha Dervishi, se mund të jetë edhe i pafajshëm.

Pas aksionit partizanët shprehën kënaqësinë që iu dha rasti pikërisht atyre të shpinin në vend betimin e tërë shokëve të tjerë

1)Idriz Jazo, eksponent i Balit dhe pronazist

2) Buletini i "Zërit të Popullit" dt.20 maj 1944, Nr.743

për të asgjësuar vrasësin e Memos. Natën vonë arritëm pjesën tjetër të batalionit në lartësitë e Malit të Shkagëzës, mbi Kuç.

### ***Demoralizimi i armikut***

Edhe në mëngjesin e 12 prillit, si zakonisht kur ktheheteshin partizanët nga aksioni, u komentua përpjekja jonë me ballistët. Aty u muar vesh, sipas pohimeve të dëshmitarëve okularë, se pjesa kryesore e batalionit të Idriz Jazos, apo kishte dëgjuar të shtënët e para kundër pararojës së tij në mbrëmjen e 11 prillit, kishte marrë vrap në të kundërtën, andej nga kishte ardhur dhe e kishte mbajtur fryshtë në Borsh. Por ata me gjithë aelatët e tyre hitlerianë kishin shumë gjynahë për të larë, prandaj pushkët partizane u qëndronin te koka vazhdimisht.

Gjer afër drekës secili nga ne ishte duke u marrë me ndonjë shërbim personal, dikush qepte ndonjë kopsë, dikush pastronte pushkën, të tjerët këndonin e kështu me radhë... Ndërmjet këngëve që buçisin atë ditë qe edhe ajo që i ishte kushtuar Memo Metos nga ana e popullit:

*"Mu në Kuç e n' atë grykë,  
komandë nisur e veje,  
pa patur dyshim as frikë  
se përpara mos' e gjeje  
....."*

Në këtë kohë Dervishi kërkoi të mblidheteshin po ata shokë që kishin marrë pjesë në përpjekjen e natës së kaluar me ballistët e Idriz Jazos. U mblodhën pa vonesë përreth tij, aty ku rrinte Dervishi.

-Sapo u ktheva nga vendvrojtimi në Majë të Shkagëzës, nga ku shihen të gjitha lëvizjet e gjermanëve poshtë në fshat- tha ai. Eshtë vendosur që t'i sulmojmë ata. Aksionin do ta drejtoj unë; mendova që të merrnit pjesë përsëri edhe ju, ashtu siç ishim mbrëmë....

Një zgjedhje e tillë, siç ishte e natyrshme, u prit me shumë

kënaqësi nga të gjithë shokët. Mandej na informoi se përveç nesh do të merrte pjesë në aksion edhe një skuadër e kompanisë së parë e cila do të sulmonte nga ana tjetër e malit, në të djathtën tonë.

Pas këtyre pak fjalëve të Dervishit morëm armët dhe u nisëm për në drejtimin e caktuar. Duke ecur nëpër gurë e shkurre të dëndura, mundëm t'i afroheshim armikut deri në një afërsi të tillë që mund të hapej zjarr edhe me automatik mbi të. Koha ishte kthjelluar; ushtarët nazistë të lagur nga shiu i ditës së kaluar ishin shpërndarë për t'u ngrohur në diell pas ledheve të shtëpive të rrëzuara.

Ne që mbërritëm të parët në bazën e nisjes për sulm ishim të detyruar të prisnim me hamendje sa të arrinin edhe të tjerët në një afërsi të tillë karshi armikut për ta nisur sulmin njëherësh. Në këtë kohë afër nesh u qas edhe një burrë i moshës mbi mesatare, me një pamje të zeshkët i cili kishte edhe një shoqëruesh nga prapa. -Po të jetë nevoja për forca të tjera mund t'i thërras se i kemi afër- tha ai, duke iu drejtar Dervishit, sakaq u rreshtua së bashku me ne sikur të ishte edhe ai pjestar i njësitet tonë.

-Kaq janë të mjaftueshmë xha Jaho- iu përgjegj Dervishi.

-Përgjigja e Dervishit dhe emri që shqiptoi ai na dha të kuptonim se ky ishte Jaho Gjoliku.<sup>1</sup>. Emri i tij qe zënë ngoje shpesh, sepse ato ditë i ishin vrarë njeri pas tjerit dy djem në radhët partizane.

Rreth orës 14.000 u dha shenja për sulm, duke i zbrazur të gjitha armët që kishim në duar kundër atyre që po ngroheshin në diell. Ndërkohë edhe nga ana tjetër e sulmit u dëgjuva zëri i Rrapo Asimit<sup>2</sup>: "Para partizanë!", ai e kishte shumë qejf të thirrurën në sulm. Po edhe gjermanët nuk ndjenjën me duar lidhur. Ata menjëherë muarën masat e kundërpërgjigjes me përdorimin e mitralozëve të njojur "sharrës" që i kishin pasur të vendosur në pozicione gatishmërie.

Pas rreth gjysmë ore luftimesh të dy njësitet tona partizane mundën të hyjnë brenda kampit të afro 200 gjermanëve që

1) *Jaho Gjoliku, ish kuadër i Brigadës së VI-S; hero i popullit*

2) *Rrapo Asimi, komandant kompanie, dëshmor i Luftës ANÇL*

ndodheshin aty, duke bërë qitje të drejtpërdrejtë mbi ta. Shumica e predhave tona binin në shenjë. kjo vihej re nga trupat e atyre që rrëzoheshin për tokë si kërcunj të sharruar, njeri pas tjetrit.

Megjithatë armiqtë akoma mundoheshin të bënин një qëndresë të dëshpëruar . Atyre iu ishin fryrë trutë nga propaganda naziste që iua kishte mbushur mendjen se partizanët me të kapur të vrisin se ata nuk dinin të mbanin robër dhe gënjeshtra të tjera që i nevojiteshin asaj për t'u hequr ushtarëve çdo shpresë shpëtimi në rast se dorëzoheshin te partizanët.

Kjo përlleshje rreth dyorëshe përfundoi me shpartallimin e plotë të garnizonit armik të Kuçit. Një e treta e tij mbetën të vrarë ose u zunë robër; pjesa tjetër mori arratinë e tromaksur për nga Vlora. Fitorja do të kishte qenë edhe më e bujshme po ta kishim ndekur armikun këmba- këmbës poshtë Kuçit, drejt Luginës së Mesaplikut. E keqja qe se u dehëm nga suksesi i fazës së parë të aksionit që i tejkaloj parashikimet tona karshi një force superiore armike dhe u mjaftuam me kaq, pa e ndjekur atë gjer në asgjësimin e saj të plotë.



Heroi i Popullit Dervish Hekali

Në fund të betejës, kur po bënim bilancin e fitores, aty ku qëndronin në këmbë, Dervishi ra papritmas në tokë; ndërkohë u dëgjua së largu edhe ushtima e krismës së një pushke. Atëhere u bë e qartë që ishte goditur për vdekje nga ata që ishin arratisur pyjeve. Më përpara, gjatë përpjekjes, na kishte rënë edhe një shok tjetër, partizani Asllan Gjika.

Humbja e të dy shokëve na i errësoi gjëzimin e asaj fitoreje aq të madhe. Duke kaluar mbi trupat e nazistëve të vrarë zgjodhëm një vend të sheshtë, për të varrosur shokët. U bëmë atyre nderimet e fundit me 10 breshëri të shtënash pushke dhe me zotimin për ta shpënë gjer në fund amanetin që na lanë.

Dyluftimi i zhvilluar në Kuç nga ne që morëm pjesë aty, mbahet

mend si një nga betejat më të stuhishme e plot sukses të luftës sonë partizane. Aty triumfuan 20 partizanë kundër 180 okupatorëve nazistë, pra çdo njeri- kundër nëntëve.

Disfata që pësoi armiku në betejën e Kuçit shënoi epilogun e hidhur të operacionit nazizto- ballist me nofkën "Shpella e Ujqërve" i cili kish nisur që nga fundi i marsit e vazhdoi edhe dhjetëditheshin e parë të prillit 1944, në zona të veçata të qarkut të Vlorës. Këtë disfatë do ta konfirmonte edhe vetë komanda gjermane e operacionit në raportin që i dha shtabit të vet epror, duke pohuar se "... trupa jonë me një forcë prej 180 vetësh me 26 mitralozë duke mbetur, siç duket, pa një komandë armike u shpartallua"<sup>1</sup>



Robër gjermanë të kapur nga partizanët e Brigadës së V Sulmuese.

### ***Në gjirin e popullit***

Nga 15 deri në 18 prill po qëndronim në fshatin Golem, në pritje të furnizimeve nga aleatët anglezë. Kjo kohë u përdor edhe

-----  
1)AQSH

për të pushuar partizanët; Numani<sup>1</sup> me një palë gérshërë mundi të qethë pothuaj të gjithë partizanët që kishin nevojë. Tahir Dalani<sup>2</sup> me gjithë Refatin po e kryenin mirë furnizimin, në këtë punë ndihmoi edhe vetë fshati sado që ishte i dëmtuar nga operacionet e njëpasnjëshme armike. Ata i sillnin vetë ushqimet për partizanët, pa ua kërkuar. Si kudo edhe në Golem e ndjemë veten tamam në gjirin e popullit, të siguruar e të mbështetur nga çdo pikëpamje.

Që ditën e parë të qëndrimit tonë aty ndërmjet të tjerëve erdhë edhe një plakë e thyer me një boçe në dorë, e hapi atë, nxori andej një kulaç të madh gruri dhe ia zgjati Tahirit që grumbullonte ushqimet duke i thënë:

-Merre, u bëftë mirë djemve të nënës! më ishte ndodhur pak miell gruri për ndonjë mik, po miq më të dashur e më të nderuar se partizanët nuk kemi...

Tahiri e pyeti se si quhej. Ai si i intendent zakonisht i mbante



Nënët labe përgatitin veshmbathje për bijtë e tyre që, të inkuadruar në radhë e e  
Brigadës së V S, i nisën maleve në luftë për liri.

shënim emrat e atyre që ishin më të gatëshëm për t'i ndihmuar partizanët.

-Shero Banushi më quajnë - tha ajo- dhe unë me luftën i kam

1) Numan Jashari, partizan me profesion berber.

2) Tahir Dalani, intendent batalioni dëshmor i Luftës ANCL

gjithë të mitë, prandaj çdo hall që të kini hajdeni se jini djemtë tanë, ja ku është shtëpia ime- dhe tregoi me dorë aty ku niste pjerrësia e malit, në krye të fshatit.

Intendeti e përgëzoi nënë Sheron për punën e saj të mirë, ajo po ashtu para se të largohej e puthi Tahirin si dhe ne, dy shokët e tjerë që u ndodhëm atje.

Fëmijët e fshatit gjithë ato ditë nuk largoheshin nga sheshi i Lerës në mes të fshatit, aty ishte dhe qendra e batalionit. Ata u qepën pas partizanëve duke bërë pyetje për gjithçka. Ishin kuriozë të dinin se sa fashistë kishim vrarë, sa fishekë mban gjerdani, sa larg shtie pushka, sa peshon një granatë,... sa...

Në njerën nga ato ditë një grup vajzash prej 7 vetash na sollën 20 copë yje të kuq që i kishin qëndisur vetë pér t'ua dhënë partizanëve. Një grup i grave të fshatit i dorëzoit intendencës 17 palë çorape leshi pér ata që kishin më nevojë etj.

### ***Raste bashkëveprimi me aleatët***

“... Ujleri e Rosi kishin ngritur bazën e zbarkimit në Golem me ndihmën e partizanëve...<sup>1)</sup> Në zbatim të këtij plani duke u gdhirë 17 prilli zhurma e një aeroplani na dha shpresë se furnizimi i pritur nga aleatët erdhi por u zhgënjenjëm sepse aeroplani bëri 2-3 rrrotullime mbi vendin që duhej të hidhët ngarkesën me pajisje dhe u largua pa hedhur asgjë.

Këtë sjellje të aeroplanit oficeri englez që ndodhej aty e shpiegoi si mungesë orientimi të pilotit. Natën tjetër afërsisht në të njëjtën kohë, u dëgjua përsëri zhurma e aeroplomit dhe ne përsëri dolëm ta prisnim me shënjat e zakonshme. Ndezëm zjarre në disa pika të caktuara përreth vendit ku do të bëhej hedhja e materialeve. Këtë herë u dukën parashutat që ranë me dengje të shpërndarë deri në dy km larg nga njeri - tjetri dhe përsëri aeroplani u largua. Kur u grumbulluan gjërat e hedhura, brenda dëngjeve u gjetën këpucë kryesish me numër shumë të madh

---

1) Reginald Hibert “Fitorja e hidhur” f. 187

që pothuajse nuk na shërbën shumë pastaj një pjesë e tyre qenë vetëm për njérën këmbë! Misionari aleat që ishte gjithnjë aty e shpjegoi këtë fakt me zotimet e mëdha që kishte marrë përsipër Anglia karshi shumë vendeve të tjera të aleancës antifashiste, prandaj: "Ngatërresa nëpër magazina - tha ai- ishte e pashmangshme."

Pavarësisht nga pengesat e ndryshme, ndihma e aleatëve gjatë luftës në përgjithësi dhe e atyre anglezë në veçanti pati një efekt të caktuar jo vetëm në kuptimin material po mbi të gjitha në anën morale, sepse Shqipëria kishte shumë nevojë për miq të tillë në atë kohë.

Duke dëgjuar shpjegimet e misionarit në Golem m'u kujtua rasti im i parë kur pata bashkëvepruar me një misionar tjetër anglez gjatë një aksioni. Kjo pat ndodhur në një mbrëmje të verës 1943 në afërsi të fshatit Ploçë. Oficeri anglez qe specialist xhenjoje dhe e ndihmoi njësitin tonë për minimin e Urës së Ploçës që lidhë rrugën automobilistike Vlorë- Tepelenë.

Bashkëpunimi në ditët e vështira të luftës na i pat shtuar shpresat se pas saj ky bashkëpunim do bëhej më i dendur dhe më frytdhënës për të gjitha palët, sidomos për Shqipërinë e vogël që kishte më tepër nevojë për ndihmën e më të mëdhenjve. Shpresa jonë karshi ndihmës së aleatëve të Koalicionit antifashist u forcua edhe më kur vinim re që edhe marrëdhëniet ndërmjet anglo- amerikanëve nga një anë e Bashkimit Sovjetik në anën tjetër qenë vendosur mbi baza të shëndosha; vet kryeministri britanik Çurçil i njojur për antikomunizmin e tij, në një mesazh që publikoi në atë kohë adresuar Stalinit me rastin e ditlindjes së këtij të fundit, ndërsa të tjera thoshte: "Jeta juaj është shumë e çmuar për fitoren e përbashkët si dhe për të ardhmen e paqes e të marrëdhënieve tona...".

Bashkë me këto shpresa, shkallë- shkallë, po çliroheshim edhe nga mbresat e hidhura historike për padrejtësitë e mëdha që i qenë bërë kombit tonë nga fuqitë e mëdha, sidomos që prej Kongresit të Berlinit të vitit 1878, nga konferanca e Londrës më

---

1) Nga letërkëmbimi Stalin-Çurçil, Vëllimit I, f.291, botim rus

1913 e në vazhdim. Por siç u vu re pozicionet e veçuara që morën më pas fuqitë e mëdha, secila për hesap të saj e njëherazi duke u përpjekur për t'i futur edhe vendet e tjera më të vogla në vorbullën e interesave të veta ekskluzive, shpuri në atë që do të quhej "luftë e ftohtë" apo "luftë klasash në përmasa ndër-kombëtare", me pasojet që dihen.

### ***Pushka dubej shtrënguar fort***

Lajmet që erdhën nga Vlora më 19 prill nuk ishin të mira. Ato na gjetën gjatë kalimit të lumit Drino për nga Rrëza e Lunxherisë. Njeri nga shokët e mi të orëve të para, Haredin Beqari kishte rënë në luftimet e rrepta që kishin bërë forcat partizane në Kodrat e Penkovës. Natën e fundit të marsit, ato kishin sulmuar pozicionet e fortifikuara armike. Komandanti ishte hedhur i pari mbi to për t'u hapur rrugën shokëve dhe atje ishte goditur për vdekje. Dëshpërimi për shokun e rënë si zakonisht kthehej në inat, kurse inati në forcë. Aty për aty lindte mendimi "vetëm pushka do na i marrë hakun". Lajmi tjetër që erdhë aty kishte lidhje me operacionin e njohur si "Shpella e ujqërve" i cili kishte vazhduar edhe në javën e parë të prillit në komunën e Trebllovës. Babanë ma kishin kapur e futur në burg, shtëpinë e kishin djegur përsëri, tërë pjesëtarët e tjerë të familjes i kishin internuar, ato pak plaçka e bagëti ua kishin grabitur. Për këtë inkursion barbar shtypi më pas do të shkruante: "Xhandarët e Xhafer Devës të udhëhequr nga Hakim Shaska, Tajar Shaska, Shahin Nuredini e një oficer i shtabit të Dedë Nikollës, bashkë me gjermanët, zhvilluan operacionin në krahinën e trebllovës, duke mbjellë tmerrin më të madh".!

Ne ishim të vetëdijshtëm se për luftën e drejtë që po bënim armiqtë do përpinqeshin për t'u hakmarrë me çdo mjet. Këtë e thoshin hapur edhe ata me anë të fletushkave të ndryshme. Ajo që kërkohej nga ne ishte vendosmëria për të ecur në rrugën e nisur, për të mposhtur çdo dëshpërim e pengesë që i kundërvihet

---

1)Gazeta "Zeri i Vlorës" Nr.22, dt. 16 prill 1945

aksioneve tona, deri në fitore. Pushkët që kishim në duar duheshin shtrënguar më fort...

### ***“...Sakrificë mbi vdekjen s’ka”***

Pas disa ditë marshimesh nëpër zona që i shkelnim për herë të parë, më 26 prill u grumbulluan të gjitha forcat e brigadës në sheshin e famshëm të Çajupit që shtrihej si ndonjë sini e stërmadhe në lartësinë e afro 1000 metrave. Malet përreth njiheshin si vendi i “shërimit të sëmundjeve”. “Porta” kryesore nga hymë këtu ishte Qafa e Çajupit.

Të shkelësh në Çajup është e pamundur që të mos kujtosh poetin tonë të dashur e patriot Andon Zako që e kish marrë mbishtesën “Çajup” pikërisht nga ky mal. Në raste të tillë kujtesa nuk mund të mos të të térhiqte “zvarrë” nëpër vargjet e tij të émbla që ia këndoi Mëmëdheut me aq krenari e zjarr patriotik.

Në kushtet e luftës një grumbullim i tillë ishte rast i rrallë prandaj ky takim u kthyte në një ditë shumë të gëzueshme për gjithë partizanët. Pas shumë kohësh po takoheshim e çmalleshim me njëri-tjetrin. Në bisedat e ndryshme shoqërore që u zhvilluan



Nga grumbullimi i brigadës në Çajup

aty u bë fjalë pér betejat e kaluara, pér heroizmin e të rënëve që nuk ndodheshin më në mesin tonë, pér përballimin e ofensivës armike të dimrit. Sollëm ndërmend sakrificat e popullit që kishte ndarë me ne edhe kafshatën e fundit të bukës, si qe përballuar uria, të ftohit, episode kufte, ngjarje të ndryshme, vuajtje... Pastaj këngë e valle, shaka...

Në mbledhjet e ndryshme që u zhvilluan me repartet e nënrepartet e brigadës, gjatë 48 orëve të qëndrimit në Çajup, u fol gjerësish mbi detyrat e pritshme luftarakë e sakrificat që kërkoheshin, ku morën pjesë aktive, krahas komandantëve e komisarëve, edhe luftëtarët e thjeshtë.

Ndërmjet shumë të tjerëve që bënë vërejtje e dhanë mendime foli edhe partizani Qemal Çize<sup>1</sup> i cili tha: "Deri sa kemi hedhur pushkën krahëve, i kemi llogaritur të gjitha, edhe vdekjen... E po, sakrificë më të madhe se vdekja nuk ka!"

Qemali tha atë që bluanim në kokë të gjithë, prandaj pa e mbaruar mirë fjalën, u dëgjuan zëra miratues nga pjesa tjeter e partizanëve: ashtu është... i ke rënë më të... të lumtë!...

Fjalët e këtij partizani patën efekt jo vetëm nga llogjika e tyre, po edhe nga shëmbulli vetjak i tij: ç'ka se ishte edhe sakat prej njerës këmbë e ecte me zor, ishte edhe shëndetlig, me një trup të imët, i rritur jetim. Po me gjithë të metat fizike që kishte mbante në shpinë, veç pajisjeve të tij personale, edhe kasetën me municion të mitralozit të lehtë që kishte skuadra, luftonte edhe si pushkatar, edhe si ndihmës mitralier, nuk kishte mbetur asnjëherë prapa shokëve. Kështu mangësitë fizike ai i kompensonte shumëfish me virtytet e tjera të larta, me vendosmërinë pér çështjen e madhe të Atdheut dhe shpirtin e sakrificës.

---

1) *Qemal Çize partizan, dëshmor i Luftës ANÇL*

## **V. DREJT ÇLIRIMIT TË PLOTË TË ATDHEUT**

*Sigurimii punimeve të Kongresit; në ndjekje të pushtuesve të huaj e bashkëpunëtorëve të tyre vendas; nga luftimet për çlirimin e Shqipërisë së Mesme; asgjësimi qëndresës gjermane dhe i bajraktarëve reaksionarë në veri.*

### ***Në mbrojtje të Kongresit***

Duhej të siguronim punimet e Kongresit të Parë Antifashist që do të zhvillohej në qytetin e Përmetit, me që armiku rrezikonte prej rajonit të tre Urave dhe nga ana e Biovizhdës. Kjo qe detyra më e re që morëm, sa po mbritëm në Zhepë, më 5 maj.

Banorët e Zhepës e të fshatrave përreth u gjëzuan që ne u vendosëm aty e mundoheshin të na ndihmonim me ç'të mundnim gjatë rrith 25 ditëve që na u desh të qëndronim atje, duke bashkëpunuar ngushtë me ne për gjithçka.

Në përpjekjet që patëm me gjermanët sidomos më 10 dhe 15 maj, armiku në të dy rastet u tërroq i mundur duke lënë me dhjetëra të vrarë në fushën e betejës dhe shumë robër në duart

tona<sup>1</sup>. kjo i afroi edhe më tepër banorët me partizanët; një pjesë e tyre, sidomos nga të rinjtë e të rejet muarën pjesë edhe në luftime, bashkë me ne. Kur e pruri rasti të largoheshin prej andej, disa erdhën me ne përgjithnjë, si pjestarë të brigadës.

Ditën që do të largoheshim nga Zhepa na foli, Reiz Malile si njeri prej ish delegatëve të Kongresit duke na shprehur mirënjojhen e komandantit të përgjithshëm dhe të gjithë delegatëve për rolin që kishim lojtur në mbrojtjen e punimeve të kongresit. Ky vlerësim ngjalli tek ne të gjithë një ndjenjë gëzimi të ligjshëm e krenari që kishim mundur të jepnim ndihmën tonë modeste në këtë vepër të shënuar që kurorëzoi sakrificat e gjeratëhershme të popullit tonë e hapte prespektiva të reja për të ardhmen.

### ***Armiku befasobet***

Të nisur nga Përmeti, në marshimin që vazhdonim drejt veriut, duke u gdhirë 3 qershor na zuri në Ogren. Atë mëgjez qenë të grumbulluar në mes të pyllit. Aty na u komunikua edhe urdhëri i komandantit të përgjithshëm, ku ndër të tjera thuhej: "Ne duhet të jemi në ofensivë... dhe kur armiku sulmon të dimë të shkatërojmë planet e tij, ta godasin atë nga të gjitha anët, t'i presim lidhjet dhe t'i hyjmë thellë në prapavijë..."<sup>2</sup>

Në ditët e para të qershorit hordhitë pushtuese të shoqëruara nga ato balliste kishin filluar operacionin e tyre të madh, i njojur si Operacioni i Qershorit. Në këtë rast një pjesë e forcave të tyre qenë nisur nga qyteti i Beratit për të shkelur zonat e lira të Tomorricës me piksynim që t'u kundërviheshin edhe forcave tona që operacionin në ato anë.

Forcat partizane të inkuadruara në radhët e Divizonit të parë që shpejtonin për çlirimin e zonave akoma të okupuara në Shqipërinë e Mesinë e në Veri të vendit, gjatë natës së 6 Qershorit u ballafaquan në Qafën e Gjarpërit me forcat e operacionit armik

1) Nga komunikata e 21 majit 1994, A.U. Fom. Brigadës V-S

2) Buletini i Shtabit të Përgjithshëm nëntor 1944, f.4

i cili u befasua nga një ballafaqim i tillë.

Beteja e Qafës së Gjarpërít u zhvillua kryesisht natën; kacafytjet ndërmjet palëve arritën gjer trup me trup dhe me humbje të konsiderueshme për të dyja palët. Armiku la aty mbi 150 të vrarë, po edhe nga ana jonë nuk u vranë pak; vetëm nga brigada jonë mbetën aty 13 luftëtarë përveç humbjeve të Brigadës së I-rë. Aty ra edhe komandanti partizan Xheladin Beqiri, hero i popullit.

Lidhur me kohën dhe furrinë e luftimeve në Qafën e Gjarpërít komandanti i regjimentit të parë alpin të nazistëve, sipas burimeve të ndryshme do t'u njoftonte eprorëve të tij më pas se "qe nga beteja në Harkov (BS) nuk kishte zhvilluar ndonjë luftim tjetër analog gjatë natës". Kështu që edhe këtë herë armiqjtë mbetën të befasuar nga guximi e shpirti luftarak i partizanëve tanë.

### ***Nga ndihma e një fëmije***

Gjatë veprimeve për çlirim e zonës së Gramshit në mbrëmjen e 17 qershorit mbërritën në një zonë fare të panjohur pikërisht në jugë të fshatit Tërviooll. Aty lajmërohemë prej një djali 12 apo 13 vjeçar se përparrë na qënkish ngrehur një pritë prej një grupi ballistësh. Ky sinjalizim na dha mundësi t'i merrnim krahët zonës ku qe ngrehur prita duke i rrëthuar ata që prisnin atje dhe duke i shtrënguar ballistët që të hidhnin armët.

Gjatë veprimeve tonë luftarake kur na qëllonte të kapnim grupe të tillë ballistësh të gabuar gjykimin e tyre e bënim në shesh të hapët, me pjesëmarjen e popullit. Në këtë mënyrë vepruan edhe kësaj here. Të nesëermen, aty në një vend të hapët u bë gjykimi i të kapurve. Morën pjesë në këtë gjykim përfaqësuesit e Këshillave NÇL, të fshatrave Tërviooll e Posnovisht si dhe përfaqësues nga shtabi i brigadës. Faktet që u paraqitën vërtetuan se robërit ishin të mobilizuar prej komandës gjermano-balliste të garnizonit të Gramshit. Ata qenë njerëz të paqartë politikisht që mund të mashtroheshin lehtë, nuk kishin arritur të bënin as krime. Shumë nga të gjykuarit u ngrenë aty përparrë popullit dhe qëndronin si të ngrirë, dridheshin nga frika, ndoshta dhe nga turpi se s'dinin ç'të thoshin. Pastaj e hapën gojën.

-Jam i gabuar,- tha ai që foli i pari- më kanë gënjer.  
Po më falët, dijeni se do të qëndroj përkrah gjithë bashkëfshatarëve të tjerë kundër armiqve.  
-Edhe unë si S.M. jam, i gënjer për 200 kg miell... ndonjë prapësi nuk kam bërë...- tha tjetri.  
Në këtë mënyrë folën edhe të tjerët. 7 prej tyre dhanë fjalën se do futeshin menjëherë në njësitin partizan të krahinës. Pastaj u lanë të lirë që të gjithë

\*\*\*

### ***Kalimi i Shkumbinit***

Pas spatrimit të zonës së Dumresë u përqëndruam në pyjet e Xheries, aty prisnim urdhërin për veprime të mëtejshme. Pikërisht aty na gjetën të nesërmen më 27 qershori dy korrierët e shtabit të brigadës me urdhrrin, ku thuhej: "Forcat e tjera të brigadës e kanë kaluar Shkumbinin. Korierët e dërguar tek batalioni juaj ngatërruan rrugën. Mundohuni të ndiqni brigadën. Në pamundësi veproni me inisiativën tuaj, Mund të kaloni në zonën e Pezës ose të ktheheni përsëri në jugë..."

Gjendja paraqitej e vështirë, sepse kalimi i Shkumbinit nuk qe i zorshëm vetëm si pengesë ujore, po ishte në mbikëqyrje të rreptë gjithë ajo zonë nga ana e armikut. Ai e dinte se divizioni i I-rë i Ushtrisë NÇL ishte në lëvizje, nga jugu për në veri të Shqipërisë.

Situata u diskutua me pjesëmarrjen e të gjithë partizanëve. Ashtu siç kishim vepruar gjithnjë në situata të ndërlikuara.

-Duhet doemos të bashkohemi me brigadën, se rrëziqet kalohen me forca të bashkuara... - tha Avdyl Bızhga<sup>1</sup>.

-Delen e veçuar e ha ujku....tha Lavdia.<sup>2</sup>

Në këtë mënyrë folën Selfo Dalani, Azemi, Rizai, Bilbili, Çania, Yzedini, Malua e të tjerë partizanë. Mendimi ishte i njëjtë dhe u nisëm, natën vonë mbërritëm në rajonin e quajtur Broskë, pak

1)Abdyl Bızhga, ish kuadër batalioni

2) Lavdie İslami, partizane

më në perëndim të fshatit Papër- Sollak. Aty gjerësia e vaut me gjithë pjesën e zallit anash ishte afro 50 metra. Thellësia e ujit rrëth një metër.

Të parët u hodhën, të zënë përdore, pesë partizanë nga ata që e kishin provuar vaun më parë; pastaj nisi të kalonte e gjithë kompania e kreut e ndarë në grupe. Secili mundohej ta mbante armën dhe pajisjet e tjera përmbi nivelin e ujit për t'i mbrojtur ato e për të zvogëluar disi edhe forcën shtytëse të tij. Rrjedha qe aq e vrullshme saqë aty ku preknin këmbët tonë formoheshin gropë në zallin e imtë të shtratit që gërryente uji.

Kalimi i lumbit vazhdonte me një tendosje të madhe fizike e nervore. Më tej duhej kaluar edhe rruga automobilistike Peqin-Elbasan, gjatë bregut tjetër të Shkumbinit. Ajo kontrollohej rreptë nga ana e armikut. Pas një ore përpjekjesh të lodhshme vetëm gjysma e batalionit kish kaluar në anën tjetër të lumbit. Në këtë kohë u dëgjua një zhurmë makinash. Pastaj të një kthese e xhades, nja 300 metra larg nesh, ca drita gjysmë të shuara po lëviznin ngadalë rrugës për në Elbasan. Dy kompani, e III-ta dhe e IV-ta nuk kishin hyrë ende në lumë dhe u detyruan të binin në bark aty, ku i zuri hera; ndërsa kompania e I-rë që e kaloi lumin e para tani ndodhej rrëth 200 metra matanë mbi xhade. Ne me kompaninë e dytë sapo kishim kaluar lumin dhe mbetëm në rrypin e ngushtë të zallit prej 15-20 metrash që shtrihet midis lumbit dhe xhades.

Në ato çaste menduam se përlleshja do të qe e pashmangshme ajo mund të niste nga sekonda në sekondë. Shpirtërisht u përgatitëm, për një përlleshje të tillë, po për habinë tonë autokolona nuk na diktoi, ajo vazhdoi të ecë me ngadalë; herë-herë, makinat bënin ndonjë qëndresë fare të shkurtër. Nga afërsia ku ndodheshim mund të përcaktohej lehtë se autokolona kishte deri në 10 apo 12 makina.

Pasi mbaroi kalimi i autokolonës, vazhdoi të hidhet në lumë pjesa tjetër e batalionit “në një thellësi që na i njomi krejt rrobat, po s’ka gjë se do na thahen gjatë udhëtimit në trup...” shkruante në ditarin e tij me këtë rast edhe partizani 16 vjeçar Dadan Dalani<sup>1</sup>.

<sup>1)Dadan Dalani, dëshmor i Luftës ANÇL, AU Fon- Brig. V.S, kutia 1, Dosja 131)</sup>

## *Ai që shpëtoi nga mbytja*

Më 28 qershor na doli si nga dheu ai që kërkonim, partizani Liko, Aliko Selfo e kish emrin ai, po e thërrisnim kështu se ishte njeri nga më të vegjlit në batalion. Na pat humbur me gjithë një mushkë gjatë kalimit të Shkumbinit. Pasi u shplodh ca, Likua nisi të tregojë se si qe shkëputur nga shokët:

"Para se të hyja në ujë e lidha mushkën përdore, me shpresë se unë dhe mushka do të ndihmonim njëri- tjetrin. Sa hyra në ujë e kaluan ca sekonda, e pashë veten si shumë larg prej shokëve të tjerë të ekonomatës që ishin edhe ata me kafshët përdore. Duke u "përleshur" me rrymën e lumiit që më arrinte deri te gryka nuk po kuptoja se ujët po më tërhiqte me vete... Në një çast m'u shkëputën fare këmbët nga toka dhe m'u fut ujë në gojë, bile m'u errësua edhe mendja po "Xhonia" (ashtu i thërriste ai mushkës), më tërhoqi me vete deri sa ndjeva që këmbët më zunë prapë në zall. Hapa sytë e po përpinqesha të kuptoja se ku ndodhesha. Atje ku lumi kthehej majtas unë e Xhonia u gjetëm papritur në pjesën e cakët të anës tjetër të tij.

Sa ra mëngjezi vendosa të eci me hamendje drejt veriut. Njeriu i parë që takova ishte një djalë i moshës sime nga fshati Papër. Ai kulloste bagëtitë... Më tregoi se aty kishte ardhur disa herë postkomandanti me xhandarë e i kishte porositur fshatarët që të mos i qasnin partizanët... Pastaj më pyeti në isha edhe unë nga ata partizanët që kishin kaluar natën nëpër fshatin e tyre...

Pa lu përgjigjur pyetjes që bëri i thashë, të shkonte në fshat e të mësonte se në ç'drejtim shkuant partizanët që kishin kaluar natën dhe ku mund të ndodheshin tani.

-Jam gati të bëj çdo detyrë që të më japësh shoku partizan! ai tani u bind që isha partizan- Mos ki merak Vdekje fashizmit- tha bariu i vogël duke shtrënguar grushtin dhe u nis për në fshat me sy të shkëlqyer nga gëzimi.

Kish kaluar rreth një orë, kur dëgjova një vërvshëllimë, shikova andej nga erdhi ajo dhe pashë se po vinte me të shpejtë bariu, po jo nga drejtimi që i prisja.Sa mbërriti më tha: -Në fshat bëhej fjalë se dy partizanë nga ata që kanë ardhur prej së largu, kërkonin

një shokun e tyre që u kish humbur me gjithë një mushkë. Njerin nga parizanët që kishin ardhur në fshat e quanin Axhem. Nuk e bëra fare veten se dija ndonjë gjë deri sa të të pyesja ty që më porosite të mos i tregoja askuajt. Erdha me vrap nga ana tjetër që të ruaja fshehtësinë...

-Bjere dorën, - i thashë, ai ma zgjati dhe unë ia shtrëngova.

-Na pushkën e zbraze njëherë, ja kështu, - ia bëra gati atë.

-Domethënë ata qënkan shokët e tu sa mirë! Rrofshin partizanët, rrofshin komunistët!- ishin fjalët e tij të fundit para se të tërhiqte këmbëzën dhe të dëgjohej krisma e parë e pushkës; ajo u përsërit edhe dy herë të tjera. Midis burrave që u nisën nga fshati e po vinin drejt nesh njoha Axhemin dhe Refikun<sup>1</sup> që kishin dalë e më kërkonin...."

### ***"Djali do të ktbehet nga lufta bashkë me lirinë"***

Rreth orës 24.00 të 4 korrikut uturima e makinave dhe autobilindave gjermane që po zbrisnin nga Mali i Krrabës për Tiranë, nisi të ndihet sa vinte e më qartë. Pas gjysmë ore, zhurma shurdhuese e tyre u bë e padurueshme. Ato tani kalonin 2-3 metra larg nesh që ishim vendosur nëpër kanalet e xhades ose prapa gurëve anës saj, ku bashkohet rruga automobilistike e minierës së Krrabës me atë kryesoren, Tiranë- Elbasan.

Shenja e hapjes së zjarrit akoma nuk po jepej, por papritur më rrëmbyen sytë flakët e një automatiku që u zbraz në krahun tim të djathtë. Aty pashë se Xhevua nga padurimi qe ngritur në këmbë dhe sa hap e mbyll sytë, zbrazi një karikator të tërë.

Ky nxitim u muar si shenjë për hapjen e zjarrit nga e gjithë prita. Automatiku i Abazit, që pas rënies së tij, përdorej nga e shoqja, ishte zbrazur ca para kohe. Kështu luftimi nisi pa hyrë e tërë autokolona brenda pritës prandaj pati mundësi t'u shmangej edhe dëmeve më të shumta që mund të pësonte.

Armiqtë nuk pandehën se ne e kishim zënë pritën fare pranë

---

1) Axhem Doraci dhe Refiku, të dy, ishin korrierë të shtabit të brigadës.

xhades dhe, pasi ndaluan makinat e ushtarët po zbrisnin me shpejtësi për t'u mbrojtur, madje disa herë, duke ecur kuturu u përplasën me partizanët trup me trup, kur po përiqeshin të zinin pozicione edhe ata po në kanalin e xhades.

Një gjerman atë kohë shkëputet nga pas rrotave të makinës, ku e kishte zënë hera dhe vjen e vendoset në kanalin e poshtëm të xhades, ndërmjet Nelo Gorrishit<sup>1</sup> dhe meje. Pandeha se ishte shoku ynë, po Nelua e kuptoi nga helmeta dhe i thirri: Kaput! duke i drejtar automatikun. Tjetri, pa mbaruar fjala "kaput", e zbrazi një herë pushkën, më pas s'u ndie më...

I them shokut tim ta hedhim jashtë kanalit të xhades kufomën e ushtarit të vrarë se na pengonte; ai bëri të afrohej e nuk po lëvizte dot. E kuptoi që ish plagosur. I qe thyer këmba në pjesën e sipërme të kofshës. Gjermanët po hidhnin vazhdimisht bomba dore 'me bisht të gjatë prej druri, në një largësi 15-20 metra për të mos dëmtuar shoqi- shoqin. Ato pëlcisnin poshtë pjerrësisë, në prapavijën tonë nga kishim edhe rrugën e mundëshme të tërheqjes së të plagosurit. Ia lidhëm plagën shokut provizorish dhe e mbajtëm aty, sa të na krijohej mundësia për ta tërhequr në thellësi.

Pas dy orë luftimesh autokolona armike nisi të largohej pjesë-pjesë nadej nga kishte ardhur. Kurse disa makina të pararojës që e kishin kaluar pritën, rrëshqitën drejt Tiranës, ku me siguri do të shpinim lajmin e atyre që po ndodhedhin tek portat e saj.

Goditjet që iu bënë armikut deri në afërsi të kryeqytetit dhe dëmet që iu shkaktuan atij në njerëz e mjete e tmerruan atë. Alarmi që u dha nga propaganda e armiqve me anë të fletushkave të tyre dëshmonte për panikun e madh që i kishte kapur. **"Me këtë që po na ndodh ne "shyqyr" që kemi më tepër fat se mend..."** pat shkruar gazeta **"Bashkimi i kombit"** në ato ditë<sup>2</sup>. Ca më vonë, kur ne vepronim përreth Tiranës, po e njëjta gazetë bënte thirrje: "ngrihuni o burra se **"Çetat komuniste u derdhën këto ditë në një pjesë të Shqipërisë së mesme".**"

Operacioni i qershorit që armiku e kishte popullarizuar me

1) *Nelo Gorrishti, ish komandant kompanie*

2) *"Bashkimi i Kombit"* dt. 25.6.1944 Nr. 148

3) *Po aty* dt. 9.7.1944 Nr. 160

shumë bujë, qe përballuar me sukses. Forcat partizane nga ky operacion dolën edhe më të forta; këtë fakt e pranuan edhe aleatët anglo- amerikanë të cilët atë kohë dukej sikur nuk shquheshin për simpati të veçantë karshi luftës sonë, me që ajo drejtohej nga PKSH. "Vrulli kryesor i ofensivës gjermane (në Shqipëri-M.Xh.) ka marrë fund... deklaronin ata. Operacionet janë drejtuar nga vetë gjenerali Loehr i cili ishte komandant i gruparmatës gjermane në Greqi dhe në Egje... ai ka eksperiençë të madhe në agresion kundër viseve të huaja... ka marrë pjesë në Anschluss-in në Austri dhe në sulmin kundër Çekoslovakisë... ka komanduar fuqitë ajrore në fushat e Polonisë dhe të Ballkanit... Komandat i Përgjithshëm i intervencionit të Kretës... shërbeu në Rusi dhe që andej u suall në Shqipëri për të komanduar ofensivën e madhe gjermane kundër Lëvizjen NÇL Shqiptare në Jug" (Buletini "Mundimi")<sup>1</sup>. Pastaj "Puna e partizanit" (shqiptar M.Xh) është si puna e dragonit që ka shumë kaptina, ja pret njëren kokë, fup i del tjetra <sup>2</sup>

Ofensiva e fundit gjermane e mprehu edhe më tepër ndjenjën çlirimtare të popullit tonë. Pjesëmarrja në luftë u bë një çeshtje nderi, një kriter dallues në marrëdhëniet midia njerëzve në përgjithësi. Edhe "Nëna që e kish nisur djalin për luftë nuk ia hapi derën (kur ky i gënjiyer nga propaganda armike deshi të kthehej në shtëpi-M.Xh), duke i thënë se ti s'je djali im, ai do të kthehet bashkë me lirinë".<sup>3</sup>

Fitoret e njësive tona patizane në verën e 1944-ës, duke përfshirë edhe përballimin me sukses të Operacionit të Madh të Qershorit, veç të tjerash shiheshin edhe si jehonë luftarake, direkte e Ofensivës Verore të Ushtrisë Kuqe 'në Frontin e Lindjes, ku ajo po triumfonte habitshëm me forcat e më se 130 divizioneve<sup>4</sup> kundër hordhive hitleriane. Këto operacione tanimë kanë hyrë në historinë e luftrave si "10 goditjet Stalinjane". I entuasiazmuar nga arritje të tilla kryeministri Çurçil, pasi më parë pat dërguar mesazhe

1) "Mundimi"- një butelin që botehej prej anglezëve në gjuhën shqipe, prej 4 faqesh si rregull, dhe shpërndahet me anë të ajrit tek ne.

2) Po aty Nr.22, 3 gusht 1944

3) "Trumpeta çlirimtare" Nr.1, dt. 21.7.1944 Nr. 18, 6 korrik 1944.

4) Nga letërkëmbimi Stalin- Çerçil Vell.I, f.233, botim rus

lavdëruese me terma superlative në adresë të Ushtrisë së Kuqe<sup>1</sup>, kërkoi me këmbëngulje edhe notat e Hymnit Sovjetik për ta ekzekutuar nga Radio Londra si dhe portretin e kryekomandantit të Ushtrisë Sovjetike për ta ofishuar atë edhe në Angli pas çdo fitoreje të saj.<sup>2</sup>

Në luftimet tona të vitit 1944 patën efekt të ndjeshëm psikologjik edhe operacionet e Frontit të Dytë në Evropë, sidomos zbarkimi i aleatëve në Veri të Francës, nëpërmjet Lamanshit, në gjysmën e parë të qershori.

\*\*\*

### *Dubej kapërcyer edhe një pengesë si kjo!*

Macukulli në rajonin e Burrelit paraqiste një kështjellë natyrale gati të pamposhtme; armiku kishte përqëndruar atje mbi 600 mercenarë, të komanduar nga zogistët e njohur të kësaj zone si Bilal Kola, Sali Llani e Sulë Kurti, të mbështetur nga forca të zgjedhura gjermane me piksynim që të pengonin përparimin e UNÇSH drejt Shqipërisë së Veriut.

Sulmi për ta marrë Macukullin nisi qysh në orët e para të 16 korrikut. Vrulli i parë i sulmit tonë u ndërpre nja 50 metra përpara lartësisë që ngrihej aty, nga zjarri i fuqishëm që po bënte armiku dhe nga shkëmbenjtë që formonin një barrikadë më vete. Vend paraqitej i tillë që edhe për t'u tërhequr prapa ishte tepër e zorshme. Ndërkaq suksesi i operacioneve tona të mëtejshme kundër bazave të fortifikuara armike në Shqipërinë e Veriut kërkonte patjetër të merrnin më parë Macukullën.

Nja njëzet partizanë, nën drejtimin e Llambro Andonit<sup>3</sup> hoqën këpucët për të mos bërë zhurmë, bënë ngjitjen me vështirësi të pabesushme, nga s'e priste armiku. Paniku që pushtoi mercenarët që i madh. Ata u detyruan të tërhiqen duke lënë aty nëpër majat e

1) Nga letërkëmbimi Stalin- Çërvil Vell. I, f.233, botim rus

2) Po aty f. 203 dhe 237

3)Llambro Andoni, dëshmor i Luftës ANÇL, hero i popullit

gërxheve përveç të tjerash, edhe një pjesë të armëve e paisje të tjera.

Krerët të llahtarisor nga disfata e plotë që i priste, u bënин thirrje zogistëve për qëndresë, duke u premtuar se nga çasti në çast do t'u vinin ndihma të reja gjermane. Pas 6 orë luftimesh rezistenza e zogistëve u imposht përfundimisht nga forcat tonas, duke u dhënë mundësi të kthehen në shtëpitë e tyre edhe banorëve vendas, që ishin dëbuar prej zogistëve për t'ua kthyer ato në fortifikata lufte.

Krahas humbjeve të konsiderueshme të armikut në luftimet përmarrjen e Macukullit nga ana jonë ra edhe komandanti i kompanisë I, batalioni III- Rrapo Asimi si dhe partizani italian Fattore Seste.

Zogistët qenë betuar për t'iua kundërvënë me çdo kusht Lëvizjes NÇL, prandaj më pas forca të reja gjermano zogiste të adhura nga Murrizi për në Gurabardhë goditën nga prapa shpine forcat tonas dhe pas dy ditë luftimesh u tërroqjnë me humbje. Në këtë goditje nga ana jonë ra Zonja Çurre, Arshi Resuli dhe partixzani italian Petro Paskuale.

Zogistët, ashtu si edhe ballistët kishin aleancë të ngushtë bashkëveprimi me gjermanët. Njeri nga misionarët më me autoritet të aleatëve në Shqipëri në ditët e luftës ripohon se "Edhe Tilmani (një misjonar tjetër M.Xh) në raportin e tij thoshte: "Forcat gjermane në operacionet e tyre qenë të shoqëruara nga ato të Ballit e Legalitetit të cilat kishin plaçkitur kudo para se të tërhiqeshin...!"", ashtu siç i pat raportuar Kajros edhe gjenerali Devis<sup>2)</sup> qysh në dhjetor 1943.




Heroi i Popullit  
Llambro Andoni

1) Reginald Hibert "Fitorja e hidhur" f. 484

2) Gjenerali Devis shefi misionit ushtarak anglez në Shqipëri AQSH

## ***Endrra e misrit***

Vapën e gjysmës së dytë të gushtit kishim ca ditë që nuk po e ndjenim si më parë. Brigada jonë i kish shtyrë veprimet e saj në zonën e Malit Korab, duke lënë prapa krejt të spastruar nga armiqtë gjithë Fushë Dibrën bashkë me qytetin e Peshkopisë. Gjatë këtyre luftimeve ra edhe partizania nga më të rejet në moshë Nimete Progonati.



**Heroinë e Popullit Nimete Progonati**

Freskia e Korabit na dukej sikur na i kishte çelur më tepër edhe oreksin për të ngrënë, megjithëse nuk kishim vuajtur ndonjëherë nga ai. Shpesh kur dukej kali i intendencës që i ngjitej malit drejt nesh me ca thasë bukë misri nga ato që grumbullonte populli, partizanët e kishin bërë si zakon të lajmëronin njëri-tjetrin: "Po vjen shpirti i repartit".

Ishte mëngjesi i ditës së tretë që kali nuk po dukej të vinte. Çdo ditë na takonte të përlesjheshim me trupat naziste e mercenarët që kishin zënë majat më të larta të Korabit. Që andej kontrollonin gjithë lëvizjet tona deri në qytetin e Peshkopisë. Atë ditë partizani 14 vjeçar Temo Sinani që kishte dremitur ca aty pas një shkëmbi, nisi t'u tregojë shkokëve:

-Sapo pashë një ëndërr të çuditshme,- filloi të thoshte Temua-që nuk e kam parë ndonjë herë tjetër,(ai ishte më i vogli ndërmjet shokëve nga mosha, po nga zëri dukej edhe më fëminor nga që nuk e shqiptonte dot mirë gërmën "rr" në vend të saj delte më tepër një si "ll" e mbytur ose "l" belbarake) Me të dëgjuar fjalët e para të Temos shokët e tjerë qeshën...

-Ju nuk besoni në endrra, edhe unë ashtu si ju mendoj- po me që jemi duke ndenjur është mirë ta dini. Më dukej sikur ishim në një fushë të shtruar si ajo atje poshtë (tregoi me dorë në drejtim

të Dovolanit)... ajo sapo qe çliruar nga ujët e lumit që e kishte pasë përmbytur. Pas tharjes së ujit qenë mbjellë e rritur çdo gjë.. po më shumë kish misër... Ne sikur u turrëm të gjithë për të mbledhur misra të njomë.

-Po pastaj?

-Pastaj i zoti i arës, një fshatar babaxhan na tha se misri i kësaj fushë mund të haqej vetëm bukë furre.

-A u ngope ti njëherë?- e ngacmoi dikush përsëri.

-Të them të drejtën - vazhdoi Temua me seriozitet- era e këndshme e tavave me misërishte që nxirreshin njëra pas tjetrës më kënaqi shumë, po përfatim tim të keq nuk hëngra dot gjë se sapo mora copën e parë e nisa ta përtypja, dikush nga ju foli me zë të lartë, m'u hapën sytë e goja mbeti bosh, ndërsa nofullat lëviznin si mulliri pa kokrra... Qeshëm të gjithë.

### ***Marrja e Korabit***

Një pjesë e forcave gjermane dhe të mercenarëve të Xhem Gostivarit pasi qenë detyruar të lënë qytetin e Peshkopisë dhe rajonet përreth në duart e partizanëve, u përforcuan në lartësitë e Malit Korab, duke i qëndruar qytetit mbi kokë si shpata e Demokleut.

Në mbrëmjen e 22 gushtit sulmi partizan i forcave të Brigadës V-të Sulmuese shpërtheu nga tre drejtime të ndryshme duke e shpartalluar qëndresën armike dhe në këto lartësi kaq dominuese për të. Në përleshje e sipër, formacionet e të dy palëve, vendevende, u përzien me njera tjetrën. Vendosmëria e partizanëve hasi në rezistencën po aq këmbëngulëse gjermano- mercenare për t'i mbrojtur me çdo kusht pozitat që mbanin. Kjo gjë vihej re edhe te komandat e shpeshta të oficerëve gjermanë drejtar ushtarëve të tyre për qëndresë si dhe nga hakërrimet e Xhemit, drejtar mercenarëve që kishte aty.

Afër mesnatës forcat tona mundën të pushtojnë të gjitha pozicionet armike, duke vënë nën kontroll edhe një pjesë armësh të rënda, të braktisura nga ai të cilat edhe pse nuk dinim i përdornin si duhej , shoku ynë Xhevít Mehmeti meqë komandonte

togën e mortajave të lehta në një batalion, mundi të përgatisë një nga këto armë të rënda duke ia drejtar grykën andej nga po tërhiqeje armiku, i vuri një predhë brenda dhe e shkrepit, "Fluturimi" i saj ia la vendin tjetrës e kështu me radhë...

Utumat që po shkatonin plasjet e predhavet të artelerisë nëpër luginat pyjore drejt Zhirovnicës, Manushajt e Ristrovës, për ku vraponin mbeturinat e Xhemit dhe ato naziste, shpinin me vete edhe lajmin e shpartallimit përfundimtar të tyre; kurse më pas mësuam që për shkak të kësaj disfate, kish përfunduar në vetvrasje edhe komandanti gjerman i tyre.

Në këto luftime u dalluan veçanërisht Sami Gjergji që edhe ra në përlleshje e sipër trup me trup, Çobo Mërkuri<sup>1</sup> që vraponte në ballë të shokëve, duke shtënë mbi armiqtë e duke ftuar të tjerët që ti kapnin të gjallë ata, si dhe Ismail Nuhu<sup>2</sup> për veprimet e tij të guximshme e me gjakftohtësi, kur u ndodh i rrëthuar prej armiqsh nga të gjitha anët.

### ***"Opingat e kapidanit"***

Gjatë veprimeve tonë në veri kishim dëgjuar për një farë Zyber Lita, i ngjashëm me "... feudalët e mesjetës, se kish zënë Kalanë e Dodës e nuk lejonte asnjeri të kalonte andej, kish lidhje me gjithë krerët e reakacionit dhe me qeverinë kuislinge, ishte rekurtuar nga Mustafa Kruja si oficer i milicisë fashiste, kishte marrë pjesë edhe në masakrën e 4 shkurtit në Tiranë"<sup>3</sup> do të pohonte shtypi i kohës me rastin e përvjetorit të parë të asaj masakre.

Udhëtonim nga krahina e Dibrës për në atë të Lumës, kur morëm urdhër që në kalim e sipër të spastrohej edhe Kalaja e Dodës prej xhandarmërisë së Komanduar prej kapitenit Zyber Lita. Mbëritëm aty me një pjesë të kufizuar forcash, duke u gdhirë 5 shtatori, fshati Ploshtan i Kalasë së Dodës, ku ishte qendra e

1) Çobo Mërkuri, dëshmor i Luftës ANÇL

2) Ismail Nuhum ish komandant skuadre

3) Gazeta "Bashkimi" Nr.38, dt. 4 shkurt 1945

xhandarëve zogistë, ndodhej akoma në gjumë, gjer pas mezit të natës, kur u plotësua rrithimi, nuk ndihej asgjë tjetër, veç lehjeve të rralla të ndonjë qeni. Këto të lehura qensh u bënë shkak i prishjes së asaj qetësie. Dhe ja paspak një patrullë xhandarësh tentoi të dilte në anën e sipërme mbi fshat. Aty befas iu tha: Ndal! dhe njëheraz i u bë thirrje xhandarëve që të dorëzoheshin. Ata vepruan me zgjuarsi, në fillim thanë: "Jemi dorëzuar!" Dhe në vend që të hidhnin armët dy prej tyre, me një lëvizje shumë të shkathët i zbrazën pushkët njëri pas tjetrit kundër pritës. Në këtë kohë e sipër, u zhdukën në errësirë.

Alarmi tani ishte dhënë, xhandarët bënë edhe një përpjekje tjetër për të çarë rrithimin po nuk ia dolën dot.

Pas një ore luftimesh ra mëngjesi dhe vetëm kur kishin kaluar disa minuta nga paralajmërimi i fundit që xhandarët të dorëzoheshin, prej oborrit të një shtëpie u duk flamuri i bardhë e njeherazi doli edhe një njeri i çalë. Zyberi ishte plagosur në këmbë. E mbanin për krahu dy xhandarë. Pas tij me radhë hodhën armët mënjanë e ngritën duart përpjetë edhe 30 xhandarë e graduatë të tjerë që ishin aty. Ndërmjet tyre qe edhe kapiteni tjetër që thuhej se ish agent i Sim-it italian, Sherif Lita.

Vlen të përmendet se familja Lita në atë kohë nga Fronti NÇL konsiderohej si njëra nga çerdhet e konspiracionit kundër rezistencës që po bënte populli shqiptar, këto konsiderata bazoheshin në faktin që vëllezërit Zyber e Sherif Lita mbanin lidhje të ngushta edhe me kërët reaksionarë të Veriut dhe me qeverinë kuislinge të Tiranës, siç do të pranonin edhe ata vetë në të pastajmen.

Nëna e kapitenit Lita që ishte lajmëruar sipas kërkesës së të birit e po vinte, e gjeti të birin, ashtu të capëluar gjatë luftimeve, pa kapele e zbathur, vetëm me 3 yjet e kapitanit që i kishin mbetur akoma mbi supe. Ajo këmbeu me të edhe këto fjalë:

-Të pata thanë o Zyber...

-Po moj nanë, po kështu na kishin urdhënue.

-Nuk ndigjove urdhnin e nanës po atë të të tjerëve...

-Vallahi i kena dalë borxhit kapedanit- ndërhyri fshatari që ishte aty pranë- po ky na thojte se komunistët nuk janë shqiptarë e

duhet t'i shuajmë... edhe tash kur i thonim të dorëzohej mezi u bind... Unë erdha me ju sjellë këto sende që mbetën në shpinë teme... (zgjati një shami të mbështjellë).

E mora në dorë shaminë e mbledhur dhe i shtyrë nga kurioziteti e hapa për të parë ç'kishte, pastaj pashë fshatarin në një mënyrë pyetëse.

-Janë opingat e kapedanit,- tha ky- në minutat e fundit meqë ishte i plagosun e nuk mund të ecte me to, i hodhi më të dalë të oborrit tem. Thashë me qenë se vet kapedani u dorëzue, t'ia sjell edhe opingat se neve ato nuk na duhen, kena tonat...

Në popull flitej se Zyberi i mbante opingat prej lëkure edhe për t'u shtirë si një me fshatarët, po më tepër i mbante pér t'i pasur këmbët të lehta, sido që të vinte puna.

### ***Maska e bajraktarit...***

Në fund të javës së parë të shtatorit kishim mbërritur në zonën e Lumës. Njohuritë pér gjendjen e atyshme i kishim disi të qarta meqë atje vepronte çeta e Lumës. Nisëm menjëherë aksionet, më 9 shtator me një batalion goditëm gjermanët në veri të fshatit Gostilë dhe i ndoqëm deri më të hyrë të Kukësit.

Një njësit i brigadës sonë brenda dy ditëve të para të mbërritjes, kapi në Bicaj kriminelin Sali Noka, bashkëpunëtor i Halil Alisë në krime kundër Lëvizjes Nacionalçirimitare dhe popullsisë civile... Aty mësuam edhe se Muharrem Bajraktari paskish dhënë fjalën se do të luftonte kundër okupatorëve të huaj...

Nga sa kishim mundur të bënim ato ditë dhe sidomos nga fjala që kish "dhënë" bajraktari pér t'u radhitur përkrah nesh, na u duk se çdo gjë ecte në rrugë normale, siguroheshin veprimet e popullit të asaj zone në një front të përbashkët. Në favor të kësaj ideje nga ana e bajraktarit u shfrytëzua edhe ndodhja pranë tij e nëntogerit gjerman Kuhmin i cili ato ditë kishte dezertuar nga radhët e forcave pushtuese naziste të garnizonit të Kukësit pér tek partizanët, po kish hasur me ata të bajraktarit dhe përkohësisht ndodhej aty.

Por bajraktari në fakt kishte qenë e mbetej armik i betuar i Luftës ANÇL të popullit tone.

Edhe aleatët e tij nazistë kanë pohuaN se bajraktari i Lumës, sipas Herman Frankut në librin "Male Karstike dhe shqiptare", kishte rënë në marrëdhënie miqësore me majorin Frei, komandant i garnizonit të Kukësit, ndërkokë erdhi edhe "lëkundja e besimit aleat ndaj krerëve (shqiptarë M.Xh) që nuk pranuan të ndërmerrnin ndonjë aksion kundër gjermanëve".<sup>1</sup>.

"Muharremi e përbysni idenë tonë për një koalicion nationalist kundër gjermanëve me deklarimin se kishte rënë në marrëveshje me vetë gjermanët për të shkatërruar partizanët".<sup>2</sup> Ai "kërkoi jo më pak se 500.000 gjer në një milion lira stërlina, para se të niste aksione kundër gjermanëve...".<sup>3</sup> "Unë për 10 muaj që qëndrova në Shqipëri u binda se partizanët qenë të vetmit që e viente të mbështesja".<sup>4</sup> vjen në përfundim ish misionari aleat në Shqipëri në kohën e Luftës ANÇL, Reginald Hibert.

Prapaskenat dhe pabesia e bajraktarit të Lumës nuk kishin të numëruar kundër Luftës ANÇL të popullit tonë. Edhe gjatë ditëve qe në ndodheshin në Lumë, lajme të sigurta thoshin se disa xhandarë nga Prizreni kishin ardhur te bajraktari si ndërlidhsa dhe i mbante ky diku të fshehur. Po ashtu komandanti i garnizonit gjerman të Kukësit majori Frei kishte vendosur lidhje të rregullta me bajraktarin nëpërmjet agjentëve të tij...

Në pasditen e 10 shtatorit bajraktari do të vinte në takimin që i ishte kërkuar nga ana e shtabit të brigadës sonë. Ky takim ishte caktuar në një shesh me ca shkurre të rralla anash, në afërsi të fshatit Gostilë.

Çeta e bajraktarit e përbërë prej ish hyzmeqarëve të tij kishte zënë vende luftimit më përpëra nga ajo anë e sheshit, ku do bëhej takimi. Të njëjtën gjë u detyruam të bëjmë edhe ne nga kjo anë, pak më pas, me forcat e një kompanie.

1)Reginald Hibert "fitore hidhur" f.150

2) " " " f.161

3) " " " f.158

4. Po aty f.172

Rreth orës 15.00 u duk bajraktari që doli nga ajo anë dhe u nis për nga ne, drejt mesit të sheshit. Kishte një trup të drejtë e të shkathët. Prapa i vinin dy shoqëruesit e tij. Në këtë kohë u nis edhe përfaqësuesi i anës sonë drejt tij.

Që bisedimi nisi menjëherë kjo vihej re edhe nga lëvizjet e ndryshme të secilës palë. Na bënин përshtypje disa lëvizje me duar që bënte bajraktari. Dukej që ai nuk donte t'i jepte llogari askujt për qëndrimet e tij pro armiqve të vendit. Pas pak minutash bajraktari u kthye rrëmbimthi nga kishte ardhur, duke lënë përfaqësuesin tonë aty.

Me mbërritjen e bajraktarit tek të tijtë, ata nisen të shtijnë kundër nesh. Përgjigja nga ana jonë nuk vonoi, ajo qe e furishme, po edhe ata me të gjithë bajraktarin i kishin këmbët shumë të shpejta duke vrapuar në drejtim të Kukësit për te gjermanët. Nga periferia e qytetit të Kukësit filloj të bombardojë artileria gjermane për të penguar forcat tona në ndjekjen e mercenarëve të bajraktarit.

Tani bajraktarit i ra fare maska; këtu na mbeti i vrarë partizani Musa Ibrahimini që përdorte mitralozin e lehtë. Më pas kur u bë kontrolli i vendit përreth njeri nga partizanët thirri:

-Ej, kush je ti aty? duart lart!

-Dua të dorëzohem i gjallë, mos më qëlloni!- ishte përgjigja që u kthye nga ferra aty pranë dhe u vu re se njeriu që foli po përpiquej të lirohej nga drizat që e kishin kapur prej rrobave të shjakta. Në kokë i zbardhonte qeleshja.

-Shpejt, ngreji duart lartë, pushkën lere për tokë!

-Ja, ja- shqiptoi robi dhe u ngrit në këmbë me duart e ngritura lart.

-Më duket se diku e kemi parë këtë fytyrë- tha përgjegjësi i grupit që ia kish ngulur sytë e po e shikonte me kujdes nga koka deri te këmbët, ti je një miku ynë i vjetër apo s'është kështu toger?- tha ai përsëri duke iu drejtar robit.

-Jam atdhetar, më quajnë Tahsim Spahiu...

-... Po, po e morëm vesh.Ky ishte një bashkëpunëtor i vjetër i okupatorëve italianë e gjermanë. Po edhe një dallkauk që i shkonte bajraktarit përpëra e prapa si ndonjë qen bensik. Ishte pikërisht ai togeri fashist që ishte kapur edhe një herë rob nga

forcat tona me një prill 1943, kur u shpartalluan të 200 karabinierët italianë në Selenicë. Tështimi fjalën e nderit që kish dhënë në atë kohë se nuk do të bashkëpunonte më me armikun, nuk e kish mbajtur, tanjë i mbetej gjyqit partizan të vendoste për të.

### ***Tradhetia e hapur e bajraktarit të Lumës***

Në vazhdën e veprimtarisë së tij progjermane, bajraktari më 18 shtator sulmon spitalin me partizanë të plagosur që ndodhej në krahinën e Lumës, duke përdorur për këtë qëllim disa njerëz të gabuar dhe ca mercenarë të tij. Akti kaq kriminal i këtyre njerëzve që frymëzuar nga propaganda e bajraktarit sipas të cilës Ahmet Zogu na paskish zbarkuar me forca të konsiderueshme në Shqipërinë e Mesme dhe pritej zbarkimi e forcave të tjera në veri të vendit!...

Persa i perket ndershmerise se nentogerit Kuhmin dhe mospaftimin e pikëpamjeve të tij me ato të bajraktarit do ta vërtetonin ngjarjet që pasuan. Pikërisht në ato ditë shtatori, kur bajraktari po godiste pabesisht spitalin partizan me të plagosur, nëntograhi Kuhmin kaloi në anën e luftëtarëve të lirisë dhe rëtrimërisht në kacafytje e sipër me mercenarët e bajraktarit. Premtimet e bajraktarit kishin qenë vetëm maskë.

Forcat tona qenë të detyruara të vepronin në mes të dy zjarreve: përballë kishin forcat pushtuese gjermane me qendër në qytetin e Kukësit, kurse nga prapa shpine bajraktarin me mercenarët e tij; njëkohësisht ndodheshim edhe përparrë detyrave me përgjegjësi politike që edhe propagandës sabotuese t'i hiqej maska me veprime të matura e konkrete, po edhe viktimat e kësaj propagande (njerëzit e gabuar) të shpëtoheshin nga kjo e keqe pa i dëmtuar.

Veprimet e vendosura e me takt të shtabit tonë bënë që të demaskoheshin gjenjeshtrat e bajraktarit e të qetësoheshin njerëzit e mashtruar nga ai. Edhe një grup i atyre që prisnin urdhërat e tij në malin Galicë u shpërndanë nëpër shtëpira, sipas thirrjes sonë, pa bërë asnje rezistencë. Ithtarët e bajraktarit që kryesonin këtë grup njerëzish iu dërguan gjyqit. Identifikimi dhe emrat konkretë

të tyre sipas dokumentave të kohës<sup>1</sup> u vërtetuan me anë të një liste që iu dorëzua komandës partizane nga ana e popullit me të mbërritur në fshatin Buzëmadh. Bajraktari u kishte caktuar ithtarëve të tij grada të ndryshme ushtarake që nga nën oficerë e gjer tek kapiteni, pjesa më e madhe e tyre qenë "graduar" aspiranta, nëntogerë e togerë.

Gjyktimi i këtyre të akuzuarve për krime kundër luftëtarëve të plagosur të lirisë që ndodheshin në spitalin partizan, sipas dokumentit në fjalë, u bë aty "... ku toka ishte ende e njomë nga gjaku që kishin derdhur partrizanët tanë për mbrojtjen e spitalit partizan të sulmuar pabesish nga ana e bajraktarit, si Hysem Çino, Dadan Dalani, Kapo Azemi dhe 25 të tjera së bashku me nëntogerin Kuhmin si dhe 15 të plagosur...<sup>2</sup>

Gjatë përgjigjeve të dhëna nga "oficerët" e bajraktarit u vërtetua se atyre bashkë me premtimet për grada e pozita të ndryshme ua kishin thartuar trutë edhe me shumë lloj gënjeshtash të tjera. Me kaq merr fund edhe roli tradhëtar i bajraktarit të Lumës.

---

1) Raporti i Brig. V.S 1.10.1944, AU kutia 1, dosja 7

2) Raport i brigadës V.S, 1.10.1944, AU Kutia 1, dosja 7.

## **VI. ME FLAMURIN E LIRISË NË KOSOVË**

*Nga pritja e përzemërt e popullit kosovar,  
pjesëmarria e tij aktive në Luftën ANÇL;  
mbi luftime për çlirimin e Kosovës*

### ***“Vllaznia e Moçme”***

Në mëngjezin e 5 tetorit mbirritëm me pararojën e brigadës V S. në fshatin Rrapçë të Kosovës. Aty çdo gjë dukej si pa jetë, asnje frymë njeriu, as bagëti nuk dukeshin gjékundi, bile as pula. Aty gjetëm vetëm një plakë. Ajo ishte struktur në rrëzë të një plevice dhe shikonte djathtas e majtas si e trembur.

Përpjekjet tona për t'i nxjerrë ndonjë fjalë rrëth gjendjes së atyshme nuk patën rezultat., rrinte me gojë mbyllur dhe dridhej. Mund të mendohej se ishte shurdh-memece. Për ta zgjidhur këtë enigmë ndihmoi partizania Kanerina Sulo.<sup>1)</sup>. Ajo kërkoi që të mbetej vetëm me plakën. Në fillim i foli asaj se cilët ishim ne, se nuk duhej të frikësohej, se partizanët ishin bij të popullit që kishin ardhur deri këtu për t'i shpëtuar ata nga njerëzit e këqinj e sidomos nga të huajt që na kishin marrë lirinë, nderin...

Pas gjithë këtyre që dëgjoi, plaka dalëngadalë nisi të çelet,

---

<sup>1)</sup> Kanerina Sulo, ish përgjegjëse rinie batalioni

përpëliti njëherë sytë- sikur të ishte zgjuar nga gjumi, duke shikuar përreth pastaj hapi gojën e foli:

- A me të vërtetë asht kështu si thue apo don me më pre më besë?- pyeti ajo.

-Ne i kemi dhënë besën popullit ta shpëtojmë nga armiqjtë e nga vuajtjet që shkaktojnë ata, prandaj nuk na dhimset as jetë për ta shpurë deri në fund besën e dhënë. Sakaq i tregoi plakës buzën e çarë nga ca ethe që kish kaluar ato ditë .

-E gjora ti!- tha plaka dhe iu afrua më pranë, duke shikuar partizanen me kureshtje.

-A do të ndodhet një çikë ujë?- pyeti pastaj partizania me mirësjelljeje, duke u munduar që të familjarizohej sa më tepër me plakën.

-Jo besa, çikat kanë ikë prej tute-u përgjegj tjetra- ato janë largue më gjithë trimat.... dhe vazhdoi të "shfajësohej" karshi partizanes që nuk po ia plotësonë dot kërkasën.

... Jo nënë, unë të kërkova vetëm ujë e jo "çikë"- sqaroi partizania, tani u kujtua që ishin keqkuptuar për shkak të dialektit (ne kishim parasysh edhe propagandën që kish bërë armiku kundër komunistëve). Kanerina i shpjegoi nënës se lufta jonë është e të gjithëve, edhe e burrave, edhe e grave, kemi dalë vullnetarisht së bashku me vëllezërit tanë... Ata që flasin keq për partizanët nuk janë të mirë, gënjejnë...

-Po shkatë<sup>1)</sup> që na kanë vra e na kanë pre, me ju janë ata?

-Jo nënë, ata shkatë e këqinj që thua ti ne i luftojmë njësoj si nazistët gjermanë, po ka edhe të mirë që e luftojnë armikun njësoj si ne, ata janë partizanë...

...-Ne jemi të besës si shqiptarë, po a na i jep edhe ti besën si po ta japid ne ty o nënë? ndërhyri komisari i qetë e me buzën në gaz i cili tanimë ishte afruar aty ku bisedonte partizania me plakën edhe pothuajse e kishte dëgjuar tërë bisedën e tyre; pastaj i zgjati asaj dorën. Plaka për ca sekonda e pa komisarin në sy me një farë mëdyshjeje, pastaj tha:

---

1) Shkatë- kjo qe nosfkë për serbo- malazestë dhe maqedonasit, prej të cilëve shqiptarët e atjeshëm kishin vuajtur shumë

-Hajt pra, qe besa- dhe ia shtrëngoi atij dorën, tani pothuajse pa drojtje.

-Ne bashkë me besën tënde duam edhe besën e trimave që janë larguar nga fshati, sepse jemi vëllezër- tha prapë komisari, duke marrë nënën për qafe- jemi djemtë tuaj...

Pasi e pa mirë komisarin nga koka te këmbët si për ta studiuar, plaka u shpreh:

-Trimi trimin s'e ha kurrë në besë hej burrë.. ecni me mue!-dhe u ngre e shkoi përpara drejt kreut të fshatit gjer sipër tij; pas saj vijoi edhe komisari me njërin nga partizanët më të rinj të batalionit, Azem Troqen<sup>1</sup>. Kur arriti në anë të fshatit nëna thirri:

-O din, o Din bree...(kështu e thërriste ajo djalin e saj)- po ende nuk dëgjohej ndonjë përgjigje. Ajo vazhdoi:- Ku je bre se kanë ardhë vllaznija e moçme me na lypë besën!...Pas disa të thirruash të tjera u dëgjua zëri i një burri që ishte jo shumë larg prej nesh po siç dukej deri tani nuk kish dashur vetë të përgjigjej

-Ç'ka ndodhur o nanë, mos të kanë rrejtë shkatë?

-Jemi shqiptarë, partizanë shqiptarë..., kemi ardhur për të lidhur besën me ju,- t'i luftojmë së bashku armiqtë- sqaroi komisari, duke qëndruar në këmbë pa bërë asnjë lëvizje për vetmbrojtje që mund të krijonte dyshime në fjalët e tij. Biseda së largu midis të dyve zgjati për disa minuta. Pastaj Dini kërkoi kohë që të fliste edhe me të tjerët, para se të jepte përgjigje. Ne ishim të interesuar të prisnim.

Pjesa më e madhe e batalionit ishte mbledhur në anën tjetër të fshatit në pushim. Këngët partizane vazhdonin. Një grup lumjanësh nga ata që kishin ardhur rishtazi në brigadë ia thoshin "Këngës së Rexhës"- popullore kosovare. Gjallëria që iu dha fshatit nga oshtima e këngëve duhej të arrinte deri tek ata që ishin "arratisur" për t'uva nxjerrë frikën e për t'i kthyer në fshat. Shpresonim se edhe nëna që hap pas hapi shkoi e u bashkua me të birin, duhej të bënte diçka për t'i afruar ata.

Do të kishin kaluar nja tre orë kur doli Dini me gjithë t'ëmën

---

1) Azem Troqe, dëshmor i Luftës ANÇL

pikërisht tek ai vendi ku kish dalë për herë të parë dhe duke ecur drejt nesh, po tundte dorën në mënyrë përshëndetëse. Me këtë shenjë edhe komisari u nis përsëri në takim me të... Dini pa pritur takimin me komisarin u kthye me fytyrë andej nga ndodheshin të tijët dhe thirri me një zë të fortë:



Partizanët e Brigadës së V S me flamurin fitimtar për çlirimin e Kosovës

pritën si vëllezër e çlirimtarë të vërtetë.

Për 'ne në atë kohë qe shumë domethënës fakti që qysh në fillim e gjatë gjithë qëndrimit tonë në tokën kosovare, pothuajse nuk hasëm në asnje rezistencë të organizuar nga kosovarët kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare siç na patën paralajmëruar jugosllavët, megjithëse edhe atje reaksiuni pat bërë punën e vet.

Mbërritjen e forcave tona, kosovarët e pritën edhe me shpresën për t'u mbrojtur nga krimet e vazhdueshme të çetnikëve e të serbomëdhenjëve që ishin sjellë egërsisht kundër popullsisë shqiptare aty. Faktet me të cilat do të njiheshin më pas do të na bindnin për krimet e llahtarshme që kishin bërë e vazhdonin të bënin akoma bandat e armatosura serbo-malazeze e maqedonase

-Ej, burra! dilni të presim vllazninë e moçme!- ndërkohe shtiu edhe tre herë me pushkë. Këto të shtëna u quajtën si një shenjë e besës që ishte lidhur tanimë midis fshatarëve kosovarë të zhgënjer dhe partizanëve që kishin ardhur për t'i ndihmuar ata që nga skajet më jugore të Shqipërisë me Brigadën e V-S.

Të shtënati e pushkëve të shoqëruara me fjalët: "Na ka ardhë vllaznia e moçme!" vazhduan edhe më pas. Ato i kaluan kufijtë e Rrapçës dhe arritën më larg deri në Vranisht, Plavë, Zhur, Verbicë e në tërë Kosovën, banorët e të cilës, kudo që kaluam, gjithashtu na

karshi shqiptarëve, të maskuar nën emrin e çetnikëve.<sup>1)</sup>

Me kalimin e ditëve në tokën kosovare partizanët, gjithë formacionet tona ushtarake atje, u familjarizuan aq shumë me vëllezërit tanë të atjeshëm sa që mund të llogarisnin çdo përkrahje të tyre në misionin tonë të përbashkët çlirimtar. Kosovarët thuajse u bënë një me ne me zemër, me mëndje e me trup. "Ju jeni tanët, bujrum bukë e krypë e besë shqiptari!" - ishin fjalët që dëgjonim kudo. Kjo gjë u përligj me pjesëmarrjen aktive në Luftën ANÇL edhe të asaj pjese të popullsisë që deri atëhere kishte qënë e gabuar ose qëndronte ende në pritje.

### **Zgjedhja e Këshillit NÇL**

Kishim marrë urdhër të niseshim nga Godeni dhe sëbashku me një batalion të brigadës kosovare të sulmojmë gjermanët më 13 tetor në Damjan. Sulmi i tanëve nisi qysh afër mëngjesit kur nuk kishte aguar mirë dita. Nga mesi i ditës njësitet tona, të veçuara mundën të hynin brenda në fshat nga dy drejtime. Në atë pasdite vonë, mbrojtja e gjermano-mercencarëve u thyte në shumë pikë dhe trupat kryesore gjermane u tërhoqën.

Në anën perëndimore të fshatit shtinte një mitroloz e ca pushkë që nuk na linin të përparonim më tej. Ato ishin vendosur në dritat e një shtëpie dykatëshe e nuk po tundeshin. Atëhere një grup prej 4 partizanësh me kapécime shumë të shpejta iu afrua shtëpisë deri sa të mund të hidhej granata e dorës. Ai u bëri thirrje atyre që ishin brenda të dorëzoheshin duke u shpjeguar se çdo përpjekje e mëtejshme për qëndresë ishte pa shpresë për ta... Se dhe hyrja e dalja nga shtëpia dykatëshe ku ndodheshin ishte vënë nën kontrollin e pushkëve partizane.

-Ne nuk dorëzohemi pa rrjepur lëkurët tuaja e pa i shitur ato për nga një lek në pazarin e Gjakovës!- ish përgjigja e anës tjetër.

-Dijeni se shtëpia është e komunistëve tuaj, po s'na hapët rrugët e daljes kjo do të digjet me të gjithë njerëzit e familjes që ka brenda!-

---

1) Çetnikët, lëvizje profashiste që vepronë kundër Lëvizjes NÇL në Jugosllavi.

u dëgjua të thoshte një zë tjetër nga ata; ndërkohë shtyu kokën e një fëmije jashtë buzës së dritare që të mund ta shihnim ne.

Detyra u bë urgjente që armiqtë të asgjësoheshin dhe njerëzit e shtëpisë të shpëtoheshin pa u dëmtuar. Dy nga partizanët skuadrës së 3-të të kompanisë së II-të, Shaqir Doda dhe Servet Ahmeti<sup>1</sup> dolën vullnetarë. Ata u ngjitën nga ana lindore e godinës në çardhakun e saj, hapën tavanin prej dërrase të shtëpisë dhe i vunë armiqtë në shënjestër. Ai që ishte më agresori prej tyre ra që në breshërinë e parë, i vdekur; dy të tjerët që nuk kishin rrugë tjetër shpëtimi u detyruan të dorëzohen. Njerëzit e familjes prej pesë vetësh: një plak një grua dhe tre fëmijë, (jo dhjetë sa kishin thënë mercenarët), u nxorrën shëndoshë e mirë.

Nga të thënët e robërve doli se përgjegjësi i mercenarëve Sef Sadiku që e kërkonim kishte shkuar në komandaturën gjermane të Gjakovës qysh një ditë më parë. Në mbledhjen me popullin që u bë atë mbrëmje u fol për qëllimin e luftës sonë dhe u demaskua propaganda që bënte armiku kundër nesh. Pastaj u ngrit çështja se kush do ta qeveriste fshatin pas këtej?

-Mirë e kemi pasur Sh. S., ai si kryeplak na i ka qa mirë hallet...- u ngre e tha njeri nga fshatarët.

-Revolucioni ynë nuk e njeh pushtetin e një njeriu siç kanë qënë kryepleqtë gjer tanë... duhet të zgjedhim Këshillin NÇL prej 9 ose 11 vetësh- shpjegoi komandanti. Kundërshtime të tjera nuk pati.

U sqaruan edhe disa pyetje që dolën, pastaj u zgjodh Këshilli NÇL i fshatit, në përbërje të të cilët u përfshinë njerëzit me popullorë e më të përshtatshëm për një detyrë të tillë.

### ***Një përpjekje e pasuksesshme***

Vendimi për çlirimin e Gjakovës qysh në fazën e parë të operacioneve tona ushtarake në Kosovë ishte marë me kohë. Kjo shpjegohej me rendësinë e veçantë politike dhe ushtarake që

---

*1) Shaqir Doda dhe Servet Ahmeti, dëshmorë të Luftës ANÇL*

kishte ajo. Informata të ndryshme kishin bërë të ditur se në qytet ndodheshin mbi 300 trupa gjermane e rreth 700 mercenarë. Mbi bazën e këtyre të dhënavë u bënë dhe përgatitjet e duhura. Në orët e para të mesnatës duke u gdhirë 16 tetori u plotësua rrëthimi i qytetit. Batalioni i II-të i brigadës sonë dhe një batalion i Brigadës së IV kosovare nisën sulmin: një pjesë forcash u hodhën kundër postbllokut në hyrjen juglindore të qytetit, forca të tjera në drejtim të gazermave, ku ishin struktur ushtarët nazistë. Një kompani sulmoi lagjen "Mulla Isuf" ku më tepër ishin përqëndruar mercenarët e Xhelal Mitrovicës.

Rezistenca e armikut nëpër rrugët e qytetit, nga dritaret e shtëpive dhe mga pozicione të tjera të parapregatitura ishte e ashpër. Disa njësite të vogla mundën të futen deri në qendrën e qytetit. Spastruan pjesën më të madhe të tij, me përjashtim të gazermave që ishin të fortifikuara me mbrojtje prej betonarmeje dhe të thurura me tela me gjëmba. Anëve të qytetit po ashtu përpjekjet u bënë të ashpra me atë pjesë armiqsh që po braktisin pozicionet në qytet dhe kërkonin të largoheshin për të shpëtuar nga rrëthimi. Me shpartallimin e këtyre të fundit i takoi të merrej kryesisht batalioni që kontrollonte hyrje-daljet prej qytetit, ku kapi dhe çarmatosi me dhjetëra prej atyre që braktisin qytetin

Në kohën që beteja në qytet e rrëth tij vazhdonte, nga lindja dhe veriperëndimi nisën të ndiheshin të shtëna të shpeshta artilerie. Forca të ndryshme armike ishin nisur nga Prizreni dhe nga Peja njëkohësisht, në drejtim të Gjakovës për t'i ardhur në ndihmë garnizonit që ishte rrëthuar aty.

Në mbrëmje forcat armike të ndihmës mbërritën te portat e qytetit, edhe nga ana e Prizrenit, edhe nga ana e Pejës njëkohësisht. Forcat tona që luftonin brenda në qytetit morën urdhër për t'u tërhequr. Batalioni ynë duhej të siguronte tërheqjen e plotë të tyre, prandaj iu desh t'i pengonte sa më shumë forcat e freskëta armike që përpinqeshin të hynin në qytet. Ata që vinin nga Prizreni sapo u afruan, i kundërsrumoi kompania e dytë dhe i detyroi të tërhiqen paksa, po ushtarët nazistë morën krahun e majtë, anës Lumit Erenik për të marë qytetin nga jugu; aty ato sulmohen përsëri nga kompania e tretë dhe përkohësisht

detyrohen të shtrihen barkas.

Nga ana veriore forcat e kompanisë së parë kishin rënë edhe ato në përpjekje me trupat gjermane që vinin nga Peja. Po u bënин atyre një qëndresë të vendosur. Kjo situatë vazhdoi kështu derisa të gjitha forcat tona kishin fituar kohën e nevojshmë për të dalë nga qyteti.

Në këtë përpjekje për çlirimin e Gjakovës armikut iu shkaktuan mjaft humbje po edhe neve na mbetën aty mbi 10 shokë, ndërmjet tyre qenë Isa Ymeri, Xhevdet Çinua, Arshi Maliqi, Dino Selfua, Shyqyri Telhai e të tjerë. Tre të fundit nuk mundëm as t'i tërhiqnim, po i varrosëm brenda në qytet me shpejtësi para se të tërhiqeshim. Këtë përpjekje ne e quajtëm të pasukseshme sepse nuk ia arritëm dot qëllimit që i kishim vënë vetes.

Do të duhej një sulm i dytë, më i fuqishëm dhe më i studiuar për ta çliruar qytetin; ai u bë më 8 nëntor dhe përfundoi me sukses më 10 nëntor kur Gjakova u çlirua plotësisht.

### ***Shtohet edhe një luftëtar***

Vepronim buzës së Drinit prej Rugove, në Gjinaj e më poshtë. Ishte ftohtë e binte dhe shi. Më datën 14 nëntor në mbrëmje në shtëpinë e Bacës R., i zoti i shtëpisë na përshëndeti të dhjetëve sa ishim. Pastaj na priu përpara. Shtëpia e tij brenda e jashtë ishte e lyer me ngjyrë të bardhë, gjithshka, shkëlqente nga pastërtia shembulllore.

Baza hyri në dhomë disa hapa me përpara dhe me të kapëcyer pragun e derës i dha dorën e mirëseardhjes shokut që hyri i pari. Ndërkohë bëri gati dhe dorën tjetër e shikimin e hodhi të vartësit që ishin prapa derës<sup>1)</sup>

-S'asht nevoja Bacë - tha Sadedini, një partizan vendas që kishte ardhur kohët e fundit në repartet tona. Partizanët duhet të jenë gati në çdo minutë se e kemi hasmin te dera- arsyetoai ai.

-Më mirë mos u mundo se jemi dhe shumë e s'na i del dot-

---

1) Sipas zakonit të vjetër shqiptar kur vjen miku arma i dorëzohet të zotit të shtëpisë e ai përgjigjet për gjithshka. Këtë pati parasysh edhe Baca në këtë rast.

shtoi komisari që bënte pjesë në këtë grup. Po s'na i more për keq, le ta rregullojë secili armën e tij ashtu si t'i vijë mbarë, mirë?

-Po more vëllazën si të jetë ma mirë- tha Baca dhe u kthyen nga dhoma duke na treguar vendet ku do rrinim. Në këtë rast e ndjemë veten shumë ngushtë sepse detyroheshim të vepronim kundër një zakoni të hershëm shqiptar i cili shprehë mikpritje të përzemërt, siguri e besnikëri të padiskutueshme njëkohësisht. Por fatmirësisht baca na kuptoi drejtë, gjë që u pa në tërë qëndrimin e mëpastajm gjersa u larguam nga shtëpia e tij.

Në bisedën e ngrrohtë që nisi e vazhdoi gjatë më pas, rreth zjarrit, u njohëm më shumë dhe u familjarizuam aq sa edhe vetë Baca, në çdo rast që vinte fjala, gjatë bisedës nuk thoshte me "ju partizanët", siç na kishte thënë në fillim po "na partizanët". Në këtë mënyrë donte të thoshte se edhe ai me gjithë familjen e tij, këtej e tutje e ndjene për nder ta quanin partizan.

Kur biseda jonë u vërtit rreth vëllazërimit edhe me popujt fqinje, i zoti i shtëpisë rrudhi vetullat, ftyra i mori një pamje të rëndë që dukej se shprehë dhimbje e brengë. Diçka nisi ta mundojë përbrenda dhe mezi po e mbante sa t'i jepej rasti që ta nxirrite. Dhe ja, pasi mbaroi tjetri, mori fjalën:

-A i shihni këto ftyra në mur?- pyeti. Ne ngritëm sytë dhe vumë re dy fotografi, të vëna në korniza dhe të varura në krye të dhomës, përbri njera tjetrës. Prapa xhamit dalloheshin dy burra të bëshëm, me veshje kombëtare. Të dyve u dukeshin kamat e futura në brez, dora e djathë mbështetur mbi to. Mustaqet i kishin të gjatë, njerit prej tyre i vareshin në të dy anët deri te mjekra, kurse tjetri i kishte të dredhura e të kthyera me cepa përpjetë. Po të mos vije re këtë hollësi, ishte zor t'i dalloje nga njeri-tjetri.

-Ai më të djathëtë me mustaqe të lëshueme asht mixha im - vazhdoi Baca- kurse ai me mustaqe të dredhuna ashtë baba. Mixhën ma kanë vra shkatë tinëz në kohën e besëlidhjes së Prizrenit sepse u bashkua me Avdyl Toskën e Sulejman Vokshin. Babën ma vranë, po ata para 25 vjetësh, me dorën e një njeriu të tyne nga fshati Manushë...Që nga ajo kohë janë vra 8 burra nga të dyja palët e hasmërija vazhdon...

-Asaj kohe duhet t'i japim fund bashkë me dëbimin e

okupatorëve nga vendi ynë - tha komisari.

-Po mbetem në duar të shkave prap ashtu ka me kenë..Ja edhe para do kohësh janë ba shumë të këqija karshi ne shqiptarëve. Na quajnë armiq pse mbajmë flamur shqiptar...Asnjihërë nuk na kanë folë me gjuhën e mikut apo të shoqit. Në Pejë, Kaçanik, Gilan Kumanovë e gjetkë, si na thonë njerëzit që vijnë andej, serbët, maqedonasit e malazezitë bashkë me gjermanët e çuan gjakun e shqiptarëve gjer në gju...

Biseda tani po zgjatej mbi një temë që për ne ishte e zorshme ta përballonim. Mundoheshim të zbatonim porositë që na ishin dhënë, herë pas here, e sidomos në mbledhjen e fundit të kuadrove për të sheshuar ndasitë e vjetra që diheshin sidomos midis shqiptarëve e serbëve. Po me ato që thoshte Baca na dilte e kundërtë e asaj që na kishin thënë të tjerë...

U përpoqëm ta qetësonim të zotin e shtëpisë, se çdo gjë do të rregullohej në mënyrë të drejtë pas këtej. Këto shqetësimë i jepnim me një sinqeritet naiv që na ishte ngulitur në kokë, sipas të cilës mund ta lidhni komunizmin me shovinizmin dhe as Partinë Komuniste Jugosllave me politikën shoviniste të qeverisë jugosllave. Pikërisht ky qëndrim kontradiktor që mbante udhëheqja e PKSH na kishte çoroditur së tepërmë aq sa, shpesh lidhur me marëdhëniet shqiptaro-jugosllave viheshim në dilemë: t'u besonim fjalëve të ëmbla që thuheshin zyrtarisht për barazi e drejtësi, apo faktëve të hidhura që hasnim përparrë çdo dite në të kundërtën e tyre?

Në ballafaqimin ndërmjet të kundërtave, me të cilat ndesheshim praktikisht, nisi të na lindte një farë dyshimi rrëth sinqeritetit të aleancës aq shumë të trumbetuar ndërmjet PKSH dhe PKJ. Shumë gjëra bluanim në kokë, por pa qenë të sigurt e pa marrë dot vendim të prerë qoftë edhe brenda vetyvet.

Në pozita delikate ramë edhe tani në bisedën me Bacën, megjithëse në një farë mënyre e kapërcyem bisedën e drejtpëdrejtë rrëth marëdhënieve shqiptaro-jugosllave në një plan tjetër me probleme anësore, më me pak rëndësi. Aty tha diçka edhe Hyria<sup>1</sup> pastaj ajo iu drejtua Bacës me pyetjen:

---

1) *Hyrie Çurre, dëshmore e Lufitës ANÇI*

- A mund të shikoj dhomën e grave?
- Me gjithë qejf- u përgjigj ai, duke u ngritur nga shilteja ku rinte- po të çoj unë.

Tërë atë natë zjarri nuk u shua. Llamba me vajguri po ashtu qëndroi e ndezur. Baca me të birin vazhduan deri në mëngjes të kryenin detyrën e sigurimit të miqve. Bënin roje me radhë pranë oborrit, çka se ne vetë kishim marrë masa si në luftë që ishim. Edhe shoqja jonë e skuadrës Hyrija atë natë, në gjirin e nënës e të motrave kosovare, e kish ndjerë veten si në shtëpinë e saj, te nënë Salihaja në Tragjas.

-Sapo hyra në dhomë tek ato- nisi të thotë Hyrija të nesërmen, u ngritën në këmbë dhe qëndruan ashtu duke më shikuar me një farë ndrojtjeje. Aty ishin gruaja e moshuar e Bacës, nusja e djalit të tij që kishte edhe dy fëmijë të vegjël dhe dy vajzat e Bacës të rritura, akoma të pamartuara. E para e theva “akullin” unë:

-Mirëse ju gjeta motra!

-Mirëse na ke ardhë!- u përgjigjën ato, pastaj m'u afroan e i përqafova me radhë. Asnjera prej tyre nuk dinte të shkruante apo të lexonte: më mbuluan me pyetje nga më të ndryshmet si për shembull: si kisha mundur unë që të dilja partizane, a kishte shumë vajza partizane në brigadë si unë, a dilnin vajzat lirisht në “Shqipnin e moçme”, a pyeteshin partizanet për burrin që u jepnin...e shumë të tjera.

- U mundova t'iu përgjigjesha pyetjeve të tyre edhe më gjerë se sa kërkonin ato edhe për luftën, edhe për çka i kishte dhënë lufta femrës: barazinë e saj me burrin edhe për ditën e saj të nesërme e të tjera. Ato veç dëgjonin me vëmendje të madhe dhe herë-herë pshëretinin si me vete: "Lumthi jul!", "Sa mirë!"... Gjatë gjithë natës nuk m'u bënë as tre orë gjumë, ngaqë më kishin vënë në mes e kërkonin t'u thosha diçka, nga njëherë edhe ndonjë përsëritje...

Koha e largimit erdhi. Të zotët e shtëpisë u vunë në lëvizje. Femrat e kishin zakon që të mos dukeshin përpara meshkujve që hynin e dilnin. Dhe ne sa ndenjëm gjer atëhere nuk pamë ndonjë grua aty; të gjitha shërbimet na i bëri djali i madhi i Bacës

---

1) *Hyrie Çurre, dëshmore e luftës ANÇ*

që gjendej vazhdimisht në këmbë. Ai për çdo gjë që duhej të serviste, komunikonte me dhomën e grave nëpërmjet një kamareje që e lidhte atë me dhomën e miqve. Po këtë "rregull" tani e prishi Hyria. Ajo kur do largoheshim atë mëngjes, i thirri për emër femrat e shtëpisë që t'u linte shëndetin. Ato u zunë ngushtë, sepse me Hyrien ishim edhe ne të tjerët si meshkuj. Nisën të vinin vërdallë nëpër dhomë sikur diçka iu kish humbur e nuk po e gjenin dot. Prisnin çdo thoshte i pari i familjes.

Dhe ne po shikonim Bacën se si do të vepronte në këtë situatë që iu rikrijua fare papritur. I vënë si në mes "dy të këqiave", pas një qëndrimi të menduar disa sekondash Baca vendosi ta shpalli vendimin me atë mënyrën e tij të thjeshtë, duke ngritur zërin: "Shka po bëni akoma moj gra, dilni t'i përcjellin bijtë e bijat tonë si na ka hije!" Fjala e tij s'u bë dy. Të gjithë anëtarët e familjes, u gjendën te porta për të na uruar: "Rrugë të mbarë e me fitore mbi armikun!"

-Bacë, a nuk do të ishte në nderin tonë që unë si më i ri t'i shoqnoja partizanët edhe ma larg se dera e oborrit tem? - foli për herë të parë i biri që gjer atëhere pothuajse nuk ia kishim dëgjuar mirë zërin. Pastaj e ktheu shikimin nga ne sikur të ishte në pritje të përgjigjes që duhej t'i jepej nga të dyja palët.

-Po...po ku je more trimi i Bacës? - tha i ati, duke i shqiptuar këto fjalë, pak si me të marrë goje e me sy që i shkëlqyen. Aty për aty i kërkoi vajzës së tij më të vogël t'i sillte pushkën, e mori atë, e shikoi me kujdes, i futi fishekun dhe deshi ta zbrazë një herë në ajër, por i tham se do qe mirë që të mos bënte alarm dhe ai e kuptoi. Pastaj ia zgjati të birit duke i thënë: Qe ku e ke, ashtë si top, lufto me nder bashkë me vllaznit e tu! - dhe e puthi djalin në ballë. Na u shtua kështu edhe një luftëtar i ri.

### ***Okupatori mbledh rraqet:***

Presioni në rritje i forcave partizane mbi qytetin e Prizrenit i detyroi gjermanët që ishin aty ta braktisnin atë sa më parë. Ky plan i tyre u kuptua qartë nga plasjet e minave që nisën të përdornin ata për të hedhur në erë depot dhe objektet e tjera me rëndësi ushtarake në qytet.

Dukej se më 16 nëntor kishin përfunduar edhe përgatitjet e fundit të garnizonit të Prizrenit për të provuar shtegdaljen nga qyteti, kur nisi në drejtëm të Kukësit një autokolonë zbuluese prej rrëth 7 automobilash, të shoqëruar me një autoblindë: Kjo forcë armike u prit në afërsi të fshatit Vllashnja nga bataioni ynë; iu shkaktuan dëme të konsiderueshme gjatë goditjes së befasishme që iu bë dhe u detyrua të kthehej përsëri prej nga pat ardhur.

Në pasdite, siç na njoftoi shtabi i brigadës, ishin paraqitur atje një grup oficerësh kuislingë<sup>1)</sup> të ardhur nga Prizreni, gjoja për "shërbime të mira". Ata kishin thënë edhe ndonjë fjalë për gjendjen e armikut në qytet, por ato nuk ishin të panjohura për shtabin partizan. Kuptohej që ata hallin e kishin për vete dhe për të gjithë ata që kishin ardhur gjer këtu së bashku me gjermanët. Tashti që aleati i tyre po e humbiste davanë ishin gati të dorëzoheshin me kusht që t'u garantohejjeta.

Përgjigja e komandës sonë qe: "Asnjë dorëzim me kusht!" Pastaj iu dha ultimatumi me paralajmërim se po të mos dorëzoheshin menjëherë e pa kushte, do të asgjësoheshin bashkë me pushtuesit gjermanë.

Gjatë natës duke u gdhirë 17 nëntori filloj sulmi i përgjithshëm mbi qytet. Ai vazhdoi gjer afër mëngjesit sa u vu i gjithë nën kontroll të një pjese forcash të brigadave të V dhe VIII të Ushtrisë NÇL Shqiptare dhe të partizanëve Kosovarë.

Fundi i autokolonës së madhe armike në tërheqje doli nga Prizreni. Autoblindat që prinin rrugën e autokolonës arritën te Ura mbi Bisticën e Prizrenit, pa u gdhirë mirë. Ato u lanë të kalojnë pa i ngacmuar në mënyrë që të ruhej befasitë përgatitjet e pjesës kryesore të makinave me ushtarë që pritej të mbërinte nga minuta në minutë. Dhe ja, pas ca u dukën makinat e para. Zjarri i menjëherëshëm i armëve që ishin vendosur në pritë, njëherazi edhe hedhja në erë e urës e detyruan autokolonën armike të qëndrojë.

Vargu i gjatë makinave që po ndaleshin njera pas tjetrës, formoi një mur të lartë para nesh. Ky "mur" tani nuk na lejonte të

---

1) *Kuisling-qe nofta me të cilën cilësoheshin individët dhe qeveritë që viheshin në shërbim të okupatorëve*

shikonim matanë xhadesë as me anë të fishekzjarreve meqenëse patëm ca të tillë dhe i përdorëm aty.

Lufta u ndez e furishme. Ne shtnim prej pozicioneve disi të tërhequra e të paramenduara kurse ata nga prapa makinave dhe kanaleve të xhadesë, ku kishte ndaluar autokolona.

Nga skuadra që hodhi urën në erë, dy vetë nuk u kthyen bashkë me të tjerët. Në këtë kohë ushtarët armiq bënин zjarr të dendur nga ana tjetër e urës.- Gjallë, vdekur shokët duhet të gjejmë dhe t'i tërheqim që të mos bien në dorë të armikut!- tha komandanti i kompanisë ku bënин pjesë edhe të dy partizanët.

Në kërkim të shokëve që mungonin u nisën dy partizanë që dualën vullnetarisht nga ata që gjer në fillim të luftimeve kishin qenë në pozicionë të afërta. Ata "fluturuan" përmes predhave armike dhe pas pak u kthyen në pozicionë tek shokët me gjithë ata që patën munguar, njeri prej çorientimit pas plasjes së minave që shkatërruan urën, ndërsa tjetri qe penguar nga plagët e lehta, që kishte marrë, po gjatë minimit të urës nga ana jonë.

Epërsia armike në forca të gjalla e mjete lufte, u dha mundësi atyre ta zëvendësojnë shpejt urën me ca pjese të gatshme që i kishin pasur me vete. Pas një ore lutimesh të ashpra e me humbje të ndjeshme në njerëz, ata e kaluan edhe pritën tonë. E kishin marrë parasysh ç'do dëm që pësonin. Pra me ç'do kusht të tërhiqeshin drejt Kukësit. Të plagosurit e të vrarët i hodhën me shpejtësi nëpër makina dhe i morën me vete. Për numrin e tyre nuk mundëm dot të bënë ndonjë llogari të saktë.

### ***Ustai i la shërbëtorët në baltë***

Edhe ditën që u çlirua Prizreni si zakonisht u bënë shumë komente rreth ecurisë së luftimeve. Qemë grumbulluar me një pjesë të forcave tona tek kazermat e qytetit dhe po bisedonim me një grup shokësh, kur më njoftuan se dikush më kërkonte.

-Ja, ata, atje- tha ai që më lajmëroi duke treguar me dorë dy veta që ishin jo shumë larg nesh. Ata, hap pas hapi, po më afroheshin. Kur erdhën aty, dalloj me habi ish togerin fashist S.M. Ishte bërë tebdil me rroba civile. Në kokë kish vënë një qeleshe

të bardhë kosovare; tjetri që i vinte pas dukej si "trim" i tij. Atë nuk e kisha parë ndonjëherë.

-Sa mirë që u takuam!- tha tjetri si me mirëdashje.

-I kam shpurë komandës së brigadës informata të vyera mbi mbrojtjen gjermane dhe forcat e tyre në qytet...shtoi ai duke u ndjer disi fajtor që kishte kaluar në radhët e okupatorëve të huaj.

- Rrugët tonë kanë qenë të kundërtë me njeri-tjetrin- iu përgjegja. Aty më erdhi ndërmend korriku i vitit 1942, kur megjithëse isha shumë më i vogël, se ai në moshë i patë thënë që të largohej nga shërbimi që po i bënte fashizmit italian e të bashkohej me lëvizjen NÇl. Më ishte përgjegjur: "Duhet ta shfrytëzojmë rastin që na është dhënë për të fituar sa më shumë... Të them edhe ty që të futesh në radhët e Partisë Fashiste..." propozoi ai atë kohë. Megjithatë u përbajtja, pa ia shfryrë tërë inatin që kisha meqenëse ai tanimë që dorëzuar e debati që pa vlerë me të. Gjithësesi u ndamë në mënyrë korrekte, pa e zgjatur. Ne e lamë të lirë atë me shumë shokë të tjerë po më pas mësuam se kur ai që kthyer në Shqipëri, që gjykuar dhe kish marrë dënimin më të rëndë nga ana e drejtësisë.

Disa nga rezultatet e para të luftimeve për çlirimin e Prizrenit ishin edhe kapja e forcave të shumta mercenare që i kalonin të 330 vetët. Ndërmjet tyre afro 200 ishin graduatë... Të vrarët ishin me dhjetëra po numri i saktë i tyre nuk u dha me që gjermanët ata të tyre i kishin hedhur nëpër makina dhe i kishin marrë me



Grup partizanësh të Brigadës së V S pas çlirimit të qytetit të Prizrenit

vete. Qenë lënë të shtrirë për tokë vetëm trupat e mercenarëve.

Në rrugicën ku kaluam, në të hyrë të qytetit na zunë sytë burra me veshje kombëtare që ishin karakteristike për krahine të ndryshme të Shqipërisë.- Këta janë nga ata që gjermanët nuk mundën t'i tërhiqnin më tej pas vetes së tyre...-sqaroi një vendas i moshuar në përgjigje të pyetjeve që iu bënë nga ana e jonë. Ai qëndronte te praku i një porte në anë të rrugës dhe shikonte partizanët që kalonin aty krenarë.

-Qenkan në ditë të hallit larot- tha njeri nga partizanët- po gjithnjë mbeten të rrezikshëm .

-Qentë e liq kur i le zoti pa ushqyer, hanë pulat e mëhallës dhe ç't'u dalë përpëra...

-Ilaçi më i mirë për t'i hequr qafe është gjyqi - ia përpoqi tjetri,në ecje e sipër.

-Pa fjalë!- u dëgjua urdhëri dhe vazhdoi ecja.

Populli në sheshin kryesor të qytetit kish nisur të mblidhej për të dëgjuar fjalën e rastit. Bashkë me të po grumbullohenët edhe një pjesë nga partizanët e brigadave të V-të e të XVIII-të të UNÇSH që kishin marrë pjesë në çlirimin e qytetit, si dhe shumë partizanë kosovarë që po ashtu kishin luftuar për çlirimin e Prizrenit.

Mitingu i asaj dite u kthye në një manifestim të fuqishëm gjëzimi. Në mes atij gjëzimi aty, nëpërmjet një hinke që u përdor si altoparlant u dha lajmi se po atë ditë ishte çliruar edhe qyteti i Pejës nga forcat e Brigadës së III-të S. bashkë me partizanët kosovarë. Gjithë Kosova e Rrafshi i Dukagjinit ushtonin nga krismat e pushkëve partizane.

### ***Qyteti që çlirohet pa luftë.***

Kishim vënë re me kohë se qëndrimi ynë në Kosovë shihej me simpati të veçantë, nga ana e popullit. Sjellja e të gjithë partizanëve tanë e kishin bërë atë për vete. Populli vetë ishte në gjendje të bënte dallimin ndërmjet nesh dhe armiqve të tij, të të gjitha ngjyrave.

Dorëzuam objektet që na ishin besuar në Prizren dhe u nisëm menjëherë për të çliruar Suharekën. Mëngjesi i 20 nëntorit na gjeti

të vendosur në pozicione zjarri përreth qytetit.

Aty opinioni ishte përgatitur nga ngjarjet e ditëve të fundit. Lajmet e çlirimt të Gjakovës, Pejës, Prizrenit e të zonave të tjera në Kosovë, e kishin ngritur shpirtërisht edhe popullin e Suharekës. Flitej hapur para hundës së xhandarëve të Xhafer Devës për ato ngjarje dhe për çlirimtarët e vërtetë.

Në kohën që ne ende nuk kishim hyrë në qytet, një grup të rinjsh dëgjoheshin nëpër rrugët e tij duke thirrur: "Rroftë Ushtria NÇl Shqiptare", Rroftë liria"!

Forcat e xhandarëve, që nuk ishin të pakta edhe këtu, qenë hutuar. Ata nuk ishin në gjendje të bënin ndonjë përçapje për të na kundërshtuar. Kjo situatë i detyroi krerët e administratës së Suharekës që t'i dorëzojnë komandës sonë simbolikisht "çelësat" e qytetit.

Partizanët marshuan nga anë të ndryshme drejt qytetit dhe nisen të merrnin në dorëzim forcat që ndodheshin aty. Rreshta të gjatë të formuara nga xhandarë dhe nga mercenarë u grumbulluan përparrë nënprefekturës. Aty edhe u çarmatosën. Kishin mundur të largoheshin apo të fshiheshin nga 10 prej tyre, ata që e ndjenin vete më përgjegjës për krimë e kishin frikë nga hakmarrja e popullit.

Kjo ditë për ne ishte e veçantë. Për herë të parë na takoi që të çlironim një qytet pa luftë me armë. Pastaj edhe diçka tjetër më me rëndësi: aty morëm lajmin e gëzueshiem që "Tirana u çlirua! I pari kryeqytet në Ballkan dhe i vetmi në Europë që u çlirua krejtësisht vetëm nga Ushtria Nacionalçlirimtare e nga populli i saj..."<sup>1)</sup> Ky lajm shërbeu për ne si një sihariq i ri që na u dha nga kryeqyteti i Atdheut. Lajmet rreth luftimeve që zhvilloheshin për çlirimin e tij ne i kishim ndjekur vazhdimisht e me preokupim që nga larg. Disa ditë më parë kishim mësuar me zemërim për një mizori të re naziste që u krye për shkak se u "...u vranë dy ushtarë gjermanë...iu vu zjarri një pjese të Tiranës dhe u pushkatuan 50 vetë që mbaheshin peng për hakmarrje..."<sup>1)</sup> Dhe ja, tani armiku i pagoi njëherësh të gjitha krimet e tij. Ky sihariq gëzoi njëloj si

-----  
1) Buletini i Luftës ANÇl nr.42, dt.19.XI.1944,sipas radio Barit që drejtohej nga forcat aleate anglo-amerikane

popullin e Suharekës edhe pjesëtarët e Ushtrisë NÇl Shqiptare që ndodheshin aty. I festuam së bashku të dyja fitoret.

### ***S'i u besobet jugosllavëve***

Më 24 nëntor, duke qenë grumbulluar në qytetin e Lipjanit, bëmë disa rregullime të reparteve. Kjo u ndie e nevojshme sidomos nga ardhja me shumicë e kosovarëve në radhët e reparteve tonas. Vetëm gjatë marshimit nga Prizrenit nëpërmjet Suharekës e Çernavelës gjer në Lipjan, efektivat tona u shtuan shumë, në disa kompani partizanët e rinj nga Kosova tanë po e kalonin në numër atë të partianëve të vjetër. Ky proces ishte gjithnjë në rritje. Më se 53000 djem e vajza të Kosovës u ngritën në këmbë dhe sidomos pas hyrjes së forcave tona aty, mbushën radhët e Ushtrisë NÇl Shqiptare dhe të atyre kosovare. Ata edhe pse qenë partizanë të rinj luftonin njëlloj si partizanët më të vjetër.

Krahas këtij vërvshimi të kosovarëve në rreshtat e Ushtrisë NÇl Shqiptare, vinin edhe fjalët e mira të komandantëve që i lavdëronin partizanët e rinj për disiplinë shembulllore dhe për akte guximi e trimërie në çdo përpjekje që kishin rënë me armikun. "Këta janë mjeshtër të pushkës"- thoshte në një raportim të tij komandanti i kompanisë IV Malo Tahiri, pas luftimeve tek Bistrica e Prizrenit. Gjithashtu një shoku im nga batalioni i V-të më shkruante ato ditë midis të tjerash"...shumë mirë luftojnë kosovarët, të gjithë këta të batalionit tonë janë njeri më trim se tjetri; po i preokupon diçka dhe na pyesin neve se si do të jetë fati i Kosovës nesër. Kur ne ju themi se atë do ta zgjidhni ju vetë, ata na thonë." Po qe për të zgjedhur ne do dimë ç'të zgjedhim..."

Në mbledhjen me komandat që bëheshin shpesh, krahas lëvdatave për kosovarët, theksohej se ata ishin trima të rrallë në fushën e betejës veçse nuk pranonin që të rreshtoheshin në njësitë partizane jugosllave. Për t'u radhitur në repartet tona ishin të gatshëm në çdo kohë. Shembuj të tillë kishim venë re kudo që

---

1) Bashkimi i kombit" fletushkë proqeveritare Nr.247, dt.28.10.1944

kishim kaluar. Në çdo rast të tillë ata ose zgjidhni reparte tona për të marrë pjesë, ose ato të krahinës së tyre siç ishin çetat "Zenel Ajdini", "Emin Duraku", "Bajram Curri", e të tjera, po fare rrallë në ato Jugosllave.

Pas dy ditësh, më 26 nëntor arritëm në Prishtinë. Edhe këtu qenë me dhjetëra ata që shprehën dëshirën për të hyrë në radhët tona partizane; një përshtypje të veçantë linte këmbëngulja e tyre për të ardhur pikërisht me ne, kur aty ndodhej qysh prej disa ditësh një njësi partizanësh jugosllave që kërkonte të kompletotohej e nuk po i shkonte njeri. Edhe puna jonë për t'i bindur të rinjtë e atjeshëm duke u thënë se ne po bënim të njëjtën luftë me jugosllavët, nuk pati shumë sukses.

Rastet e këtij lloji bënin të mendoje për ndjenjën e mosbesimit që shprehej midis shqiptarëve nga njera anë dhe serbo malazezëve e maqedonasve në anën tjetrër. Rrënjet e kësaj të keqeje mundoheshim t'i gjenim e t'i shpjegonim me historinë e së kaluarës, njëherë për njëherë, dhe jo tek e sotmja. Për t'i zhdukur mbresat e hidhura të së kaluarës i kishim vënë detyrë vetes të bënim një punë më të madhe propagandistike në mbështetje të miqësisë midis popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë. Kështu porositeshim vazhdimi shqiptarëve tanë dhe prej partisë që udhëhiqte luftën.

Këmbëngulja nga lart për të vepruar apriori, në kundërshtim me realitetin dhe ndjenjat e popullit nga poshtë, që bërë e mërzitshme për ne, sepse ndesheshim vazhdimi shqiptarëve tanë dhe prej kontradiktore në terrenin konkret.

Besimi i tepruar i udhëheqjes shqiptare në atë kohë karshi premtimeve të bujshme jugosllave na shtonte edhe frikën e zhgënjimit, sepse për premtimet e dhëna nuk jepej asnjë garanci nga faktorë të ndryshëm ndërkombëtare pikërisht prej atyre që e patën copëtuar vetë Shqipërinë prej motesh, duke lënë edhe Kosovën nën sundimin serb. Koha tregoi se intuita popullore, e bazuar në përvojat historike, doli më e saktë se sa prognozat jorealistë të kërëve fanatikë.

### *Në vend të armiqve-shokë e vëllezër*

Para se të shkelnim në zonën e Drenicës, nga goja e autoriteteve jugosllave, civile apo ushtarake, dëgjonim të njëjtin vlerësim për Drenicën: "një bazë e pushtuesve naziste, me qëndrim nationalist e shovinist..." e plot epitetet të tjera negative. Në bazë të këtyre të dhënave u morën masa serioze nga ana jonë që të mos binim në ndonjë grackë të përgatitur nga armiku. Në urdhërin që na u dha me këtë rast thuhej se "sipas informatave në zonën e Drenicës ndodhen fuqi armike prej 700 vetësh të gatshme për të goditur forcat tona; urdhëroheni...të rrëthohen e të shpartallohen me çdo kusht..."<sup>1)</sup>

Më 28 nëntor me një pjesë forcash mbërritëm në Kalla e pastaj Dulavec, Deçiqë, Krasolicë, Kroshnicë etj., ku qëndruam deri më 8 dhjetor. Por për çudi tonë gjithë ajo masë populli që gjetëm kudo e u takuam me ta, na u drejtuam me fjalët:"Ku jeni more vëllazën se na hëngri shkau të gjallë..." Këto qenë fjalët e para që dëgjuam edhe nga burrat e fshatit që kishin dalë e po na prisin në të hyrë në Kallas.

Në Dulavec u informuam se një pjesë e madhe e banorëve e kishte braktisur fshatin. Ata qenë larguar nga frika që kishin marrë prej keqtrajtimit të disa reparteve serbe e maqedonase. Këto reparte me uniformë partizane qenë futur në Kosovë nga Gryka e Kaçanikut dhe kishin kryer veprime të shëmtuara. Shumë veta ishin marrë natën nga shtëpia me grupe dhe ishin zhdukur pa lënë gjurmë. Një gjendje të ngjashme gjetëm edhe në fshatrat e tjera shqiptare.

Ankimet e shqiptarëve drejtoheshin jo vetëm karshi çetnikëve, siç thuhej nga ana e autoriteteve, po edhe karshi njësive të Ushtrisë NÇl, Jugosllave. Ato kishin marrë masa detyruese e persekutuese të pajustifikuara karshi popullit. Të gjitha këto në kalim e sipër, pa i studjuar fare dhe kundër të gjithëve pa bërë asnijë dallim.

E kishim parasysh veprimtarinë e reakisionit në Kosovë, sidomos para se të shkelnin forcat tona atje, po nuk mund ta fusnim të gjithë popullin në anë të armikut, as nuk mund të binim

---

1)AU Fon.Brig.V-S.kutia 1, dosja 6.

në kurthin e ambicjeve hakmarrëse nationale, nga cilado anë që të vinin. Me sjelljet dhe punën tonë përpinqeshim të sheshonim me çdo mënyrë hendeqet e vjetra armiqësore që kishin hapur regjimet e kaluara midis shqiptarëve dhe popullsive sllave të jugut.

Mendimet që kishim formuar më parë për zonën e Drenicës mbi bazën e "të dhënave" jugosllave, po na ktheheshin në të kundërtën e tyre. Banorët e atyre anëve ishin shumë të etur për liri e drejtësi. Ata na shoqeronin kudo me shprehjet mirënjoħe:- Ju na sollët lirinë e vërtetë dhe besimin se fati ynë ka me u zgjidhë drejt...-Ju po silleni me ne tamam si kena dëgjue për ushtrinë e popullit...-Ju na shpëtuat tue u ndalë dorën atyre që duen me na vra e me na shfarosë...

Logjika na e donte se sjelljet çnjerëzore këtu me banorët e pafajshëm do të ishin shkaktuar kryesisht nga elementë të caktuar dhe nuk kishin të bënin me politikën që ndiqte Partia Komuniste jugosllave karshi shqiptarëve. Për t'i diferencuar dhe për t'i izoluar këta elementë udhëzoheshim: "Të ruhemti të mos biem në pozitat e disa njerëzve (ekstremistë-M.Xh.) pasi në zonat ku jemi...shovinizmi është shumë i zhvilluar, aq sa ka arritur edhe në krimë!"

Gjatë 10 ditëve që qëndruam në zonën e Drenicës takuam kudo shokë e vëllezër. Ata jo vetëm që na priten si çlirimtare, po u treguan edhe të gatshëm që të luftonin së bashku me ne. Më 3 dhjetor, në nënrepartin që ndodhej në Dulavec u regjistruan 6 partizane të rinj nga ky fshat, një ditë më vonë, në kompaninë që ndodhej në Krasolicë u regjistruan 4 të tjera: po kështu ndodhi në kompaninë e IV që u regjistruan 7 luftëtarë. Edhe lajmet që na vinin përditë nga shtabi i brigadës tregonin se e njëjtë gjë vihej re në të gjitha rajonet ku vepronin batalionet e brigadës sonë...

### ***Hendek në thellim***

Në ato ditë na bëri veçanërisht përshtypje përpjekja në masë

---

1) AU, Fon.brigadës V-S, kutia 1, dosja 7

e kosovarëve që ndodheshin në njësi të përbashkëta partizane me serbët e malazezët, për t'u larguar nga këto njësi dhe për t'u bashkuar me formacionet tona. Më 6 dhjetor në Deçic, ku që shtabi i batalionit u paraqitën një grup prej 12 kosovarësh që ishin larguar nga forcat e Kosmetit dhe kërkonin të pranoheshin në radhët tona. Pse veproni kështu?- i pyetëm. "U bashkuem me ata në bazë të fjalës se po bënim luftë të drejtë, po ajo që pamë në Gradicë me sytë tanë, na bindi se kena qenë gabim. Shkatë që ishin me Mihajloviçin<sup>1)</sup> e dinin dhe ikën nëpër pyjet e Gllana-Sellos, po kot u trembën se ata nuk i kërkoi kush. Shqiptarët që ishin krejt të pafajshëm u torturuan e u trajtuan keqas. Vajtja e repartit tonë në Gradicë shërbeu vetëm për të terrorizuar banorët shqiptarë të atij fshati dhe për asgjë tjetër..."

Më 7 dhjetor në kompaninë që ndodhej në Koshinicë erdhën edhe 9 shqiptarë të tjera nga Kosova e kërkuan të pranoheshin aty. Komandanti i kompanisë u thotë:-Ju quheni dezertorë, s'kemi urdhër të pranojmë të tillë...Ata njëherësh përgjigjen- Në qoftë se ju nuk kini urdhër me na pranue, duhet ta kërkoni këtë urdhër...Na te serbët nuk mund të kthehem ma...Ata edhe dje pushkatuan dy shokë tanët fare kot, se gjoja kishin dashur me dizertue. Po edhe në familjet tona nuk kena me u kthyse e dimë ç'na pret...

Fakte si këto që përmendëm qenë të shumta e gati të përditshme saqë nuk mund të përshkruhen të gjitha. Këto nga njera anë na bënin të mendonim se kosovarët kishin të drejtë në pretendimet e tyre, kurse politika zyrtare që na servirej nga ana e të dy shteteve "aleate" karshi kësaj situate qe krejt tjetër, duke na vënë nën një presion që nuk na lejonte hapësirë veprimi.

Lajmet për braktisje të formacioneve jugosllave nga ana shqiptare që na vinin edhe nga batalionet e tjera të brigadës, na e forcuan edhe më tepër bindjen se kosovarët duheshin besuar për ato që thoshin. Të prirë nga kjo bindje ndryshoi shumë edhe qëndrimi ynë karshi tyre, i cili vihej re në të gjitha nënrepartet e brigadës përfshi edhe veprimtarinë e komandantëve e të

---

1) Drazha Mihajloviç, kreu i reaksionit jugosllav kundër lëvizjes NÇI etj.

komisarëve. Ky qe i vetmi aspekt i veprimitarisë sonë luftarake në Kosovë, në të cilin ne i lejonim vetes shmangie nga rekomandimet apo urdhërat e qendrës. Ato u përshtateshin kryesisht arsyetimeve dhe bindjeve tona të formuara në terren e jo direktivave nga lart.

Pretendimet e vëllezërve tanë atje ndaj jugosllavëve qenë të drejta, me këto përshtypje u larguam edhe nga Drenica për të vazhduar shtegtimin drejt betejave të reja në ndjekje të pushtuesve nazistë.

## **NGA VITI 1944-1945**

### **VII. NË NDIHMË TË POPUJVE TË JUGOSLLAVISË**

*Akte të larta guximi e trimërie gjatë ndjekjes së pushtuesve nazistë . spastrimi i zonave të gjëra nga cetnikët e Mihajloviçit . mirënjojje për misionin tonë nga popujt e atjeshëm*

#### ***Një baba që kërkon djalin***

Më 11 dhjetor u nisëm nga qyteti i Mitrovicës për në tokat jugosllave e në thellësi të tyre. Kalimi në këto anë që do të bëhej nëpër një terren të thyer malor e me klimë të ftohtë, nuk do të ishte i lehtë për ne. Ishim të veshur lehtë e të mbathur keq. Këto vështirësi partizanët i kishin provuar vazhdimit dhe ishim të përgatitur jo vetëm shpirtërisht po edhe fizikisht për sakrifica të tilla.

Në atë mëngjes të ftohtë dhjetori, njerëzit e radhitur gjatë gjithë rrugës për dalje nga qyteti zgjatnin duart, tundnin flamurin tonë kuq e zi me buzëqeshje e dashamirësi. Tek shumë prej tyre dallohen në edhe lotë mallëngjimi që u rridhnin nëpër faqe. Herë-herë dikush shkëputet nga turma, i afrohej ndonjë partizani në kalim, i jepte atij dorën, i uronte fitore të reja...ndonjë send për kutjim....e shoqëronte disa hapa në ecje dhe përqafohej e mezi shkëputet.

Ecja afér kreut tē kolonës më tē dalë tē qytetit, ndërmjet atyre që na përcilllnin dallova një burrë tē moshuar me flokë tē thinjura, i veshur si për festë me rrobe kombëtare. Ai nuk fliste si tē tjerët, vetëm shikone. Dukej i humbur në shikimin e tij tē thellë, sikur dikë po kërkonte midis atyre që po kalonin aty përpara tij. Pastaj m'i nguli sytë mua; dhe unë e përshëndeta duke ngritur dorën lart. Ai nuk iu përgjegj shenjës sime siç bënин tē tjerët po më kish ngulur sytë e s'po m'i hiqte sikur tē kish frikë se mos i humbisja. Në çastin që arrita paralel me tē, bëri dy hapa përpara dhe më zuri për krahu me tē dyja duart sikur donte tē mbahej. Sapo ndeshi në shikimin tim miqësor, nxitoi tē thotë:

-Më ngjan tamam si ai, si djali em, është prej kohësh partizan në brigadën e Kosmetit, po kena shumë kohë pa e pa. Në shtëpi na ka marrë malli tē gjithëve për tē. Kur tē pashë ty m'u duk sikur pashë vet atë, mendova se po çmallem diçka... Mos u besdis nga unë plaku... Më hodhi duart në qafë dhe më puthi në ballë disa herë shumë i emocionuar, kjo dukej nga dridhjet e lehta tē trupit dhe nga fjalët që mezi i thoshte.

-Nuk besdizem se edhe unë kam baba që mallohet për djalin e tij, ti je prind i një partizani si unë, pra je baba edhe për mua, ashtu siç jam edhe unë djali yt... Ndërkohë u tërroqa pak në anë tē rrugës për t'u liruar kalimin tē tjerëve.

-Po besa- mundi tē thotë ai vetëm me buzë, pa zë. Më kapi përsëri për qafe e më shtrëngoi fort për disa sekonda tē tjera, pastaj shtoi:- Të ishte edhe djali jem me ju nuk do tē më vinte keq. Le tē vritej se luftën trimat e bëjnë, po-o...

-Ti babë mos u bëj merak se ne do tē fitojmë e do tē kthehemë në shtëpi bashkë me lirinë,- sakaq bëra tē ndahesha.

-Ashtu qoftë, po na, prit pak! atë kohë hoqi nga prapa brezit, ku e kish lidhur, një shami, me sende dhe ma zgjati ta merrija.

-Faleminderit për gjithshka, ne nuk mbetemi keq, prandaj mbajti këto për vete se jeni dëmtuar nga lufta, quaje njësoj sikur m'i dhe mua... - u mundova ta bindja.

-Prapa s'po i marr më kurrë këto pak gjana: do t'ia kisha dhanë djalit tem po tē kish ardhë, tashti do i marrësh ti medoemos, njësoj jeni ju, a nuk the vetë se edhe ti je djali jem?

Në këtë “duel” të vogël ai doli fitues. Nga cepi i shamisë shihej një kuaç gruri, një copë e madhe djathi dhe një triko leshi. Me t'u ndarë nga ky babë që sapo e njoha, jetova çaste të tëra përmallimi, ishte ky një përmallim i veçantë për të gjithë ata njerëz, për Kosovën që na kish pritur e po na përcillte me aq dashuri, për gjithë Shqipërinë tonë që sapo kish nisur të shijonte ditët e para të lirisë. Atë ditë më kish rënë në dorë edhe një kopje e Buletinit “Mundimi”. Aty midis të tjerash thuhej: ”Partizanët

shqiptarë shpëtojnë disa ushtarë anglezë<sup>1)</sup> dhe jepeshin hollësi se si më 22 shtator kur anglezët ishin përpjekur të zbarkonin në Spile të Himarës me një grupim ushtarësh, qenë rrezikuar nga më se 250 gjermanë që i kishin rrethuar. Partizanët e Brigadave të XIV e të XII e diktuan forcën armike, e sulmuani dhe e shpartalluan atë duke vrarë 80 prej tyre dhe duke zënë 50 robër e pajisje të ndryshme



Drejt betejash të reja në thellësi të tokave jugosllave

luftarake.

“Edhe anglezët presin ndihmë nga ne, me gjithë forcën e madhe që disponojnë, në vend që ata të na ndihmonin- mendova me vete, duke lexuar buletinin, ndërkohë po ecja bashkë me kolonën partizane që vazhdonte marshimin përpara drejt zonave malore e të egra të Sanxhakut, të cilat ngjanin si të shtruara me qilima të bardhë nga dëbora që i kishte mbuluar.

1)Buletini “Mundimi”, nr.33, datë 9 nëntor 1944

## *Akte të larta guximi, gjer në vetmobim*

Kishim udhëtuar nëpërmjet qendrave të banuara Novi-Pazar, Doljana, Resno e Duke nëpër një terren tepër të thyer dhe herëherë të pyllëzuar e të mbuluar me dëborë. Ushqimin bazë si rregull e përbënин 4-5 kokrra patate të ziera në vakt. Rreth 70 partizane i kishim fare pa kapota ndërsa përmbi 30 të tjerë nuk kishin as këpucë e u qenë çarë këmbët nga dëbora e ngrirë.

Në mbrëmjen e 19 dhjetorit sa mbëritëm në destinacion u detyruam të marrin në dorëzim sektorin e luftimit në vendin e quajtur Noshevicë prej një reparti jugosllav të Divisionit të 37-të. Aty na thanë se ky formacion kish mbi 20 ditë që rrinte në këto pozicione, pa bërë ndonjë ndeshje serioze me armikun me pretekstin se gjermani ishte i fshehur thellë nëpër transhe, kishte pozicione zjarri të përgatitura me kohë, sasira të shumta municioni për qëndresë dhe ushqime për një kohë të gjatë e nuk mund të shkulej me që partizanët nuk i kishin këto!...

Ky arsyetim i komandës jugosllave nuk na u duk bindës, ai qe absurd sepse ne vetë nuk kishim pritur asnjëherë që armiku të delte vullnetarisht nga transhetë. Ai ishte nxjerrë andej vetëm me forcën e armëve...Edhe nga ato rezervat e tjera nuk kishim pasur, çdo gjë ia kishim marrë armikut me luftë. Nuk qe i arsyeshëm as fakti i zëvendësimit të një reparti që ka ndenjur 20 ditë në transhe pa bërë asgjë, nga një tjetër siç ishim ne, që sapo mbaruam operacionet në Kosovë, kishim bërë edhe ditë rrugë nëpër zona të vështira. Megjithatë pozicionet i pranuam pa u thënë gjë të tjerëve. Sedra burrërore s'na lejonte të vepronim ndryshe.

Atë natë, gjatë vendosjes në pozicione, një nënrepart yni e kaloi vijën e caktuar për të. Ai në njerin krah gabimisht shkoi një 50 metra më tutje dhe hipi mbi ushtarët gjermanë. Ata reaguan dhe i vunë në mes të dy zjarreve shokët tanë. U bë e domosdoshme të hidhnik në sulm pjesën tjetër të forcave që ta shpëtonim nënrepartin që ra në rrezik. Sulmet e kundërsulmet nga të dyja palët vazhduan tërë natën, rreth kodrave të mbuluara me dëborë.

Kushitet ishin fare të pabarabarta në çdo drejtim. Ne nuk kishim mbushur as barkun me bukë, ndërsa gjermanët, kur u arrit në

luftim trup me trup, jo vetëm që qenë të armatosur më së miri, të çlodhur e të ngopur, po qelbeshin edhe alkool saqë dhe nga sytë nuk shihnin, ecnin përpëra duke shkelur me mospërfillje mbi trupat e shokëve të tyre që shtriheshin për tokë nga goditjet tonë.

Episodet e trimërisë nga ana e luftëtarëve tanë në këto momente përsëriteshin nga minuta në minutë."Partizanit tonë Mete Rakipi kur iu mbaruan fishekët, iu hodh një nazisti përsipër dhe ia rrëmbeu gjerdanin duke thënë:"Ky më duhet mua". Atëherë tjetri u tmerrua dhe llomotiti diçka që nuk u muar vesh as nga Metja as nga shokët e tjerë që u ndodhën afér tij. Në atë hutim e sipër Metja ia rrëmbeu atij edhe pushkën nga dora, e shtriu përdhë, armikun pa u tronditut aspak nga plumbat që i vërvshëllën përqark e ia bënë rrobat gjithë vrima."

Ndaj të gdhirë u detyruam të tërhiqeshim rrëth 500 m, në pozicione të reja. Mëngjesi na zuri në fund të një kodre që ishte krejtësisht e mbuluar me dëborë dhe pjesërisht e pyllëzuar. Koha ishte e thatë, gjatë ditës retë që "bridhnin" nëpër quell duke lëvizur nga veriu për në drejtim të jugut, e lironin diellin herë pas here po rrezete tij nuk kishin fuqi ngrohjeje.

Në majë të kodrës e gjatë kurrizit që zgjatej nga e majta e saj shiheshin ushtarët armiq. Ata ecnin të shkujdesur duke mbledhur kufomat e shokëve të tyre të vrarë gjatë natës. Ora shënonë 10.00 kur përgatitja nga ana jonë për t'i kundërsulmuar kishte mbaruar. Filluam lëvizjen e tänëve nëpër shkurret me pisha që mbulonin pllajën. Mundëm të ecnim të maskuar deri afér majës së kodrës. Krahu ynë i majtë filloj përsëri kundërsulmin mbi gjermanët. Ata ishin vendosur në pozita provizore me ballë nga ne dhe u munduan ta ndalnin vrullin e kundërsulmit partizan, po qe e pamundur: nga ana jonë u hodhën në kundësulm edhe dy nënpreparte të tjera.

Qysh në çastet e para të kundërsulmit tonë nazistët gjermanë, bashkë me çetnikët e Mihajloviçit filluan të zmbrapsen. Pas 30-40 minutave u vunë në ikje të plotë drejt Miloshev-dolit.

Në këto luftime armikut iu shkaktuan humbje të ndjeshme, të

---

I) AU, Fom.Brig.V.S.Buletini i Div.V.dt. I.2.1945

vrarët në anën e tij u llogaritën mbi 20, përvèç shumë të plagosurve. Të gjitha trupat e atyre që mbetën në fushën e luftimit, binin erë verë dhe paguret e tyre, që i kishin hedhur në tèrheqje e sipër, ishin po ashtu me verë.



Grup shoqesh partizane të Brigadës së V S në Sanxhak

Midis 7 të vrarëve që mbetën nga ana jonë ishte edhe Hyrie Curre. Ajo u plagos rëndë qysh në kundërsulmin që bënë nazistët natën. U tèrroq në rregull nga shokët dhe u mijekua, po kish humbur shumë gjak dhe pas 10 orësh vdiq me fjalën në gojë: "S'më vjen keq që vdes se e di që do ma merrni hakun, përparrë vëllezëri!"

Ndër të plagosurit mbeti si shembull i paharruar guximi e gjakftohtësie, akti i partizanit Ali Zyberi. Ai nga një plagë që kish marrë në gju, gjatë tèrheqjes sonë të mbrëmjes, kishte mbetur në vend. Kur nazistët e çetnikët e vunë nën kontrollin e tyre atë rajon me anë të kundërsulmit që bënë natën, Aliu u shti si i vdekur. Nuk mund të bënte dot asnje veprim tjetër. Njeri nga çetnikët që e pa i pari iu turr me thikë në dorë për t'i prerë gishtin e t'i hiqte

unazën që ia kish diktuar me anë të një elektriku dore; çetniku tjetër që u ndodh më i shkathët, shpejtoi ta merrte për vete atë, duke provuar t'ia hiqte unazën me dorë me që nuk kish thikë. Me tërhejen e parë unaza doli pa vështirësi. Partizanit i shpëtoi gishti pa iu prerë. Po Ailu pas pak i ndodhi më keq akoma. Një ushtar gjerman që luftonte me një mitraloz sharrës, duke kaluar pranë tij e duke menduar se ky ishte i vdekur, vendosi mitralozin mbi zverkun e Aliut dhe filloi të shjterë me të papushim. Nga nxehja e armës Aliut nisi t'i digjej edhe zverku.

Partizanit iu desh të duronte me shpresën se shokët do të kthehen në përsëri. "E dija që do të më gjenit..." - mundi të shqiptojë ai midis atyre pak fjalëve që tha kur u gjet nga ne, me ndjenja gjysëm të humbura"<sup>1)</sup>

### *Urdhëri i papritur*

Kishim përparuar gjer tej Kolin-Brodit dhe po merreshim me spastrimin e zonës në lindje të Prilejit nga mbeturat e drazhistëve që qenë hallakatur atyre anëve, pas tërheqjes së gjermanëve. Ishte 13 janar 1945, pasdite kur papritmas vjen urdhëri: të ndërprisnim veprimet e mëtejshme në thellësi të tokës jugosllave dhe të qëndronim në vend deri sa të vinin urdhëra të reja. Më tej asnjë sqarim.

Qemë nisur e përgatitur shpirtërisht që ta vazhdonim ndjekjen e armikut deri në asgjësimin e tij të plotë. Vështirësitë kryesore ishin kaluar, tanë në prag të fitores përfundimtare na u tha "Ndali!" Diçka duhej të kishte ndodhur. Për t'i qetësuar partizanët- njëherë për njëherë-kërkua edhe ndonjë shpjegim tjetër nga shtabi e pror. Përgjigja që morëm, ishte se urdhëri kish ardhur nga shtabi i lartë i Ushtrisë Jugosllave. Të vërtetën e plotë nuk do ta mësonim as më vonë, kur të kthehen në Kosovë përsëri. Pyetja logjike që na mundonte qe: Ç'punë kishim ne me shtabin e lartë jugosllav, kur kishim shtabin tonë? Po qe se ai na kishte drejtuar me të vërtetë gjer tanë ashtu siç na ishte thënë, pse duhej të prisnim përgjigje nga jugosllavët për një problem kaq shqetësues.

1) AU.Fon.Brigada V.S.Buletini i Div.V.dt.1.2.1945

Më pas do të konstatonim fakte shumë tronditëse, apo kishin kaluar forcat tona tej kufijve të Kosovës, në ndjekje të nazistëve, në thellësi të Jugosllavisë, njësitë e Ushtrisë NÇl të Jugosllavisë qenë vërsulur si bisha të tërbuara kundër popullit kosovar e të trojeve të tjera shqiptare në Jugosllavi për të shuar me gjk e terror çdo kërkesë legjitime të tij.

Përsëri më pas pyetjet: mos rikthimi i trupave tona në Kosovë kishte lidhje me këto ngjarje për t'i detyruar vëllezërit tanë që të rrinin urtë? Mos qe ky ndonjë komplot për t'i përdorur shqiptarët kundër shqiptarëve si xhandrë? Po të vërtetohej kjo mundësi, a nuk do të ishte një fyerje për të gjithë ushtrinë tonë NÇl si dhe për tërë kombin? Por asnjë nga këto pyetje nuk na i sqaroi dot njeri.

Vazhdonte ndërkohë të dëgjohej në mënyrë frenetike pyetja kyçë që bënин shqiptarët e trojeve tona matanë kufirit, sidomos ata që ishin inkuadruar në formacionet tona, po edhe qytetarët e tjerë! A do të na lejojnë Titua & Enveri që edhe ne të mbetemi përgjithmonë me Shqipërinë?... Krahas përgjigjes sotë se "pas luftë jeni ju ata që do të vendosni për fatin tuaj", qarkullonte edhe një zë, sipas të cilit, me qenë se Jugosllavia ndodhej në një stad zhvillimi më të lartë se Shqipëria, Kosova dhe trojet e tjera shqiptare në Jugosllavi duhej të mbeteshin në kuadrin e kësaj të fundit, përrndryshe këto troje do të bënин një hap prapa! Thuhej dhe se shprehës i këtyre tezave qe Koci Xoxe, ish sekretar organizativ i PKSH.

Këto lloj ngacmimesh ngjanin si përpjekje për të na mpirë vetëdijen kombëtare me frazologji të dyshimta dhe për të përligjur statukuonë ekzistuese etj. Ndërkohë vlen të theksohet se gjatë Luftës, sidomos në prag të mbarimit të saj, prej fuqive të mëdha aleate u fol shumë për kufijtë e Polonisë si dhe për kufijtë e Jugosllavisë me Italinë. Por fatkeqësisht nuk u tha asnjë fjalë e vetme për kufijtë e sakatuara keqas të Shqipërisë prej atyre vetë, apo për Kosovën posaçërisht<sup>1)</sup> As vetë ne shqiptarët nuk bëmë sa duhet në këtë drejtim.

---

1) Nga letërkëmbimi Stalin-Çerçill-Truman, vell 1, f.352, 359, dhe 363, 378 etj. botim rus

Propaganda joshiëse që vazhdonte të zhvillohej nga të dy krahët me ato termat bajate të “miqësisë” na kishte çorientuar aq shumë, saqë vetëm kur të riktheheshim në tokën kosovare e të shihnim aty gjendjen reale do të na binte ndërmend se izolimi ynë në Sanxhak duhej të kishte qenë i qëllimshëm, për t'u lejuar serbosllavëve duart të lira në veprimet e tyre terrorizuese që po kryenin atje, për të na shkëputur nga bota shqiptare dhe nga ngjarjet e tjera që zhvilloheshin përreth.

Duhet të kthehem me mendje ca prapa, t'i shpjegojmë ngjarjet kronologjikisht për të kuptuar pozitën prej polici të thjeshtë, në të cilën tanimë ishim vënë.

Një batalion yni u tërhoq ca më papa nga pjesa tjetër e brigadës, me përqendrim pikërisht në sektorin midis Miloshev-Dolit dhe Senicës. Aty përfshiheshin qendrat e banuara Halinovice, Noshevicë dhe Krashevë. Popullsia e këtushme kish vuajtur shumë nga armiku. Ajo qe e gatshme të na ndihmonte: na sillte vazhdimisht informata sidomos mbi vendndodhjen dhe lëvizjet e mercenarëve të Drazho Mihajloviçit etj.

Çetnikët synonin që të na godisnin jo ballë për ballë, po nga prapa krahëve. Përgjonin rastin dhe ja, më 17 janar në imbrëmje një grup çetnikësh që sorrollateshin atyre anëve si zotër të vendit sulmoi skuadrën roje të nënrepartit që gjendej rrëth një kilometër në jug të Miloshev-Dolit. Skuadra mundi ta përballojë me sukses sulmin armik deri sa mbërriti aty dhe pjesa tjetër e nënrepartit që i detyroi çetnikët të tërhiqeshin në drejtimin e lindje-juglindjes.

Lajmi mbi përpjekjen u përhap me shpejtësi në të gjitha nënrepartet e batalioni. Me atë shpejtësi që ishin mësuar të vepronin partizanët, nuk na u desh kohë që të viheshim në gatishmëri për luftim. Vendet u zunë menjëherë. Krismat e pushkëve të gjithë nënrepartit që tanimë ishte vënë në ndjekje të drazhistëve vazhdonin të ndiheshin ende megjithëse më rrallë, ndërsa nata me hijen e saj të zezë kishte mbuluar gjithshka. Zhurma e këpucëve që çanin dëborën gjysmë të ngrirë nëpër luginë, u dha mundësi dy skuadrave të nënrepartit tjetër që ishin të vendosur aty, t'i diktonin çetnikët e t'u hapnin zjarr. Armiqtë u vunë mes dy goditjeve, po ata qenë njoħes tē mirë të vendit dhe

mundoheshin të rrëshqisnin. Thirrjeve për të hedhur armët në fillim iu përgjigjën me të shtëna. Pastaj rrallë e më rrallë sa nuk po ndiheshin më.

U vendos rrithimi i një territori prej rrëthi 4 km katrore dhe u mbajt ashtu tërë natën. Në mëngjes herët të 18 janarit filloj kontrolli i zonës për ta spastruar atë nga çetnikët, ata duhej të ishin fshehur diku aty. Besnonim se kishin rënë në grackë e nuk do të mund të dilte asnjeri prej andej. Po edhe ata nuk i kishin humbur shpresat për të shpëtuar. Përpinqeshin të merrnin arratinë fshehurazi. Komandanti i tyre, një farë Petrovici, i ndilimuar deri diku edhe nga mugëtira e mëngjesit, me një grup prej 5 vetash bëri të çante rrithimin duke lënë pjesën tjetër të bandës prapa. Në minutën e fundit, kur ndoshta mendonte se i kish shpëtuar rrezikut, pushkët partizane që vigjelonin më tej i shtrinë për tokë dy nga shoqëruesit e tij në ikje e sipër. Petroviçi vetë i tretë, mundi të shpëtonte. Çetnikët e tjerë që ishin brenda “unazës” së rrithimit kur e panë se nuk kishin rrugëdalje tjetër, u dorëzuan.

Gjithë përpjekja përfundoi me asgjësimin e 5 çetnikëve e kapjen e 17 të tjerëve. Kishim urdhër që në çdo rast çetnikët e kapur t'ua dorëzonim autoriteteve jugosllave për t'i gjykuar. Edhe të 17 robërit e kapur këtë herë ia dorëzuan menjëherë komandës së vendit në Senicë.

Në ato ditë edhe një batalion i Brigadës së III-të S, qe gjithashtu bënte pjesë bashkë me ne në Div. e V-të S. të UNSH kishte kapur 15 drazhistë me gjithë komandantin e tyre. Këta i kishin bërë pritë një grupi të sëmurësh jugosllavë nga tifua që po shoqëroheshin për nënë Senicë. Dy nga partizanët e sëmurë kishin mbetur të vrarë gjatë përpjekjes me çetnikët.

Kur luftotonim kundër reaksionit vendas në Sanxhak, u informuam se Ushtria NÇL Jugosllave atje kishte pasur baza të saj. Aty na lindi paqartësia se si kishte qenë e mundur që këta banditë kishin arritur të organizoheshin e të vepronin aq guximshëm në territore të tilla që paskeshin qenë edhe baza të Luftës Antifashsite? Pas gjithë këtyre dhei shumë fakteve të tjera si këto kish lindur interesit të dinim se ç'po bëhej me këta armiq të betuar kur binin në duar të drejtësisë. Cili qe dënim i që merrnin këta kriminelë të neveritshëm?

## *"Gjyqi" i kriminelëve*

Kishim dëgjuar për gjyqe të ndryshme që zhvilloheshin kundër pjesëmarrësve të bandave të Drazho Mihajloviçit, po zhvillimi i tyre konkret nuk dihej. Për të plotësuar këtë boshllék të përfytyrimit tonë na ndihmoi gjykimi që u zhvillua në sallën e shkollës së Senicës kundër 15 drazhistëve që ishin kapur nga partizanët e Brigadës së III-të S, të divisionit tonë disa ditë më parë. Shpallja që u bë për këtë gjyq thoshte se ai do të ishte i hapur. Pra nuk e patëm të zorshme për të hyrë në sallë edhe ne një grup ushtarakësh shqiptarë.

Trupi gjykues përbëhej prej 5 vetash -komandanti i vendit që e kryesoi seancën, një funksionar partie dhe tre përfaqësues nga organizatat e masave shoqërore (dy nga këto ishin gra). Në fillim të seancës, kryetarit të bandës, një farë Markoviçi, iu bënë shumë akuza për bashkëpunim me pushtuesit e për krime të tjera që të rrënqethnin mishtë...Krimineli nuk e prishi shumë gjakun. Ai dha ca përgjigje të thata e të shkurtëra sikur nuk donte të dinte për grupin gjykues. Ndërmjet të tjerash deklaroi: "Kam qenë i detyruar nga rrethanat:" ose "kjo është shpifje", "Kjo nuk është e vërtetë", "le të përgjigjen ata që thonë"...Me një fjalë as ai nuk mori ndonjë gjë konkrete përsipër dhe as trupi gjykues nuk u mundua për t'ia lënë mbi kurri krimet që kishte bërë. Bile as për vrasjen e dy partizanëve të sëmurë ditën që u kap banda nuk iu kërkuan hollësira të mjafueshme.

Përafërsisht kështu u veprua edhe me të tjerët e si përfundim ky lloj "gjykimi" përfundoi me dënimin me heqje lirie që morën dy çetnikë të thjeshtë, 13 të tjerët së bashku me kryetarin e tyre morën vetëm masa të ndryshme "morale" si "këshillim", "vërejtje për herë të fundit", "paralajmërim"...dhe u lanë të lirë!

Duke dalë nga seanca përfundimtare e gjyqit u ndez një diskutim i gjallë midis nesh që qemë aty. Secili kishte vërejtje rreth gjykimit dhe vendimeve që u morën. Mendimi ynë i përgjithshëm ishte se edhe vetë Drazha Mihajloviçi t'i kishte gjykuar ithtarët e tij, më zemërgjerë se kaq nuk do të ishte treguar.

-Mbase drazhistët e këtushëm janë më të ndershëm se ç'ishin

ballistët tanë atje- tha njeri nga shokët, pastaj vazhdoi- unë pashë edhe të 20 drazhistët që zuri batalioni i II-të në Pribojë e i dorëzoi në komandën e vendit të atjeshëm, po ata nuk bënë as 24 orë burg dhe u lanë të lirë se paskeshin qenë të gabuar e kishin dhënë “fjalën e nderit” për të mos bërë më gjëra të këqija!

-Ne rrezikojmë kokën për kapjen e çetnikëve, ndërsa ata që duhet t'i gjykojnë tregohen zemërgjerë që të mos prishin miqësinë e vjetër me ta- turfulloj Xhebrua<sup>1)</sup>, siç e kishte zakon.

-Edhe ne nuk i kemi pushkatuar ballistët në radhë kur i kemi zënë. Tjetër është puna e Markoviçit që u gjykua sot, ai ndoshta duhej dënuar edhe me pushkatim. Megjithatë nuk na i heq njeri të drejtën që këto gjëra t'ia themi komandës sonë, ajo le të gjykojë, tha komisari si për ta mbyllur këtë lloj diskutimi.

Faktet që shihnim e jetonim përditë, na krijonin një farë paqartësie se si elementët revolucionarë të trumpetuar aq shumë nga jugosllavët në vendin e tyre, po humbisnin në kënetën e madhe të dyshimeve. Ujërat e ndotura të kësaj “kënete”, siç do të provohej më vonë, ushqenin papushtim dhe nxirrnin në skenë parazitë të rinj.

### ***Mirënjobje ndaj nesh nga populli i atjeshëm***

Luftëtarët e gjithë njësive shqiptarë që vepronin ende në Jugosllavi ishin të ndërgjegjshëm se veprimet e divizioneve tonë atje, përvëç rolit të tyre si çlirimtarë, kishin shpurë edhe mesazhin e miqësisë. Këtë mesazh ia kish dërguar një popull i vogël si yni, fqinjët të tij më të madh.

Populli i atjeshëm me sa vihej re e ndjente këtë nevojë miqësie e ndihme dhe e vlerësonte në praktikë drejt këtë dorë të zgjatur nga ne dhe me sa mundi, u përpoq që ta shtrëngojë fort atë. Për ta kuptuar më qartë këtë le t'u referohemi banorëve të Krashevës, ku një pjesë e jona pati rastin të qëndrojë gati për gjithë muajin shkurt.

---

1)Xhebro Gumenica, komandant kompanie

Krahina e Sanxhakut atëhere ishte nga më të pa zhvilluarat në Jugosllavi. Megjithë kushtet e tyre të këqija, banorët e Krashevës e priten me kënaqësi qëndrimin tonë aty. Na i strehuan gjithë partizanët nëpër banesat e tyre që u caktuan posaçërisht. Banimi i partizanëve u rregullua në basë skuadre edhe për arsyen gatishmëri, e nganjëherë edhe në bazë toge me qëllim që të mundnim të zhvillonim edhe instruksione të ndryshme ushtarake me ta. Furnizimi vinte nga një burim i përqendruar po edhe mjaft i kufizuar.

Muaji shkurt pati rreshje të shpeshta dëbore dhe një të ftohtë që të priste sapo të nxirrje kokën përjashta. Ne ishim kalitur me kushte të tilla, partizanët nuk donin t'ia dinin. Edhe drutë që sillnin fshatarët për zjarr: "ua kemi refuzuar sepse nuk u mjatojnë për fëmijët e tyre me që dhe mali për të prerë të tjera është i zenë nga dëbora..." - i raportoi në një rast shtabit të brigadës kuadri-i batalionit Siri Dine.

Po më kryesorja ishte çështja e ushqimit, në rend të parë patatja që zëvendësonte bukën. Aty nga mesi i muajit rezervës që kishim po i vinte fundi. I kërkua këshillit NÇl që të na i shkurtonte çارacionin e zakonshëm ditor meqenëse ai e administronte atë. Kjo masë na u duk e nevojshme gjersa të liroheshin rrugët nga dëbora për kalimin e kafshëve që na furnizonin. Këshilli pasi e diskutoi këtë çështje edhe me banorët e tjerë të fshatit, të cilët gatuatin për partizanët sipas shpërndarjes që ishte bërë, na pruri edhe fjalët e tyre:-

Partizanët shqiptarë kanë ardhur për të na çliruar, prandaj jemi gati të 'ndilimojmë me atë që kemi... Ata janë treguar më të afërt se djemtë tanë me ne... Të kishin qenë partizanët jugosllavë në vend të tyre në këtë kohë të keqe, do të na kishin djegur edhe trarët e shtëpisë, siç kanë bërë herë të tjera... Këta nuk pranojnë as drurë që u japim ne vetë, duke menduar me shumë për fëmijët tanë... - kishin thënë ata.

Në kohën që po dëgjoja ato që po thoshte kryetari i këshillit të Krashevës në emër të bashkëfshatarëve të tij, më erdhi ndërmend edhe ajo që më kishte thënë kohë më parë një punëtor nga Mitrovica me emrin Aleksandroviç. Më kish sjellë puna si mysafr tek ai në një natë të dhjetorit 1944. Atë ditë zhvillohej në

këtë qytet aktivi i kuadrove të brigadës dhe për fjetje u shpërndamë nëpër baza. Gjatë pritjes së ngrohtë në familjen e tij, Aleksandroviçi shfaqi edhe kënaqësinë që partizanët shqiptarë luftojnë trimërisht kundër armikut e sillen miqësish me popullin, këto janë mendimet e të gjithëve dhe jo vetëm të miat, u shpreh ai...

Po le të kthehemë në Krashevë. Ditën e 23 shkurtit që shënonte përvjetorin e Ushtrisë së Kuqe, si aleate në luftën e përbashkët antifashiste bëmë një konferencë politike me gjithë batalionin në qendrën e kompanisë së parë, në një sallë në mes të fshatit.

Pasi mbaruam punë njeri nga banorët e shtëpive përreth na u paraqit në emër të disa familjeve që kujdeseshin së bashku për partizanët e strehuar në shtëpitë e tyre, dhe shfaqi dëshirën që të qëndronim aty të gjithë siç ishim për të ngrënë drekën së bashku.

Si rregull racioni i zakonshëm secilit do të vinte nga baza ku banonte, po përsëri na u duk si e rëndë që të qëndronim të gjithë në një vend. E falenderuam atë dhe i thamë se e shihnim të arsyeshme të shpërndaheshim nëpër bazat e zakonshme, po ai nguli këmbë përsëri në të tijën, duke thënë:-"U bënë kaq kohë që partizanët ndodhen këtu e nuk na është bërë mbarë t'u bëjmë diçka...me që u mblohdhët me rastin e festës, unë therra një derrr...mishi do të jetë yni, të tjerat si gjithnjë (Fjala ishte për patatet dhe për ndonjë lakër të zier se tjetër gjë nuk kishte) do të silleshin nga bazat përkatëse.

Më së fundi u bë e tija dhe festimi i kësaj dite u bë bashkarisht nga batalioni dhe banorët e atjeshëm. Po thuajse u mblodh i gjithë fshati. U kënduan këngë e u kërcyen valle nga partizanët dhe rinia e fshatit. Këtu vumë re se edhe për Ushtrinë e Kuqe të Bashkimit Sovjetik dhe kryekomandantin e saj Josif Stalinin, populli jugollav ushqente simpati. Ai kish mësuar pak a shumë për fitoret e mëdha që kish korru ajo gjer atëhere në fushat e ndryshme të betejave deri në çlirimin e kryeqytetit të tyre, Beogradit. Aty me këtë rast u komentua edhe mesazhi i Çerçillit dërguar Stalinit, transmetuar nga Radio-Londra ku thuhej edhe se "Brezat e ardhmë do t'i jenë mirënjohës Ushtrisë së Kuqe. U lutem Juve komendant

i madh i ushtrisë së madhe, ta përshëndetni atë në emrin tim, tani në prag të fitores përfundimtare...”<sup>1)</sup>

### ***Luftë edhe me tifon***

Të shtrohesha në spital nga ndonjë plagë, siç u kishte ndodhur shumë shokëve të mi që ishin plagosur rëndë në luftime e sipër, më kish shkuar mendja, po që të shtrohesha nga tifua jo. Po bënim dy muaj që ndodheshim në Sanxhak ku kishte rënë tifua midis popullsisë, po vetëm kohët e fundit kishin nisur të sëmureshin edhe partizanët nga kjo sëmundje. Që nga fundi i janarit numëroheshin në spitalin e Senicës mbi 30 vetë, ndërsa tre të tjerë atje kushin vdekur. Në ditët e fundit të shkurtit u detyrova edhe unë të shtrohesha aty.

Me sa mbaj mend qe hera e parë në jetën time që më duhej të shtrohesha në spital, prandaj dhe mezi u binda që të vija aty, me arsyetimin e drejtë të mjekut, për t'u veçuar edhe prej shokëve të tjerë me që sëmundja ishte ngjitëse.

“Spitali” ku mjekoheshin të sëmurët ishte një shtëpi dykatëshe, ku si tavan shërbenin dërrasat e dyshemesë së katit të dytë, pra spital i thënçin! Dëshira për të më lënë në katin e parë ku kisha edhe një pjesë të shokëve të njohur m'u plotësua. Këtu u radhita në rreshtin e shtrirë mbi dërrasa të dhomës. Çdo i sëmurë rrinte i veshur me rrobat që i ndodheshin, me pak kashtë të shtruar në vend të dyshekut, sipër mbuloheshim me kapotë, natyrisht ata që kishin. Për ata që nuk kishin kapotë, përdorej ndonjë batanije sidokudo.

Të sëmurët ishin vendosur aq afër me shoku-shokun sa që mezi rrrotulleshin. Vetëm njera anë e dhomës ku ishim vendosur ne meshkujt, kishte nxënë 10 veta. Në anën tjetër përballë saj, ku ishin vendosur femrat, qe ca më lirë, sepse ato ishin më të pakta. Sytë ishim të detyruar t'i mbanim vazhdlimisht të mbuluar me diçka ose të mbyllur nga që çdo lëvizje e të sëmurëve në katin e sipërm

---

1) Nga letërkëmbimi Stalin-Çerçill, vell 1, f.310, botim rus.

shkaktonte rënie blozash e sendesh të ndryshme prej trarërve të drunjtë që mbanin dyshemenë e katit të dytë. Kërcitjet e vazhdueshme e monotone që bënин trarët, sa herë që shkelnin këmbët e njerëzve mbi to, dukej se edhe ata po rënkonin bashkë me ne të sëmurët.

Mjekimet që na bëheshin qenë ca kokrra, rrallë fortë, atyre që ishin më rëndë, mund t'u bëhej edhe ndonjë gjilpërë. Ilaçet nuk kishte dhe për këtë gjë mendimi i të sëmurëve që se nuk kishte shumë preokupim.

Të sëmurët që kishin qenë të shtruar para një muaji, kishin përfituar nga një pjesë e mirë ilaçesh, të dërguara nga Shqipëria në ndihmë të partizanëve e të popullit që ish prekur nga sëmundja e tifos në Jugosllavi. Tani ato ishin mbaruar, mbetej që fjalën e fundit ta "thoshte" qëndresa e vetë organizimit.

Mjeku që na kishte nën kujdes ishte jugosllav. Vizitën e të sëmurëve ai e bënte një herë në 24 orë. Më ka mbetur e paharruar edhe vizita e parë ashtu si çdo gjë e parë në jetë që mbahet mend më shumë. Doktori atë ditë e nisi vizitën nga vajzat, pastaj vazhdoi në anën tonë. Kish mbaruar edhe me mua, pastaj filloj të shikonte Veren <sup>1)</sup> që ishte i shtrirë në anën time të majtë. Sapo doktori e preku atë me dorë në kraharor, ai lëshoi një "O-o" të zgjatur dhe kërceu përpjetë nga kashta ku ndodhej shtrirë. Doktori e pa në sy të sëmurin sikur desh t'i thoshte: "Të kuptova", pastaj u largua e vazhdoi vizitat e tjera.

Ne që ishim pak më lehtë, nisëm ta ngacmonim Veren, sapo iku doktori, pse bëri "O-o"?...Me shakatë tonë mundoheshim t'ia largonim disi mendjen nga dhimbjet që ndiente e nga rënkimet e vazhdueshme që bënte. Veria sado që ishte keq e përtonte të nxirrte zë, mblodhi forcat dhe shakave të shokëve iu përgjegj:

"Më gudulisi gomari ndaj bërtita..." kjo shkaktoi të qeshura të zgjatura. Pastaj ra prapë në heshtje. Ishte në kategorinë e të sëmurëve rëndë. Ja se si e pëershkruanë partizani V.Kosta gjendjen e tij të rëndë prej titos: "Tifua- shkak i vuajtjeve të mia...ajo pë

---

1) Enver Godo, ish kuadër kompanie në brigadën e VI S.

pak desh të ma ndante nga shokët e luftës e të sakrificave. Sa ditë që kalonin, sëmundja po forcohej më tepër...Trupi i ngjante një skeleti dhe truri nuk funksiononte më...asnjeri nuk më ngiste se u hidhesha për gryke pa vetëdije, ishte tifua që më gatoi në këtë mënyrë..."

Ushqimi që jepej në spital ishte kryesisht prej buke me miell tërëshëre, ose patate të ziera apo të pjekura. Nganjëherë përmëngjes jepej edhe ndonjë gotë çaj me fare pak sheqer. Këto kushte i provova vetëm për nja 10 ditë, sepse më 7 mars u nisëm përsëri në drejtimin e Kosovës, nëpërmjet Novi-Pazarit. Ky marshim sikur na shkundi edhe ne të sëmurëve. Me rastin e kësaj lëvizje drejt Atdheut edhe mua m'u lehtësua shumë trupi. Hap pas hapi po u afrohesha shumë shokëve të Brigadës deri sa nuk u shkëputa më prej tyre.

## VIII. RIKTHIMI NË KOSOVË

*Shenja genocidi të shfrenuar • përballë faktesh që akuzojnë • mosbesim dhe urretje nacionale • shovenizmi sllav- në veprim • me mendje e zemër në Shqipëri*

### *Me mendje tek shokët që "lamë" prapa*

Nisja për në Novi-Pazar e drejt Kosovës u bë në një ditë të kthjellët po të ftohtë. Vendı nga po kalonim ishte krejt i mbuluar me dëborë. Të sëmurët që ishin më rëndë e nuk ecin dot u hipën mbi ca sana rrëshqitëse të tërhequra me qe. Gjatë kohës në spital luftëtarët që kishin mbetur gjallë, ndërmjet gjithë atyre që kishin qenë të sëmurë më rëndë, na kishin treguar për qëndrimin kurajoz të shokëve tanë që mbetën atje, për burrërinë që kishin treguar ata në përballimin e sëmundjes dhe për krenarinë që ndjenin lidhur me shpurjen e misionit të çlirimit deri në fund. Këto ndjenja shumë prej tyre i kishin shprehur si Kio Thana, Hasan Mërtiri, Rustem Dangëllia e të tjera. Ata nuk kursyen as jetën kur ishte fjala për lirinë e popullit të vet e më gjerë.

Tani që ishim duke u kthyer në Shqipëri me mendje nuk mund të ndaheshim nga ata që nuk arritën të vinin bashkë me ne në Atdheun e dashur tanimë të çliruar që do t'i priste me krahë hapët, po ashtu si dhe familjet e të afërmit e tyre... —

Rruga e kthimit nga Sanxhaku në dhjetëditëshin e parë të marsit krijoj shumë vështirësi e telashe për ne. Në Qafën e Malit Golja

dëbora arrinte deri edhe mbi një metër, në disa vende, aty na mbetën e nuk lëviznin dot më tej disa kuaj dhe nga 12 partizanë nga e gjithë brigada, kryesisht nga ata që kishin kaluar sëmundjen e tifos. Partizanët u tërroqën nga ana e shokëve dhe shpëtuan, kurse kafshët nuk patëm mundësi t'i nxirrним.

Ushqimin edhe tanë e kishim shumë me kursim. Marshimi vazhdonte nëpër ca gryka e shpate malit, ku mezi na mbanin këmbët. Më keq nga të tjerët e kishim ne të tifosurit siç na thërrisin shokët me shaka. Kohë pas kohe, për të mbajtur lart shpirtin e qëndresës sajoheshin lloj-lloj shakash e bejtesh të ndryshme. Për të tilla dallohej tek ne sidomos Shaban Muharremi. Ai kur po kalonim, në qafën e malit, ia nisi labçë me grupin e shokëve që ia mbanin, sipas vargjeve që pat thurur vetë:

*Nga Bramyshnja në Sanxhak  
s'të ndali usnjë pengesë  
shkrive plumb e derdhe gjak  
lifstëtar' i Brigadës pestë.*

*Të shumtë si mizëria  
qen' armiqjt nga allomonja,  
me ta bashkë bor' a stuh  
dhe ai Mihaj Drazhoja..."*

Kështu mundoheshim ta largonim lodhjen, urinë dhe çdo mërzitje tjetër nga vështirësitë që po kalonim. Në fund të gjashtë ditëve arritëm përsëri në kufijtë e Kosovës, te vëllezërit tanë. Ishim të gëzuar e me shpresë se do të takonim shokët e miqtë e shumtë që kishim bërë dhe njojur gjatë luftimeve në këto anë.

### ***Shtëpia kish mbetur pa zot***

Siç është e natyrshme, kur njeriu kthehet në një vend që e ka njojur edhe më parë, mundohet të dallojë ndryshimet që mund të jenë bërë. Në rastin tonë gjëja më e dukshme për të gjithë ishte pakënaqësia në masë e popullsisë për shkak të raprezaljeve që ishin përdorur nga ana e reparteve të ushtrisë jugosllave dhe

organeve të OZN-ës<sup>1)</sup>

Lajmet e këqia më nxitën edhe mua të interesoheshë përfamiljen e atij plakut nga Mitrovica që e kisha njojur në kohën e largimit prej andej dhe për djalin e tij që ishte partizan në një brigadë të Kosmetit. I vura detyrë vetes që ta gjeja me çdo kusht shtëpinë e tij e të merrja vesh përtë.

Më 20 prill, bashlikë me dy shokët që më shoqëronin, shtëpinë që kërkonim e gjetëm, po ajo ishte e vulosur. Disa gjitonë që u bënë kuriozë përinteresimin tonë, u grumbuluan te një rrugicë aty pranë. Ata na thanë se familja që kërkonim ishte hequr prej këtej qysh para dy muajsh...Disa kishin hapur fjalë se djali i tij do të ketë bërë ndonjë faj atje si partizan: disa flisnin përtë jatin...- Ne mund të garantojmë se asnje nga këto që thonë nuk është e vërtetë, e njohim mirë familjen e tyne si nga më të ndershmet e më patriotet këtu...-thanë ata dhe shtuan.- si këta janë marrë edhe shumë të tjerë nga qyteti ynë, po me tepër akoma nga katundet përreth e nuk dihet ç'po bëhet me ta...

Dëshmitarët ishin të mirëfinformuar e duleshin besuar, sadë të hidhura që ishin pohimet e tyre. Në këto çaste m'u errësua gjithshka përreth. Përpara më dilte figura e atij burri babaxhan, ashtu siç e kisha parë atë ditë që më kish thënë: "edhe ti je djalim em".

Pikëllimi që ndjeva përkëtë babë patriot dhe përfamiljen e tij ishte shumë i madh. E kisha njojur rastësisht po gjaku i përbashkët dhe idealet e qëllimet fisnike që kishin zënë vend edhe në qenien e tij, na kishin bërë të pandarë. Vrisja mendjen se ç'mund të bëja përtë mësuar se ku e si ndodhjej...Asnjëri s'dëftonte gjë më shumë nga ata që pyetëm nga që ose nuk dinin, ose qenë edhe vetë me faj.

Edhe shoqëruarve që kisha me vete, një herë përfjorë një herë, nuk isha në gjendje t'u përgjigjesha. Eca deri në një farë vendi pastaj nxorra nga çanta shaminë që më kishte dhënë "babë", ua tragova atë shokëve dhe mënyrën se si isha njojur. Aty më erdhën të plota ndërmend ato pak fjalë të asaj bisede aq të ngrohtë që patëm bërë, pikërisht në këtë vend ku kaloja tani përsëri. Edhe

---

1) OZN-a kështu quhej në atë kohë shërbim sekret jugosllav (UDB-ja)

pas denoncimit që i bëra këtij fakti të dhimbshëm në shtabin tonë më të lartë dhe në instancat e tjera, përsëri nuk u gjet asgjë.

### ***Fakte që akuzojnë***

Në rrethet e Lipjanit, ku ndodheshim përkohësisht na ishte vënë detyra të ftolnim edhe gjakrat e ndezura nationale në popull. Më 3 maj Avdi Rrokaj<sup>1)</sup> dhe mua na u ngarkua detyra të bënim një takim me popullin e zonës përreth në qendrën e banuar Gadimla. Detyra për ne ishte e zorshme. Nuk dinim ç'të thoshim tjetër përveç parimeve të përgjithshme që njiheshin. Aty kishte probleme të tilla që s'kishin lidhje me ne, nuk i sqaronim dot. Ngulëm këmbë që të na shoqëronte edhe ndonjeri nga oficerët jugosllavë të garnizonit të tyre që ishte vendosur në Lipjan. Së fundi ashtu u bë, erdhi vetë komisari i atij garnizoni.

Fillimi shi u thanë fjalët e zakonshme të hapjes dhe pastaj u bë një paraqitje e shkurtër e situatës nga ana ime. Pas kësaj hyrjeje, ashtu siç pritej, vërvshuan pyetjet në formë ankesë nga anë të ndryshme të grumbullit të madh të njerëzve. Drejtimi i përgjithshëm i pyetjeve ishte ky: A jemi të barabartë me serbët apo jo? Na si shqiptarë kemi luftue me flamurin tonë deri tash, a do të na lejohet me mbajt atë përgjithmonë, duam me na thënë copë se si qëndron e vërteta e atyne që u mobilizuan për në ushtri dhe pastaj erdhi lajmi se u vranë të gjithë, po çështja e K.... I.... N.... etj., që janë marrë natën nga shtëpia dhe s'dihet si kanë përfunduar ... po...

-Partia Komuniste Shqiptare dhe Partia Komuniste Jugosllave luftojnë për drejtësi, barazi e vëllazërim midis popujve. Kjo u pa edhe nga gjaku i qindra partizanëve shqiptarë që u derdh për çlirimin e tokave të Jugosllavisë...Për të tjerat do t'ju sqarojë më mirë komisari i qytetit...-Kështu e çeli përgjigjen e pyetjeve Avdiu.

-Mareshalli Tito na udhëheq me largpamësi,- nisi të thottë komisari jugosllav ca si i shtyrë,- ai na mëson e na edukon ne që t'i zbatojmë drejt rregullat dhe urdhërat që na jepen, po ka edhe

---

1)Avdi Rrokaj ish komandant batalioni

njerëz që bëjnë të kundërtën e tyre: ndihmojnë reaksionin..Ja edhe para dy javësh në afërsi të Janjevos u gjet i vdekur një shok i yni shumë i mirë, ai ishte goditur nga afër aty ku po kryente shërbimin...

-...Njerëzit e mirë nuk i vret kush ashtu si thua ti, hej burrë.Jo! Na i mbrojmë ata edhe me jetën tonë, si e ka zakon shqiptari-ndërhyri një burrë i mesëm nga mosha që nga fundi i sheshit, ku ishte ulur, me një fjalë të prerë e i revoltuar nga kundërataket e komisarit jugosllav.

-Ju, populli, duhet të ndihmoni për t'i kapur e për t'i bërë të padëmshëm armiqtë... -vazhdoi me të tijën komisari.

-Ne pyetëm e duam me dijtë pér çështjen e flamurit, pér marrjen e njerëzve fshehurazi natën, pér ata që po humbasin pa lënë gjurmë. Deshëm të dinim pse ndodhin këto- tha pastaj një tjetër. Ai tani ishte ngritur me këmbë e priste përgjigje. U bë dhe ca zhurmë nga zërat e shumtë të atyre që e pasuan folësin në shenjë miratimi pér ato që thoshte:"po, po...mirë e ka...s'dimë ku jena as vetë... si humbkan njerëzit kështu?"

-Mirë pra, le t'i marrim çështjet një e nga një - filloj të thotë përsëri komisari, sapo u vendos një far qetësie- flamurin tuaj ja ku e keni- duke bërë me dorë nga flamuri ynë që ishte vendosur në krye të sheshit ku bëhej mbledhja (ai me kthimin e forcave tona nga Sanxhaku ngrihej përsëri lirisht dhe jugosllavët nuk e kundërshtonin). Mund të jetë bërë edhe ndonjë gabim në të kaluarën nga ndonjë njeri i pandërgjegjshëm; ajo patrjetër do të ndreqet. Sa pér ata që janë arrestuar duhet të kenë qenë bashkëpunëtorë me armikun...

-...S'është e vërtetë ne i njohim ata,- kundërshtuan nga masa.

-Po të jetë bërë përsëri ndonjë gabim me siguri që do të rregullohet,- vazhdoi ai,- po tanimë ishte vënë në një pozitë të papëlqyer edhe shikonte nga përkthyesi sikur të kërkonte ndihmën e tij, pér ata që mund të janë vrarë unë nuk mund të jap dot hollësira tani pér tani, po do ta sqarojmë edhe atë, veç duhet ta dini se lufta akoma nuk ka mbaruar krejtërisht e mund të na vriten edhe të tjerë...e rrumbullakosi komisari "sqarimin" e tij. Kështu që në fakt me të asgjë nuk mundëm të sqaronim. Komisari me

kombësi serbe u bëri bisht atyre fakteve për të cilat kërkohej sqarim. Prapëseprapë për ne teorikisht mbetej në fuqi orientimi tabu i partisë sonë - të bënim gjithshka për kapërcimin e marrë-dhiënieve të vjetra armiqësore ndërmjet shqiptarëve e sllavëve. E gjithë kjo vinte nga që sipas orientimeve të udhëheqjes sonë, çdo gabim që vërtetohet i duhej atribuar personave të caktuar dhe jo vijës së përgjithshme të PKJ pra "...fajin ne e shihnim vetëm tek të dërguarit, tek ekzekutuesit e vijës, por jo tek ata që i dërgonin. Titoja me shokë"<sup>1)</sup>.

Pavarësisht nga shpjegimet e mësipërmë kuadrot ushtarake të bazës që vepronin përtet kufirit shtetëror i shihnin zhvillimet nga afër, më me objektivitet, në bazë të fakteve që përfjetonim, por njohja e të vërtetave dhe veprimi konform tyre nuk u pëlqente jugosllavëve, ndaj dhe qenë të prirë që kur nuk e kishin të kollajtë të na izolonin plotësisht, siç u veprua me dislokimin tonë të dimrit në Sanxhak, të na dizinformonin sa të qe e mundur më shumë.

### ***Presion i padurueshëm***

Detyrat për të patur gjithnjë kujdes e të bënim çmos për t'i mbyllur plagët e vjetra, na i kujtoi edhe një herë analiza e punës dhe masat që përcaktoi mbledhja e shtabit me të gjitha kuadrot. Ajo u zhvillua në javën e parë të majit me temën "Detyrat e kuadrove për punën e veçantë me popullsinë e kombësive të ndryshme në komunën e Bujanvcit", ku vepronte tashti brigada.

Ato ditë u dukën përsëri grupe njerëzish të armatosur vec e vec. Në fillim menduan se mos ishin çetnikë nga ata të Ragoviç Peroviçit, një ish toger i Kralj Pjeterit që vepronte atyre anëve clie e kërkoni ose nga mercenarët e tjerë që po ashtu i kërkoni. Pastaj u sqarua gjithshka: vetëm brenda dy ditëve u bënë 53 veta që kërkuan të pranoheshin në nënrepartet e ndryshme të batalionit tonë. Ishin partizanë shqiptarë nga anët e ndryshme të Kosovës e të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi. Ata qenë larguar prej njësive ushtarake jugosllave, shumica prej brigade së II-të së Kosmetit.

---

1) E.Hoxha, "Titistët". f.63

Nga lart udhiëzoheshim: në rast takimi me grupe "dezertorësh", duhej t'i afronim ata me kujdes, ashtu siç ishte vepruar në batalionin e II-të ku nga komuna e Ogoshit "...qenë dorëzuar 42 të dezertuar nga brigada e Kosmetit" (thuhet në njoftimin e shtabit të brigadës). Ndërkojë oficeri informativ i brigadës njoftonte se në këtë rajon gjenden akoma mjaft të dezertuar nga Brigada e III e Kosmetit...

Përfaqësuesit e brigadës jugosllave me të cilët morën kontakt ankoreshin se po iu shkrihej brigada nga dezertimi në masë i ushtarëve të tyre. Ata si shkak të kësaj të keqeje quanin punën e reaksionit në këto anë dhe ndjenjat "nacionaliste" që kish "ushqyer" ai midis banorëve shqiptarë. Veten e tyre ata e nxirrin gjithnjë të larë!

Sipas udhëzimeve që merrnim vazhdimisht u munduam gjatë asaj kohe për t'i bindur "dezertorët" që na u paraqiten të kthetheshin në brigadën e tyre. E morën vetë përsipër edhe përgjegjësinë për t'i garantuar që të mos merrej ndonjë masë dënim i përtak nga ana e komandave të tyre. Në këtë mënyrë donim të besonim se po luftonim për forcimin e miqësisë e të solidaritetit vëllazëror me luftën e drejtë të popujve të Jugosllavisë.

Detyra ishte e rëndë sepse duhej të hidhej poshtë një bagazh i tërë psikologjik që ishte krijuar historikisht me gjakun që kishin derdhur shqiptarët në të kaluarën për të mbrojtur identitetin e tyre kombëtar, po me kohë do të forcohej dyshimi se e keqja nuk qëndronte vetëm tek e kaluara, po edhe tek politika sllavo-serbe e ditës.

Cilat do të ishin arsyet e vërteta të këtij rebelimi në përmasa kaq të gjëra? Përgjigjen më konkretisht për këtë gjë do ta jepnin faktet e shumta që paraqiten të akuzuarit si "dezertorë". Ata na bindën se shpërbërja e reparteve jugosllave e kish burimin: Së pari, tek mobilizimi për të plotësuar radhët e kësaj brigade nga popullsia shqiptare, duke marrë përdhunisht të gjithë burrat që ishin gjetur në shtëpi, edhe ata që nuk ishin në moshë për ushtri, edhe ata që i kishin vëllezërit ose djemtë prej kohësh partizanë e mund të liheshin përkohësisht për të përballuar nevojat e familjes, edhe ata që ishin me të meta fizike...

Së dyti, ushtarët shqiptarë shpërndaheshin nëpër reparte sllave që të mos mundnim të komunikonim me njeri-tjetrin.

Së treti, komandantët e tyre serbo-malazezë nuk dinin fare shqip e me këtë rast sajonin akuza fallso për mosbindje, mos respekt e shkelje disiplinore nga ana e shqiptarëve...

Sjellja e oficerëve sllavë karshi shqiptarëve që shërbenin nën komandën e tyre, ishte tepër arrogante sikur të kishin të bënin jo me bij nga populli që u ishin besuar t'i stërvitnin e t'i edukonin, po me ca robër lufte që mund të ndëshkoheshin moralisht dhe materialisht pa mëshirë në çdo rast që paraqitej.

Së katërti, nga ana e komanduesve dhe e agjentëve (kryesisht me origjinë serbe) ishin bërë përpjekje të ulta për të prishur marrëdhëniet vëllazërore midis shqiptarëve me njeri-tjetrin dhe krijonin incidente artificiale ndërmjet tyre me qëllim që t'u siguronin eprorëve të dhënat që u nevojiteshin për të justifikuar gjithë arrogancën dhe qëndrimin prej padroni karshi shqiptarëve...

Së fundi, në operacionet e saj "spastruese" që bënte ushtria jugosllave zhvillohshin kudo ndjekjet dhe ndërmerrreshin masat më të egra vetëm kundër banorëve shqiptarë pa diferencime. Kjo mënyrë sjellje nuk kish si të mos cënonte rëndë sedrën e tyre kombëtare. Shqiptarët nuk mund ta duronin më tej një qëndrim kaq përbuzës e diskriminuese ndaj tyre. Pra "morëm armët dhe erdhëm të qajmë hall me vëllaznit tanë, tue kenë të bindur se nuk do të pritemi në besë..." - deklaronin ata.

Faktet bindëse shtoheshin çdo ditë. Në një raport të një delegacioni që ishte dërguar nga shtabi operativ për marrëveshje me komandën jugosllave thuhej, midis të tjerash, se vrasja e 20 vetëve nga Malësia e Gjakovës pa asnjë arsy, vrasjet në masë në Drenicë, humbja e njerëzve natën pa i marrë vesh kush etj, janë shkaqet që revoltojnë për së tepërmë popullin e Kosmetit kundër Ushtrisë NÇl Jugosllave.

Situata në përgjithësi paraqitej e rëndë. Kjo gjendje preokupoi edhe gjithë partizanët <sup>1)</sup> e thjeshtë. Disa efektiva në mbledhjet e

---

1) Partizanë-kështu vazhdonim t'i quanim akoma ushtarët tanë, edhe pse një pjesë e tyre kishin stazh luftarak qysh nga periudha e çetave vullnetare partizane.

tyre u shprehën për atë që shqiptarët e ardhur te ne të mbaheshin aty, siç kërkonin ata vetë. Po ky problem për ne qe i komplikuar e nuk mund ta quanim të zgjidhur me kaq. Ai i kalonte kompetencat e kompanive, të batalioneve edhe të brigadës e të divizionit. Ngjarjet kishin lidhje me një politikë të tërë që prekte marrëdhëniet e popullsisë shqiptare dhe asaj sllave në përgjithësi si dhe raportet midis shteteve e partive komuniste, shqiptare e jugosllave.

Përfaqjesuesi i Shtabit të brigadës së Kosmetit paraqitet aty përsëri dhe përsëri ankohet se shqiptarët paskeshin ngritur krye "kot" në brigadën e tyre, se edhe ndonjë gabim pa dashje po të ketë shpëtuar, do të ndreqet, se ata qenë trajtuar e do të trajtohen mirë...e plot "garancira" për korrigjime që do të bënin dhe betime të "sinqerta" për sjellje të mira karshi shqiptarëve në të ardhmen. Por ne pavarësisht nga udhëzimet që na ishin dhënë për mirëkuptim e lëshime karshi jugosllavëve, tani sajuam shkaqe dhe nuk i dorëzuam me "dezertorët" tek ata.

### ***Pobime konfidenciale***

Gjatë qëndrimin tonë në zonën e Ferizajve, ku kaluam pjesën më të madhe të muajit maj, u njohëm edhe me disa nga oficerët jugosllavë. Përpinqeshim që të afroheshim me kolegët tanë jugosllavë. Po edhe një pjesë e mirë prej tyre e dëshironte këtë afrim. Në vazhdim të kësaj fryme pata rastin të haja një drekë me njerin nga oficerët e OZN-së, me të cilin kisha zenë muhabet. Ai mbante gradën e kapitenit dhe ne e thërrisnim druzhe kapetane, pa u interesuar aq për emrin e tij.

Atë ditë zhvilluam një bisedë të gjatë shoqërore. Ndër të tjera u thanë përafërsisht edhe këto:

-Si është e mundur që të zhduken kaq shumë njerëz këtu në Kosovë?- ishte pyetja që bëra duke ia vërtetuar këtë edhe me disa nga të dhënat që kishim.

-Ne zhdukim vetëm armiqtë...ndërsa po të jetë fjala për operacionet tona gjatë dimrit në zona të gjëra që nga Drenica e deri në Kërçovë, duke përfshirë edhe Gilanin, Ferizajt, Gostivarin, aty pati një kryengritje të vërtetë që nuk mund të shuhej ndryshe

- tha ai lirshëm në gjuhën shqipe, me që e zotëronte mirë atë.  
-Po për disa qindra kosovarë që janë mobilizuar qysh në muajin janar për në rreshtat e ushtrisë e tashti nuk dihet fare se ku ndodhen, ç'mund t'u thuhet të aférme që i kërkojnë?  
-Unë di që ata u mobilizuan nga një komision i zgjedhur oficerësh për të kompletuar reparte të ndryshme...Me sa kam mësuar më vonë, një pjesë e tyre kanë qenë të infektuar nga ana e reaksionit dhe janë përpjekur të dezertojnë, ose të vrasin oficerët...Në këto raste nuk mund të mos jepen edhe dënimë...

-Reaksioni këtu thonë se duhet të jetë i fortë- thashë përsëri për ta nxitur që të fliste më shumë -çudi sesi ne akoma nuk jemi përpjekur me të"!?

-Armiku këtu është shumë i zgjuar. Nuk dallohet kollaj nga njerëzit e zakonshëm dhe nuk shfaqet gjithnjë hapur...Pastaj dinë edhe të thonë se çdo gjë e bëjnë për vetmbrojtje për të fshehur gjurmët.

Nga kjo bisedë deri diku shoqërore, m'u përforcua më tepër mendimi se në Kosovë gjaku i shqiptarëve derdhë lumë, edhe pas dëbimit të pushtuesve gjermanë.

Na dukej e pabesueshme kur secila nga palët ankohej për tjetrën, si të persekutuarit, ashtu edhe persekutuesit. Po këta të fundit i kishin të gjitha në dorë: edhe "gurin" edhe "arrën", ndaj i manipulonin faktet sipas interesit të vet.

Propaganda zyrtare nga ana e saj bënte punën e vet mbi tragjedinë e popullit të Kosovës, duke derdhur lot krokodili për padrejtësitë e së kaluarës. Ja psh si shkruante shtypi jugosllav atë kohë:..."... në këtë pjesë të Jugosllavisë (në Kosovë në të kaluarën M.Xh.) hegemonistët serbomëdhenj kanë kryer krimet më të mëdha... Metohia ishte thjesht një koloni. Popullsisë shqiptare i ndalohej gjuha e saj dhe lidhja kulturore me bashkatdhatarët prej Shqipnije... Hegemonistët u rrëmbyen shqiptarëve komplekse të tana tokash fshatare të punueshme dhe në këto komplekse vendosën Malazes, Boshnjak... Sot Metohinë e çlironjë bashkarisht njësitë tona dhe shqiptare... ky fakt është skaji dhe garancia...se të

---

1)Gazeta "Borba" 21 nëntor 1944, ribotuar nga "Bashkim" më 9 janar 1945

gjitha problemet e këtij vendi të martirizuar do të zgjidhen drejtësisht”<sup>11</sup>)

Më qartë se kaq ishte zor të premtohej për drejtësinë e të ardhmes së kosovarëve. Këto shpallje të hapta nga një herë na bënin të mendonim se ndoshta ishte në rregull me të vërtetë vija e përgjithshme që ndiqte PKJ, dhe se ato që në praktikë nuk përputheshin me këtë vijë, mbase qenë të rastit që shkaktoheshin nga njerëz të veçantë, apo edhe nga “moskuptimi” i direktivave, siç thoshin jugosllavët.

Në atë kohë nuk ishim çliruar akoma edhe nga euforia e fitores mbi armikun e përbashkët. Pastaj ndonjë ballist shqiptar si Myslim Bajgora me një grup mercenarësh që vërtitej atyre anëve, objektivisht e ndihmonte propagandën jugosllave për “spastrime”. Prapëseprapë, me ndërgjeje, askush nga ne nuk i besonte ato faje që u ngarkoheshin vëllezërve tanë atje.

Me rikthimin tonë në Kosovë u ndërprenë edhe operacionet masive të ushtrisë jugosllave që bëheshin në zonat e ndryshme të krahanës, u mënjanuan disi edhe dallimet karshi shqiptarëve që ishin bërë deri atëhere etj; tek populli nisi të lindë përsëri shpresa se do të rrgulloheshin padrejtësitë e mëparshme. Si njete mashtrimi e pabesie shërbyen edhe premtimet e shuma në bazë të të cilave shqiptarët do të ishin të barabartë me kombësitë e tjerë e nuk do të guxonte t'i prekte kush, se të gjitha ato që kishin ndodhur gjer atëhere i takonin të kaluarës...se...

### ***Agjentura e buaj në radhët tona***

Kërçova ishte qyteti ku ne qëndruam më shumë se në çdo vend tjetër përtej kufirit. Aty, partizanët u vendosën për herë të parë në kushtet e jetës së gazerniës, që shtriheshin në afërsi të qytetit. Aty kishin qëndruar për një kohë të gjatë edhe njësi të ndryshme të ushtrisë italiane.

Jeta e gazermës na vuri përpara konditat që kërkoheshin për ushtritë e rregullta. Disiplina e rregulli në mbajtjen e kapanoneve, vendosja e oficerëve për fjetje veças ushtarëve, ngrënia e tyre po veças, zhvillimi i stërvitjes së programuar e të tjera. Edhe puna

edukative tani bëhej e sistemuar dhe më shpesh.

Në njerën nga ditët e fundit të qershorit tema politike që do të zhvillohej ishte mbi “*Disa shfaqje negative që ishin vënë re midis banoreve shqiptarë e atyre sllave në marrëdhëniet e tyre*”. Faktet për të ilustruar bisedën ishin grumbulluar gjatë operimit të forcave tona në rajone të ndryshme të Kosovës e Maqedonisë. Kur iu la radha debatit ndërmjet pjesëmarrësve (këtë e kishim metodë pune të zakonshme), dolën edhe mendimet e vërteta të secilit për problemin që shtrohej.

-Ne i kuptojmë drejt ato që u thanë nga komisari dhe u jena përbajtun atyne, po nuk i kuptoj dot sjelljet e Ushtrisë Jugosllave që po bëjnë shumë dallim midis shqiptarëve dhe serbëve?.. shtroi problemin një shqiptar nga rrëthet e Prishtinës.

-Ato mund të janë gabime nga njerëz të veçantë e nuk kanë të bëjnë fare me Ushtrinë Jugosllave- u përgjegj S.K. me prejardhje nga familjet e bajraktarëve të Dibrës e që e kish sjellë rasti në radhët tona me gjithë të vëllanë.

- Si do që të jetë shtabet e ushtrisë drejtojnë dhe përgjigjen si eprorë që janë- ndërhyri një partizan- unë vetë kam qenë nën urdhërat e të tjerve si çirak dhe kur s'e kryeja punën mirë, ustai më hiqte veshët e s'më linte të veproja me kokën time; jo më një ushtri që thuhet se ka rregull e disiplinë...

Pasi u bënë edhe disa diksutime të tjera, nga kreua i sallës u ndie një e kollitur paralajmëruese dhe pastaj zëri autoritar që pasoi...

-Kërkoj që të ndërpritet ky diskutim që po merr rrugë të shtrembër, sepse prek miqësinë që na lidh me Jugosllavinë e Titos-tha, rëndë- rëndë, e shkurt, duke mos luajtur fare nga vendi R.K. vëllai i S.K., i cili qe dërguar aty si kuadër në batalion.

U bënë shumë pyetje e u dhanë përgjigje në këtë mbledhje. U bënë edhe kritika e vërejtje ngajeta e veprimitaria jonë atje. Në çdo rast konkret në një mënyrë apo në tjetrën, doli se ne i ishim përbajtur me kujdes frymës së miqësisë e të afërmit me popullsinë sllave, ndërsa repartet jugosllave i kishin shkelur rëndë këto parime.

Në një relacion të byrosë së batalionit të dt 14 qershor 1945

për brigadën psh vinim në dukje se “*Në krahinën e Ogoshit gjatë 10 ditëve që qemë atje, populli te Ushtria Jugosllave kishte mosbesim dhe nuk e simpatizonte. Ushtrinë tonë e donte populli*”<sup>1)</sup>

Përsa u përket bajraktarëve u nxorën veshët në këtë diskutim duhet thënë se ata bashkë me nipin e tyre F.S. ishin bashkuar me forcat tona gjatë operacioneve që bënë ato në Qarkun e Dibrës. R.K. deri atëherë mbante pas vetes një tok njerëzish të armatosur prej ish bujqërve të tij. Po asnjëherë nuk e kishte zbrazur dyfekun, Sukseset e njësive partixane në Dibër bënë që edhe ata që u shkonin pas bajraktarëve ta kuptionin rrugën që duhej të ndiqnin e nisën të largoheshin prej tyre.

Ndërkohë edhe zotërit e tyre vendosën të shpalleshin “kundër” okupatorit të huaj e kërkuan të pranoheshin në radhët e Brigadës së V-S, gjë që edhe u pranua si për të gjithë shqiptarët që dëshironin të luftonin armikun.

“Patriotizmi” i bajraktarëve të Dibrës nuk zgjati shumë. Ai shteroi apo u çlirua Atdheu, kur ata u bindën se nuk kishte mbetur gjë nga privilegjet e mëparshme. Zgjuarsia e popullit dhe trimëria e forcave tona të mbrojtjes bëri që edhe bajraktarët të demaskoheshin për tradhëtinë e tyre.

Po le të ktheheni aty ku e lam fjalën, te diskutimi që po bënин partizanët në gazermat e Kërçovës. Partizanët flisnin me kurajo. Çështjet që po ngriheshin në këtë diskutim lëndonin sidomos plagët e të gjithë atyre që ishin nga zonat e përtej kufirit. Për të mos e rënduar gjendjen më tej, e mbyllëm atë me ca detyra që u dhanë në fund të saj.

Të nesërmen parade të zyrën e shtabit të batalionit tonë e vizitoi oficeri jugosllav i OZN-ës që na u paraqit me emrin Bijediç (kishim vënë re në shumë raste që nuk na i tregonin emrat e vërtetë). Ky erdhë i shoqëruar edhe nga oficeri informativ i brigadës sionë Latif Meçe “E takova rastësisht oficerin tuaj- tha Bijediçi- erdha t’ju shoh...” Pastaj ai e vërtiti bisedën e tij rrëth e rrotull deri sa erdhë te puna e gazermave që, siç tha ai, “partizanët tuaj nuk janë mësuar t’i mbajnë si duhet” dhe më tej doli në një drejtim tjetër. -Nuk e

---

1) AU, fom. Brig V.S., kutia 5, dosja 92

prisnim që të kishite edhe punë armiqësore kaq të madhe në repartet tuaja!- shtoi ai.

-Ku e kishit fjalën konkretisht?- qe pyetja nga Adem Xhaka<sup>1</sup>.

-Po ja, edhe fotografia e mareshallit në sallën e konferencave nuk ishte në vendin e vet. Ky nuk besoj të jetë ndonjë veprim pa qëllim të caktuar... do të ketë edhe gjëra të tjera... La të kuptohej sikur sëkëldia e tij më e madhe qënkej se fytyra e marëshallit na kish mbetur në faqen e murit të anës së sallës, kur ne ndryshuam sistemin e saj të brendshëm.

-Ne nuk kemi pasur kohë që të vëmë materiale tonat nëpër salla, me përjashtim të portretit të Komandantit tonë. Fotografinë e marëshallit nuk e ka prekur njeri. Prandaj na ndihmoni që t'i caktojmë më mirë gjërat!- ndërhyra unë që përgjigjesha më shumë për këto punë si komisar batalioni!

-Nejse për këtë mund të bisedojmë edhe një herë tjetër, kur të kemi më tepër kohë- i bëri bisht bisedës që kish nisur për t'u larguar nga një temë në të cilën ndoshta kish hyrë para kohe.

Më vonë, kur bajraktarët deshën të shkonin te Titua, e kuptuam se edhe Bijediçi në atë rast nuk duhej të kish ardhur as për vizitë mirësjelljeje dhe as "rastësisht", po për të nuhatur më tej e për të vërtetuar ato që i ishin raportuar nga mbledhja e ditës së mëparshme. Ai kish vepruar gjithnjë me kujdes që të mos i digjeshin "letrat" që kishte në dorë dhe kësaj deri diku ia' pat arritur gjersa agjentët e tij më pas e nxorën vetë kokën si miu nga thesi.

### ***Shovinizmi sllav në veprim***

Sipas vlerësimit të jugosllavëve edhe rrrethet shqiptare të Maqedonisë ndodheshin nën influencën e reaksionit. Pra, na duhej të ushtronim ndikimin tonë aty. Brigada e V-S me gjithë nënrepartet e saj gjatë një turneu gjatë muajit korrik 1945 shkeli fshatrat Berikovë, Novoselë, Tojna, Kolibër, Tajnisht, Bacelisht, Bardhaj- Kula etj. Në të gjitha këto rajone u bë një punë e planifikuar me pikësynime të qarta, gjë që e tregojnë edhe titujt e

---

<sup>1)Adem Xhaka, ish zv. komandant batalioni</sup>

bisedave e të konferencave që u zhvilluan si psh “Ç'i dallon e ç'i bashkon popujt tanë me njëri- tjetrin?”, “Mbi taditat e luftës së përbashkët kundër zaputesve osmanë”, “Lufta jonë e përbashkët kundër nazifashistëve - garanci barazie e lirie për të ardhmen, “Kujt mund t'i shërbejnë mëritë e vjetra midis popujve të ndryshëm?” etj.<sup>1)</sup>. Këtë detyrë atëhere e kryenim me sinqeritet e përkushtim të madh. Donim të besonim akoma se i shërbënëm një kuaze të shënjtë, pa asnjë paragjykim.

Në disa vende si në Arapi- Kula e gjetiu ku pati mundësi më shumë, u organizuan dhe aktivitete artistike të përbashkëta nga grupet tona diletante dhe ato të fshatrave. Aty ku nuk paraqitej kjo mundësi nga pala tjetër, dhanë shfaqje vetëm grupet tona. Me këtë rast sigurohej edhe grumbullimi më i madh i popullit që edhe u shfrytëzua për biseda e sqarime të ndryshme politike.

Ky turne për nga rezultatet dhe nga gjurmët që la në popull, u quajt si një nga më të sukseshmit në vargun e punës sonë për të shpurë vijën e mirëkuptimit në popullsinë e atjeshme disakombëshe.

Mbi të gjitha modeli i sjelljeve të mira të partizanëve tanë, sidomos me popullsinë jo shqiptare të atyre zonave, ashtu si gjithmonë, bëri përshtypje e zuri vend më tepër se çdo fjalë e thënë. Gjithë banorët e atyre anëve u bindën se nuk kishim vajtur atje për të shfryrë ndonjë inat kundër tyre në shenjë hakmarrjeje për krimet që qenë bërë karshi banorëve me kombësi shqiptare nga forcat e ushtrisë jugosllave që kishin vepruar më parë në ato anë.

Kjo dalje nëpër rrëthinat e Kërçovës shkallë-shkallë na i përforcoi më tepër bindjet se shqiptarët edhe këtu diskriminoheshin e përbuzeshin, se ata ishin lënë pas dore në çdo pikëpamje dhe ishin bërë objekt persektuimesh e ndjekjesh të vazhdueshme. Për këtë flasin qartë dokumentet e asaj kohe.

Qysh ditët e para të daljes në terren, më 13 korrik u hartua nga ne ky raport mbi gjendjen e atjeshme. "...Fryma e shovinizmës është shumë e zhvilluar në fshatrat ku ndodhemi... u munduam të bindnin fshatarët që të dorzonin elementët që ishin arratisur, po nuk kanë besim ndaj autoriteteve jugosllave..... populli kërkon

---

1) AU, Fom, Brig. V-S, Kutia 5, dosja 92

siguri që si i pafajshëm që është të mos dënohen siç ka ndodhur gjer tani, prandaj të "arratisurit" i mbron populli.<sup>1</sup> Këtu bëhej fjalë për ata shqiptarë që qenë larguar nga frika e raprezaljeve të egra të administratës jugosllave që qenë bërë në masë e pa dallime. Ky raport pasonte atë që kish bërë më parë shtabi i një batalioni tjeter, ku thuhej: "Ata - (shqiptarët -M.Xh) thonë se neve na shtypin jugosllavët, mirë bëtë që erdhët ju që të na shpëtoni....është më mirë të vijmë me ju se këtu do vuajmë... këtu mbretëron shovenizmi".<sup>2</sup>

Në një tjeter raport të datës 17 korrik thuhet: "Situata në komunën e Zajazit nuk është e mirë, këta ( shqiptarët -M.Xh) e quajnë veten të okupuar e jo të çliruar se nuk i gjëzojnë të drejtat e tyre si gjithë të tjerët".<sup>3</sup> Disa ditë më pas raportohej: "Të arratisur ka mjaft, qëndrojnë nëpër çeta të vogla.. populli mban një qëndrim formal nga frika po nuk është i qartë në luftën dhe në qeverinë (jugosllave - M.Xh)... punë nuk bëhet me ta dhe sidomos në katundet shqiptare"<sup>4</sup>. Përbajtje të përaferta me këto mund të citojmë edhe në të gjitha raportet e tjera që përshkruajnë gjendjen e rëndë të shqiptarëve në tokat e tyre përtet kufirit. Por megjithëatë ngjante sikur të gjitha sinjalizimet tona binin në vesh të shurdhër, asnje reagim s'bëhej nga autoritetet kompetente!

Nga të gjithë sa u tha më sipër ishte e natyrshme që atje ku shkelnin forcat tona çdo gjë niste nga e para, qetësohej gjendja dhe fillonte një farë normalizimi i situatës. Sapo ne largoheshim e gjithçka mbetej në dorë të jugosllavëve, situata acarohej përsëri, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme.

Kjo që po konstatonim në rrethet e Kërçovës nuk ishte e re për ne, ajo qe një përsëritje më bindlëse për ato që kishim konstatuar edhe në zona të tjera ku kishim kaluar më parë, në të gjitha viset e shqiptarëve të atjeshëm. E gjithë kjo i ngjante asaj lojës së fëmijëve që, kur njeri diçka e ndreq tjetri, për hir të kapriços, shkon dhe e prish, kurse të mëdhenjtë bëjnë sehir.

1)AU Fon. Brig. V-S, Kutia 5, dosja 92

2) Po aty kutia 6, dosja 130.

3)AU, Fon. Brigadës V-S, kutia 6, dosja 130

4) Po aty kutia 5, dosja 92

## ***Me mendje e zemër në Shqipëri***

Po bëhej një kohë e gjatë që ishim larguar dhe malli na kish marrë shumë. Kisha gati dy vjet pa patur asnje lidhje me familjen. Letrat as shkonin, as vinin. Vetëm në mezin e nëntorit 1945 babai kishte marrë një letër timen bashkë me 100 napolona (monedhe e kohës) nga rrugat që na erdhën edhe neve aty. Ish ndodhur pikërisht një ditë pazari, kur babai kishte nxjerrë për të shitur edhe një kalë që i pat shpëtuar nga lufta.

Megjithëse familjarët e mi nuk kishin pranuar haptaz të pajtoheshin me mendimin e përgjithshëm, sipas të cilit djali i tyre ishte vrarë, por në fakrt edhe shitja e kalit duhej bërë për shpenzimet e pritëshme, apo të merej konformimi zyrtar i asaj që nuk iu a thoshte goja e nuk iu a donte zemra.

“Ardhja e letrës s’ate e ktheu gjithëshka në anën tjetër- më shkruante babai ndër të tjerë në përgjigjen që mora më pas - Tmerri e frika për hapjen e kujës që pritej në shtëpinë tonë nga çasti në çast, u zëvendësua prej gjëzimit e harresë që shkaktoi “ringjallja” jote, bile as kalin nuk e shëtimë më, po na duket akoma e pabesueshme sa te të shohim me sy” - përfundonte ai plot mall në emër të të gjithëve.

Gjatë qëndrimit në gazermat e Kërçovës, dëshirat tona për ta parë Shqipërinë sà më parë u bënë më të flakta. Në çdo takim e bisedë me shoku - shokun fjala vërtitej gjithnjë rreth Shqipërisë, që tani kish nisur një luftë tjetër në disa fronte: nga njëra anë rindërtimin e shkatërrimeve që i kish lënë pas armiku, nga ana tjetër për të fituar të drejtat prej fuqive të mëdha të cilat akoma nuk po e njihnin qeverinë e re të dalë nga lufta.

Demonstratat e fuqishme që zhvilloheshin në të katër anët e Shqipërisë, drejtuar misioneve të huaja diplomatike për të na njojur qeverinë e sapodalë nga lufta dhe për të na dorëzuar kriminelët e luftës, kishin përfshirë edhe garnizonin tonë aty, jashtë kufijve të Atdheut.

Kur Radio -Tirana apo ndonjë gazetë njoftonte se “5000 vetë demonstrojnë nëpër rrugët e Vlorës me parrulat: “Kriminelët e luftës para gjyqit!”- Populli u kërkon misioneve aleatë dorëzimin

e kriminelëve të arratisur...”<sup>1</sup> “Në Shkodër gjenerali Hodson pritet me demonstrata nga populli që kërkon njojjen e qeverisë demokratike dhe të drejtat e Shqipërisë”<sup>2</sup>. “Më tepër se 6000 vetë në Berat dhe 3000 veta në Elbasan demonstrojnë duke thirrur: “Drejtësi”!<sup>3</sup> etj.

Në të gjitha këto raste, repartet tona dilnin spontanisht nëpër sheshe, ku zhvilloheshin mitingje dhe marshonin nëpër rrugët e qytetit, apo të fshatit, ku ndodheshin, kundër zvarritjeve që na bëheshin nga ish aleatët. Në këto manifestime zakonisht përfshihej edhe një pjesë e madhe e popullit jugosllav të atjeshëm, përvëç atyre me kombësi shqiptare që qëndronin pa u ndarë e në të njëjtën vijë me ushtarët tanë.

Më së fundi gazeta e xhepit “Grushti”<sup>4</sup> do të njoftonte: “Një lajm i madh u hap në të gjithë brigadën. Mortajat, topat dhe pushkët po buçitnin, zjarri i armëve dilte si rrufeja nga grykët e tyre dhe përcillte larg oshëtimën e lajmit, anembanë qytetit (Kërçovë)...një lajm madhështor...Qeveria Demokratike e Shqipërisë u njoh nga aleatët e mëdhenj...I gjithë populli që u bashkua me ne brohoriste për qeverinë tonë” Pra mendja e efektivave tona punonte vazhdimisht pranë Mëmës Shqipëri dhe zemrat e ne të gjithëve rrihnin me pulsin e tërë Atdheut.

### ***Gëzim e brengosje***

Sipas urdhërit të Komandës sonë të Përgjithshme, duheshin marrë të gjitha masat për përgatitjen e nisjes, njoftoi komandanti i brigadës Dane Mehmeti në njerën nga ditët e fundit të dhjetorit 1945.

Njera nga masat më të rëndësishme të përgatitjes sonë për nisje ishte puna që duhej të bënim me atë pjesë të efektivave që ishin nga krahinat shqiptare përtej kufirit e që me këtë rast duhej të ktheheteshin në familjet e tyre (ata që kishin mbaruar detyrën

---

1)Gazeta “Bashkimi ”Nr.37, 3 shkurt 1945

2) Po aty Nr.105

3) Po aty, Nr.38, dt.4.2.1945

4)AU, Fon.Brigadës V.S.kutia 1, dosja 131m gazeta “Grushti”

ushtarake ose ishin të moshuar e kishin ardhur në reparte tona si vullnetare); do të inkuadroheshin në formacionet e ndryshme të Ushtirisë Jugosllave (ata që nuk e kishin plotësuar shërbimin ushtarak). Në çdo rast ata do të ndaheshin nga ne dhe kjo ishte vështirësia kryesore që duhej të përballonim.

Kishim luftuar e jetuar për një kohë të gjatë së bashku me vëllezërit tanë të këtyre krahinave, i përfytyronim deri diku vështirësitë që paraqiteshin për t'i ndarë ata nga ne dhe nga brigada e tyre, por jo në shkallën e duhur. Kjo paraqitej më e vështirë kur dihej mirë se një pjesë e këtyre bashkatdhetarëve e kishte "shijuar" çorbën e reparteve jugosllave dhe ishte larguar prej tyre në mënyrën që dihej.

Çështja u shtrua hapur dhe u kërkua që të ndihmonin të gjithë për zgjidhjen e këtij problemi serioz jo vetëm nga ana ushtarake por edhe nga ajo politike. I pari që e mori fjalën pas komunikimit të vendimit ishte luftëtari nga Kosova J.O.i cili ndërmjet të tjera tha:

-Edhe unë komunist internacionalist jam, ashtu siç u tha këtu, po para së gjithash jam shqiptar dhe anëtari i Partisë Komuniste Shqiptare...Pra nuk do të pranoja kurrë që partinë time dhe Kombin Shqiptar ta këmbej me këdoqoftë tjetër...

Shprehjet e tij kaq të vendosura bënë përshtypje edhe tek të tjerrët. Siç po i vihej re, nga lëvizjet që bënin prej padurimit edhe ata ishin gati që të bënin të njëjtin pohinr.

Në fund, kur kosovarët ishin të detyruar që të vepronin ashtu siç u thuhet, përsëri u mbeti koka nga ne. Shprehën hidhërimin e dhimbjen që ndjenin nga kjo ndarje në mënyra të ndryshme:- Nuk shihnim rrugë tjetër, ndaj e pranuam ndarjen.... thia skuadërkomandanti nga rrëthet e Gostivarit, L.P.

-Do ta provojmë edhe këtë herë drejtësinë komuniste të këtyre, meqë na këshilloni ju...- tha I.M. nga anët e Pejës etj.

Sa herë që më vijnë në kujtesë çastet e ndarjes me vëllezërit e atjeshëm, më ngjan se jam akoma i pushtuar nga përqafimet e puthjet vëllazërore të atyre djemve e burrave të fuqishëm. Ata kishin formuar një rresht të gjatë që nga gazermat e Kërçovës e gjer tek stacioni i trenit për në Strugë nga do të niseshim. Kjo

ishte një përcjellje dhe një ndarje e pazakonshme. "Po ndahemi pa dëshirën tonë e kjo si s'ka si të mos shkaktojë dhiimbje"- tha Sh.D. në çastin që mezi u shkëput nga krahët e mi kur po largoheshim. U përshëndeta i fundit me të, prandaj më mbetën të ngulitura si gozhdë fjalët që tha ai.

Deri në minutën e nisjes na ishte dukur e pabesueshme se mund të krijuheshin çaste aq prekëse. Trimave që nuk u qe trëmbur syri nga asnjë armik tani u dridhej mjekra e u ziheshin fjalët në grykë nga sedra burrërore për të mos u treguar të ligështuar. Çasti i ndarjes erdhi për të dyja palët, me atë dhiimbje që shkakton ndarja e mishit nga thoi. Kjo e errësoi deri në një farë shkalle edhe gjëzimin e madh që kish ngjallur lajmi i kthimit tonë në Shqipëri.

U larguan duke marrë me vete nëpërmjet fjalëve, miimikave dhe syve të tyre urimet: "Rrugë të mbarë e ta gjëzoni Shqipërinë e lirë!", "Të rrojë sa vetëjeta Shqipëria jonë e dashur!" "Zemrat tona do të rrahin për jetë me tuajt!".., "Përshëndetje të gjithëve!"...

Atë ditë gjithë populli i Kërçovës e i fshatrave përreth kishte dalë i téri në rrugë. Ai na përcollti me shumë nderime e dashuri. Gjatë afro 7 muajve që qëndruam aty, ishte mësuar me ne. Lufta jonë e sinqertë në ndihmë të tyre dhe sjelljet tona miqësore atje, kishin ngjallur tek ata dashuri e respekt karshi nesh. Shumë prej tyre me njérën dorë na përshëndetnin, me tjetrën fshinin lotët.

Atmosferën miqësore që kishin krijuar qëndrimi dhe lufta e partizanëve shqiptarë në Jugosllavi, ndërmjet tyre dhe popujve të atjeshëm nuk na i merrte mendja se do të kthelhej aq shpejt në drejtim të kundërt. Kjo rriddhte nga besimi që kishim ndaj idealeve të lirisë e të demokracisë të cilat ishin motoja e luftës sonë. Ndërkohë mendonim se edhe jugosllavët do t'u qëndronin besnikë prentimeve të tyre të bujshme lidhur me këto ideale.

Në vargun e demagogjive të tjera të udhëheqjes shoviniste jugosllave radhitet edhe shpallja e dekorimeve të një pjese kuadrosht tonat me medaljet: "Ylli partizan", "Urdhëri i Bashkim-Vëllazërimit" dhe "Medalja e çlirimt", diktuar kjo ndoshta edhe nga presioni i opinionit populor të atjeshme që në shenjë mirënjojje, me të drejtë kërkonin përfjetësimin e rolit historik të

luftëtarëve tanë në Jugosllavi, për çlirimin e atij vendi dhe për krijimin e urave të miqësisë ndërmjet dy popujve tanë.

Por siç u pa, këto "ura" miqësie ndërmjet Shqipërisë që drejtohej nga një ekip i tejetur për pushtet absolut dhe Jugosllavisë titiste, të dominuar prej psikologjisë shoviniste ekstreme serbosllave, nuk mundën t'u qëndrojnë provave. Ato u këputën shpejt nën presionin e konjukturave të kohës dhe të megalomanisë titiste, kështu që padrejtësish u kthyen prapa edhe dekoratat e akodruara çka se ato nuk ishin dhuratë zemërgjerësie e ndokujt, por vetëm një pjesë fare e vogël e meritës së madhe të luftëtarëve shqiptarë që nuk kursyen as jetën për t'iu ardhur në ndihmë fqinjëve të tyre veriorë.

Për të vlerësuar drejt ndihmesën dhe kontributin e Ushtrisë NÇL Shqiptare për çlirimin e Jugosllavisë, do të ishte i mjaftueshëm qoftë edhe vetëm shembulli i Brigadës së V.S me efektivin e saj i cili varionte gjatë fazave të ndryshme të luftimit nga 2500 deri 3000 trupa dhe veproi në kuadrin e dy divizioneve shqiptare që luftuan pertej kufirit.

Ajo, pas përrurimit të saj që ishte bërë në qëndër të Labërisë dhe u kalit në beteja të ashpra me pushtuesit e huaj e bashkëpunëtorët e tyre vendas, e vazhdoi "vallen" e betejave fitimtare që nga brigjet e detit Jon e gjer në kufitë jugëlindore të Bosnjës. Një rrugë luftarakë kjo prej rrith 2900 kilometresh, duke kaluar mbi 700 ditë në përleshje aktive, ku nxorri jashtë luftimit mbi 5000 armiq dhe la në fushat e betejave 356 luftëtarë nga më të mirët, 141 prej të cilëve në tokat jugosllave.

Faktet historike lidhur me qëndresën e popullit shqiptar gjatë Luftës ANÇL, brenda dhe jashtë kufive të Atdheut të vet, janë kurora të reja lavdie për këtë popull që u shtohen traditave tonë më të mira e që do të frymëzojnë edhe brezat pasardhës.

# Përbajtja

NË VEND TË HYRJES .....	3
NGA VITI 1942.....	5
I. IDETË QË NGRITËN STUHINË .....	5
Nga propaganda në veprime konkrete, efektet e para të thirrjes së PKSH për luftë kundër pushtuesve; hovi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe popullariteti i saj. ....	5
Kontakti i parë .....	5
Leximi i traktit .....	7
28 nëntor .....	8
Jehona e 28 nëntorit.....	11
Dy sihariqe .....	15
Një postë e veçantë .....	17
Tek prefekti .....	17
NGA VITI 1943 .....	22
II. FORMACIONET PARTIZANE NË VEPRIM .....	22
Aksionet me armë në shkallë të gjerë. Forcimi i lidhjeve të partizanëve me popullin, kapitullimi i pushtuesve fashistë. ....	22
Aksioni i parë me armë .....	22
Armiku shpartallohet plotësisht .....	25
Pëllëmbë e plumb .....	27
Nga ngrrohtësia e një nëne .....	30
Përtëritje kujtimesh .....	33
Malli që djeg për vendlindjen .....	36
Lufta na njeh me njeri-tjetrin .....	44
Kolona e pestë .....	46
“Dora e Zezë” .....	50
Garnizoni fashist hedh armët .....	53

<b>III. BALLAFAQIMI ME PUSHTUESIT E RINJ GJERMANË .....</b>	<b>55</b>
Nga përpjekjet me nazistët gjermanë; vetëdemaskimi i “Ballit Kombëtar” si bashkëpunëtor i pushtuesit; fillimi i operacionit të dimrit 1943-1944. ....	55
Përpjeka e parë me nazistët gjermanë .....	55
Prova e tretë. ....	56
Partizanë e popull në një llogore. ....	57
“U shqye fshati në gaz” .....	58
Vullneti e mposht moshën .....	62
Babai i lë amanet djalit .....	64
“Lufta kërkon sakrifica dhe heronj” .....	66
Nga beteja në betejë .....	69
Nëna ia bën hallall sisën birit të saj .....	72
Mbrohemë duke sulmuar.....	73
Bishti i derrit .....	77
“Kafshatën e parë partizanëve” .....	79
<b>NGA VITI 1944 .....</b>	<b>83</b>
<b>IV.NGA BRAMYSHJA NË PËRMET .....</b>	<b>83</b>
Dita e përrimit të Brigadës VS; nga luftimet gjatë operacionit të dimrit 1943-1944, grimca nga bashkëveprimi në luftë me misionarët e aleatëve të mëdhenj; zgjerimi i zonave të çliruara. ....	83
Përrimi i Brigadës .....	83
“Mos pyesni për shtëpitë tonal!” .....	86
Shkatërrimi i urës .....	89
Goditje nga pas shpine .....	91
Bllokimi në shpellë .....	92
Çarja e bllokimit .....	94
“Gryk’ e Kuçit, gryk’ e keqe...” .....	97
Historia e mustaqeve të qethura .....	98
Marrja e Kalasë .....	100
Me Memo Meton2 .....	101
Asgjësimi i kriminelit .....	104
Demoralizimi i armikut .....	107
Në gjirin e popullit .....	110
Raste bashkëveprimi me aleatët .....	112
Pushka duhej shtrënguar fort .....	114
“... Sakrificë mbi vdekjen s’ka” .....	115

V. DREJT ÇLIRIMIT TË PLOTË TË ATDHEUT .....	117
Sigurimii punimeve të Kongresit; në ndjekje të pushtuesve të huaj e bashkëpunëtorëve të tyre vendas; nga luftimet për çlirimin e Shqipërisë së Mesme; asgjësimi qëndresës gjermane dhe i bajraktarëve reaksionarë në veri .....	117
Në mbrojtje të Kongresit .....	117
Armiku befasohet .....	118
Nga ndihma e një fëmije .....	119
*** .....	120
Kalimi i Shkumbinit .....	120
Ai që shpëtoi nga mbytja .....	122
“Djali do të kthehet nga lufta bashkë me lirinë” .....	123
*** .....	126
Duhej kapërcyer edhe një pengesë si kjo! .....	126
Endrra e misrit .....	128
Marrja e Korabit .....	129
“Opingat e kapidanit” .....	130
Maska e bajraktarit... .....	132
Tradhëtia e hapur e bajraktarit të Lumës .....	135
VI. ME FLAMURIN E LIRISË NË KOSOVË .....	137
Nga pritja e përzemërt e popullit kosovar, pjesëmarrja e tij aktive në Luftën ANÇL; mbi luftime për çlirimin e Kosovës .....	137
“Vllaznia e Moçme” .....	137
Zgjedhja e Këshillit NÇL .....	141
Një përpjekje e pasuksesshme .....	142
Shtohet edhe një luftëtar .....	144
Okupatori mbledh rraqet: .....	148
Ustai i la shërbëtorët në baltë .....	150
Qyteti që çlirohet pa luftë. .....	152
S’iu besohet jugosllavëve .....	154
Në vend të armiqve-shokë e vëllezër .....	155
Hendek në thellim .....	157
NGA VITI 1944-1945 .....	160
VII. NË NDIHMË TË POPUJVE TË JUGOSLLAVISË .....	160
Akte të larta guximi e trimërie gjatë ndjekjes së pushtuesve nazi-stë . Spastrimi i zonave të gjëra nga cetnikët e Mihajloviçit. Mirënjohje për misionin tonë nga popujt e atjeshëm .....	160
Një baba që kërkon djalin .....	160

Akte të larta guximi, gjier në vetmohim .....	163
Urdhër i papritur .....	166
“Gjyqi” i kriminelëve .....	170
Mirënjohe ndaj nesh nga populli i atjeshëm .....	171
Lufte edhe me tifon .....	174
<b>VIII. RIKTHIMI NË KOSOVË .....</b>	<b>177</b>
Shenja genocidi të shfrenuar • përballë faktesh që akuzojnë	
• mosbesim dhe urretje nationale • shovenizmi sllav- në veprim	
• me mendje e zemër në Shqipëri .....	177
Me mendje tek shokët që “lamë” prapa .....	177
Shtëpia kish mbetur pa zot .....	178
Fakte që akuzojnë .....	180
Presion i padurueshëm .....	182
Pohime konfidenciale .....	185
Agjentura e huaj në radhët tonë .....	187
Shovinizmi sllav në veprim .....	190
Me mendje e zemër në Shqipëri .....	193
Gëzim e brengosje .....	194
<b>PËRMBAJTJA .....</b>	<b>198</b>



Muharrem Xhufi  
Kosovë, 1944

**ndryshme, kryesishit në Ministrinë e Mbrojtjes; mban 11 dekorata lufte e shërbimi, perfshi edhe dy urdhëra të Skënderbeut. Gjatë karierës së tij nuk u konformua me disa politika të ditës; u nxuar në lirim para kohës së pensionit me gradën e kolonelit në rezervë; ndjek me preokupim zhvillimet në vend e përreth.**

Lindi në Progonat më 10 maj 1921; mësimet e para i mori në vendlindje; pjesëmarrës aktiv në Luftën ANÇ; diplomuar për shkenca humanitare dhe art ushtarak në akademinë "Lenin" të Moskës; punoi në institucione të

**Kalendar ditësh të zjarra MUHARREM XHUFİ**

albin a.0000 Tirana, 1997